
PËRGJEGJËSIA PENALE NDËRKOMBËTARE

Kandidatja- Arta B. Mehmeti Ademi

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale, Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës
në Shkencat juridike, profili penal, për marrjen e gradës “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr Xhezair Zaganjori

Numri i fjalëve: 91,104

Tiranë, Shkurt 2017

TEMË DISERTACIONI

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj që ky studim është puna ime dyvjeçare e kërkimit për disertacion të doktoraturës dhe punim i cili nuk është i botuar në asnjë titull, artikull dhe në asnjë universitet. Unë më tej deklaroj se kam marrë autorizimin e nevojshëm dhe pëlqimin për të kryer këtë studim.

ABSTRAKT

Përgjegjësia penale ndërkombëtare nënkupton përgjegjësi penale për të gjithë ata persona, cilëdo qofshin ata, shtetërorë ose ushtarakë, që kryejnë veprime të kundërligjshme, veprime që, sipas dispozitave të së drejtës penale ndërkombëtare, janë të inkriminuara dhe të sanksionuara si krime ndërkombëtare.

Për konsolidimin e nocionit të krimeve ndërkombëtare dhe të përgjegjësisë penale ndikuan shumë faktorë që, për shtetet në bashkësinë ndërkombëtare, luajtën një rol vendimtar në përcaktimin dhe në ngritjen e një niveli të pranueshëm të këtij nocioni.

Pranimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare deri vonë ishte i papranueshëm dhe shumë i diskutueshëm nga ana e shteteve.

Diskutimi dhe aplikimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare u bë pas përfundimit të LPB-së, ku fuqitë aleate, me nënshkrimin e Traktatit të Paqes së Versajës, u zotuan se do të përgjigjen për krimet, po kështu dhe personat, të cilët gjatë zhvillimit të LPB-së shkelën rëndë ligjet dhe zakonet e luftës, do të ndëshkohen. Pas marrëveshjes së Londrës u vendos themelimi i Tribunalit të Nurembergut, dhe më vonë themelimi i Tribunalit të Tokios me qëllim gjykimin e kriminelëve nazistë.

Pas një periudhe të gjatë, kur përfundoi puna e këtyre dy Tribunaleve, të krijuara pas LDB-së, u krijuan Tribunali i Hagës dhe Tribunali i Ruandës, në dallim nga Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios, që u krijuan me anë të marrëveshjes, Tribunali i Hagës dhe i Ruandës u krijuan me anë të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Krijimi i këtyre dy Tribunaleve luajti rol vendimtar në përforcimin e idesë për krijimin e një gjykate të përhershme, me juridiksion ndjekjen penale dhe gjykimin e personave të cilët, në çfarëdo kohe dhe në çfarëdo vendi, kryejnë krime ndërkombëtare.

Dhe, pa dyshim, në procesin e gjatë të konsolidimit të përgjegjësisë penale, krijimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është ngjarja që në mënyrë përfundimtare zgjidhi çështjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: përgjegjësia penale, krimet ndërkombëtare, tribunalet

ABSTRACT

International criminal responsibility implies criminal responsibility of persons in any state or military capacity they may be , who commit illegal acts, acts which under the provisions of international criminal law are incriminated and sanctioned as international crimes. The consolidation of the notion of international crimes and criminal responsibility, has influenced many factors that played a crucial role in determining and establishing an acceptable level for the States in the international community. The acceptance of international criminal responsibility by the states until recently was unacceptable and very controversial .The international criminal responsibility was made after the end of IPR, where the allied powers with the signing of the peace treaty of Versailles, vowed to respond that those persons who during the development of IPR violated severe laws and customs of war will be punished . Real application of international criminal responsibility was made after the end of WWII, with the agreement of London it was set the foundation of Nuremberg Tribunal for the trial of Nazi criminals and the subsequent establishment of the Tokyo Tribunal. After a long period , after the completion of the work of the two Tribunals established after World War II, the Hague and Rwanda Tribunals were established, which unlike the Nuremberg and Tokyo Tribunals that were created by the agreement, the Hague and Rwanda Tribunals were created by resolutions of the Security Council of the UN. The creation of these two Tribunals had a decisive role in strengthening the idea of establishing a permanent court that will have jurisdiction for the prosecution and trial of persons who at any time and in any place commit international crimes. And certainly in the long process of

consolidation of criminal responsibility, the creation of the International Criminal Court is the event which definitively chose the issue of international criminal responsibility.

Key words: criminal responsibility, international crimes, tribunals

DEDIKIMI

Këtë disertacion ia dedikoj yllit më të ndritshëm, djalit tim për mungesën gjatë kohës që i përkushtohesha disertacionit të doktoraturës...

FALËNDERIM

Në këtë udhëtim të gjatë të punimit të disertacionit, jam me fat falë disa individëve të mrekullueshëm, të cilët më mbështetën në çdo kohë; për këta individë fjalët, mirënjohjet dhe falënderimet nuk do të jenë të mjaftueshme për t'ua përcjellë.

Dituritë dhe aftësitë analitike, të shprehura në këtë punim, nuk do të ishin të këtij niveli pa ndihmën e profesorit dhe udhëheqësit tim, për të cilin kam një mirënjohje të veçantë, Prof. Dr Xhezair Zaganjori, të cilit ia dedikoj një falënderim të veçantë për ndihmën e palodhshme që më ka ofruar në çdo kohë derisa e ndërtova këtë punim.

Udhëtimi i studimit tim është rezultat i besimit të familjes sime, e në veçanti besimi i bashkëshortit tim, i cili për këtë kohë më mbështeti dhe mbajti një pjesë të përgjegjësisë të mia.

Shkurtesat

OKB – ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA

KS I OKB-së – KËSHILLI I SIGURIMIT I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

GJPN – GJYKATA PENALE NDËRKOMBËTARE

TPNJ – TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË

TPNR – TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR RUANDËN

LPB – LUFTA E PARË BOTËRORE

LDB – LUFTA E DYTË BOTËRORE

NPK – NDËRMARRJA E PËRBASHKËT KRIMINALE

PËRMBATJA:

KAPITULLI I	1
1.1. Shtrimi i problemit.....	1
1.2. Qëllimi	9
1.3. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore	12
1.4. Metodologjia dhe metodat e studimit.....	14
1.5. Rëndësia e studimit	17
1.6. Kufizimet e studimit	18
1.7. Përmbledhja dhe strukturimi i punimit.....	18
KAPITULLI II: EVOLUIMI I Përgjegjësisë penale ndërkombëtare	20
2.1. Historiku i së drejtës penale ndërkombëtare dhe i përgjegjësisë penale ndërkombëtare ...	20
2.2. Përgjegjësia e shteteve	25
2.3. Burimet e së drejtës ndërkombëtare penale	31
2.4. Konventat për krimet e dënueshme ndërkombëtare.....	33
2.5. E drejta zakonore.....	37
2.6. Parimet e përgjithshme të së drejtës penale të pranura nga bashkësia ndërkombëtare ...	39
2.7. Vendimet gjyqësore.....	40
2.8. Mendimet e ekspertëve ose doktrina e së drejtës ndërkombëtare.....	41
Kapitulli III: Tribunalet Ndërkombëtare <i>ad-hoc</i> dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare	43
3.1. Nocioni	43
3.2. Tribunali i Nurembergut dhe Tokios.....	45
3.3. Tribunali i Hagës dhe Ruandës	54
3.4. Tribunali i Hagës	55
3.5. Tribunali për Ruandën	62
3.6. Mekanizmi për Tribunalet Penale Ndërkombëtare	66
3.7. Gjykata Penale Ndërkombëtare	69
Kapitulli IV: Organizimi dhe funksionimi i gjykatave	75
4.1. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Nurembergut	75
4.2. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Tokios	94
4.3. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Hagës.....	106

4.3.1. Analizë e shkurtër e procedurës së zhvilluar para TPNJ-së ndaj Ramush Haradinajt, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj.....	119
4.4. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Ruandës.....	143
4.5. Mekanizmi për Tribunalet Penale Ndërkombëtare	158
4.6. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare.....	178
4.6.1. Situata dhe rastet para GJPN-së	225
KAPITULLI V: Juridiksioni.....	250
5.1. Nocioni	250
5.2. Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare	255
5.2.1. Parimi i territorialitetit	258
5.2.1.1. Territori shtetëror	259
5.2.1.2. Vendi i kryerjes së veprës penale.....	260
5.2.1.3. Parimi i flamurit dhe parimi i regjistrimit	261
5.2.2. Parimi real	262
5.2.2.1. Parimi i personalitetit aktiv.....	263
5.2.2.2. Parimi i personalitetit pasiv	264
5.2.2.3. Parimi universal.....	265
5.2.2.4. Parimi i juridiksionit përfaqësues.....	265
5.3. Juridiksioni primar dhe plotësues.....	267
Kapitulli VI: Nocioni i krimeve ndërkombëtare.....	270
6.1. Krimet ndërkombëtare të parapara me Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.....	270
6.2. Krimi i gjenocidit.....	275
6.3. Krimet kundër njerëzimit	278
6.4. Krimet e luftës	282
6.5. Krimi i agresionit.....	292
6.6. Terrorizmi si krim i veçantë kur kryhet në kontekstin e luftës.....	300
KAPITULLI VII: PËRFUNDIME dhe rekomandime.....	310
Literatura	330

KAPITULLI I

1.1. Shtrimi i problemit

E drejta ndërkombëtare ose siç e quajnë ndryshe e drejta e popujve është tërësia e rregullave mbi të drejtat dhe mbi detyrimet që ekzistojnë midis shteteve dhe popujve.

Nevoja e respektimit të disa rregullave dhe normave nga ana e shteteve është e vjetër dhe një detyrim i tillë daton qysh me ekzistimin e shteteve të para.

Respektimi i rregullave të së drejtës ndërkombëtare nga ana e shteteve është i lidhur ngushtë me sovranitetin. Meqë në kohët më të hershme sovraniteti është menduar si diçka absolute dhe si rezultat i një qasjeje të tillë është menduar që shteteve sovrane nuk mund t'u vishet asnjë lloj përgjegjësie për veprimet e bëra (Gruda,2007:136), botëkuptim ky që, me kalimin e kohës, është hedhur poshtë, dhe është pranuar përgjithësisht qëndrimi se shteti mund të ushtrojë dhe të gëzojë sovranitetin e tij, vetëm deri në atë masë sa të mos i shkaktojë dëm të tjerëve.

Nëse në të kaluarën, përgjegjësia juridike ndërkombëtare e shteteve është shtrirë vetëm në konstatimin e shkakut të dëmit dhe eventualisht kompensimit të tij, në kohët bashkëkohore ky qëndrim ka ndryshuar skajshmërisht, dhe tani kjo përgjegjësi shkon shumë më larg.

Tashmë ekzistojnë mënyra dhe mekanizma ndërkombëtarë, të cilët i detyrojnë shtetet që të sillen në një mënyrë të caktuar.

Për ngritjen e përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare si dhe konventat e shumta që janë miratuar me qëllim humanizimin e veprimeve gjatë zhvillimit të luftërave, përmes të cilave synohej futja e elementeve njerëzore edhe gjatë luftimeve me armë dhe mbrojtja e dinjitetit dhe jetëve të njerëzve (“Jeta Juridike”, Marika&Zaganjori,vol.1:74), e me këtë edhe mposhtja e parimit se qëllimi i luftës është arritja e fitores dhe përdorimi i çfarëdo mjeti është i lejuar.

Shtetet, si subjekte juridike, e ushtrojnë sovranitetin e tyre brenda territorit shtetëror si edhe ndaj njerëzve të cilët jetojnë në atë territor shtetëror. Mirëpo, veç kësaj, shteti si subjekt juridik përveç marrëdhënieve, të cilat i zhvillon brenda territorit të tij shtetëror, e ka të patjetërsueshme që të mbajë marrëdhënie dhe të ndërveprojë edhe me subjektet e tjera, qofshin ato persona juridikë ose fizikë, prandaj, pikërisht në këtë pikë, paraqitet nevoja e kufizimit të sovranitetit shtetëror, sepse shteti si subjekt juridik nuk gëzon vetëm të drejta, por ka edhe detyrime.

Globalizimi dhe trendi, gjithnjë në rritje, i zhvillimit të teknikës, teknologjisë dhe komunikimit, e ka shtuar edhe më tepër nevojën e ndërveprimit më të afërt si të njerëzve ashtu edhe të shteteve; mobiliteti dhe mundësitë e krijuara, si rezultat i këtyre zhvillimeve të hovshme tekniko-teknologjike, e kanë shtuar edhe më tepër nevojën e ekzistimit të rregullave të gjithëpranuara ndërkombëtare, rregulla që do të vlejné dhe do të respektohen nga të gjithë, e si rezultat i kësaj do të lehtësoheshin në masë të madhe marrëdhëniet midis njerëzve dhe shteteve.

Mirëpo, përveç të mirave dhe përparësive, që sjellin trendet e zhvillimit global, ato sjellin edhe veprime kriminale të cilat kanë qenë gjithmonë dukuri shoqëruese negative të zhvillimit të shoqërisë.

Përderisa brenda një territori shtetëror aplikohet e drejta ndaj njerëzve, që jetojnë brenda atij territori shtetëror edhe marrëdhëniet juridike zhvillohen kryesisht midis personave fizikë dhe juridikë, ndërsa në të drejtën ndërkombëtare situata është ndryshe për arsye se edhe këtu zhvillohen dhe aplikohen marrëdhëniet juridike, por me një dallim qenësor të subjekteve të cilave u adresohen ose i përkasin këto marrëdhënie juridike; gjegjësisht janë shtetet ato që krijojnë të drejtën dhe njëkohësisht ato janë edhe aktorët kryesorë të respektimit të saj.

E drejta krijohet nga shteti, prandaj qytetarët janë të detyruar t'i binden dhe ta respektojnë atë rregullim të caktuar juridik, kurse në të drejtën ndërkombëtare shtetet edhe e krijojnë të drejtën, por njëkohësisht edhe janë të detyruara ta respektojnë atë. Dhe pikërisht për këtë arsye situata është paksa më e ndërlikuar për sa i përket konsolidimit dhe zbatimit të rregullave ndërkombëtare të çfarëdo karakteri ose natyre qofshin ato.

Qysh prej fillimit të ekzistimit të shteteve filluan të bashkekzistojnë edhe rregulla të caktuara për veprimin e shteteve në raport me të tjerët. Shtetet, fillimisht, veprimet e tyre në arenën ndërkombëtare i kanë mbështetur në të drejtën zakonore, duke vazhduar më pastaj me lidhjen e marrëveshjeve të ndryshme dypalëshe dhe shumëpalëshe me anë të të cilave shtetet janë të detyruara të sillen në një mënyrë të caktuar derisa të arrijnë te kodifikimi i

rregullave të caktuara juridiko-ndërkombëtare si dhe te garantimi i respektimit dhe zbatimit të tyre me masa represive dhe sanksione.

Duke i hedhur një vështrim evolucionit të së drejtës ndërkombëtare dhe zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare mund të shohim se procesi i vetëdijesimit të shteteve dhe i pranimi të realitetit ka ecur shumë ngadalë. Ashtu sikurse brenda shteteve, ku ekziston një rregullim i caktuar juridik, po ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare është e patjetërsueshme që të ekzistojë një rregullim i tillë me qëllim që të funksionojë si duhet rendi botëror dhe, pas pranimi të këtij realiteti, vjen në konsideratë pranimi i realitetit tjetër: që kush në emër të shteteve duhet të mbajë përgjegjësi. Është e mirënjohur se shtetet janë subjekte juridike të përbëra nga një numër i caktuar personash fizikë, gjegjësisht njerëz, të cilët, në emër të shtetit dhe për llogari të tij, ndërmarrin veprime të ndryshme. Shteti nuk është një nocion abstrakt, por është diçka e krijuar prej njerëzve dhe prej këndej, rrjedhshmërisht, na paraqitet nevoja e përgjegjësisë së personave që në emër të shtetit dhe për interesa të tij ndërmarrin veprime të cilat janë në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

Meqenëse, e drejta ndërkombëtare si nocion është gjithëpërfshirës dhe në vetvete ngërthen të gjitha marrëdhëniet juridike ndërkombëtare tek të gjitha formacionet e mundshme të paraqitjes, është e nevojshme ta theksojmë që shteti, si subjekt juridik, në disa prej tyre, mban përgjegjësi kryesisht deri në masat dhe represionet e ndryshme që mund të aplikohen ndaj tij dhe ndaj personave fizikë, që në emër të shtetit dhe për llogari të tij kryejnë veprime kriminale. Këta persona përgjigjen penalisht për këto veprime, edhe pse këto veprime kriminale i kanë kryer nën mburojën e shtetit dhe për mbrojtjen e “interesave” të tij.

Vënia para përgjegjësisë juridiko-penale edhe e këtyre personave që, nën arsyetimin e mbrojtjes së të ashtuquajturave interesa shtetërore, kanë kryer veprime kriminale, është një arritje shumë e madhe e së drejtës ndërkombëtare.

Për veprimet që shkaktojnë të këqija, që konsiderohen të mëdha, si vrasje të popullsisë civile, përdhunim, dëbim, tortura etj., nuk mund të ketë falje dhe amnisti. Si rezultat i një veprimtarie shumëvjeçare, të shumë institucioneve ndërkombëtare, janë konsoliduar shumë instrumente të cilat garantojnë se të gjithë kriminelët, të cilët kryejnë krime të vrasjeve dhe shkatërrimit në masë, herët ose vonë dhe pa marrë parasysh në cilin cep të botës do të fshihen, do të dalin para drejtësisë dhe do t'i nënshtrohen përgjegjësisë penale.

Sa i përket përgjegjësisë penale ndërkombëtare të personave, kryesisht kemi të bëjmë me atë përgjegjësi të personave të cilët si bartës të funksioneve të caktuara shtetërore në periudhën e luftës, para saj ose pas përfundimit, kryejnë veprime të cilat janë në kundërshtim me rregullat e gjithëpranuara ndërkombëtare. Gjatë historisë vazhdimisht janë bërë përpjekje që të kufizohen luftërat në përgjithësi ose së paku të humanizohen veprimet e ndërmarra gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake. Mirëpo, përkundër përpjekjeve të tilla, një gjë e tillë ka qenë e vështirë të arrihet. Në këtë aspekt, një përparim i vogël është shënuar pas krijimit të Lidhjes së Kombeve e cila, duke ndier pasojat e Luftës së Parë Botërore, me Statutin e saj mbajti qëndrim kundër luftës ose kundër çdo lloj kërcënimi me armë (Gruda, 2007:535). Efekti i saj i zbehtë, në këtë drejtim, u pa me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës u thyen shumë rregulla ndërkombëtare të luftës dhe u kryen shumë krime lufte. Midis dy luftërave botërore vazhdoi procesi i humanizimit të luftës, me miratimin e konventave ndërkombëtare për humanizimin e saj siç janë: Konventa e

Gjenevës mbi të plagosurit dhe të sëmurët e v.1929, Konventat e Gjenevës të v.1949, Konventa për pengimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit si dhe dokumente të tjera për kufizimin dhe ndalimin e luftës si Pakti Brian-Kellog i v.1928 (Kambovski,1998:379).

Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios u krijuan menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, si rezultat i horrorit nga gjenocidi nazist dhe nga krimet japoneze, të kryera në kohën e okupimit japonez të numrit madh të kombeve jug-perëndimore aziatike (Cassese,2003:319).

Me Marrëveshjen e Londrës u krijua Gjykata Ndërkombëtare ushtarake e quajtur si Tribunali i Nurembergut, e cila ishte kompetente që të gjykonte kriminelët nazistë, të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore kryen krime lufte, krimin e gjenocidit, agresion ose krime ndaj popullsisë civile nën mburojën e shtetit nazist gjerman. Në këtë Tribunal janë gjykuar njëzet e dy kriminelë ushtarakë.

I ngjashëm me Tribunalin e Nurembergut ishte edhe ai i Tokios, në të cilin u gjykuan njëzet e tetë kriminelë lufte, të cilët kryen krime lufte nën mburojën e shtetit japonez. Gjykatat ad hoc të Nurembergut dhe Tokios në fakt ishin gjykatat e para me karakter penal ndërkombëtar.

Falë përgjegjësisë penale ndërkombëtare dhe vënies para drejtësisë të kriminelëve të luftës, vlejné të përmenden edhe Tribunali Ndërkombëtar penal i Hagës për krimet e luftës të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën. Të dyja janë themeluar si gjykata ad hoc.

Pas tyre në arenën ndërkombëtare pati një aktivitet të bujshëm për krijimin e një gjykate penale ndërkombëtare dhe kjo më në fund u arrit nga OKB-ja, e cila në një konferencë të veçantë diplomatike, më 17 korrik të v.1998, arriti që të aprovojë Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, e cila zyrtarisht e filloi veprimtarinë e saj në Hagë të Holandës më 1 korrik të v.2002 (“Jeta Juridike”, Marika&Zaganjori, Gjykata penale ndërkombëtare si zhvillim i rëndësishëm pozitiv në kuadër të përgjegjësisë penale ndërkombëtare, vol.1:75).

Tribunalet ad hoc, të cilat u krijuan për gjykimin e kriminelëve të luftës, që kryen krime të rënda, si ai i Nurembergut dhe Tokios e sidomos Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, në bashkëveprim edhe me dokumentet ligjore ndërkombëtare kontribuan fuqishëm në vetëdijesimin përfundimtar lidhur me një të vërtetë; që është i domosdoshëm krijimi i një gjykate të përhershme penale ndërkombëtare, e cila do të ketë juridiksion që të gjykojë krimet e kryera gjatë, para dhe pas çfarëdo lloj konflikti të armatosur, pra krijimi i një gjykate të tillë do të bënte që të zvogëlohet në maksimum mundësia e kryerjeve të krimeve të rënda që mund t’i shpëtojnë përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Çështje tjetër e problematikës së përgjegjësisë penale ndërkombëtare është edhe përcaktimi i saktë se cilat veprime konsiderohen si krime ndërkombëtare si dhe çështja e respektimit të parimit *nullum crimen sine lege scripta*.

Është i gjithëpranuar mendimi se askush nuk mund të gjykohet për ndonjë vepër e cila para se të kryhet nuk është paraparë me ligj. Për këtë arsye, problem shtesë ka qenë çështja e unifikimit ose e kodifikimit të normave, në bazë të të cilave mund të thirreshin në

përgjegjësi personat që kryejnë krime të inkriminuara si krime ndërkombëtare. Edhe pse në të drejtën ndërkombëtare ekzistojnë një mori konventash ndërkombëtare, me anë të të cilave trajtohet kjo problematikë, prapëseprapë ishte i nevojshëm një akt, prapa të cilit të qëndronte edhe organizata e caktuar që do të garantonte sigurinë e zbatimit të tij.

Një gjë e tillë u arrit me themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Statuti i së cilës paraqet akt të kodifikimit të krimeve ndërkombëtare (Kambovski,1998:379), ku përcaktohen edhe burimet juridike në bazë të të cilave vepron gjykata. Burimet juridike janë: Statuti dhe Rregullat e procedurës së provave, marrëveshjet ndërkombëtare si dhe parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe parimet e së drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës të cilat gjykata i merr nga ligjet nacionale të sistemeve juridike.

Në Statutin e Romës janë përcaktuar nocionet e krimeve ndërkombëtare, të cilat bien nën juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Ato janë:

Krimi i gjenocidit

Krimet kundër njerëzimit

Krimet e luftës

Krimet e agresionit

Në këtë Statut është përcaktuar qartë se cilat veprime përbëjnë figurën e secilit krim, të përcaktuar me këtë Statut.

Si rezultat i një veprimtarie të llojllojshme të shumë aktorëve ndërkombëtarë si organizatat, shtetet dhe personat fizikë, tashmë në të drejtën ndërkombëtare nuk ekziston dilema se kryesit e krimeve të rënda do të përgjigjen ose jo për krimet e bëra, sepse me një mekanizëm të tillë, të njohjes dhe inkriminimit të veprimeve të tilla si dhe i garantimit të zbatimit të tyre, është vetëm çështje kohe, pra ata që kryejnë veprime të tilla të përcaktuara si kriminale do të dalin para drejtësisë dhe do t'i nënshtrohen përgjegjësisë penale.

Tribunalet e përkohshme, që u krijuan për gjykimin e kriminelëve të luftës, të cilët kryen krime të rënda, si ai i Nurembergut dhe Tokios e sidomos Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, në bashkëveprim dhe me dokumentet ligjore ndërkombëtare kontribuan fuqishëm në vetëdijesimin përfundimtar lidhur me një të vërtetë, se është i domosdoshëm krijimi i një gjykate të përhershme penale ndërkombëtare, e cila do të ketë juridiksion që të gjykojë krimet e kryera gjatë, para dhe pas konfliktit të armatosur, dhe me këtë do të zvogëlohet në maksimum mundësia që kryesit e këtyre krimeve të rënda të mund t'i shpëtojnë përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

1.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është studimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare të shteteve, po ashtu edhe individëve, por dhe të shumë kompetentëve të tjerë të lidhur ngushtë me këtë përgjegjësi.

Përgjegjësia penale nuk shfaqet dhe nuk ekziston aspak nëse nuk ekziston objekti dhe subjektet, që janë bartës të veprimeve të kundërligjshme. Dhe për pasojë, domosdo, duhet të shpjegohen se cilat veprime konsiderohen si veprime të kundërligjshme të inkriminuara si krime ndërkombëtare, ndërmarrja e të cilave çon në përgjegjësi penale ndërkombëtare.

Kur vihet në pyetje studimi i çështjeve me karakter ndërkombëtar atëherë kemi të bëjmë me një çështje paksa më të ndërlikuar për studim, sepse në dallim nga sistemet juridike nacionale, ku ekziston një hierarki e akteve juridike, hierarki e organeve shtetërore dhe vetë mënyra e aplikimit të së drejtës brenda një shteti është shumë e qartë, sepse shteti e krijon të drejtën, ndërsa qytetarët janë të detyruar që ta respektojnë dhe t'i binden asaj së drejte, por në të drejtën ndërkombëtare janë sovranët ata që e krijojnë të drejtën dhe janë po të njëjtit ata që janë të detyruar ta respektojnë atë. Vështirësi shtesë në aplikimin e së drejtës ndërkombëtare, në përgjithësi paraqet edhe territori shumë i gjerë dhe numri shumë i madh i subjekteve ndaj të cilave vepron kjo e drejtë.

Kusht vendimtar, që dikush të mund të thirret në përgjegjësi penale ndërkombëtare, është inkriminimi i veprimeve që konsiderohen si krime ndërkombëtare me dokumente ligjore ndërkombëtare. Parimi *nullum crimen sine lege scripta, nullum poena sine lege* – “s’ka krim pa ligj të shkruar”, “s’ka dënim pa ligj”, është parim shumë i rëndësishëm edhe në të drejtën penale ndërkombëtare, për arsyen se gjatë kohës në të drejtën penale ndërkombëtare ka qenë e hapur dilema që në të vërtetë a respektohet ky parim. Madje kjo dilemë ka qenë shumë aktuale gjatë kohës së gjykimeve para Tribunalit të Nurembergut, me ç’rast pala mbrojtëse e të akuzuarve e ka shfrytëzuar këtë si argument duke sulmuar Tribunalin për jolegjitimitet për gjykimet e tilla. Mirëpo, edhe atëherë edhe tani akuza të tilla janë hedhur poshtë, mbështetur në faktin se e drejta ndërkombëtare përveçse mbështetet në dokumentet ligjore, qofshin ato marrëveshje midis shteteve, konventave ose akteve të tjera, si dhe në të drejtën zakonore, krimet ndërkombëtare cenojnë të mirat dhe vlerat më elementare të shoqërisë njerëzore, të cilat përveçse përbëjnë figurën e krimeve ndërkombëtare, të marra veç e veç përbëjnë figurën e veprave penale të posaçme, që parashihen pothuajse në të

gjitha legjislationet penale nacionale si, për shembull, cenimi i integritetit fizik dhe psikik, privimi i lirisë, marrja e jetës dikujt, etj.

Që të arrihet qëllimi përfundimtar i drejtësisë, është e nevojshme që personat, të cilët kryejnë veprime të inkriminuara, si krime ndërkombëtare, duhet të përgjigjen për veprimet e tyre kriminale, por edhe të marrin dënimin e merituar, që njëherit do të ishte edhe një satisfaksion emocional dhe moral i viktimave. Është kjo arsyeja që i kam kushtuar një vëmendje të posaçme themelimit dhe funksionimit të Tribunaleve *ad hoc* si dhe gjykatës penale ndërkombëtare.

Themelimi dhe aktivitetet e Tribunalit të Hagës për gjykimin e krimeve të luftës të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, në dhjetëvjeçarët e fundit, ka zgjuar një interes të posaçëm për mbarë opinionin publik. Themelimi i tij përveç të tjerash shënoi një kthesë të rëndësishme në të drejtën penale ndërkombëtare si dhe një rikthim të çështjes së ngritjes së përgjegjësisë penale ndërkombëtare në një aktualitet, sepse nga koha e përfundimit të punës së Tribunalit të Nurembergut dhe të Tokios, u desh të kalojë një kohë e gjatë, derisa bashkësia ndërkombëtare të merrte guximin e hedhjes së një hapi përpara në drejtim të përgjegjësisë penale të personave përgjegjës për kryerjen e krimeve ndërkombëtare. Themelimi i këtij Tribunali, gjithashtu, njihet si shumë i rëndësishëm për sa i përket vetëdijesimit të bashkësisë ndërkombëtare për nevojën e themelimit të një gjykate të përhershme për gjykimin e krimeve ndërkombëtare.

Në territorin e ish-Jugosllavisë u zhvilluan shumë luftëra të përgjakshme midis regjimit jugosllav dhe popujve, të cilët duke shfrytëzuar të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe liri kërkuan të shpëriteshin nga federata jugosllave dhe të formonin shtetet e tyre sovraane. Gjatë zhvillimit të këtyre luftërave u kryen shumë krime lufte, krime kundër njerëzimit,

gjenocid, prandaj bashkësia ndërkombëtare nuk mund të qëndrojë e verbër dhe të tolerojë që kriminelë të tillë të mbeten pa u gjykuar. Krime të tilla u kryen kryesisht nga regjimi i pushtetit jugosllav, gjegjësisht nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare, Tribunali përveç tyre nuk mbeti pa akuzuar edhe pjesëtarë të ushtrive çlirimtare të popujve të federatës jugosllave, edhe pse u organizuan dhe luftuan për mbrojtjen e popujve të tyre nga veprimet dhe trajtimet çnjerëzore të regjimit jugosllav. Nga ky Tribunal u akuzuan edhe shumë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nën akuzat se gjatë zhvillimit të luftës në v.1999, në territorin e Kosovës u kryen krime ndërkombëtare edhe nga pjesëtarë të kësaj ushtrie.

Analizimi i kësaj çështjeje dhe arsyeve pse u akuzuan pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po edhe ata të ushtrive të popujve të tjerë të federatës jugosllave, sigurisht që meriton një studim dhe një analizë më të thellë, por ndoshta edhe një punim të posaçëm, megjithëse unë, në një pjesë të këtij punimi, jam munduar ta studioj dhe ta analizoj rastin e akuzimit të Ramush Haradinaj, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj, në Tribunalin e Hagës, gjegjësisht fillimin, zhvillimin e deri në përfundim të procedurës ndaj tyre.

Qëllimi përfundimtar i secilit studim është që të arrijë të nxjerrë disa konkluzione, të bazuara në fakte, për dukurinë që studion, por dhe të bëjë disa propozime të mundshme me qëllim që të eliminohen të meta dhe eventualisht të futen risi pozitive për çështjen e bërë objekt studimi.

1.3. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

Gjatë përpilimit të këtij punimi kam shtruar tri hipoteza të cilat jam munduar ti argumentoj dhe vërtetoj me shtjellimin dhe analizimin e shumë faktorëve dhe rrethanave të

cilat në ndërlidhje direkte ose indirekte kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

HIPOTEZA 1: Përgjegjësia penale ndërkombëtare nënkupton përgjegjësinë e personave që duke vepruar në emër dhe për “interesat” e shtetit kryejnë veprime të inkriminuara si krime ndërkombëtare.

HIPOTEZA 2: Në ngritjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare të individëve kanë ndikuar shumë rrethana dhe faktorë të cilët kontribuan në vetëdijimin e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me rëndësinë e përgjegjësisë penale ndërkombëtare, e cila përgjegjësi përveç se ka bërë të mundur gjykimin dhe sanksionimin e personave përgjegjës për veprime çnjerëzore ka ndikuar edhe në përforcimin e parimit të sundimit të së drejtës në mbarë globin.

HIPOTEZA 3: Në Statutin e Romës për GJPN-në janë inkriminuar dhe numëruar në mënyrë taksative të gjitha veprimet të cilat përbëjnë figurat e krimeve ndërkombëtare, gjë e cila paraqet garancion shtesë në drejtim të aplikimit të përgjegjësisë penale ndërkombëtare si dhe parakusht fillestar në jetësimin e kësaj përgjegjësie.

Gjatë studimit tim kam shtruar edhe disa pyetje kërkimore të cilave jam munduar të ju jap përgjigje në kapitujt e paraqitur në këtë temë, nëpërmjet shtjellimit të shumë çështjeve, fakteve, rrethanave e faktorëve në drejtim të analizimit dhe qartësimit të çështjes së përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Kur për herë të parë u shtrua problemi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare?

Cilët ishin faktorët që ndikuan në ngritjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare të subjekteve fizike?

Cilat janë dokumentet ligjore ndërkombëtare që përmbajnë norma juridike me të cilat sanksionohen krimet ndërkombëtare?

Cila ishte gjykata e parë që nxori para përgjegjësisë dhe gjykoi personat që kryen krime ndërkombëtare?

Si rregullohet tani çështja e përgjegjësisë penale ndërkombëtare dhe cilat janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen dhe gjykimin e atyre që kanë kryer krime ndërkombëtare?

Organizimi dhe funksionimi i Tribunaleve Penale Ndërkombëtare *ad-hoc* dhe roli i tyre në krijimin e GJPN-së, si institucion i përhershëm për gjykimin e krimeve ndërkombëtare?

Studimi dhe analizimi i një rasti të zhvilluar para TPNJ-së, për të parë nga afër si janë aplikuar në rastin konkret normat e së drejtës penale ndërkombëtare?

Si është e organizuar dhe si funksionon GJPN-ja, si institucioni i vetëm për gjykimin dhe sanksionimin e kryesve të krimeve ndërkombëtare?

Si është e rregulluar çështja e juridiksionit në mes të gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare?

1.4. Metodologjia dhe metodat e studimit

Çdo punim shkencor ka një qëllim që synon ta realizojë nëpërmjet një qasjeje të planifikuar të hulumtimit shkencor të ndonjë dukurie ose procesi.

Ekzistimi i shumëllojshmërisë së disiplinave shkencore ka kushtëzuar paraqitjen e shumë metodave që zbatohen në disiplina të ndryshme shkencore, nëpërmjet të cilave bëhen hulumtime shkencore, për të arritur suksese dhe për të zbardhur probleme të përgjithshme (Jakupi,2005:20).

Çdo disiplinë shkencore ka metoda të caktuara, nëpërmjet tyre ajo zhvillon punën shkencore–kërkimore, me qëllim gjurmimin, por edhe promovimin e rezultateve të kërkimeve shkencore (Jakupi,2005:21).

Gjatë përpilimit të këtij punimi doktoral, kam shfrytëzuar disa metoda kërkimore-shkencore, si:

Metodën historike

Metodën empirike

Metodën deskriptive

Metodën e analizës

Metodën e sintezës

Metodën e induksionit

Metodën deduktive

Metodën e analizës e kam shfrytëzuar sipas funksionit të saj gnoseologjik, pra gjegjësisht deskriptive eksplikative. Nëpërmjet kësaj metode kam përshkruar veçoritë kryesore të secilit prej elementeve që çojnë në përgjegjësinë penale ndërkombëtare të shteteve, organizatave të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare si dhe të individëve; kam bërë përshkrimin e elementeve që përbëjnë figurën e krimeve ndërkombëtare, përshkrimin e rrethanave kohore në të cilat janë paraqitur organet e para për gjykimin e personave që

kryejnë krime ndërkombëtare, gjegjësisht Tribunaleve *ad hoc*, përshkrimin e krijimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare si dhe përshkrimin e rrethanave nën të cilat u gjykuan Ramush Haradinaj, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës për krimet e luftës në territorin e ish-Jugosllavisë.

Çdo studim shkencor synon të arrijë një qëllim ku nëpërmjet shpjegimit të proceseve të ndryshme të një dukurie të caktuar tentohet të dilet në përfundime që arrihen nëpërmjet lidhjes së elementeve të një procesi të përgjithshëm në një tërësi të përbashkët, gjë e cila realizohet nëpërmjet shfrytëzimit të metodës së sintezës.

Gjatë këtij punimi kam shfrytëzuar gjithashtu edhe metodat deduktive dhe induktive. Në këtë punim, përmes analizimit të çështjeve të përfshira, çështjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale ndërkombëtare, kam pasur si qëllim të analizoj proceset dhe dukuritë, fillimisht duke u nisur nga e përgjithshmja e deri tek e veçanta, me ndihmën e metodës deduktive, dhe më pas nëpërmjet shfrytëzimit të metodës induktive dhe pasi kam analizuar secilën çështje në veçanti jam përpjekur që të arrij deri te konkluzionet e përgjithshme.

Nëpërmjet metodës empirike bëhet grumbullimi i fakteve shkencore, në bazë të të cilave verifikohen të vërtetat dhe ligjshmëritë shkencore (Jakupi,2005:42).

Për të arritur deri tek e vërteta është e patjetërsueshme që të mblidhen, të shqyrtohen e të analizohen të gjitha faktet dhe rrethanat e shkruara për atë dukuri a proces që hulumtohet dhe studiohet, gjë që unë në këtë punim e kam arritur nëpërmjet metodës empirike.

Çdo dukuri, që hulumtohet, ka një rrugëtim nëpër të cilin ka kaluar gjatë gjithë kohës, qysh kur është paraqitur, dhe për të nuk mund të bëhet një studim i mirëfilltë pa shqyrtimin e të gjitha filleve të kësaj dukurie, prandaj shfrytëzimi i metodës historike më ka ndihmuar për

shqyrtimin e pjesës historike të marrëdhënieve dhe proceseve që kam studiuar në këtë punim.

Gjithashtu në këtë punim kam shfrytëzuar edhe metodën deskriptive ose përshkruese për sqarimin e nocioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me lëmin e së drejtës penale ndërkombëtare.

1.5. Rëndësia e studimit

Lufrat gjithmonë kanë qenë dukuri shoqëruese negative e njerëzimit, ku fatkeqësisht ato janë aktuale edhe sot në vende të ndryshme të globit. Arsyeimi i i fillimit ose zhvillimit të një konflikti të armatosur gjithmonë ka qenë “i drejtë”, mirëpo fakti i përgjegjësisë së personave të cilët në emër të shtetit dhe për interesa të tij ndërmarrin veprime të kundërligjshme ka ndryshuar, sepse tani kjo përgjegjësi në të drejtën ndërkombëtare njihet dhe sanksionohet. Të këqijat dhe pasojat që shkaktohen nga pasojat negative që shkaktohen nga ndërmarrja e veprimeve luftarake vështirë se mund të kompenzohen ose rikuperohen, por të mbeten pa u përgjigjur shkaktarët e këtyre të këqijave, në fakt do të paraqiste një aprovim të heshtur të veprimeve të tilla.

Studimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare gjegjësisht i kushteve dhe rrethanave historike-juridike që kanë ndikuar në shtrimin e përgjegjësisë penale, por edhe ndikimin e rrethanave politike të zbatimit të saj, është një hallkë shumë e rëndësishme në procesin e sundimit të së drejtës në arenën ndërkombëtare.

1.6. Kufizimet e studimit

Secili studim mëton që në mënyrën më të mirë ti pasqyrojë të gjitha çështjet që janë të ndërlidhura me objektin i cili studiohet, por që në fakt është e pamundur që një studim të ndërtohet në mënyrë të përsosur.

Rrethanat historike nëpër të cilat ka kaluar dhe është zhvilluar nocioni i përgjegjësisë penale ndërkombëtare i ndërthurrur edhe me eventet e ndodhura në periudha të ndryshme kohore të cilat në mënyrë direkte ose indirekte janë të lidhura me nocionin e përgjegjësisë penale ndërkombëtare, janë marrë nga autorë ndryshëm të cilët në kohë të ndryshme kanë paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me evente të caktuara shoqërore, që natyrisht se nuk mund të jenë plotësisht të realta e objektive, pa u ndikuar nga rrethana dhe shkaqe të ndryshme.

Studimi i zhvillimit të një rasti konkret para një Tribunali ose GJPN-së, do të ishte më i plotë, nëse ai do të ndiqej nga afër prej fillimit e deri në arritjen e epilogut përfundimtar, gjë e cila ka qenë vështirë e realizueshme për faktin e njohur të tejzgjatjes së proceseve të tilla gjyqësore dhe afatit kohor të limituar të puminit të këtij disertacioni.

1.7. Përmbledhja dhe strukturimi i punimit

Ky punim është i përbërë prej gjashtë kapitujve. Në kapitullin e parë fillimisht kam bërë shtrimin e problemit, qëllimin e studimit, kam shtruar hipotezat dhe pyetjet kërkimore, metodat dhe metodologjinë e ndjekur gjatë realizimit të këtij punimi, kam paraqitur rëndësinë si dhe kufizimet studimit dhe kam dhënë një përmbledhje të shkurtër të kapitujve.

Në kapitullin e dytë kam paraqitur evoluimin e përgjegjësisë penale ndërkombëtare gjegjësisht historik të shkurtër të përgjegjësisë penale ndërkombëtare të shteteve dhe individëve si dhe burimet e së drejtës penale ndërkombëtare.

Në kapitullin e tretë kam shkruajtur për themelimin dhe funksionimin e Tribunaleve ad hoc si dhe GJPN-së, si faktorë shumë të rëndësishëm në konsolidimin e përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Në kapitullin e katërt kam paraqitur organizimin e Tribunaleve ad hoc dhe GJPN-së si dhe kam studiuar rastin e gjykimit nga ana e Tribunalit të Hagës të Ramush Haradinaj, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj, për të shqyrtuar dhe analizuar se si dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale ndërkombëtare janë zbatuar në një rast konkret.

Në kapitullin e pestë kam shqyrtuar nocionin e juridiksionit dhe llojet e tij, si çështje e lidhur ngushtë me funksionimin e Tribunaleve ad hoc dhe GJPN-së.

Në kapitullin e gjashtë kam paraqitur dhe numëruar krimet ndërkombëtare të parapara në Statutin e Romës në bazë të së cilës edhe funksionon GJPN-ja.

Kapitulli i shtatë përmban konkluzionet dhe rekomandimet.

KAPITULLI II: EVOLUIMI I PËRGJEGJËSISË PENALE NDËRKOMBËTARE

2.1. Historiku i së drejtës penale ndërkombëtare dhe i përgjegjësisë penale ndërkombëtare

E drejta penale ndërkombëtare si disiplinë e mëvetësishme është e një kohe më të re.

Në të kaluarën koncepti i së drejtës penale ndërkombëtare nuk ka qenë i ndarë nga e drejta penale nacionale.

Ka autorë që fillesat e së drejtës penale ndërkombëtare i lidhin me shek. XVI, kurse disa të tjerë mendojnë se fillesat e para janë paraqitur në shek. XVII, gjegjësisht që nga postulati i Hugo Grocius *aut dedere aut punire* ose dorëzoje ose ndëshkoje.¹

Origjina e drejtësisë penale ndërkombëtare përmendet në të kaluarën e thellë, gjegjësisht në vitin 1474 kur në Brajzah u zhvillua gjykimi kundër Dukës së Burgundit, ndërsa ideja e krijimit të një gjykate penale ndërkombëtare, si e kemi përmendur më lart, i takon Kryetarit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, zviceranit Gustave Moynier i cili propozoi krijimin e një gjykate penale që do t'i gjykonte ata që kishin kryer krime të tilla (Jovic, Institut za pravo i finansije:2).

Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, gjegjësisht në v. 1862, autori gjerman Carl Ludwig von Bar përdori termin “ e drejta penale ndërkombëtare” (Kambovski,1998:19).

Nëse do të shohim aspektin e zhvillimit të së drejtës penale, mund të vërejmë se zgjerimi i pushtetit represiv të shtetit, jashtë kufijve shtetërorë, paraqitet në shekullin XIX gjatë kodifikimeve të mëdha penalo-juridike, periudhë që përputhet me marrëdhëniet intensive

¹ www.slideshare.net

ndërshtetërore, të ndaluara më herët me strukturën statike të shoqërisë feudale dhe me marrëdhëniet e pazhvilluara ekonomike dhe marrëdhëniet e tjera.

Është e njohur se qysh nga e drejta romake ka ekzistuar një regjim i dyfishtë normash: *jus civile* që ka vlejtur për romakët dhe *jus gentium* që ka vlejtur për të huajt, e që filloi të përhapet me zgjerimin e Perandorisë Romake.

Rregullat, për shtrirjen e pushtetit represiv të shtetit, kanë qenë të determinuara nga karakteri i marrëdhënieve shoqërore, kështu që parimi territorial në kohën e feudalizmit ka qenë drejtpërdrejt i lidhur me lidhshmërinë e kmetit me pronësinë tokësore.

Parimi i territorialitetit ka qenë dominant edhe gjatë së drejtës penale mesjetare. Kështu ky parim, në të drejtën angleze është pranuar dhe rrënjosur thellë, dhe më vonë edhe në vendet të cilat e kanë aplikuar sistemin e *common law*, dhe është ngushtësisht i lidhur me karakteristikat e procedurës penale anglosaksone. Ndërsa pas revolucionit francez borgjez të v.1789, parimi i territorialitetit vjen deri tek absolutizimi; kjo edhe me ndikimin e filozofëve Monteskie, Ruso, Voltaire dhe Becaria.

Si rezultat i qasjeve të tilla, fillimisht kodifikimet e shekullit XIX, ishin nën ndikimin e tezës për sovranitet absolut, që rezultonte me pranimin e parimit territorial, dhe më pas në kodifikimet e mëvonshme filluan të depërtojnë edhe parimet të tjera.

Përkundër një qasjeje të tillë, në Kodin penal Bavarez të v.1813, nën ndikimin e ideve nacionaliste parashikohej edhe parimi i personalitetit aktiv, por vetëm si parim plotësues i parimit territorial (Kambovski,1998:23-24).

E drejta penale ndërkombëtare pati zhvillim të madh sidomos me paraqitjen e ideve dhe të tendencave nga shtete dhe nga bashkësia ndërkombëtare që, brenda mundësive, të humanizohej lufta. Zhvillimi i hovshëm i së drejtës penale ndërkombëtare erdhi falë

nxjerrjes së konventave të Hagës në vitin 1899 dhe në vitin 1907, që faktikisht paraqesin një lloj kodifikimi të së drejtës ndërkombëtare të luftës. Me këto konventa u përcaktuan rregullat për mbrojtjen e popullsisë civile, për sjelljen ndaj të zënëve rob, si duhej vepruar ndaj të sëmurëve dhe të plagosurve, janë ndaluar mënyrat apo mjetet barbare të luftimit.²

Konsolidimi i së drejtës penale ndërkombëtare, si disiplinë e mëvetësishme, me objekt dhe subjekte të veçanta studimi daton diku pas përfundimit të LPB-së, kurse pas përfundimit të LDB-së ajo fillon të aplikohet realisht.

Fakti që kjo disiplinë është konsoliduar shumë vonë, ka ndikuar edhe në refuzimin e shteteve për ta pranuar këtë të drejtë, sepse një gjë e tillë është nënkuptuar si heqje dorë nga sovraniteti i brendshëm.

Gjithashtu, për sa i përket këtij aspekti, faktor shumë i rëndësishëm janë edhe subjektet e së drejtës penale ndërkombëtare.

Në procesin e ngritjes së përgjegjësisë penale ndërkombëtare, rol kyç kanë pasur normat dhe dokumentet juridike ndërkombëtare për humanizmin e veprimeve luftarake.

Në të kaluarën lufta shihej si një mjet i duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve, mirëpo me kalimin e kohës një botëkuptim i tillë filloi të zbehej kryesisht nga realiteti i hidhur që sillnin zhvillimet e veprimeve luftarake, si dhe pasojat e dëmshme afatgjate që shkaktoi lufta. Mirëpo edhe përkundër një realiteti të tillë ishte e vështirë që luftërat të flakeshin menjëherë nga praktika e veprimit të shteteve, prandaj u gjetën rrugë alternative, që së paku ato të humanizoheshin, gjë që do të kontribuonte shumë, që gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake të mbroheshin së paku të drejtat dhe liritë themelore të

² www.juridiku.webly.com, Lënda e së drejtës penale, f.13.

njeriut, veprime që do të kontribuonin, gjithashtu, në zvogëlimin e numrit të pasojave negative që sollën luftërat.

Pas përfundimit të LPB-së kishte tendenca që personat të cilët kryen veprime në kundërshtim me rregullat e luftës dhe që shkelën rëndë të drejtën zakonore për luftën, të nxirreshin para drejtësisë dhe të gjykoreshin, mirëpo një orvatje e tillë dështoi për shkak të refuzimit të shteteve, që të dorëzonin ata që kishin kryer vepra të tilla. Me Traktatin e Versajës, pas LPB-së, nga fuqitë aleate u vendos që ata persona, të cilët përgjatë zhvillimit të LPB-së shkelën rëndë ligjet dhe zakonet e luftës, të vireshin para përgjegjësisë penale dhe të ndëshkoheshin. Përgjegjësi kryesor i krimeve gjatë LPB-së, Vilhelmi II, nuk u arrit të nxirrej para gjykatës sepse iku në Holandë, e cila më vonë refuzoi ta ekstradonte me arsyetimin se veprat për të cilat kërkohet Vilhelmi II, nuk përbënin shkelje sipas legjislacionit të Holandës, kurse në Gjermani në Gjykatën Supreme të Lajpcigut u dënuan vetëm 6 persona edhe ata me dënime minimale, të cilat nuk u ekzekutuan kurrë.

Mirëpo, pavarësisht dështimit të kësaj nisme, ajo shënoi kthesë kyçe në vetëdijesimin e opinionit publik për rëndësinë dhe nevojën e shqyrtimit të mekanizmave me të cilat do të bëhej e mundur që persona të tillë të përgjigjen penalisht dhe të dënohen.

Një gjë e tillë u bë realitet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore me krijimin e Tribunalit të Nurembergut dhe të Tokios, në të cilat u gjykuan kriminelët nazistë dhe japonezë që kryen krime lufte gjatë zhvillimit të LDB-së.

Edhe me miratimin e shumë dokumenteve ligjore si konventave, protokolleve, marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe me rregullimin e kësaj çështjeje edhe nga legjislacionet penale nacionale, në botën bashkëkohore çështja e përgjegjësisë penale dhe e ndëshkimit të personave, të cilët kryejnë veprime me të cilat cenohen të drejtat

themelore të njeriut ose me të cilat dëmtohen të mira të caktuara, ose pasojat e të cilave i kalojnë kufijtë kombëtarë, ka zënë vendin e duhur në të drejtën ndërkombëtare. Në favor të saj flet edhe fakti i krijimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, e cila si një institucion i përhershëm gjyqësor për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, është një fakt i cili, gjithashtu, kontribuon edhe në stabilitetin dhe vazhdimësinë e së drejtës penale ndërkombëtare.

Zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare ka qenë i lidhur ngusht me të drejtën ndërkombëtare humanitare, normat e së cilës kanë luajtur një rol vendimtar në ngritjen dhe në përforcimin e përgjegjësisë penale si të shteteve, ashtu edhe të subjekteve individuale brenda shteteve. Lidhshmëria e zhvillimit të ngushtë të së drejtës ndërkombëtare penale me të drejtën ndërkombëtare humanitare qëndron edhe në faktin se qëllimi i së drejtës ndërkombëtare humanitare është zbutja e pasojave të luftës, nëpërmjet kufizimit të mjeteve e metodave, gjatë kryerjes së operacioneve luftarake, si dhe detyrimit të palëve ndërluftuese për të kursyer jetën e personave, që kanë dalë jashtë luftimit për shkak të dëmtimeve, zënies rob, ose që janë tërhequr nga pjesëmarrja në veprime armiqësore, kurse qëllimi i së drejtës ndërkombëtare penale është pikërisht përgjegjësia e personave të cilët gjatë veprimeve luftarake shkelin rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe krijimi i kushteve që persona të tillë duhet të përgjigjen për veprimet e tyre dhe të dënohen.

Duke qenë se e drejta penale ndërkombëtare është në zhvillimin e sipër, ajo vazhdimisht zgjeron spektrin e saj edhe me inkriminime të reja të veprimeve kriminale. Përderisa më herët vetëm krimet e luftës dhe veprimet e kryera gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake si: krimet kundër njerëzimit, gjenocidi, aparteidi, konsideroheshin si krime ndërkombëtare, por tani ky rreth është zgjeruar edhe me inkriminime të tjera. Si rezultat i zhvillimit të hovshëm të teknikës dhe teknologjisë, urbanizimi i përshpejtuar dhe industrializimi, shumë çështje

dhe veprime që më herët ndoshta ka qenë e vështirë edhe të mendohen, tani janë bërë realitet. Zbulime të tilla, përkundër faktit që në masë të madhe kanë lehtësuar jetën e qenieve njerëzore, bartin me vete edhe të këqija. Nëpërmjet shfrytëzimit të kësaj teknike dhe teknologjie me konotacion negativ, mund të kryhen veprime kriminale, që shkaktojnë dëme te një numër i madh personash në një hapësirë të madhe gjeografike. Veprime të tilla, të dokumentuara nga shumë dokumente ligjore ndërkombëtare, janë paraparë si krime ndërkombëtare, si krim kompjuterik, kriminalitet ekologjik, terrorizëm, kriminalitet ekonomik, trafikim i lëndëve narkotike, trafikim i qenieve njerëzore etj.

Në një rrugëtim të tillë të së drejtës penale ndërkombëtare, përgjegjësia penale dhe ndëshkimi i personave që kryejnë krime ndërkombëtare, qoftë në kohë lufte, qoftë në kohë paqeje, nuk është më çështje në diskutim, por është vetëm çështje kohe se kur dhe si ata që kanë kryer krime të tilla do të ndëshkohen.

2.2. Përgjegjësia e shteteve

Përgjegjësia penale ndërkombëtare është shumëdimensionale dhe ajo në vetvete ngërthen shumë lloje dhe subjekte të ndryshëm të cilat i nënshtrohen kësaj lloji përgjegjësie.

Përgjegjësi penale ndërkombëtare kanë shtetet si subjekte të së drejtës ndërkombëtare, më pastaj radhiten institucionet, organizatat dhe organet e shtetit si dhe personat fizikë.

Fillimisht, është paraqitur lloji i përgjegjësisë së shteteve, përgjegjësi që rrjedh nga burime të ndryshme ndërkombëtare.

Kur shohim evolucionin e së drejtës ndërkombëtare, mund të vërejmë se ajo si e tillë ka ndryshuar disa herë formë përgjatë historisë.

Në të kaluarën, shtete të pavarura dhe sovrane janë konsideruar ato shtete, që e kanë pasur këtë pavarësi, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të tyre, në një botëkuptim të tillë shtete të tilla sovrane kanë qenë të lira që të ndërmarrin çfarëdo veprimi dhe për pasojë nuk i janë nënshtruar asnjë lloj përgjegjësie ndërkombëtare. Mirëpo, me kalimin e kohës një botëkuptim i tillë është tejkaluar dhe ka filluar të zërë vend koncepti i sovranitetit të kufizuar të shteteve, si rezultat i faktit se shtetet në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të tyre duhet të mbajnë llogari që mos të dëmtojnë palët e treta, qofshin persona fizikë ose juridikë.

Në të drejtën ndërkombëtare qysh moti janë konsoliduar rregulla lidhur me parimet mbi përgjegjësinë e shteteve në përgjithësi, dhe tanimë është bërë praktikë që shtetet në përgjithësi respektojnë rregullat e së drejtës ndërkombëtare, por dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Kjo nga arsyeja se shtetet si subjekte juridike e kanë të patjetërsueshme të ndërveprojnë edhe me shtetet e tjera, proces gjatë të cilit mund të lindin mosmarrëveshje dhe konflikte. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të tilla ka shumë mënyra dhe kjo varet prej dëshirës së shtetit ose shteteve që në rastin konkret cilën zgjidhje do të aplikojnë.

Shumë ngadalë ka ecur procesi i vetëdijesimit të shteteve lidhur me përgjegjësinë për veprimet e tyre, por edhe më ngadalë ka ecur procesi lidhur me përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

Pas konstatimit të faktit se edhe shtetet duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet që janë në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, lind pyetja tjetër se kush në emër të shteteve duhet të mbajë përgjegjësi për këtë veprim. Dihet fakti se shteti si entitet politiko-juridik ka në përbërje organe të caktuara, përmes të cilave shteti ushtron pushtetin e vet.

Gjithashtu, organet e tij drejtohen nga njerëzit të cilët, si bartës të funksioneve të caktuara, ushtrojnë të drejta dhe detyrime. Për këtë arsye, kur flasim për përgjegjësinë e shteteve në të drejtën ndërkombëtare, duhet të kemi parasysh se shteti si institucion nuk mund të akuzohet i tëri. Kjo edhe për arsye praktike, nga fakti se brenda territorit të caktuar shtetëror jeton populli, në përbërjen e të cilit janë shumë persona dhe ata si tërësi nuk mund të përgjigjen sepse një gjë e tillë do të ishte e palogjikshme për faktin se në përbërje të popullit ka kategori të ndryshme personash të cilat në bazë të normave juridike përjashtohen nga përgjegjësia penale (Gruda,2007:138).

Shtetet, nga sistemi i së drejtës ndërkombëtare, kanë shumë përfitime dhe si rezultat i pranimit të këtij funksionaliteti nga ana e shteteve, ato janë të detyruara që të pranojnë edhe obligimet e caktuara juridike, por dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, të cilat kanë efekt ndaj subjekteve juridike ndërkombëtare ose ndaj bashkësisë ndërkombëtare (Dixon&McCorquodale,2002:425).

Prandaj, në të drejtën penale moderne mbizotëron parimi për përgjegjësinë penale ndërkombëtare individuale, gjegjësisht parimi i përgjegjësisë kolektive nuk është më i pranueshëm dhe si rezultat i kësaj në të drejtën penale moderne dhe kryesisht në të drejtën penale ndërkombëtare është rrënjosur thellë parimi i autonomisë individuale, me ndihmën e të cilit individ është i lirë, që në bazë të vullnetit të lirë dhe pa ndikimin e askujt, të zgjedhë mënyrën e sjelljes (Cassese,2007:33).

Në të drejtën penale ndërkombëtare ekziston një parim që ka të bëjë me përgjegjësinë penale ndërkombëtare të shteteve, gjegjësisht për përkufizimin e saj dhe thuhet se një veprim i paligjshëm në të drejtën ndërkombëtare, i ndërmarrë nga një shtet, tërheq përgjegjësinë penale ndërkombëtare të atij shteti. Mirëpo, duhet cekur atë që shteti si

subjekt politiko-juridik, si diçka abstrakte, nuk mundet drejtpërdrejt të kryejë veprime të kundërligjshme. Për këtë arsye, duhet të ekzistojnë rregulla që të përcaktojnë se një veprim i kryer nga ana e shtetit, qoftë ai afirmativ ose me mosveprim, është kryer nga ana e një shteti. Nga ana e Komisionit për të drejtën ndërkombëtare janë përcaktuar disa rregulla të cilat janë të gjithëpranuara nga ana e praktikës së shteteve, dhe që përcaktojnë se cilat veprime të shtetit mund t'i vishen një shteti:

- Sjellja e organeve të shtetit, duke përfshirë organet ligjdhënëse, ekzekutive dhe gjyqësore në nivel nacional ose në nivel më të ulët të udhëheqjes;
- Sjellja e personave, të cilët nuk janë organe të shtetit, por që kanë autorizim nga ana e shteteve që të aplikojnë elemente të autorizimit shtetëror (p.sh. firma private të sigurimit në lidhje me veprimet e aplikuara në kornizë të atij kapaciteti);
- Sjellja e organeve shtetërore, të vëna në shërbim të shtetit tjetër siç është ushtria;
- Sjellje e imponuar ose e kontrolluar nga shteti;
- Sjellje e aplikuar nga persona të caktuar, të cilët në mungesë të pushtetit zyrtar shtetëror ushtrojnë elemente të pushtetit shtetëror, që mund të paraqiten në shtete në shkatërrim;
- Sjelljet e kryengritësve të cilët më pastaj shndërrohen në qeveri të shtetit dhe
- Sjellje e njohur dhe e miratuar nga ana e shtetit si sjellje e vet (Murphy,2006:181).

Këtë qëndrim, lidhur me përcaktimin e subjekteve, të cilat duke vepruar në emër dhe për llogari të shteteve kryejnë veprime në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe që i parashohin shumica e teorive që flasin për përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve, qëllimi i të cilave është konkretizimi i subjekteve përgjegjëse për veprime të tilla,

e cila është një mënyrë nëpërmjet së cilës krijohet mundësia reale, që ndaj subjekteve të tilla të aplikohen rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

Ekziston një tendencë e vazhdueshme e plotësimit dhe e avancimit të gjithëmbarshtëm të marrëdhënieve juridike duke tentuar që të parashikohen rregulla juridike që, me norma juridike do të rregulloheshin të gjitha sferat e jetës së njerëzve. Kjo i jep një ndihmesë të madhe sigurisë juridike të njerëzve brenda territorit të një shteti. Edhe në të drejtën ndërkombëtare, përgjatë zhvillimit të saj, vazhdimisht është tentuar që të rregullohen të gjitha marrëdhëniet juridike, që lindin në të drejtën ndërkombëtare, qofshin ato midis subjekteve fizike të shteteve të ndryshme, midis subjekteve fizike dhe institucioneve shtetërore të shtetit tjetër, midis institucioneve shtetërore të dy ose më shumë shteteve.

E drejta ndërkombëtare është një lëmi shumë e gjerë dhe ajo në vetvete ngërthen rregulla dhe norma të ndryshme juridike me të cilat rregullohen shumë marrëdhënie juridike që klasifikohen në shumë degë të së drejtës.

Lidhur me lëmin e përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve gjatë evolucionit të së drejtës ndërkombëtare mund të shohim se ajo e ka zanafillën shumë herët. Fillimisht marrëdhëniet juridike midis shteteve janë rregulluar duke u bazuar në të drejtën zakonore të shteteve dhe gjegjësisht me përsëritjen e një veprimi në marrëdhëniet ndërshtetërore. Një veprim i tillë është bërë zakon, duke u pasuar nga lidhja e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe midis shteteve, me qëllim që, në mënyrë më të lehtë, të zhvillohen marrëdhëniet midis shteteve si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale, që mund të lindin gjatë realizimit të marrëveshjeve të tilla, dhe duke arritur të sjellja dhe miratimi i konventave dhe traktateve të ndryshme me karakter ndërkombëtar, që i kanë detyruar shtetet të sillen në një mënyrë të

caktuar duke paraparë edhe represalie, kompensime ose satisfaksione të ndryshme për shtetin shkelës të rregullave të tilla.

Pas konsolidimit të rregullave për përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve për veprimet ose mosveprimet e tyre, ka lindur edhe përgjegjësia penale ndërkombëtare. Ideja e përgjegjësisë penale ndërkombëtare për individët, të cilët kryejnë veprime të kundërligjshme në territorin e shtetit tjetër ka ekzistuar qysh moti, gjegjësisht ndaj personave që ushtronin pirateri në ujërat nacionale të shtetit tjetër ose në detin e hapur (Shaw,2008:335).

Ideja për përgjegjësinë individuale penale ndërkombëtare ka lindur kryesisht si rezultat i ideve progresive për humanizimin e veprimeve gjatë zhvillimit të luftërave. Pas përfundimit të LPB-së e kryesisht pas përfundimit të LDB-së, duke parë pasojat si dhe duke pasur parasysh që gjatë kohës së zhvillimit të këtyre luftërave u kryen shumë veprime të kundërligjshme, veprime çnjerëzore, shkatërrime në masë, kryesisht nga udhëheqësit shtetërorë dhe ushtarakë, kështu fuqitë aleate, që dolën fitimtarë të LDB-së, e panë të patjetërsueshme që kriminelë të tillë të ndëshkoheshin. Falë saj u krijua Gjykata e Nurembergut, e cila ishte kompetente për të gjykuar kriminelët që kryen krime gjatë zhvillimit të LDB-së (Kambovski,1998:381).

Gjithashtu është parë e nevojshme që të ekzistojnë rregulla juridike të cilat do të rregullojnë përgjegjësinë penale të personave fizikë në territorin e një shteti –shtetas të të cilit nuk janë të kryejnë vepra penale dhe t'i ikin përgjegjësisë penale duke u fshehur në territorin e një shteti, shtetas të të cilit janë ose në territorin e shtetit të tretë me tendencë që të keqpërdoren rregullat juridike të legjislacionit nacional, të cilat shtetet i parashohin me qëllim të mbrojtjes së shtetasve të tyre jashtë territorit shtetëror.

Themelimi i gjykatës së Nurembergut dhe vënia e kriminelëve para përgjegjësisë sepse gjatë LDB-së kanë kryer krime që cenojnë paqen, krime kundër njerëzimit, krime agresioni dhe krime lufte, është një kthesë kyçe që shënon fillesat e së drejtës penale ndërkombëtare.

2.3. Burimet e së drejtës ndërkombëtare penale

Natyra dhe struktura komplekse e së drejtës ndërkombëtare penale është e theksuar edhe në lidhje me veprimin e burimeve, se cilat burime duhet aplikuar ose cilat kanë primat, burimet nacionale ose ato ndërkombëtare (Kambovski, 1998:41). Lidhur me këtë çështje, shtetet varësisht se cilin sistem kanë përqafuar, një çështje të tillë e rregullojnë në mënyra të ndryshme. Për shembull, në Republikën e Maqedonisë është e paraparë se marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat ratifikohen në pajtim me Kushtetutën, janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj (neni 18 i Kushtetutës së RM-së), kurse gjykatat, gjatë gjykimit, veprojnë në bazë Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën (neni 98 i Kushtetutës së RM-së), (Kambovski, 1998:42).

Meqenëse e drejta ndërkombëtare penale është ende në zhvillim e sipër, shumë dispozita të saj nuk janë ende të kompletuara në krahasim me të drejtën penale (Cassese, 2003:17).

E drejta penale ndërkombëtare shfrytëzon shumë burime, të cilat duke u bazuar edhe në strukturën e saj janë të llojllojshme, si: konventat ndërkombëtare, zakonet ndërkombëtare, statutet e Tribunaleve dhe të Gjykatave Ndërkombëtare, vendimet e mëparshme të Tribunaleve dhe të Gjykatave Ndërkombëtare, parimet e përgjithshme të së drejtës, të njohura nga bashkësia ndërkombëtare si dhe mendimet e ekspertëve dhe doktrinën juridike.

Meqë e drejta penale ndërkombëtare ende nuk është e unifikuar dhe e kodifikuar, secili prej këtyre burimeve e ka rëndësinë e vet dhe kontribuon në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme. Pa dyshim, ekzistimi dhe funksionimi i Tribunaleve dhe Gjykatave Ndërkombëtare, ka kontribuar shumë edhe për sa i përket aspektit të vendosjes së parimeve të caktuara, lidhur me atë se cilat janë burimet në të cilat duhet të bazohen këto Tribunale dhe gjykata gjatë punës së tyre.

Statutet e Tribunalit të Nurembergut, të Tokios, të Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë, të Tribunalit të Ruandës si dhe Statuti i Romës për GJPN-në, vendosën parime lidhur me të drejtën materiale dhe procedurale të veprimtarisë së tyre.

Sipas Statutit të Romës, dispozitat ligjore në bazë të të cilave funksionon GJPN-ja, janë:

- Statuti, elementet e krimeve dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave;
- Traktatet e zbatueshme, parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë parimet e pranuar të së drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;
- Parimet e përgjithshme të së drejtës, që nxirren nga ligjet vendëse të sistemeve ligjore të botës, ligjet vendëse të gjykatave, që normalisht do të ushtronin juridiksionin mbi krimin me kusht që këto parime të mos jenë në kundërshtim me këtë Statut dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe normat e standardet e njohura ndërkombëtarisht;
- Gjykata mund të zbatojë parimet dhe rregullat ligjore, të interpretuara më parë në vendimet e saj.

Zbatimi dhe interpretimi i ligjit duhet të jetë në pajtim me të drejtat e njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht dhe pa asnjë dallim të bazuar në gjini, në moshë, në racë, në ngjyrë, në

origjinë kombëtare, etnike ose sociale, në pasuri, në bindje ose në ndonjë status tjetër (neni 21).

Parimet e përgjithshme të ligjit penal, i mbrojnë individët nga hetimi, nga ndjekja, nga gjykimi dhe dënimi, dhe nga veprimi në mënyrë arbitrare i organeve shtetërore.

Për nga rëndësia e tyre dispozitat e përmbajtura në statute mund të barazohen me konventat ndërkombëtare, gjë të cilën Dhoma e Apelit e TPNJ-së e ka konfirmuar në shumë vendime të saj (Cassese,2003:15).

2.4. Konventat për krimet e dënueshme ndërkombëtare

Shkeljet e së drejtës ndërkombëtare, që paraqesin krime të së drejtës ndërkombëtare, janë të inkriminuara në shumë konventa ndërkombëtare, në statute dhe në rregullore të institucioneve ndërkombëtare, në statute të Tribunaleve Ndërkombëtare Penale si dhe në Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare dhe në shumicën e legjislacioneve nacionale.

Nga evolucioni i së drejtës penale ndërkombëtare mund të shohim se vetë procesi i inkriminimit të veprimeve të caktuara nga subjekte të ndryshme, si krime ndërkombëtare, ka qenë shumë i gjatë.

Është dashur të kalojë një kohë e gjatë që veprime të tilla të statutohen dhe të zënë vendin e duhur në piramidën legjislative kombëtare dhe ndërkombëtare. Vështirësia e inkriminimit të veprimeve të tilla si krime ndërkombëtare të dënueshme, është determinuar ndoshta edhe nga cilësia e subjekteve që mund të paraqiten si kryerës të mundshëm të krimeve ndërkombëtare. Gjithashtu, faktorë tjetër në prolongimin e gjatë të inkriminimit të këtyre

veprimeve si dhe gjykimit të personave që kryejnë veprime të cilësuar si krime ndërkombëtare, ka qenë edhe hezitimi dhe refuzimi i shteteve që ta bëjnë një gjë të tillë nga arsyeja se shtetet është dashur të heqin dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre të cilin e kanë kuptuar si absolut.

Shumica e veprimeve të inkriminuara si krime ndërkombëtare mund të kryhen gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura, qofshin ato kombëtare apo ndërkombëtare, por jo vetëm, sepse tani në shumicën e legjislacioneve bashkëkohore inkriminohen si krime ndërkombëtare, që nuk parashkruhen, edhe veprime që kryhen në kohë paqeje, të tilla si terrorizmi, kriminaliteti kompjuterik, korrupsioni, kriminaliteti ekonomik etj.

Krijimi i Tribunaleve të Nurembergut dhe Tokios pas përfundimit të LDB-së, i ka dhënë fund mospërgjegjësisë dhe mosndëshkimit të atyre që kanë kryer krime ndërkombëtare. Gjatë vënies para përgjegjësisë penale ndërkombëtare të personave të tillë para Tribunaleve, problem kyç ka qenë parimi i ligjshmërisë, i cili nënkupton se askush nuk mund të gjykohej dhe të dënohej për veprime të cilat para se të kryhen nuk janë paraparë me ligj. Gjegjësisht ka qenë arsyetimi për shkeljen e parimit të ligjshmërisë, me të cilin kriminelët kanë dashur të mbrohen dhe t'i ikin përgjegjësisë penale. Mirëpo, ky arsyetim si i tillë nuk ka qëndruar për faktin se veprimet e cilësuar si krime ndërkombëtare janë paraparë edhe me shumicën e legjislacioneve nacionale ose në të drejtën zakonore ndërkombëtare si, p.sh. vrasja, tortura, përdhunimi etj., edhe pse ndoshta jo të cilësuar deklarativisht si krime ndërkombëtare, të cilat tani inkriminohen si nga legjislacionet nacionale, ashtu edhe nga konventat ndërkombëtare ose nga statutet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si krime ndërkombëtare.

Parimi *nullum crimen sine lege*, gjithashtu, paraqet pengesë për Tribunalet ose Gjykatat Ndërkombëtare në aplikimin e një numri më të madh ose më të vogël të konventave ndërkombëtare, sepse gjykatës ndërkombëtare nuk i lejohet të aplikojë dispozita të një konvente për një lloj të caktuar krimi mbi të cilin nuk ka kompetencë. Për shembull nëse statuti i një Tribunali ose i një Gjykate përcakton kompetencë vetëm për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, atëherë Tribunali ose Gjykata nuk mund të aplikojnë dispozita të një konvente që ka të bëjë me krimet e luftës dhe ta marrë në pyetje të akuzuarin për një lloj të tillë krimi (Cassese,2003:16).

Në shumëllojshmërinë e mekanizmave ligjorë ndërkombëtarë, ekzistojnë edhe shumë konventa ndërkombëtare të cilat inkriminojnë veprimet e cilësuar si krime ndërkombëtare. Traktatet ndërkombëtare mund të klasifikohen në bazë të disa kriterëve, por sipas lëndës, objektivave, formës, mënyrës së lidhjes, kohës sa do të jenë në fuqi, hapësirës gjeografike, mundësisë së aderimit etj. Sipas veprimeve të normave juridike traktatet ndahen në traktate ligje ose normavënëse, dhe traktate kontrata (Gruda,2007:56).

Nëpërmjet traktateve ligje ose normavënëse kontraktohen rregulla të reja të sjelljes ose vërtetohen rregullat ekzistuese, përkufizohen ose obligohen rregullat ekzistuese zakonore ose kontraktuese të karakterit të përgjithshëm dhe njëherit këto traktate janë burim i drejtpërdrejtë i së drejtës ndërkombëtare (Gruda,2007:56).

Traktatet kontrata janë marrëveshje midis dy ose disa shteteve dhe kanë për objekt rregullimin e një çështjeje të caktuar midis atyre shteteve (Gruda,2007:57).

Konventat, të cilat janë të përshtatshme për materien e së drejtës ndërkombëtare penale janë ato që përmbajnë rregulla materiale të së drejtës ndërkombëtare humanitare si, për shembull, dispozitat e përmbajtura në konventën e katërt të Hagës të v.1907, katër

konventat e Gjenevës të v.1949, dy protokollet plotësuese të Gjenevës të v.1977, pastaj konventat që kanë të bëjnë me krime të tjera ndërkombëtare si, për shembull, Konventa për Gjenocid e v.1948, Konventa kundër torturës e v.1984, konventat e ndryshme për terrorizëm e të tjera (Cassese,2003:16).

Gjithashtu, të kësaj rëndësie janë edhe Statutet e Tribunaleve Ndërkombëtare *ad hoc* si dhe Statuti i Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare.

Konventat ndërkombëtare, të cilat miratohen nga ana e organizatave me karakter ndërkombëtar, janë burim shumë i rëndësishëm i së drejtës penale ndërkombëtare, dhe si të tilla me ratifikimin nga shtetet nacionale bëhen pjesë e legjislacioneve nacionale të detyrueshme për shtetet. Mënyra e ratifikimit dhe e hyrjes në fuqi të konventave ndërkombëtare në shtetin nacional, mund të jetë e ndryshme varësisht nga ajo që cilin sistem ka paraparë shteti i caktuar.

Përveç konventave ndërkombëtare dhe normave të përmbajtura në Statutet e Tribunaleve *ad hoc* ose Statutit të Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, në teori përmenden edhe burime të tjera të cilat janë të rëndësishme si për teorinë e së drejtës penale ndërkombëtare, ashtu edhe për praktikën. Duke pasur parasysh faktin, se e drejta penale ndërkombëtare është degë e së drejtës ndërkombëtare publike, mund të konkludojmë se burimet juridike të së drejtës ndërkombëtare publike, njëherit mund të jenë edhe burime dytësore të së drejtës ndërkombëtare penale, të tilla si: e drejta zakonore, marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe midis shteteve, parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare për krimet dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, parimet e përgjithshme të së drejtës penale të pranura nga bashkësia ndërkombëtare, rregulloret e ndryshme dhe

rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare si dhe vendimet gjyqësore e mendimet e ekspertëve (Cassese,2003:13-26).

2.5. E drejta zakonore

Gati se në të gjitha fushat e së drejtës, e drejta zakonore paraqitet si burim plotësues, në raste kur në praktikë ndeshemi me zbrazëtira juridike, mirëpo nënkuptohet vetëm në raste të caktuara. E drejta zakonore mund të merret si burim i së drejtës në rastet e caktuara kur ajo sanksionohet me norma ligjore nga ana e organit ligjdhënës. Kjo vlen për shtetet me sistem kontinental, kurse në vendet me sistem anglosakson e drejta zakonore llogaritet burim i drejtpërdrejtë i së drejtës.

E drejta zakonore si burimi së drejtës është karakteristikë i së drejtës ndërkombëtare publike e cila konsiderohet në rastet kur janë plotësuar dy kushte edhe atë: praktika e përhershme e shteteve relativisht e uniformuar lidhur me një çështje të caktuar si dhe bindja e shteteve se një praktikë e caktuar është juridikisht e detyrueshme. (Sean D. Murphy, 2006:78)

Vendet të cilat bëjnë pjesë në sistemin anglosakson kryesisht bazohen në precedentin gjyqësor gjatë marrjes së vendimit gjegjësisht në qoftë se një rast i mëparshëm është i ngjashëm me rastin aktual, që është duke u gjykuar, atëherë vendoset duke u bazuar në aktgjykimin e mëparshëm. E drejta ndërkombëtare penale ka shumë ngjashmëri me vendet ku aplikohet e drejta zakonore si p.sh. Anglia, ku përkrah veprave penale të parashikuara me ligj ekzistojnë edhe shumë vepra penale të cilat janë të parapara në të drejtën zakonore që janë zhvilluar nga rastet e mëparshme gjyqësore, mirëpo në të drejtën penale

ndërkombëtare për dallim nga Anglia, mangësitë, që burojnë nga e drejta e pashkruar, janë shumë më të theksuara. Kjo për faktin se në Angli ka pasur një periudhë disashekullore, periudhë gjatë së cilës aplikohet e drejta zakonore si edhe një numër të konsiderueshëm precedentësh gjyqësorë, që ekzistojnë si rezultat i praktikës së gjatë të funksionimit të gjykatave (Cassese,2003:17). Në të kundërt të kësaj, sistemi kontinental bazohet vetëm në të drejtën e shkruar, kurse e drejta zakonore mund të bëhet burim i së drejtës vetëm në qoftë se sanksionohet me norma ligjore.

Për sa i përket së drejtës penale ndërkombëtare si dhe duke parë praktikën e veprimit të Tribunaleve Ndërkombëtare dhe të Gjykatës Penale Ndërkombëtare mund të themi se zbatohet një sistem i përzier, ku fillimisht për gjykimin e çështjeve, që paraqiten, merren normat e statuteve ose të konventave ndërkombëtare, por gjithashtu pa lënë anash edhe rregullat e së drejtës zakonore, ku në shumë raste gjykata ndërkombëtare bazohet në rregullat e së drejtës zakonore për të përcaktuar përmbajtjen dhe formën e ndonjë rregulle ndërkombëtare, që ka të bëjë me veprim të dëmshëm, duke mos caktuar paraprakisht veprimin e ndaluar (Cassese,2003:18).

Gjithashtu faktorë tjetër determinues lidhur me dominimin e të drejtës zakonore në të drejtën ndërkombëtare penale, është edhe fakti se konventa, gjegjësisht dispozitat e shkruara, që rregullojnë materien e së drejtës penale ndërkombëtare, ende janë shumë pak dhe nuk e mbulojnë gamën e gjerë të rasteve, të cilat paraqiten për zgjidhje para Tribunaleve ose Gjykatave Ndërkombëtare.

2.6. Parimet e përgjithshme të së drejtës penale të pranuar nga bashkësia ndërkombëtare

Parimet e përgjithshme të së drejtës, të pranuar nga kombet e qytetëruara si burim i së drejtës ndërkombëtare, janë të përfshirë në nenin 38 të Statutit të Gjykatës së përhershme për të drejtën ndërkombëtare, i cili paraqitet si burim plotësues (Marphy,2006:86).

Nevoja për shfrytëzimin e një burimi të tillë plotësues, në të drejtën ndërkombëtare, lind në rastet e paraqitjes së zbrazëtirave juridike, të cilat mund të paraqiten në të gjitha sistemet juridike (Shaw,2008:81), e aq më shumë në të drejtën penale ndërkombëtare që nuk ka një legjislacion të unifikuar. Parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mund të shfrytëzohen në rastet kur marrëveshjet ose rregullat zakonore nuk janë të qarta dhe të plota, atëherë gjykata mund të thirret në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Gjatë gjykimeve të shumta, të zhvilluara para TPNJ-së, në shumë vendime është theksuar nevoja dhe mundësia që Tribunali të bazohet në parimet e përgjithshme të së drejtës si, p.sh. gjatë procedimit të rastit kundër Kupreshkiq-it dhe të tjerët nga TPNJ-ja, Dhoma Gjyqësore II vendosi se në secilin rast kur me Statut nuk rregullohet një materie e caktuar, Tribunali ka të drejtë të kërkojë zgjidhje nga normat zakonore, nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare penale, si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës penale, të njohura nga sistemet juridike më të mëdha të botës ose nga parimet e përgjithshme të së drejtës që janë në pajtim me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare (Cassese,2003:21).

Çdoherë kur gjykata gjatë zgjidhjes së një rasti gjen se nuk ka ligj që e mbulon plotësisht atë pikë, atëherë ajo mundohet të gjejë ndonjë rregull të përshtatshëm nëpërmjet parimeve

të përgjithshme, që udhëheqin sistemin juridik, pa marrë parasysh se parime të tilla e kanë bazën në drejtësi, në barazi apo të respektit për politikën publike (Shaw,2008:81).

Parimet e përgjithshme juridike paraqesin rregullat që janë zhvilluar në të drejtën e brendshme të shteteve dhe janë parime fundamentale të drejtësisë të pranuar nga vetëdija juridike e përgjithshme, të tilla si: parimi mbi çështjen e gjykuar-*res judicata*, parimi që askush s'mundet të përfitojë nga faji i vet, parimi i ndalimit të keqpërdorimit të së drejtës, parimi i përgjegjësisë që lind nga aktet e paligjshme dhe rikthimi i asaj që është fituar nga pasurimi i pabazë (Gruda2007:61), parimi se askush nuk mund të jetë gjyqtar i rastit personal, parimi i respektimit të marrëveshjeve, parimi i mospërzierjes së një shteti në punët e shtetit tjetër, parimi i barazisë juridike të shteteve, parimi i mosdiskriminimit në bazë racore, gjinore, të përkatësisë fetare (Marphy,2006:86-87), dhe parimet të tjera të cilat janë formuluar nga të drejtat nacionale dhe në bazë të një analogjie mund të përdoren edhe në të drejtën ndërkombëtare.

2.7. Vendimet gjyqësore

Vendimet gjyqësore, si burime të së drejtës ndërkombëtare, paraqiten vetëm si burime ndihmëse ose plotësuese. Në shumicën e legjislacioneve nacionale, me sistem kontinental, vendimet gjyqësore kanë fuqi juridike vetëm për rastin për të cilin është vendosur dhe palët, që janë subjekt i vendimit të tillë, dhe si i tillë nuk mund të ketë kurrfarë fuqie juridike për rastet e ardhshme të ngjashme. Në sistemet juridike me sistem anglosakson vendimet gjyqësore, duke u bazuar në të ashtuquajturën doktrinë të precedentëve gjyqësore, merren si bazë kur vendoset për ndonjë çështje të ngjashme. Në të drejtën ndërkombëtare vendimet

gjyqësore janë vetëm burime ndihmëse dhe si të tilla ato i ndihmojnë gjykatat për sqarimin ose ekzistencës së rregullave zbatuese në të drejtën ndërkombëtare (Murphy,2006:88).

Nga praktika e funksionimit të Gjykatave Ndërkombëtare dhe të Tribunaleve mund të konstatohet se në shumë raste vendimet e mëparshme merren parasysh gjatë vendosjes së çështjeve të ndryshme që paraqiten. Një praktikë e tillë është zbatuar edhe ndoshta si rezultat i ekzistencës së normave dhe rregullave të shumta të përmbajtura në shumë konventa dhe dokumente të tjera ndërkombëtare dhe një Gjykatë ose Tribunal për të mos përsëritur punën e njëjtë që ka bërë Gjykata ose Tribunali tjetër, i cili gjatë marrjes së një vendimi ka përmbledhur të gjitha burimet e përshtatshme, dhe vetëm atëherë mund të bëjë analizën e këtyre burimeve dhe t'i shfrytëzojë për vendimin që do të marrë. (Murphy,2006:88).

Pra, roli i gjykatave nuk është për të krijuar të drejtën, por për ta zbatuar në raste të caktuara dhe vendimet e gjykatave kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, për shkak të kategorive juridike të ndryshme që trajtojnë (Gruda,2007:62).

2.8. Mendimet e ekspertëve ose doktrina e së drejtës ndërkombëtare

Doktrina e së drejtës ndërkombëtare gjithashtu paraqet një mjet ndihmës gjatë zbatimit të së drejtës nga ana e gjykatave.

Doktrina e së drejtës ndërkombëtare penale është disiplinë shkencore e cila merret me studimin e pandërprerë të instituteve themelore të së drejtës ndërkombëtare penale, gjegjësisht të sistemit të normave penalo-juridike nacionale dhe ndërkombëtare të cilat janë

të ndërlidhura me marrëdhënie ndërkombëtare si dhe me normat dhe standardet supranacionale (Kambovski,1998:48).

Vështruar historikisht, doktrina juridike ka kontribuar në masë të madhe në sqarimin e rregullave ndërkombëtare (Shaw,2008:89&Cassese,2003:27). Sidomos i rëndësishëm ka qenë roli i autorëve të shquar në rastet kur s'ka ekzistuar ndonjë traktat ndërkombëtar dhe kur në mungesë të burimeve më të sigurta është dashur të kërkohet zgjidhje në zakone ose në praktikat e popujve të qytetëruar (Gruda,2007:62).

E drejta ndërkombëtare në përgjithësi si dhe e drejta ndërkombëtare penale, nga objekti i studimit si dhe të subjekteve, janë degë të së drejtës më specifike, krahasuar me degët e tjera të së drejtës. Këtu si element kryesor na paraqitet elementi ndërkombëtar i cili ngërthen në vetvete shumë elemente të shteteve të ndryshme duke bërë të njëjtin, por paksa më të ndërlikuar. Edhe në vazhden e burimeve juridike, në të cilat bazohet dhe funksionon e drejta ndërkombëtare publike, ato janë të shumta dhe të llojllojshme. Edhe pse shumica e tyre bazën e ka në të drejtën kombëtare, përsëri elementi ndërkombëtar i tyre i bën më specifike dhe nga këtu më të vështira dhe më të ndërlikuara për t'u sqaruar dhe për t'u zbatuar nga ana e shteteve, gjykatave, organizatave ose institucioneve të tjera me karakter kombëtar ose ndërkombëtar.

KAPITULLI III: TRIBUNALET NDËRKOMBËTARE AD-HOC DHE GJYKATA PENALE NDËRKOMBËTARE

3.1. Nocioni

Në të kaluarën lufta ka qenë mjeti kryesor me anë të të cilit shtetet i kanë zgjidhur mosmarrëveshjet midis tyre. Ajo është llogaritur si diçka normale, si një e drejtë e shteteve që të rikthejnë të drejtat e tyre të shkelura nga një veprim ose mosveprim i shtetit tjetër. Me kalimin e kohës njerëzit janë vetëdijesuar për dëmet që shkaktohen nga zhvillimet e luftërave, prandaj kanë filluar të kërkojnë mjete dhe metoda të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve krejt me qëllimin e parandalimit të tyre, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur. Nga një pamundësi që të gjenden forma për eliminimin e luftërave nga praktika e veprimeve të shteteve, është tentuar që së paku të humanizohen ato. Si rezultat i kësaj, nga ana e shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare është bërë një aktivitet i vrullshëm për sjelljen dhe miratimin e shumë konventave ndërkombëtare të cilat përmbajnë parime dhe rregulla për humanizimin e veprimeve gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, me tendencë që konventa të tilla të bëhen të detyrueshme për shtetet.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore u krijua Lidhja e Kombeve, organizatë e cila në statutin e saj mbajti qëndrim negativ ndaj ndërmarrjes dhe zhvillimit të veprimeve luftarake (Gruda,2007:535).

Mirëpo, në këtë drejtim, moseskësi i kësaj organizate, u vërejt me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës u kryen shumë veprime në kundërshtim me rregullat ndërkombëtare lidhur me humanizimin e luftërave.

Një hap progresiv në këtë drejtim u hodh pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, me themelimin fillimisht të Gjykatës së Nurembergut e më pastaj edhe të Tokios. Fuqitë aleate, në prag të mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, u zotuan se krimet e kryera në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, përgjatë zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore, nuk do të mbeten të pandëshkuara dhe në vitin 1945 me marrëveshjen e Londrës u krijua Gjykata Ndërkombëtare Ushtarake ose Gjykata e Nurembergut, e cila ishte kompetente që të gjykojë kriminelët që gjatë zhvillimit të LDB-së kryen krime lufte, krime kundër njerëzimit, krime gjenocidi dhe krime agresioni (Kambovski,1998:383).

Duke u bazuar në parimet e Gjykatës së Nurembergut, u krijua edhe Gjykata e Tokios, kompetente për të gjykuar kriminelët japonezë që, gjatë okupimit japonez, kryen krime lufte ndaj shumë kombeve të Azisë Juglindore (Cassese,2003:319).

Ndërkohë pas përfundimit të punës së dy Tribunaleve *ad-hoc*, të krijuara pas LDB-së, u krijua Tribunali Ndërkombëtar për gjykimin e kriminelëve, që kryen krime lufte në territorin e ish-Jugosllavisë. Ky Tribunal u krijua në vitin 1993 prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Kittichaisaree,2001:22).

Në bazë të modelit të Tribunalit të Hagës për krimet e luftës në territorin e ish-Jugosllavisë, u krijua, në vitin 1994, nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Cassese,2003:327&Kittichaisaree,2001:24) edhe Tribunali *ad-hoc* për gjykimin e kriminelëve, që kryen krime gjatë zhvillimit të luftës civile në Ruandë.

Krijimi i Tribunaleve *ad-hoc* edhe pse ishte një arritje shumë e madhe e së drejtës ndërkombëtare penale, ideja që të krijohet një Gjykatë Penale Ndërkombëtare me status të përhershëm ishte e kahmotshme. Në vitin 1980, shtetet latino-amerikane, të udhëhequra nga Trinidad dhe Tobago, para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, bënë një propozim për

krijimin e një gjykate të përhershme për gjykimin e liderëve të drogës në suaza ndërkombëtare. Mirëpo, një ide e tillë u realizua shumë më vonë, gjegjësisht me 17 korrik të vitit 1998; në konferencën diplomatike të mbajtur në Romë, u miratua Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare (Kittichaisaree,2001:27&Gruda,2003:535).

Themelimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është një sukses i madh i së drejtës ndërkombëtare penale, sepse kjo Gjykatë paraqet një siguri të fortë se asnjë kriminel, që ka kryer ose kryen krime, nuk do të mbetet pa u gjykuar dhe pa u ndëshkuar, pa marrë parasysh se ku do të fshihet ose sa kohë do të kalojë nga kryerja e krimit. Juridiksioni i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është shumë i gjerë dhe krimet për të cilat kjo gjykatë është kompetente nuk parashkruhen. Përfundimisht, botëkuptimi mbizotërues i së kaluarës se luftërat janë mjete kryesor i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis shteteve tashmë është i tejkaluar dhe sot në botën bashkëkohore janë konsoliduar mjete të tjera, me ndihmën e të cilave shtetet tentojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet midis tyre.

3.2. Tribunali i Nurembergut dhe Tokios

Mosekzistenca e një gjykate në suaza ndërkombëtare për gjykimin e kriminelëve të luftës, si dhe realiteti i pamohueshëm se gjatë zhvillimit të luftërave u kryhen shumë krime ndërkombëtare, bëri që të krijohen Tribunalet *ad-hoc*, si një shpëtim i përkohshëm nga pamundësia për të gjykuar kriminelët e luftës. Vazhdimisht në arenën ndërkombëtare, gjatë zhvillimit të luftërave të ndryshme në rruzullin tokësor, përgjatë historisë, opinionin publik ka qenë dëshmitar i kryerjes së krimeve që cenojnë rëndë të drejtën ndërkombëtare, dhe nga fakti i mosekzistencës së një legjislacioni të përshtatshëm dhe një organi kompetent për gjykimin e veprimeve të tilla, u krijuan Tribunalet *ad-hoc*. Ideja e parë për krijimin e një

gjykate penale ndërkombëtare të përhershme i atribuohet zviceranit, Maynier, i cili në vitin 1872, para komitetit ndërkombëtar për ndihmë të plagosurve gjatë luftës, kishte propozuar krijimin e një gjykate të përbërë nga pesë anëtarë, një gjyqtar prej secilit shtet në konflikt si dhe tre gjyqtarë nga vendet neutrale. Kjo gjykatë do të kishte juridiksion për gjykimet e veprave të përmbajtura në Konventën e Gjenevës të vitit 1864 (Kambovski,1998:377).

Pas përfundimit të LPB-së pati disa tentativa për të nxjerrë para drejtësisë dhe të gjykohen kriminelët që kryen krime përgjatë LPB-së, mirëpo tentativa të tillë ishin të pasuksesshme. Një komision i përbërë nga fuqitë aleate fitimtare, propozoi që të formohej një Tribunal Ndërkombëtar, i cili do të gjykonte funksionarët dhe udhëheqësit e lartë shtetërorë që thyen rregullat e luftës dhe rregullat ndërkombëtare humanitare, përfshirë Kajzerin gjerman Wilhelm II. Një propozimi i tillë dështoi për arsye se Wilhelm II u strehua në Holandë, e cila refuzoi ta ekstradonte me arsyetimin se veprat për të cilat akuzohej Wilhelm II, nuk përbënin shkelje sipas së drejtës holandeze (Shaw,2008:334). Edhe Lidhja e Kombeve, organizata ndërkombëtare, që u krijua pas LPB-së, qëllimi i së cilës ishte rivendosja dhe ruajtja e paqes në suaza ndërkombëtare, në Statutin e saj mbajti qëndrim negativ ndaj ndërmarrjes së veprimeve luftarake, duke konstatuar se kushdo që bën një veprim të tillë duhet të dënohet (Gruda,2007:535).

Gjatë zhvillimit të LDB-së, u cenuan shumë rëndë rregullat e së drejtës ndërkombëtare duke u kryen shumë krime të rënda. Duke qenë pjesë e atij realiteti të hidhur dhe duke ndier pasojat e atyre veprimeve fuqitë aleate u zotuan se pas përfundimit të luftës, nuk do të mbeten të pandëshkuar të gjithë ata që shkelën rëndë zakonet dhe rregullat e luftës, nuk respektuan rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, kryen krime të rënda kundër njerëzimit dhe krime agresioni.

Në Konferencën e Londrës fuqitë e mëdha vendosën krijimin e një Gjykate ndërkombëtare ushtarake, e cila u konkretizua me Marrëveshjen e Nurembergut, me qëllim të ndjekjes së kriminelëve ushtarakë nazistë të rangut më të lartë, të cilët kryen krime kundër paqes, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit (Cassese,2003:327).

Për të arritur të themelimi i Tribunalit të Nurembergut u desh të kalohen vështirësi juridike dhe procedurale. Së pari, nuk kishte asnjë precedent për një gjykim ndërkombëtar të kriminelëve të luftës. Ka pasur raste të mëparshme të ndjekjes për krime të luftës, të tilla si ai i ekzekutimit të oficerit të ushtrisë aleate, Henry Wirz (1823-65), për keqtrajtimin e të burgosurve të luftës së *Unionit* gjatë Luftës Civile Amerikane (1861-65) dhe për të ndëshkuar ata që janë përgjegjës për gjenocidin armen të viteve 1915-16 nga gjykatat luftarake të mbajtura nga Turqia në vitet 1919-20. Megjithatë, këto ishin gjykimet e mbajtura në bazë të ligjeve të një kombi të vetëm në vende të caktuara, kurse në rastin e Tribunalit të Nurembergut, gjykimet do të jepeshin nga një grup i përbërë prej katër fuqive (Franca, Britania, Bashkimi Sovjetik dhe SHBA-ja), të cilat kishin tradita dhe praktika të ndryshme ligjore.³

Në Statutin e Gjykatës së Nurembergut, të përbërë nga katër gjykatës, nga katër zëvendës të tyre si edhe nga katër prokurorë, janë paraparë të gjitha çështjet formale, procedurale dhe materiale në lidhje me funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës. Në Statut janë përcaktuar edhe veprat për të cilat Gjykata ka qenë kompetente për krime kundër paqes: për përgatitje,

³ http://www.history.com/topics/world-war-ii/nuremberg-trials#section_1 (shikuar me date 26.04.2016 në ora 20.32)

nxitje, ndërmarrje ose fillim të luftës agresive ose të luftës ku shkelen marrëveshjet ndërkombëtare ose edhe pjesëmarrja në konspiracion për kryerjen e cilësdo nga veprat e mëparshme; për krime lufte gjegjësisht për shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës ku hyjnë keqtrajtimet, deportimi në punë të dhunshme i popullatës civile, kanosjet dhe keqtrajtimet e robërve të luftës ose personave në det, vrasja e pengjeve, plaçkitja e pronës publike dhe private si dhe shkatërrimi i paarsyeshëm i qyteteve, qytezave ose fshatrave, nëse kjo është bërë jo për shkak të nevojave ushtarake, po për krime kundër njerëzimit: vrasja, deportimi, skllavërimi dhe akte të tjera johumane të ndërmarra kundër popullsisë civile, para luftës ose gjatë luftës, ose ndjekjet për arsye politike, racore a fetare pa marrë parasysh nëse me këtë bëhet shkelja e së drejtës së shtetit ku janë kryer krimet (Gruda,2007:152).

Gjykata e Nurembergut funksionoi nga 20 nëntori i vitit 1945 deri më 1 tetor të vitit 1946, periudhë gjatë së cilës, gjykata e Nurembergut ka shpallur fajtorë dhe ka dënuar 12 vetë me vdekje, tre persona me burgim të përjetshëm dhe katër persona me burgim prej 10 deri në 20 vjet (Gruda,2007:152).

Nga Tribunali i Nurembergut ishin paditur njëzet e katër persona, së bashku me gjashtë organizata naziste të cilat supozohej se janë të penalizuara (të tilla si " Gestapo ", apo policia e fshehtë e shtetit). Një nga të akuzuarit, për arsye shëndetësore, u vlerësua i paaftë për të dalë në gjyq, ndërsa një tjetër vrau veten para se të fillonte gjykimi. Hitleri dhe dy bashkëpunëtorët e tij më të lartë, Heinrich Himmler (1900-1945) dhe Joseph Goebbels

(1897-1945), kishin kryer vetëvrasje në pranverën e vitit 1945 para se të nxirreshin para gjyqit.⁴

Në Statutin e Nurembergut janë paraparë edhe parime lidhur me përgjegjësinë për vepra penale ndërkombëtare, të cilat llogariten edhe si parime themelore të së drejtës ndërkombëtare penale. Organizatorët, udhëheqësit dhe bashkëpunëtorët e bashkimit kriminal, përgjigjen për të gjitha veprat që janë kryer nga cilido anëtar i grupit; gjykata mundet që organizatat, grupet, partitë ose qeveritë, udhëheqësit e të cilave shpallen si kriminelë lufte, t'i shpallë kriminale si dhe të gjithë pjesëtarët e grupacioneve të tilla të vihen në përgjegjësi para Gjykatës. Pozita zyrtare e atyre që kanë kryer krime si, për shembull, shef i shtetit ose një person që ka pozitë zyrtare në administratën e shteteve nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale dhe pozita nuk mund të jetë bazë për zbutjen e dënimit. Fakti që i akuzuari ka vepruar në pajtim me urdhrat e qeverisë ose të udhëheqësit nuk është bazë për lirimin nga përgjegjësia, por mund të jetë arsye për zbutjen e dënimit (Kambovski,1998:377).

Tribunali i Tokios - Gjykata ndërkombëtare ushtarake për lindjen e largët ose e njohur si Gjykata e Tokios veproi mbi parime të njëjta si Gjykata e Nurembergut (Kambovski,1998:381), e themeluar nga ana e udhëheqësit ushtarak suprem të SHBA-së në Japoni në vitin 1946 (Kittichaisaree,2001:19), për të gjykuar kriminelët japonezë, të cilët

⁴ http://www.history.com/topics/world-war-ii/nuremberg-trials#section_1 (parë me datë 26.04.2016, ora

gjatë kohës së okupimit kryen krime në një numër të madh vendesh të kombeve juglindore aziatike.

Të dyshuarit janë klasifikuar në tri grupe: A, B dhe C. Të dyshuarit e grupit A kanë qenë të akuzuar për krime kundër paqes, të dyshuarit e grupit B kanë qenë të akuzuar për krime lufte konvencionale dhe të dyshuarit e grupit C kanë qenë të akuzuar për krime kundër njerëzimit. Tribunali i Tokios ka gjykuar vetëm të akuzuarit e grupit A, kurse ata të grupit B dhe C ia ka lënë për gjykim, gjykatave ushtarake në shtete të ndryshme (Kittichaisaree,2001:19).

Për Tribunalin e Nurembergut dhe atë të Tokios pati shumë kritika që kishin të bënin me krijimin dhe me funksionimin e tyre.

Tribunali i Nurembergut ka qenë i diskutueshëm edhe në mesin e atyre që dëshironin ndëshkimin e kriminelëve më të mëdhenj. Kështu, Harlan Stone, në atë kohë shef i Gjykatës së Lartë të SHBA-së, i përshkroi punimet si një "mashtim moralizues" dhe si një "parti të nivelit të lartë për linçim", kurse William O. Douglas, bashkëpunëtor i Gjykatës së Lartë të SHBA-së tha se aleatët në Nuremberg "zëvendësuan fuqinë për parime".

Megjithatë, shumica e vëzhguesve i kanë konsideruar provat një hap përpara për krijimin e së drejtës ndërkombëtare. Gjetjet në Nuremberg çuan drejtpërdrejt në Konventën e Kombeve të Bashkuara të Gjenocidit (1948) dhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, si dhe Konventën e Gjenevës mbi ligjet dhe zakonet e luftës të vitit 1949. Përveç kësaj, Gjykata Ndërkombëtare Ushtarake shërbeu si një precedent i dobishëm për themelimin e Tribunalit për gjykimin e kriminelëve të luftës japoneze në Tokio në vitin 1946-48, gjykimin e liderit nazist Adolf Eichmann në vitin 1961 si dhe krijimin e

gjykatave për krimet e luftës të kryera në ish-Jugosllavi në vitin 1993 dhe në Ruandë në vitin 1994⁵.

Ato kritikoheshin kryesisht për mungesë të parimit të legalitetit, gjegjësisht shkeljes së parimit *nullum crimen, nullum poena sine lege scripta*, pra se nuk ka krim dhe nuk ka dënim pa ligj të shkruar. Një kritikë e tillë nuk mund të ishte e qëndrueshme për vetë faktin se parimi i legalitetit nuk është i kufizuar me sovranitetin e shtetit, por ai paraqet parim të së drejtës. Dhe për pasojë, të mos dënoheshin ata, që duke shkelur konventat dhe parimet ndërkombëtare, sulmojnë shtetin tjetër pa asnjë paralajmërim, duke ndërmarrë veprime që paraqesin shkelje të rënda të rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe të asaj humanitare, me arsyetimin se nuk e kanë ditur që veprime të tilla paraqesin krime, arsyetim që paraqet një të pavërtetë të madhe dhe për pasojë do të mbeten pa u gjykuar krime të tilla që realisht do të ishte e padrejtë (Kittichaisaree,2001:18). Shumica e veprave të inkriminuara, për të cilat ishin kompetente që t'i gjykonin Tribunalet, paraqisnin vepra penale edhe me legjislacionin e brendshëm të shteteve në të cilat ishin kryer krimet. Është shumë e vërtetë se në kohën e themelimit të këtyre Tribunaleve rregullat dhe dispozitat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, ishin të përmbajtura dhe të shpërndara në shumë traktate, në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe si dhe në rregulla zakonore, të cilat nuk kishin një njohje dhe aplikim universal. Por, gjithsesi ato ekzistonin dhe ishin të njohura edhe para themelimit të këtyre Tribunaleve. Fakti i shpërndarjes së këtyre normave dhe rregullave në më shumë akte juridike ndërkombëtare pa dyshim që paraqiste vështirësi për vetë punën e këtyre Tribunaleve, por në asnjë mënyrë një fakt i tillë nuk mund të interpretohej si

⁵ http://www.history.com/topics/world-war-ii/nuremberg-trials#section_1 (shikuar me datë 26.04.2016 në ora 20.22).

mosekzistencë e tyre. Këto Tribunale kishin Statutet, të përpiluara në pajtim me normat ekzistuese të asaj kohe e gjithashtu me përfshirjen edhe të instituteve dhe normave të shumë traktateve dhe konventave të miratuara para themelimit të këtyre Tribunaleve. Të gjitha veprimet e inkriminuara si krime me Statut, kanë qenë krime të njohura botërisht edhe para përfshirjes së tyre në Statutet e këtyre Tribunaleve, por ndoshta me një emërtim ndryshe me çka në asnjë mënyrë nuk është e bazuar kritika se themelimi dhe funksionimi i këtyre Tribunaleve shkel parimin e ligjshmërisë.

Duke u nisur nga subjektet që ishin themeluese të Tribunalit të Nurembergut dhe më pastaj atij të Tokios, gjegjësisht fuqitë aleate që dolën fitimtare nga LDB-ja, ajo kritikohej edhe për atë se këto Tribunale nuk mund të ishin objektive në gjykim.

Me procesin e Nurembergut është tejkaluar një kornizë deri atëherë e pakalueshme lidhur me supremacionin e sistemit të së drejtës ndërkombëtare penale, e ajo është doktrina e sovranitetit absolut të shtetit, gjë e cila i hapi rrugë edhe çështjes tjetër shumë të rëndësishme për të drejtën ndërkombëtare penale, që është parimi i përgjegjësisë individuale ndërkombëtare (Kambovski,1998:383-384).

Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios, si gjykata pioniere në lëmin e gjykimit dhe të ndëshkimit të personave, që gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake kanë shkelur rëndë rregullat e luftës dhe dispozitat ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare humanitare, është normale të kenë patur të meta përkaj risive të shumta me konotacion pozitiv, që përgjithësisht kanë sjellë në të drejtën penale ndërkombëtare, e posaçërisht për sa i përket aspektit të përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Ideja e mospërgjegjësisë së shteteve e sidomos e udhëheqësve të tyre, të cilët nën mbrojtjen e shtetit kryenin veprimet më mizore dhe më çnjerëzore, ishte e rrënjësuar thellë në

vetëdijen e njerëzve, prandaj flakja e një bindjeje të tillë ishte shumë e vështirë. Sepse një gjë e tillë u interesonte shteteve, të cilat duke mbajtur llogari vetëm për interesat e tyre, ishin të gatshëm të shkelnin mbi çdo vlerë dhe të mirë të shoqërisë njerëzore. Dhe për pasojë mbijetonin vetëm më të fuqishmit.

Edhe pse ishte shumë vështirë, dalëngadalë si rezultat i veprimit të shumë faktorëve të ndryshëm, çështjet e të mirave më themelore të njeriut si: jeta, shëndeti, të drejtat, liria e të tjera u ngritën në rang të vlerave më themelore, për të cilat çdo shoqëri duhet të ketë respekt pa asnjë rezervë dhe përjashtim.

Njëra ndër kritikën e para që Tribunalit të Nurembergut, e më pas i adresohet edhe atij të Tokios, është se këto Tribunale u krijuan nga ana e shteteve që ishin fituese të luftës, për të gjykuar humbësit, dhe për pasojë këto Tribunale nuk mund të ishin objektive në gjykim. Është e vërtetë se këto Tribunale u krijuan nga shtetet fitimtare të LDB-së, për të gjykuar kriminelët nazistë dhe japonezë, pjesëtarë të shteteve të cilat humbën LDB-në, një kritikë e cila mbase vetëm pjesërisht mund të ishte e qëndrueshme. Sepse, personat të cilët u gjykuan dhe u ndëshkuan nga Tribunali i Nurembergut dhe Tokios, me të vërtetë kishin kryer krimet për të cilat akuzoheshin, ku në shumicën e gjykimeve të zhvilluara nuk mund të shihej ndonjë paanshmëri. Ndoshta mund të flasim për njëanshmëri duke pasur parasysh subjektet themeluese të këtyre Tribunaleve, gjegjësisht fuqitë fitimtare, të cilat themelimin e këtyre Tribunaleve e shihnin edhe si sanksionim të shtetit në përgjithësi, gjegjësisht shteteve humbëse. Mënyra e themelimit të këtyre Tribunaleve, ndoshta nuk ishte mënyra më e mirë, por që në të tilla rrethana ishte e vetmja mënyrë që siguronte se kriminelë të tillë, me të vërtetë, do të gjykoreshin dhe do të ndëshkoreshin, sepse një detyrim i tillë po t'u lihej në dorë vetë shteteve si, p.sh., Gjermanisë dhe Japonisë, ishte më se e sigurt se nuk do ta bënin

një gjë të tillë, duke pasur parasysh rrethanat të cilat mbizotëronin në atë periudhë në këto shtete.

Tribunali i Nurembergut është Tribunali i Parë Ndërkombëtar i cili arriti të nxjerrë para drejtësisë dhe të dënojë personat të cilët, duke vepruar nga pozitat më të larta shtetërore dhe ushtarake, shkelën rëndë rregullat dhe dispozitat e së drejtës së luftës dhe të së drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, përveç kësaj gjëja më e rëndësishme, që i përshkruhet këtij Tribunali, është vendosja e disa parimeve të cilat më vonë, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën nr. 95 të 11 dhjetorit të v. 1946, u njohën si parime të së drejtës ndërkombëtare dhe këto parime luajtën rol vendimtar në zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës ndërkombëtare penale (Lopiçiç Jançiç, 2011: 383).

Parime të tilla, së bashku edhe me dokumentet e tjera ndërkombëtare për materien e së drejtës penale, për një kohë të gjatë shërbyen si bazament i qëndrueshëm mbi të cilin mund të mbështeteshin veprimet e bashkësisë ndërkombëtare; sa herë që ishte i nevojshëm veprimi i saj lidhur me një shkelje serioze të rregullave të së drejtës ndërkombëtare penale ose të asaj ndërkombëtare humanitare si dhe të konventave e dokumenteve të tjera ndërkombëtare në lëmin e së drejtës ndërkombëtare penale. Sepse, pas themelimit dhe funksionimit të Tribunaleve të Nurembergut dhe të Tokios një herë e përgjithmonë ishte kapërcyer barriera e mosndëshkimit të atyre që kanë kryer krime të rënda që atakonin vlerat më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore.

3.3. Tribunali i Hagës dhe Ruandës

Pas përfundimit të punës së dy Tribunaleve të Nurembergut dhe Tokios, në arenën ndërkombëtare për një kohë mbretëroi një stopim i procesit të gjyqimit dhe ndëshkimit të

kriminelëve, të cilët cenonin të mirat më themelore të njerëzimit; gjegjësisht mosekzistenca e një gjykate, që do të ishte kompetente për gjykimin e krimeve më të rënda, për faktin e vetëm të hezitimit të disa shteteve që, për arsye të shumta, nuk mund të binin dakord lidhur me themelimin e një organi, i cili do të kishte kompetencë ekskluzive në gjykime të tilla. Dhe për pasojë gjendja mbeti pezull për një kohë të gjatë, ndërsa me themelimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe më vonë edhe për Ruandën u gjet vetëm një zgjidhje e përkohshme e problemit, sepse sërish Tribunale të tilla u themeluan si Tribunale të përkohshme, veprimi i të cilave do të shtrihej vetëm mbi një territor të caktuar, çka në fakt paraqiste zgjidhje të pjesshme të problemit. Mirëpo, ngjarjet që ndodhën në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë shpërbërjes së saj dhe ngjarjet e ndodhura në territorin e Ruandës gjatë luftës civile ngjallën sërish interesimin e bashkësisë ndërkombëtare për themelimin e një gjykate penale ndërkombëtare (Shaw,2008:338), me ç'rast përsëri u ndoq modeli i mëparshëm i themelimit, i ngjashëm me Tribunalet e themeluara pas LDB-së, si të përkohshme dhe me veprim të kufizuar në territor, subjekte dhe vepra.

3.4. Tribunali i Hagës

Për dallim nga përvoja e themelimit të Tribunaleve të Nurembergut dhe Tokios, të cilat u krijuan nga fuqitë fituese të LDB-së në një konferencë ndërkombëtare, Tribunali i Hagës dhe ai i Ruandës u themeluan nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, akt të cilit i paraprinë një sërë aktivitetesh.

Në Rezolutat 764 të vitit 1992 dhe 820 të vitit 1993 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilat ishte theksuar brenga për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare,

por dhe ishte vërtetuar përgjegjësia e palëve si dhe përgjegjësia individuale e palëve për shkelje serioze të Konventës së vitit 1949.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, kishte formuar një komision të ekspertëve, i cili ishte përgjegjës që të vërtetojë shkeljet serioze të Konventës së Gjenevës dhe shkeljet e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Ky komision në vitin 1993 kishte formuluar një raport në të cilin kishte konstatuar se në territorin e ish-Jugosllavisë ishin kryer shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë këtu vrasje të qëllimshme, pastrim etnik, vrasje masive, tortura, dhunime, grabitje dhe shkatërrim i pronës private, shkatërrim të trashëgimisë kulturore dhe fetare si dhe arrestime arbitrare (Shaw,2008:338).

Këshilli i Sigurimit i OKB-së duke aplikuar të drejtat e veta nga kreu VII i Kartës së OKB-së, themeloi Tribunalin ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, si organ ndihmës që do të kontribuojë në rinovimin dhe mbrojtjen e paqes në territorin e ish-Jugosllavisë.

Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë u miratua nga Këshilli i Sigurimit më 3 maj të vitit 1993, në bazë të raportit të sekretarit gjeneral të OKB-së (Kittichaisaree, 2001:22-23).

Me statutin e Tribunalit Ndërkombëtar, për ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë, prej vitit 1991, janë të rregulluara të gjitha çështjet formale dhe materiale për gjykimin e personave përgjegjës, përfshirë këtu kompetencën e Tribunalit, inkriminimin e veprimeve, që konsiderohen si shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, për të cilat është kompetent Tribunali Ndërkombëtar i Hagës, juridiksionin individual gjegjësisht përgjegjësinë penale individuale të personave fizikë si dhe juridiksionin hapësinor, parimin

non bis in idem, gjegjësisht parimin se asnjë person nuk mund të gjykohej dy herë për të njëjtën vepër.

Me tej Statuti i Tribunalit të Hagës përmban dispozita lidhur me organizimin e Tribunalit. Ai përbëhet nga tri organe kryesore:

- Dhoma, ku përfshihen tri dhomat Gjyqësore dhe Dhoma e Apelit.
- Prokurori.
- Sekretaria, e cila u shërben edhe dhomave dhe prokurorit.

Tribunali ka gjyqtar të përhershëm dhe *ad litem* të cilët zgjidhen nga Asambleja e përgjithshme me propozim të Këshillit të Sigurimit. Prokurori emërohet nga Këshilli i Sigurimit pas propozimit të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, i cili është i pavarur në punën e tij dhe nuk merr udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.⁶

Me Statut përcaktohen saktësisht të gjitha çështjet formale-procedurale, që duhen të ndiqen nga Tribunali prej fillimit të procedurës e deri në përfundimin e saj. Hetimet, lidhur me shkeljet e mundshme e të parapara në Statut, i fillon prokurori *ex officio* ose në bazë të informacioneve të marra nga ndonjë burim posaçërisht nga qeveritë, organet e Kombeve të Bashkuara si dhe nga organizata të tjera qeveritare ose joqeveritare (Shaw,2001:340).

Për sa i përket kompetencës, lidhur me ndjekjen e të akuzuarve të caktuar, kompetencën gjyqësore e kanë Tribunali dhe gjykatat kombëtare, por në dallim kompetenca e Tribunalit ka përparësi në raport me gjykatat kombëtare (Shaw,2001:339).

Që nga themelimi e deri më tani TPNJ-ja ka ngritur aktakuza kundër 161 personave, si të dyshuar për krime lufte në territorin e ish-Jugosllavisë. Prej tyre 60 gjykime me mbi 120

⁶ www.icty.org/sid/135, Statute of the Tribunal, September, 2009, pdf.

persona të gjykuar kanë përfunduar, ku janë shqiptuar dënime të përcaktuara për personat për të cilët është vërtetuar fajësia për kryerjen e krimeve të luftës. Prej të akuzuarve nga ana e Tribunalit ka edhe persona që janë liruar nga akuza dhe janë shpallur të pafajshëm për ato veprime për të cilat janë akuzuar, disa persona pas ngritjes së aktakuzës, gjegjësisht para se të transferoheshin në Tribunal për gjykim, kanë ndërruar jetë, kurse disa të tjerë edhe gjatë zhvillimit të gjykimit.

Tribunali, gjithashtu, ndaj disave personave i ka tërhequr akuzat dhe e ka ndërprerë procedurën nga mungesa e fakteve dhe argumenteve për vazhdimin të mëtejshëm të procedurës.

Momentalisht, para Tribunalit të Hagës gjegjësisht në apel është në përfundim e sipër procedura ndaj Ratko Mladic, e cila pritet të përfundojë në nëntor të v.2017.

Tribunali i Hagës gjithashtu disa raste i ka transferuar në Gjykatat kombëtare për gjykim.⁷

Tribunali i Hagës për gjykimin e krimeve në territorin e ish-Jugosllavisë, gjatë punës dhe veprimtarisë së tij mbi 20 vjeçare, ka kontribuar në shumë aspekte, me vendosjen e shumë parimeve të rëndësishme si në teori ashtu edhe për praktikën e së drejtës ndërkombëtare.

Gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura në territorin e ish-Jugosllavisë, janë viktimizuar mijëra persona dhe në qoftë se shkaktarët e këtyre konflikteve nuk do të ndëshkoheshin, atëherë do të kishim një viktimizim të dytë si për viktimat e mbijetuara, ashtu edhe për familjet e viktimave që e kanë pësuar. Në këtë drejtim Tribunali, duke ndjekur dhe akuzuar ata që kanë kryer krime, ka kontribuar që të ketë drejtësi për viktimat;

⁷ www.icty.org/sid/135

u ka dhënë mundësinë mijëra viktimave që t'u dëgjohe zëri për të folur në lidhje me vuajtjet e tyre.⁸

Si e thekson ish-kryetari i TPNJ-së, Antonio Cassese, “Drejtësia është element i pazëvendësueshëm në procesin e pajtimit kombëtar. Ajo përbën thelbin e rivendosjes së marrëdhënieve paqësore dhe normale ndërmjet njerëzve të cilët jetuan në një kohë të sunduar nga terrori. Drejtësia thyen ciklin e dhunës, urrejtjes dhe hakmarrjes jashtëgjyqësore (Antonio Cassese, Kumtim Shtypi i TPNJ-së, nr.27, 24 nëntor 1996).

Tribunali gjithashtu ka kontribuar edhe në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Puna dhe arritjet e Tribunalit kontribuan dhe frymëzuan krijimin e gjykatave të tjera penale ndërkombëtare, ndër të cilat Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën, Gjykata e posaçme për Sierra Leonen dhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

Përveç funksionit kryesor të gjykimit të individëve për krime lufte, Tribunali gjithashtu shërbeu si stimulues për reformimin e sistemit gjyqësorë dhe pikërisht ky Tribunal ka nxitur reformimin e sistemit të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe vazhdimin e punës për të gjykuar përgjegjësit për krime lufte.

Tribunali ka kontribut jetik për drejtësinë ndërkombëtare, kontribut që shtrihet edhe jashtë territorit të ish-Jugosllavisë. Me përvojën e tij, Tribunali luajti një rol të një rëndësie të madhe në arritjen e drejtësisë jo vetëm për popujt e ish-Jugosllavisë, por në mbarë globin.

Përgjatë funksionimit të tij Tribunali pati shumë pengesa dhe kryesisht nga subjektet të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ishin palë në procese të ndryshme gjyqësore.

Fillimisht Tribunali kishte probleme me Serbinë sepse refuzonte të ekstradonte të akuzuarit që ishin shtetas të saj, gjë që ndikoi edhe në tejzgjatjen e punës së këtij Tribunali. Në radhë

⁸ www.icty.org/sid/135

të parë ishin vetë personat e akuzuar të cilët fuqimisht kundërshtonin dorëzimin e tyre para Tribunalit, mirëpo një gjë të tillë ata nuk mund ta arrinin pa përkrahjen edhe të autoriteteve shtetërore të Serbisë, e cila për një periudhë të caktuar kohe mbajti një qëndrim të tillë refuzues ndaj Tribunalit, ndoshta edhe si rezultat i opinionit të përgjithshëm publik dhe presionit gjithëpopullor; që personat e akuzuar të mos dorëzoheshin, sepse konsideroheshin si heronj të popullit serb dhe një dorëzim eventual i tyre do të konsiderohej si tradhti. Ky botëkuptim nuk ishte i rastësishëm, po përkundrazi ishte i rrënjosur te populli serb si rezultat i një propagande të fuqishme mediatike, të bërë nga regjimi i Slobodan Millosheviçit dhe të të tjerëve edhe më përpara tij, lidhur me territoret që realisht ishin të huaja, por mbaheshin në mënyrë të dhunshme nga ana e Serbisë. U desh, që nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, të merreshin masa të ndryshme dhe të bëhej një lloj presioni ndaj autoriteteve vendase me qëllim që fillimisht të detyroheshin të bashkëpunonin me Tribunalin e më pas edhe të dorëzonin personat e akuzuar. Sidoqoftë u desh ndryshimi i disa qeverive në Serbi, deri në ardhjen në pushtet të forcave pak më demokratike dhe më progresive, për të ndryshuar dhe për të bindur edhe opinionin publik se Serbisë një gjë e tillë do t'i sillte vetëm dëm. Nëse Serbia donte të përparonte dhe të integrohej në strukturat europiane i duhej domosdo të ndryshonte shumë gjëra të trashëguara nga sistemet e mëparshme ultra nacionaliste dhe shoviniste, prandaj rruga dhe detyra e parë që duhej të kryente ishte të dorëzonte personat e tillë.

Një tjetër pengesë, që i është paraqitur Tribunalit në punën e tij dhe që është cekur edhe në aktgjykimet e saj, ishte edhe refuzimi i dëshmitarëve për të dëshmuar para Tribunalit. Edhe pse Tribunali në Statutin e tij kishte paraparë një mekanizëm për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve, sërisht kishte hezitim që të dëshmohej para Tribunalit, kjo ndikoi, që çështje

të caktuara, lidhur me rrethanat rënduese që i ngarkonin të akuzuarit, të mbeteshin pa u zbardhur, gjë që gjithashtu ndikoi drejtpërsëdrejti edhe në përcaktimin e përgjegjësisë, fajësisë dhe lartësisë së dënimit ndaj disa të akuzuarve. Kjo ndodhte kryesisht se territoret, ku supozohej se ishin kryer krimet, ishin vende të vogla dhe njerëzit që jetonin në këto vende, por që njëkohësisht ishin edhe dëshmitarë të shumë krimeve, njiheshin mes tyre dhe nga frika e etiketimit dhe e hakmarrjes së mundshme refuzonin të dëshmonin ose fshihnin faktet kyçe lidhur me ngjarjet ose veprimet e caktuara.

Çështje të natyrave të tilla përshkuan në vazhdimësi punën e Tribunalit, të cilat ndikuan edhe në tejzgjatjen e disa prej proceseve. Bile kohët e fundit, nga disa anëtarë të Kombeve të Bashkuara, që ishte edhe financuese kryesore e Tribunalit, filluan të dëgjohen zëra për koston shumë të lartë që mbarte ky Tribunal, gjë që nuk mund të arsyetohej më, dhe kjo për vetë faktin që tejzgjatja e ekzistencës së Tribunalit po e bënte atë joefikas.

Prandaj kishin filluar të kërkoheshin alternativa të mundshme të cilat do të ishin zgjidhje për përfundimin e punës së mbetur të Tribunalit, por me një kosto më të ulët.

Kështu, me 22 dhjetor të vitit 2010, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën për ngritjen e organit të ri që do të merret me përfundimin e detyrave të mbetura të TPNJ-së dhe TPNR-së pas përfundimit të mandatit të tyre, i cili do të trashëgojë juridiksionin, të drejtat, detyrimet dhe detyrat themelore të TPNJ-së dhe TPNR-së. Ky mekanizëm ishte paraparë për ta filluar punën me 1 korrik të vitit 2013 për TPNJ-në dhe midis të tjerash do të kishte kompetencë të procedojë penalisht të akuzuar ende të pakapur që do të arrestoheshin pas përfundimit të mandatit të Tribunalit.⁹

⁹ www.icty.org

3.5. Tribunali për Ruandën

I ngjashëm me Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë, edhe Tribunali për Ruandën u krijua nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së me Rezolutën 955, të 8 nëntorit të vitit 1994, selia e të cilit ndodhet në Arusha të Tanzanisë.

Tribunali Ndërkombëtar penal për Ruandën ka kompetencë që të gjykojë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit të cilat janë kryer në territorin e Ruandës dhe në vendet fqinje prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 1994 (Kittichaisaree,2001:24).

Rregullat e TPNR-së lidhur me organizimin e Tribunalit, hetimin, përgatitjen e aktakuzës, revizionin e aktakuzës, të drejtat e të akuzuarve, sanksionet, procedurat në apel dhe ndihmën gjyqësore, i pasqyrojnë rregullat e ngjashme me Statutin e TPNJ-së. TPNJ-ja dhe TPNR-ja kanë pasur edhe prokurorin e përbashkët deri në vitin 2003, kurse nga viti 2003 TPNR-ja ka prokurorin e saj, kurse gjykatës *ad litem*, TPNR-ja nuk ka (Murphy,2006:425). Zyra e prokurorit, regjistri si dhe gjykatësit ndodhen në Arusha të Tanzanisë, kurse Dhoma e Apelit ndodhet në Hagë të Holandës.

Që nga viti 1995 Tribunali ka akuzuar 93 persona për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Ruandës gjatë vitit 1994, përfshirë këtu udhëheqës të lartë të qeverisë ose ushtrisë si dhe liderët fetarë, ushtarakë ose të mediave.

TPNR-ja është Tribunali i parë, që e përkufizoi përdhunimin në të drejtën penale ndërkombëtare si dhe njohjen e dhunimit si një mjet për kryerjen e gjenocidit.

Tribunali për Ruandën duke shqiptuar aktgjykimin kundër Jean-Paul Akayesu, duke e shpallur fajtor për gjenocid, nxitje të drejtpërdrejtë dhe publike për të kryer gjenocid si dhe

për krime kundër njerëzimit¹⁰, u bë Tribunali i parë i cili interpretoi përkufizimin e gjenocidit të përcaktuar në konventat e Gjenevës të vitit 1948.¹¹

TPNR-ja, gjithashtu, është Tribunali i parë penal ndërkombëtar i cili i gjykoi anëtarët e medias si përgjegjës për transmetimet me qëllim nxitjen e publikut për kryerjen e gjenocidit. TPNR-ja dha vendimin e saj të fundit më 20 dhjetor të vitit 2012. Deri në tetor të vitit 2014 kanë përfunduar edhe ankesat para Dhomës së Apelit dhe një apel shtesë do të gjykohej nga Dhoma e Apelit e Mekanizmit për Gjykatat *ad-hoc*, i cili nga 1 korriku i vitit 2012 ka marrë përsipër funksionet e mbetura të TPNR-së.

Mbyllja formale e TPNR-së ishte planifikuar që të përkonte me vendosjen nga Dhoma e Apelit të ankesës së fundit deri në vitin 2015.

TPNR-ja deri në mbylljen formale të saj vazhdimisht ka bërë përpjekje për t'i dhënë fund mosndëshkimit për ata që janë përgjegjës për gjenocid nëpërmjet një kombinimi të gjyqësorëve, kontakteve dhe ndërtimit të kapaciteteve. Përmes këtyre përpjekjeve TPNR-ja, ka përmbushur mandatin e dhënies së drejtësisë për viktimat e gjenocidit dhe me këtë proces shpreson të pengojë të tjerët në kryerjen e mizorive të ngjashme në të ardhmen.¹²

TPNR-ja ishte Tribunali i parë, përpara të cilit një person i akuzuar për gjenocid pranoi fajësinë. Ish-kryeministri i qeverisë së përkohshme, Zhan Kambanda, pranoi fajin për gjenocid, që shënon edhe herën e parë që një person i akuzuar pranoi përgjegjësinë për gjenocid, konspiracion për të kryer gjenocid dhe krime kundër njerëzimit. Pranimi i fajit

¹⁰ <http://www.unict.org/sites/unict.org/files/case-documents/ictr-96-4/appeals-chamber-judgements/en/010601.pdf>

¹¹ <http://www.unict.org/en/ictr-milestones>

¹² www.unict.org/en/tribunal

para TPNR-së u bë me 4 shtator të vitit 1998, me çka TPNR-ja bëhet gjykata, që pas asaj të Nurembergut, lëshoi një gjykim kundër një ish-kreu të shtetit.¹³

Gjatë funksionimit të saj TPNR-ja është përballur me një sërë kritikash. Një kritikë që i është adresuar TPNR-së është se me themelimin e TPNR-së është shkelur parimi *jus de non evocando*, gjegjësisht parim i së drejtës kushtetuese në sistemet juridike civile, i cili ndalon krijimin e gjykatave speciale dhe jo të rregullta për gjykimin e shkeljeve gjatë periudhës së trazirave shoqërore pa gjykim fer. Mirëpo, duke u bazuar në faktin se Ruanda e ka kërkuar vetë krijimin e një Tribunali të tillë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së në kapitullin VII-të Kartës së OKB-së, e ka arsyetuar krijimin e këtij Tribunali dhe ka garantuar se e drejta e gjyqimit fer është e garantuar me Statutin e TPNR-së (Kittichaisaree, 2001:25).

Komora e Apelit e TPNJ-së, që ka shqyrtuar kërkesën lidhur me ligjshmërinë e themelimit të TPNR-së, ka pranuar se zgjerimi i detyrimeve ndërkombëtare dhe përgjegjësia penale drejtpërdrejt ndaj individëve në rastet e konfliktit të brendshëm të armatosur, ka qenë një inovacion i së drejtës ndërkombëtare që është arsyetuar me seriozitetin, madhësinë dhe rëndësinë e konfliktit (Kittichaisaree, 2001:25).

Tribunali për Ruandën që nga themelimi është përballur me sfida nga më të ndryshmet, tejkalimi i suksesshëm i të cilave ka kërkuar një angazhim të madh dhe një mund të konsiderueshëm. Në territorin e Ruandës, në një periudhë kohore prej 100 ditësh janë kryer krime të ndryshme dhe kryesisht ndaj njerëzve pjesëtarë të grupit etnik Tutsi. Sipas Bernard Muna-s zëvendësprokuror në Tribunalin e Ruandës, rasti i Ruandës ishte një akt konspiracioni. Ata që u thirrën si zyrtarë të qeverisë, të departamenteve qeveritare dhe policia në fakt u kthye kundër popullit dhe i vranë (Presentation by Bernard Muna – deputy

¹³ <http://www.unict.org/en/ictr-milestones>

prosecutor for International Tribunal for Rwanda, American University International Law Review, Vol.13/Issue 6, Article 6, 1998:1481).

Lidhur me vështirësinë që kishin hasur prokurorët e Tribunalit të Hagës për mbledhjen e dëshmive dhe refuzimin e autoriteteve shtetërore që të bashkëpunonin me Tribunalin në lehtësimin e punës së tyre, te Tribunali për Ruandën nuk e hasim një problem të tillë sepse ishte Ruanda ajo vetë që kishte kërkuar të bëhej një hetim dhe gjykim i tillë. Mirëpo një problem i njëjtë, lidhur me gatishmërinë, gjegjësisht hezitimin e dëshmitarëve që të dëshmonin para Tribunalit, sepse shumica prej tyre druanin për jetët e tyre dhe të pjesëtarëve të familjeve të tyre. Si e thoshte gjykatësi i TPNR-së, Navanethem Pillay, se: në Ruandë ende nuk ka siguri dhe jo vetëm për dëshmitarët, por edhe për pjesëtarët e stafit të Tribunalit, gjë që e vështirëson edhe më shumë punën e Tribunalit (Presentation by the Navanethem Pillay-judge, International Criminal Tribunal for Rwanda, American University International Law Review, Vol.13/Issue 6, Article 6, 1998:1477).

Një problem tjetër, që ishte paraqitur dhe që kishte të bënte me dëshmitarët, ishte ngritja e dyshimeve nga ana e palës mbrojtëse lidhur me besueshmërinë e dëshmive të paraqitura nga dëshmitarët sepse kishte dyshime që ekzistonte një bashkim i fshehtë i informatorëve të cilët sajnin histori lidhur me përdhunimet dhe dhunën seksuale (Presentation by the Navanethem Pillay-judge, International Criminal Tribunal for Rwanda, American University International Law Review, Vol.13/Issue 6, Article 6, 1998:1479).

Të dyja Tribunalet, si TPNR-ja ashtu edhe TPNJ-ja, patën shumë probleme gjatë funksionimit të tyre disavjeçar, kryesisht si rezultat i rrethanave postkonfliktuale të cilat mbretëronin në Ruandë si dhe në vendet e ish-Jugosllavisë, me ç'rast problemet me të cilat ballafaqoheshin këto Tribunale mbartnin karakteristika të veçanta, që, natyrisht, kërkonin

impenjime të ndryshme për t'u zgjidhur. Shumicën e sfidave, me të cilat u përballën këto Tribunale gjatë punës së tyre, i tejkaluan me sukses, gjë që e tregojnë rezultatet tani në prag të përmbylljes së punës së tyre. Tashmë shumë raste, të gjykuara nga këto Tribunale, kanë përfunduar, ndërsa shumë të tjera janë drejt përfundimit.

3.6. Mekanizmi për Tribunalet Penale Ndërkombëtare

Ky mekanizëm u krijua nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së me 22 dhjetor të vitit 2010, për të kryer një numër të funksioneve thelbësore të TPNR-së dhe TPNJ-së pas përfundimit të mandatit të tyre.

Ngritja e mekanizmit është një hap kyç për përfundimin e strategjive të të dyja Tribunaleve. Është një organ i përkohshëm dhe efikas, i ngarkuar me vazhdimin e juridiksionit, të drejtave, detyrimeve dhe funksioneve thelbësore (Rezoluta 1966 të KS të OKB-së) për TPNJ-në dhe TPNR-në, si dhe ruajtjen e trashëgimisë së dy institucioneve. Mekanizmi për Tribunalet *ad-hoc* përbëhet nga dy degë, njëra degë mbulon funksione të trashëguara nga TPNR-ja dhe është e vendosur në Arusha, Tanzani; ka filluar të funksionojë me 1 korrik të vitit 2012 dhe dega tjetër gjendet në Hagë dhe mbulon funksione të trashëguara nga TPNJ-ja që ka filluar të funksionojë nga 1 korriku i vitit 2013.

Rezoluta 1966 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së parashikon se funksionet dhe madhësia e aktiviteteve të MTPN-së do të zvogëlohen me kalimin e kohës, pasuar edhe me një zvogëlim të stafit, gjë e cila do të jetë në proporcion me funksionet e tij të reduktuara. Përparimi i punës së MTPN-së do të rishikohet çdo dy vjet nga ana e KS të OKB-së.

MTPN-ja do të kryejë një numër funksionesh thelbësore, të kryera nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja. Arrestimi, transferimi dhe ndjekja penale e nëntë të arratisurve, të mbetur ende të kërkuar për gjykim nga ana e TPNR-së, kjo do të jetë përparësia e lartë për MTPN-në.

Përveç detyrave të lartpërmendura MPTN-ja kryen edhe funksione të tjera si: ndjekja penale e të arratisurve të mbetur, procedura apeli, rigjykime, gjykime për shpifje ndaj Tribunalit dhe dëshmi të rrejshme, procedura për shqyrtimin e vendimit përfundimtar, mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve, mbikëqyrja e zbatimit të sanksioneve, ndihmë ndaj juridiksioneve nacionale dhe ruajtjen dhe menaxhimin e arkivave të MTPN-së, TPNR-së dhe TPNJ-së.¹⁴

Tribunali për ish-Jugosllavinë dhe Tribunali për Ruandën ishin krijuar si tribunale me karakter të përkohshëm me qëllim kryerjen e detyrave të caktuara, të cilat për realizimin e qëllimit për të cilin ishin themeluar kishin një mandat të caktuar. Brenda këtij mandati supozohej që këto Tribunale do të përmbushnin detyrimet për të cilat ishin ngarkuar dhe do të pushonin së ekzistuari. Mirëpo, gjatë punës së tyre, për arsye dhe rrethana të ndryshme si edhe të shumë peripecive që iu ishin paraqitur, këto Tribunale nuk arritën brenda afatit të paraparë të përmbushnin funksionet e tyre. Edhe pse që prej ekzistimit të tyre numri më i madh i çështjeve të paraqitura për zgjidhje vetëm sa kish fituar epilogun përfundimtar, kishte ende çështje që ishin të papërfunduara. Prandaj midis anëtarëve të Kombeve të Bashkuara kishin filluar të qarkullonin zëra për koston shumë të lartë që bartnin këto Tribunale për të funksionuar, në raport me punën tashmë të reduktuar tej mase dhe me efikasitetit të zvogëluar. Prandaj ishte e nevojshme gjetja e një zgjidhjeje që, në njërën anë do ta ulte koston e mbajtjes së këtyre Tribunaleve, dhe në anën tjetër do të vazhdonin

¹⁴ www.unmict.org/en/about

funksionet e të dyja Tribunaleve. Për këtë arsye u propozua krijimi i këtij mekanizmi, i cili ishte zgjidhje e përshtatshme për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Duke pasur parasysh funksionet e reduktuara të Mekanizmit, me Statutin për MTPN-në, është paraparë që ky Mekanizëm do të përbëhet prej dy Dhomave gjyqësore, nga një Dhomë gjyqësore për të dyja degët e Mekanizmit, prokurorin i cili do të jetë i përbashkët për të dyja degët e Mekanizmit si dhe Sekretarinë e cila do të jetë e përbashkët dhe në shërbim të Dhomave Gjyqësore dhe prokurorit.

Gjyqtarët dhe Prokurori i Mekanizmit nuk e kanë për detyrim të qëndrojnë në selitë e degëve të Mekanizmit, por prania e tyre do të jetë e nevojshme vetëm për kryerjen e detyrave të nevojshme.

Deri më tani Tribunali për Ruandën ka përfunduar procesin e transferimit të të gjitha të drejtave dhe funksioneve në kompetencë të Mekanizmit, ndërsa Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë nuk e ka përfunduar ende këtë proces.

Para MTPN-së nuk mund të fillojnë procedura të reja ndjekjesh, përveç atyre tashmë të filluara nga TPNJ-ja ose TPNR-ja. Me Statut nga ky rregull parashihet përjashtimi i vetëm dy rasteve: gjegjësisht mund të fillohet procedurë e re para MTPN-së vetëm për mospërfillje të Tribunalit dhe për dëshmi të rreme.

Mekanizmi ka funksione *ad-hoc* dhe të përhershme. Si funksione *ad-hoc* të Mekanizmit janë: hetimi dhe ndjekja e të kërkuarve të mbetur, procedurat e apelit, rigjykimet, gjykimet për mospërfillje të Tribunalit dhe për dëshmi të rreme dhe procedura për rishikimin e aktgjykimit përfundimtar. Kurse si funksione përhershme parashihen: mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave, mbikëqyrja e zbatimit të dënimeve, ndihmë ndaj

juridiksioneve kombëtare dhe ruajtja dhe menaxhimi e arkivave të MTPN-së, TPNJ-së dhe TPNR-së.¹⁵

Përveç përmbushjes së funksionit themelor, për të cilin edhe është themeluar MTPN-ja, gjegjësisht kryerjen e punëve dhe të funksioneve posaçërisht të filluara nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja, si dhe menaxhimin me arkivat e TPNJ-së dhe TPNR-së, të cilat pa dyshim janë të një rëndësie të madhe dhe kanë vlerë historike për teorinë dhe praktikën juridike, MTPN-ja, gjithashtu, do të ketë edhe një rol shumë të rëndësishëm: t'u japë ndihmë juridiksioneve nacionale për zhvillimin me sukses të proceseve penale të natyrës për të cilën kanë pasur kompetencë këto dy Tribunale. Sepse TPNJ-ja dhe TPNR-ja, përveç të tjerash gjatë gjithë ekzistencës së tyre i kanë kushtuar një vëmendje dhe kujdes të veçantë çështjes së aftësisë së juridiksioneve nacionale në drejtim të zhvillimit të proceseve penale komplekse. Prandaj, pas mbylljes përfundimtare të TPNJ-së dhe TPNR-së, MTPN-ja si një ndër detyrat parësore të saj do ta ketë edhe ofrimin e ndihmës për juridiksionet nacionale, në çfarëdo forme qoftë.

3.7. Gjykata Penale Ndërkombëtare

Nevoja për të pasur një Gjykatë Penale Ndërkombëtare, me karakter të përhershëm, ishte e kahmotshme, por u jetësua vetëm në vitin 1998 në Konferencën e Romës ku u miratua Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Aspiratat për krijimin e një gjykate penale ndërkombëtare, diku në vitet 80-të, me propozim të shteteve latino-amerikane u paraqitën nga Trinidad dhe Tobago para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Ideja e tyre ishte krijimi i një gjykate të përhershme si zgjidhje e fundit për gjykimin e dilerëve të drogës (Kittichaisaree, 2001:27).

¹⁵ <http://www.unmict.org/en/about>

Në teori përmendet fakti se suksesi i dy Tribunaleve *ad-hoc* për territorin e ish-Jugosllavisë dhe Ruandës, kontribuan shumë në themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, gjegjësisht për krijimin e një gjykate që do të ketë ndikim global dhe do të jetë në gjendje që të përgjigjet për të gjitha krimet që ndodhin nëpër botë (Cassese,2003:329).

Në vitin 1996 nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së u krijua një Komitet preliminar, i cili ishte kompetent që të formulonte rregullat për krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Ky Komitet në Konferencën diplomatike të Romës, të mbajtur më 15-17 korrik të vitit 1998, paraqiti një propozim-ligj dhe një propozim-akt final, të cilët edhe u miratuan gjatë kësaj konference.

Që të hynte në fuqi Statuti i Romës ishte e nevojshme të ratifikohej nga 60 shtete, dhe kjo u realizua më 1 korrik të 2002-it.

Për dallim nga dy Tribunalet *ad-hoc*, atë për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, themelimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale nuk rrjedh nga një Rezolutë e detyrueshme e Këshillit të Sigurimit, por është rezultat i një marrëveshjeje ndërkombëtare (Shaw,2008:343).

Sipas Statutit të Romës, Gjykata Penale Ndërkombëtare është një institucion i përhershëm dhe ka juridiksion mbi personat në lidhje me krimet serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare.

Gjykata ka juridiksion mbi krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimin e agresionit.

Juridiksioni i GJPN-së shtrihet mbi krimet të cilat kryhen gjatë zhvillimit të luftërave ose gjatë çfarëdo konflikti të armatosur ose në lidhje me fillimin e luftës. Gjatë kohëve të fundit, si rezultat i globalizimit, i zhvillimit të hovshëm të teknikës dhe teknologjisë, shumë gjëra dhe procese jetësore kanë ndryshuar. Trende të tilla të zhvillimit dhe globalizimi pa

dyshim që kanë përmirësuar në masë të madhe jetën dhe mirëqenien e njerëzve në rruzullin tokësor. Mirëpo ato gjithashtu kanë ndikuar edhe në paraqitjen e shumë formave dhe sjelljeve kriminale, të cilat më parë kanë qenë të paimagjinueshme për t'u realizuar. Zbulime të tilla, duke u shfrytëzuar nga mendjet kriminale për arritjen e qëllimeve kriminale, kryejnë shumë veprime kriminale si pasojë e të cilave humbasin jetën një numër më i madh njerëzish dhe shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale. Veprime të tilla kriminale si terrorizmi, trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kriminaliteti kompjuterik etj, të cilat atakojnë të mirat më themelore të njeriut si jeta ose shëndeti, krime që për nga serioziteti, rreziku dhe madhësia e pasojave, janë të ngjashme me pasojat që shkaktohen edhe nga krimet që janë nën juridiksionin e GJPN-së, prandaj për raste të tilla parashtrohet pyetja: kush do t'i dënojë ata që kanë kryer krime të tilla? Edhe pse disa elemente të këtyre krimeve janë të përfshira në figurat e krimeve të luftës, krimet të gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit, ato prapëseprapë janë të kushtëzuara me ekzistencën e rrethanave të luftës, qoftë në stad zhvillues, ose në stad përgatitje të saj. Mirëpo kur veprime të tilla kryhen në kohë paqeje, që është dukuri pothuajse e përditshme, atëherë paraqitet nevoja që edhe krime të tilla të përfshihen në Statutin e GJPN-së ose ndoshta do të duhet të krijohet një gjykatë tjetër ndërkombëtare e cila do të kishte kompetencë gjykimin e krimeve të tilla. Nga shtetet është krijuar një mekanizëm nëpërmjet të cilit, shtetet me forma të caktuara të bashkëpunimit policor, gjyqësor ose edhe të organeve të tjera luftojnë dukuri të tilla, mirëpo sa sukses ka një luftë e tillë duke pasur parasysh kompleksitetin dhe rrezikshmërinë e këtyre sjelljeve kriminale është një çështje që meriton trajtim dhe analizë të thellë të më shumë faktorëve dhe dukurive që janë determinues i një suksesi ose mosesuksesi të tillë. Gjithashtu suksesi i luftimit nga vetë

shtetet është i dyshimtë për faktin se shtetet gjithsecili në mënyrë të veçantë nuk i ka as kapacitetet, as mundësitë, e në disa raste as dëshirën për të luftuar në mënyrë të drejtë dukuri të tilla. Prandaj është e nevojshme që edhe për dukuri të tilla të ekzistojë një organ në suaza ndërkombëtare siç është GJPN-ja, e cila pa dyshim do të paraqiste një garanci që në qoftë se ndjekja dhe gjykimi i atyre që kanë kryer krimeve të tilla do të dështonte nga sistemet nacionale, atëherë ata që i kanë kryer të tilla krime nuk do të mbeten pa u gjykuar. Siç është rasti edhe me GJPN-në e cila ka juridiksion komplementar në raport me gjykatat nacionale, dhe vetëm në qoftë se sistemet juridike nacionale për çfarëdo arsye nuk janë në gjendje që të bëjnë një ndjekje ose të zhvillojnë një gjykim, atëherë vepron GJPN-ja. Po marrim si shembull aktet terroriste, për të cilat ne të gjithë jemi dëshmitarë se këto akte ndërmerren kudo dhe vazhdimisht, të cilat veç pasojave të shumta që po mbartin njerëzit dhe shtetet në mbarë globin, qoftë në humbje të jetëve të njerëzve e po ashtu edhe në dëme të konsiderueshme materiale, mjellin edhe frikë, pra në mënyrë të vazhdueshme ushtrohet dhunë psikologjike ndaj të gjithëve sepse kushdo edhe mund të jetë viktimë e radhës e akteve të tilla terroriste. Ata që kryejnë akte të tilla në qoftë se kapen në vendin ku kryejnë krime të tilla, normalisht se do t'i nënshtrohen përgjegjësisë penale dhe do të dënohen, por parashtrohet pyetja se çka ndodh kur terroristë të tillë strehohen në vende të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi përkrahin sjellje të tilla. Për pasojë ata mbeten të pandëshkuar sepse mungon mekanizmi i duhur për ndjekje ose ndëshkim dhe ky fakt është një fatkeqësi dhe një dështim i drejtësisë në përgjithësi. Prandaj është më se e nevojshme që në të ardhmen edhe krime të tilla të përfshihen nën juridiksion të GJPN-së ose edhe të krijohet një gjykatë në suaza ndërkombëtare e cila do të ishte kompetente për gjykimin e krimeve të tilla. Sigurisht kjo kërkon një punë dhe një angazhim të mirëfilltë të shumë

subjekteve, e më së shumti të shteteve të cilat para se gjithash duhet të kenë edhe vullnetin për ta bërë një gjë të tillë. Por duke pasur parasysh tejzgjatjen e procesit të themelimit të GJPN-së, kryesisht hezitimin e shteteve të caktuara për ta bërë një gjë të tillë, duket se përfshirja edhe e këtyre krimeve nën juridiksion të GJPN-së është një gjë e vështirë për t'u arritur, sepse si duket interesat politike, ekonomike dhe interesat e tjera të shteteve përballë interesave reale të njerëzve janë në kundërshtim drastik.

Gjykata Penale Ndërkombëtare përbëhet nga këto organe: Kryesia, Divizioni për ankesa, Divizioni për gjykim, Divizioni për Procedurën Paraprake, Zyra e prokurorit dhe Sekretaria.

Me këtë statut parashihen të gjitha institutet dhe rregullat procedurale të nevojshme për fillimin, mbarëvajtjen dhe përfundimin me sukses së procedurës.¹⁶

Sipas Statutit të Romës Gjykata Penale Ndërkombëtare ka juridiksion komplementar në raport me legjislacionet nacionale, çka nënkupton se Gjykata nuk i zëvendëson, por i plotëson gjykatat nacionale me çka para Gjykatës Penale Ndërkombëtare nuk mund të fillohet procedurë në qoftë se funksionon sistemi nacional i drejtësisë penale (Kambovski,1998:395-396).

Gjykata Penale Ndërkombëtare është kompetente vetëm për ato krime që parashihen në Statutin e Romës, të cilat janë kryer pas hyrjes në fuqi të Statutit të Romës.

Roli dhe rëndësia e Tribunaleve *ad-hoc*, për të drejtën ndërkombëtare penale është e pamohueshme për vetë arsyen se ato kontribuan në masë të madhe për heqjen e disa barrierave deri vonë të pakapërcyeshme si, p.sh., sovraniteti i shtetit, mospërgjegjësia penale individuale e individëve, të cilët duke u fshehur pas nocionit shtetëror kryejnë krime

¹⁶ www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_sq.pdf

ndërkombëtare dhe shkelje të rënda të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, si dhe lënia pa u ndëshkuar e këtyre personave. Mirëpo, themelimi i një gjykate me karakter të përhershëm pa dyshim është arritja më e madhe e së drejtës penale ndërkombëtare, sepse me themelimin e saj është siguruar ajo që tashmë ekziston një organ i përhershëm dhe kompetent për gjykimin e krimeve ndërkombëtare me çka është zvogëluar në maksimum mundësia që dikush, i cili kryen krime ndërkombëtare në cilindo vend të botës, duke u nisur nga karakteri universal të mbetet pa u ndëshkuar.

KAPITULLI IV: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE

4.1. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Nurembergut

Duke qenë dëshmitarë se gjatë zhvillimit të LDB-së u shkelën shumë rëndë rregullat dhe zakonet e luftës dhe u kryen shumë krime, fuqitë aleate kah përfundimi i LDB-së vendosën se do të krijonin një gjykatë ushtarake, me qëllim që ata që kishin kryer krime gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake të LDB-së të mos mbeten pa u gjykuar dhe ndëshkuar.

Themelimit të Gjykatës së Nurembergut i paraprinë disa akte të fuqive aleate, akte që ishin edhe hapat e parë në rrugën e themelimit të Gjykatës së Nurembergut. Në konferencën e Moskës qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, nisur nga “Deklarata e mizorive gjermane” të datës 30 tetor të vitit 1943, deklaruan se “oficerët gjermanë, njësitë dhe anëtarët e partisë naziste, të cilët janë përgjegjës ose që kanë qenë pjesëmarrës në kryerjen e mizorive, masakrave dhe ekzekutimeve në vendet e mbrojtura nga forcat gjermane do të dërgohen në vendet ku i kanë kryer veprimet e neveritshme dhe do të gjykohen e dënohen në bazë të ligjeve të vendeve tashmë të çliruara dhe nga qeveritë e lira të cilat do të krijohen në ato vende.

Ata më tej shtuan se një deklaratë e tillë është pa kurrfarë paragjykimi për rastet e kriminelëve kryesorë, shkeljet e të cilëve nuk kanë lokacion të pjesshëm gjeografik dhe të cilët do të dënohen në bazë të një mendimi të përbashkët të fuqive aleate.¹⁷

Në pajtim me Deklaratën e Moskës, qeveria e SHBA-së, e Francës, e Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Sovjetik, nënshkruan marrëveshjen e Londrës më 8 gusht të vitit

¹⁷ <http://legal.un.org/ilc/documentation>, The Charter and Judgment of the Nürnberg Tribunal – History and Analysis: Memorandum submitted by the Secretary-General, United Nations - General Assembly International Law Commission Lake Success, New York 1949, f. 3.

1945, në të cilën parashiheshin që, në konsultim me Këshillin e Kontrollit për Gjermaninë, të themelojnë një Tribunal Ndërkombëtar Ushtarak për gjykimin e kriminelëve të luftës, veprimet e të cilëve nuk kanë lokacion gjeografik të pjesshëm dhe të cilët do të akuzohen në mënyrë individuale ose si pjesëtarë të organizatës ose grupit, por edhe në të dyja rastet (neni 1).

Themelimi, juridiksioni dhe funksionet e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak rregulloheshin me Kartën e cila ishte pjesë integrale e Marrëveshjes së Londrës (neni 2).

Secili shtet nënshkrues duhej të ndërmernte hapat e nevojshëm me qëllim që të bëjë të mundshëm hetimin për akuzimin dhe gjykimin e kriminelëve kryesorë të luftës, të arrestuar dhe të cilët do të gjykoreshin nga ana e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak (neni 3).

Në Kartën e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak ishin rregulluar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përbërjen, juridiksionin dhe parimet themelore, me Komitetin për hetimin dhe ndjekjen e kriminelëve kryesorë të luftës, me parimet lidhur me gjykimin për të pandehurit, me kompetencat e Tribunalit, përmbajtjen dhe shqiptimin e aktgjykimit si dhe me parime lidhur me shpenzimet e punës së Tribunalit dhe mbajtjes së gjykimeve.

Tribunali ka qenë i përbërë nga katër anëtarë dhe nga një zëvendës të cilët janë emëruar nga shtetet nënshkruese (neni 2 i Kartës së Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak).

Anëtarët e Tribunalit ose zëvendësit e tyre nuk kanë mundur të ndikohen as nga prokurorët, të pandehurit ose mbrojtësit e tyre. (neni 3).

Prezenca e katër anëtarëve ose zëvendësve të tyre, ishte e nevojshme për të formuar kuorumin.

Kryetari zgjidheshte me marrëveshje nga shtetet anëtare ose nëpërmjet votimit nga anëtarët, ku kandidati i zgjedhur për kryetar duhej të kishte më së paku tre vota, kurse në qoftë se

ndonjë sesion i Tribunalit mbaheshte në territorin e ndonjërit prej shteteve nënshkruese, përfaqësuesi i atij shteti nënshkrues do të ushtrojë funksionin e presidentit.

Për sa i përket mënyrës së votimit lidhur me vendimet kërkohej shumica e votave të anëtarëve, dhe në rastet kur votat ishin të barabarta vendoste vota e kryetarit, kurse lidhur me vendimet dhe aktgjykimet është vendosur vetëm në bazë të votave afirmative të më së paku tre anëtarëve të Tribunalit (neni 5).

Në pjesën e dytë të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak ishin paraparë juridiksioni dhe parimet kryesore të Tribunalit të Nurembergut. Krimet kundër paqes, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, ishin krimet për të cilat Tribunali i Nurembergut ka pasur juridiksion.

Në krimet kundër paqes, përfshinë planifikimin, përgatitjen, inicimin ose shkaktimin e agresionit të luftës, ose luftë në kundërshtim me traktatet ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare, ose pjesëmarrja në plan ose në konspiracion për realizimin e ndonjë veprimi të mësipërm.

Krime lufte quhen shkeljet e së drejtës së luftës ose rregullat e luftës. Me shkelje të tilla nuk kufizohen vetëm vrasja, por edhe keqtrajtimi ose deportimi me qëllim i robërve në punë ose i popullsisë civile në territoret e okupuara, vrasjet dhe keqtrajtimet e të burgosurve të luftës ose i personave në det, vrasjet e robërve të luftës, plaçkitja e pasurisë publike apo private, shkatërrimi i qyteteve, qytezave dhe fshatrave ose shkatërrimi i paarsyetuar për nevojat ushtarake.

Në aktet që konsiderohen pjesë e krimeve kundër njerëzimit bëjnë pjesë asgjësimi, skllavërimi, dëbimi dhe akte të tjera johumane të kryera kundër popullsisë civile, para ose gjatë luftës, persekutimet në bazë politike, racore ose religjioze, ekzekutimi në lidhje me

ndonjë krim, që është në juridiksion të Tribunalit, pa marrë parasysh se a paraqet ai veprim shkelje të legjislacionit të brendshëm ku është kryer ai akt.

Liderët, organizatorët, nxitësit dhe bashkëpunëtorët pjesëmarrës në përpilimin ose ekzekutimin e planit të konspiracionit, për kryerjen e krimeve të lartpërmendura, janë përgjegjës për të gjitha aktet e kryera nga cilido person në drejtim të realizimit të një plani të tillë (neni 6).

Përgjegjësia penale ishte e rregulluar në nenet 7 dhe 8 të Kartës së Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak, ku parashiheshte se pozita e të pandehurve si, për shembull, kryetari i shtetit ose zyrtarë qeveritarë nuk është rrethanë që e liron nga përgjegjësia penale ose rrethanë lehtësuese për matjen e dënimit (neni 7).

Personat të cilët kryejnë krime duke zbatuar urdhrat e qeverisë ose urdhrat eprorit nuk do të lirohen nga përgjegjësia penale, por kjo mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit në rastet kur Tribunali vlerëson se këtë e kërkon drejtësia (neni 8).

Gjatë gjykimit të personave, Tribunali mundeshte që organizatën ose grupin, anëtar i të cilit ka qenë personi, ta shpallë si kriminale.

Pas pranimit të aktakuzës, në të cilën ka një cilësim lidhur me pjesëmarrjen e një personi në një grup ose në një organizatë të caktuar, dhe kur kjo varet nga cilësimi që Tribunali i bën grupit ose organizatës, nëse e quan kriminale ose jo, dhe sipas rastit personat kanë të drejtë që të kërkojnë nga Tribunali të deklarohen për një gjë të tillë, dhe në qoftë se Tribunali e lejon një gjë të tillë atëherë para se të vendosë ai duhet të lejojë dëgjimin dhe deklarimin e atij personi (neni 9).

Cilësimi i një grupi ose i një organizate si kriminale nga ana e Tribunalit, ka fuqinë edhe në rastet kur një pjesëtar i grupit ose i një organizate së tillë do të gjykohet para gjykatës nacionale, ushtarake ose profesionale (neni 10).

Personi, pjesëtar i grupit ose i organizatës kriminale mund të gjykohet edhe nga gjykata nacionale, ushtarake dhe profesionale, me çka një personi të tillë mund t'i jepet dënim i pavarur ose dënim shtesë ndaj dënimit të dhënë nga Tribunali për pjesëmarrje në aktivitete kriminale të grupit ose organizatës së tillë kriminale (neni 11).

Gjithashtu, Tribunali ka të drejtë që të gjykojë personat në mungesë në rast se, për çfarëdo arsye, e shih të nevojshme dhe në interes të drejtësisë (neni 12).

Në pjesën e tretë të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak janë të përmbledhura rregullat për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të hetimit dhe ndjekjes penale të kriminelëve kryesorë të luftës si dhe autorizimet dhe detyrimet e prokurorëve.

Secili shtet anëtar nënshkrues i marrëveshjes së Londrës ka emëruar kryeprokurorin për hetimin e akuzave dhe ndjekjen e kriminelëve kryesorë të luftës. Kryeprokurorët kanë vepruar si komitet për qëllime të ndryshme (neni 14).

Kryeprokurori në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me të tjerët, gjithashtu ndërmerr edhe detyra të tjera.

Asnjë dëshmitar ose i pandehur, i cili është ndaluar në ndonjërin nga shtetet nënshkruese, nuk do të merret në posedim të shtetit tjetër pa miratimin e tij (neni 15).

Me qëllim të sigurimit të gjyqimit fer për të pandehurit, në pjesën e katërt të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak janë paraparë rregulla me të cilat sigurohet një gjë e tillë, me çka gjatë zhvillimit të secilës procedurë para gjyqit duhet të ndiqen disa rregulla.

Aktakuza duhet të përmbajë në detaje të gjitha pjesët e specifikuara për akuzat e ngritura kundër të pandehurit. Një kopje e aktakuzës, së bashku me të gjitha dokumentet që janë paraqitur me aktakuzën, të përkthyer në gjuhën që e kupton i pandehuri, duhet t'i dorëzohen të pandehurit në një kohë të arsyeshme para fillimit të gjykimit. Gjatë secilit ekzaminim ose gjykim paraprak, të pandehurit duhet t'i jepet e drejta që të deklarohet duke dhënë shpjegimet e duhura lidhur me akuzat e ngritura ndaj tij.

Ekzaminimi preliminar i të pandehurit dhe gjykimi duhet të mbahet ose të përkthehet në një gjuhë që e kupton i pandehuri. I pandehuri ka të drejtën e mbrojtësit para Tribunalit ose të ketë ndihmën e mbrojtësit.

I pandehuri ka të drejtë që, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit, të parashtrojë dëshmi në mbështetje të mbrojtjes së tij dhe ekzaminimit kryqëzor të secilit dëshmitar të thirrur nga prokuroria (neni 16).

Çështjet që kanë të bëjnë me thirrjen e dëshmitarëve dhe me marrjen e dëshmisë së tyre, marrja në pyetje e dëshmitarëve, marrja në pyetje e të pandehurve, administrimi i dokumenteve dhe i materialit tjetër, janë të përcaktuara në nenin 17 të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak.

Gjatë zhvillimit të procedurës para Tribunalit është respektuar parimi i efikasitetit i shprehur në nenin 18 të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak ku është paraparë që Tribunali e ka për detyrë që të kufizojë gjykimin në mënyrë rigoroze, me qëllim që brenda një seance të dëgjojë çështjet që kanë të bëjnë me akuzën si dhe të marrë masat që do të parandalojnë marrjen e akteve që do të shkaktojnë shtyrje të paarsyeshme ose çështje dhe deklarata lidhur me akuzën.

Lidhur me procedurën, që është dashur të ndjekë Tribunali, gjatë gjykimit në nenin 19 parashihet se Tribunali në punën e tij nuk duhet të jetë i lidhur pas rregullave teknike, por duhet të aplikojë masat për procedurë të shpejtë dhe joteknike dhe duhet të pranojë ato prova që kanë vlera provuese.

Tribunali mund të kërkojë që të informohet për natyrën e secilës dëshmi para se ajo të ofrohet për procedim me qëllim që të vlerësojë fuqinë provuese dhe rëndësinë e saj (neni 20).

Gjykata nuk duhet të refuzojë provat për faktet lidhur me njohuritë e zakonshme, por paraprakisht faktet duhet të shihen nga Gjykata. Gjykata gjithashtu duhet të njihet me dokumentet zyrtare gjyqësore dhe me raportet e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe aktet dhe dokumentet e komiteteve të përpiluara në vendet aleate për hetimin e krimeve të luftës si dhe të dhënat dhe gjetjet e tribunaleve ushtarake ose cilitdo Tribunal tjetër të Kombeve të Bashkuara (neni 21).

Në nenin 23 janë përcaktuar rregulla lidhur me prokurorët dhe avokatët e të pandehurve.

Një ose më shumë prokurorë mund të marrin pjesë në ndjekje në secilin gjykim.

Në nenin 24 janë përcaktuar veprimet që duhet të ndjekë Tribunali gjatë zhvillimit të procedurës:

- Aktakuza duhet të dorëzohet në gjykatë;
- Tribunali duhet të pyesë çdo të pandehur se a ndihet fajtor ose jo;
- Prokuroria duhet të bëjë deklaratë të hapur;
- Tribunali duhet të pyesë prokurorinë dhe mbrojtjen lidhur me dëshmitë që do t'i paraqiten Tribunalit dhe Tribunali do të vendosë se cilat prova do t'i pranojë;
- Dëshmitarët e prokurorisë do të pyeten së pari dhe pastaj ata të mbrojtjes;

- Më pas provat e mohueshme mund të mbahen nga Tribunali, sepse me këto prova nuk mund të thirret as prokuroria e as mbrojtja;
- Tribunali mund t'iu parashtojë pyetje dëshmitarëve dhe të pandehurve në çdo kohë;
- Prokuroria ka të drejtë të marrë në pyetje dhe t'iu parashtojë pyetje nga të gjitha krahët cilitdo dëshmitar ose të pandehur që jep dëshmi;
- Mbrojtja duhet t'iu drejtohet gjykatës;
- Prokuroria duhet t'iu drejtohet gjykatës;
- Secili i pandehur mund të japë deklaratë para Tribunalit;
- Dorëzimi i Aktgjykimit dhe shqiptimi i dënimit duhet të bëhet nga Tribunali.

Procedura e zhvilluar para Tribunalit të Nurembergut ka qenë një përzierje elementesh nga sistemi kontinental dhe ai *common law*, sepse përmbante elemente të të dyja llojeve të procedurave, e kombinuar në mënyrë që të balanconte interesat e të gjithë palëve pjesëmarrëse në procedurë, e para se gjithash interesat e drejtësisë.

Në pjesën e gjashtë të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak janë të përmbledhura rregulla për përmbajtjen e aktgjykimit dhe shqiptimin e dënimit.

Aktgjykimi i Gjykatës, në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e çdo të pandehuri, duhet të përmbajë arsyet mbi të cilat është bazuar, dhe do të jetë përfundimtar dhe jo objekt rishikimi (neni 26).

Gjykata ka të drejtë të vendosë mbi një të pandehur, me bindje të plotë, për dënim me vdekje ose ndëshkim tjetër që do të përcaktohet nga Tribunali (neni 27).

Përveç dënimit të shqiptuar Tribunali ka të drejtë që personin e dënuar ta privojë nga çdo pasuri e vjedhur dhe të urdhërojë dorëzimin e tij në Këshillin e Kontrollit të Gjermanisë (neni 28).

Në rastin e shpalljes fajtor, dënimet do të ekzekutohen në pajtim me urdhrat e Këshillit të Kontrollit për Gjermaninë, e cila mundet që në çdo kohë të zvogëlojë ose të ndryshojë dënimet, por nuk mundet të rritë ashpërsinë e dënimit.

Në qoftë se Këshilli i Kontrollit për Gjermaninë, zbulon fakte të reja për një të pandehur edhe pse është gjykuar dhe dënuar më parë, fakte të cilat sipas mendimit të saj çojnë drejt gjetjes së ndonjë akuze ndaj tij, Këshilli duhet të raportojë për rrethanat te Komiteti për hetim dhe ndjekje për ndonjë veprim që ata mund ta konsiderojnë të duhur, duke pasur parasysh interesat e drejtësisë (neni 29).¹⁸

Themelimi i Tribunalit të Nurembergut ka qenë një kompromis i fuqive aleate fitimtare të LDB-re, për fatin e kriminelëve nazistë të luftës që janë kapur nga fuqitë aleate.

Në mbarim të LDB-së fuqitë aleate u ballafaquan me marrjen e vendimit se çka duhet bërë me kriminelët e kapur të luftës. Tri drejtime ishin të hapura si zgjidhje e mundshme e kësaj çështje: të lirohen, të ekzekutohen ose të gjykohen. Ndër fuqitë aleate, ishin sovjetikët ata që mendonin se kriminelët nazistë të luftës duheshin ekzekutuar, gjë që e mbështeti edhe Çerçili – kryeministër i atëhershëm i Britanisë së Madhe, por mbështetur edhe në faktin që nga sondazhet e realizuara në Britani të Madhe dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezultonte se pjesa më e madhe e opinionit publik ishin të mendimit se klasa e lartë e udhëheqësve nazistë duhej ekzekutuar pa gjyq. Mirëpo, sekretari i atëhershëm i Luftës, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Henry L. Stimson, ishte i mendimit se në qoftë se bëhet ekzekutimi pa procedurë gjyqësore atëherë “pozicioni moral” i fuqive aleate do të vihej në pikëpyetje sepse ishte i ngjashëm me metodat naziste që e kryenin ekzekutimin pa

¹⁸ <http://legal.un.org/ilc/documentation>, The Charter and Judgment of the Nürnberg Tribunal – History and Analysis: Memorandum submitted by the Secretary-General, United Nations - General Assembly International Law Commission Lake Success, New York 1949.

mbrojtjen e ligjit (McKeown,2014:110). Gjithashtu, nëse zhvillohet një procedurë e rregullt, ku të akuzuarit në bazë të provave dhe dëshmive do të gjykohen, atëherë një gjë e tillë do të përbënte edhe një garanci shtesë që në të ardhmen të parandalohen kritikën se të pandehurit ishin dënuar pa prova.¹⁹

Për sa i përket gjykimit të kriminelëve nazistë të luftës rëndësi patën dy deklaratat e fuqive aleate respektivisht Deklarata e St. James, e Londrës në vitin 1942, e nënshkruar më 13 janar në pallatin e St. James në Londër nga qeveritë e nëntë shteteve aleate për gjykimin e kriminelëve të luftës, si dhe deklarata e Moskës e vitit 1943. Në të dyja deklaratat theksohej nevoja e gjykimit të kriminelëve të luftës, veç të tjerave edhe për faktin se viktimat e agresionit të ushtruar gjatë luftës mund të dominohen nga ndjenja e hakmarrjes, sepse para së gjithash ato kërkojnë drejtësi. Deklaratat i paraprinë dhe patën ndikim të fuqishëm për nënshkrimin e marrëveshjes së Londrës, në bazë të së cilës u themelua Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak, i njohur ndryshe si Tribunali i Nurembergut.

Solidariteti ndërkombëtar ishte i nevojshëm në mënyrë që të shmangeshin aktet e hakmarrjes prej publikut të përgjithshëm dhe së dyti të plotësohej nevoja për drejtësi e botës së qytetëruar.

Karta për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak, e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Londrës të vitit 1943, përcaktoi në mënyrë të detajuar themelimin, parimet, juridiksionin dhe funksionet e Tribunalit.

¹⁹ http://www.history.com/topics/world-war-ii/nuremberg-trials#section_1 (shikuar me datë 26.04.2016, në orën 20.32.

Në mbështetje të vendimit të fuqive aleate për krijimin e një Tribunali Ndërkombëtar, që do të ketë juridiksionin për të gjykuar kriminelët nazistë të Luftës së Dytë Botërore, u krijua Komiteti i Kombeve të Bashkuara për krimet e luftës, i cili ishte trupi i parë zyrtar i krijuar, qëllimi ekskluziv i të cilit ishte hetimi i krimeve të luftës për të siguruar provat dhe faktet për dënimin e krimeve nga ana e një organi gjyqësor ndërkombëtar.

Gjatë kohës së funksionimit të Tribunalit të Nurembergut, atij i janë adresuar shumë kritika sidomos nga pala mbrojtëse e të pandehurve, por edhe nga studiues e teoricienë të ndryshëm të së drejtës. Ndër kritikën më të shpeshta, që i janë adresuar këtij Tribunali, kanë qenë se ai ishte një Tribunal me karakter politik dhe jojuridik, dhe kjo për faktin se është krijuar nga katër fuqitë fituese të luftës, prandaj ky Tribunal nuk përfaqëson të gjithë bashkësinë ndërkombëtare dhe karakteri *ad-hoc* i tij është rrethanë që paraqet dyshim për mundësinë e plotësimit të qëllimit për të cilin është themeluar, ndërsa njëra ndër kritikën më të shpeshta adresuar po Tribunalit ka qenë shkelja e parimit *nullum crimen, nulla poena sine lege*.²⁰

Mirëpo, edhe përkundër të metave që i ka pasur Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak gjatë funksionimit të tij, akti i themelimit të tij paraqet finalizimin e përpjekjeve të kahershme, të cilat u intensifikuan pas përfundimit të LPB-së kryesisht nga Lidhja e Kombeve, por pa sukses, për gjykimin dhe për dënimin e kriminelëve të cilët shkelën rëndë rregullat dhe zakonet e luftës si dhe rregullat dhe normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Kritika që veprimtaria e Tribunalit është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, gjegjësisht se Tribunali është duke shkelur parimin *nullum crimen, nulla poena sine lege*,

²⁰ Yearbooks of the International Law Commission, 1950, Volume II, Documents of the second session including the report at the Commission to the General Assembly, United Nations, New York, 1957.

është theksuar kryesisht nga pala mbrojtëse e të pandehurve, duke e përdorur si argument kryesor me synim tentativën për mbrojtjen e të pandehurve duke tentuar që Tribunalin dhe procedurën gjyqësore, që zhvillohet ndaj të pandehurve, ta shpallin si jolegjitime.

Edhe përkundër tendencave të tilla, ato kanë qenë vetëm kritika boshe sepse Tribunali vërtet është themeluar me një marrëveshje ndërkombëtare midis katër fuqive fituese të LDB-së, por themelimi, funksionimi, juridiksioni dhe parimet kryesore ku bazohet puna e Gjykatës së Nurembergut, kanë qenë të përmbajtura në Kartën për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak. Në nenin 6 të Kartës numërohen krimet për të cilat ka juridiksion Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak dhe elementet që e përbëjnë figurën e krimeve të tilla, të cilat si të tilla edhe pse kanë paraqitur risi për të drejtën ndërkombëtare penale, sërish shumica e elementeve, që përbëjnë figurën e këtyre krimeve, kanë qenë të njohura edhe para themelimit të Tribunalit të Nurembergut, qoftë në të drejtën zakonore, qoftë në akte dhe dokumente të ndryshme ndërkombëtare. Dhe për pasojë të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre në asnjë mënyrë nuk kanë mundur që këtë rrethanë ta shfrytëzojnë në favor të mbrojtjes së tyre, sepse të gjitha veprimet e ndërmarra prej tyre, në kryerjen e krimeve të tilla, kanë paraqitur shkelje të së drejtës zakonore të luftës, por edhe të së drejtës ndërkombëtare penale dhe asaj humanitare, gjëra që kanë qenë të njohura botërisht, e sidomos duke pasur parasysh faktin se shumica e kriminelëve nazistë kanë pasur përgatitje të lartë profesionale, arsimore edhe ushtarake dhe është e pamundur që të mos kenë pasur njohuri që veprimet e tyre janë të kundërligjshme. Dhe ndoshta gjëja e vetme, që nuk e kanë ditur, ka qenë se një ditë ata do të përgjigjen penalisht para një organi gjyqësor, për krimet e bëra, gjë që nuk është bërë më parë sepse deri në momentin e themelimit të

Gjykatës së Nurembergut nuk ka pasur një organ serioz që të merrte përgjegjësi dhe të gjykonte kriminelët e luftës.

Gjykata e Nurembergut, gjithashtu, ka kontribuar edhe në vendosjen e disa parimeve të së drejtës ndërkombëtare penale të cilat janë paraparë në Kartën e Tribunalit si dhe në aktgjykimet e saj.

Parime të tilla janë:

- Secili person i cili kryen një akt, që përbën krim sipas së drejtës ndërkombëtare, është përgjegjës për këtë dhe i aftë për t'u ndëshkuar;
- Fakti se për një akt i cili përbën krim sipas të drejtës ndërkombëtare, nuk parashihet dënim sipas së drejtës së brendshme, personin që ka kryer një akt të tillë nuk e liron nga përgjegjësia penale ndërkombëtare;
- Fakti që personi, i cili ka kryer aktin që përbën krim sipas së drejtës ndërkombëtare, ka vepruar si kryetar i shtetit ose zyrtar përgjegjës qeveritar, nuk e liron atë nga përgjegjësia penale ndërkombëtare;
- Fakti që personi ka vepruar në pajtim me urdhrat e qeverisë ose të eprorit sipas së drejtës ndërkombëtare nuk e liron atë nga përgjegjësia, sepse gjetja e një zgjidhjeje morale në fakt ka qenë e mundshme për të;
- Secili person i akuzuar për krime sipas së drejtës ndërkombëtare ka të drejtë për një gjykim fer të bazuar në fakte dhe në të drejtën;
- Krimet e mëposhtme janë të dënueshme si krime në të drejtën ndërkombëtare:

Krimet kundër paqes quhen:

- Planifikimi, përgatitja, inicimi ose bërja e një lufte të agresionit apo një lufte në kundërshtim me traktatet ndërkombëtare, marrëveshjet apo dokumentet ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në një plan të përbashkët apo komplot për realizimin e ndonjërit prej akteve të përmendura më lartë.

Krimet e luftës janë:

- Shkelja e ligjeve ose e zakoneve të luftës të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vrasje, keqtrajtim ose dëbim të popullsisë civile të territoreve të pushtuara dhe shfrytëzimi i tyre për punë të detyrueshme ose për qëllime të tjera, vrasja dhe keqtrajtimi i robërve të luftës, të personave në det, vrasja e pengjeve, plaçkitja e pronës publike ose private, shkatërrimi me dashje i qyteteve, qytezave dhe fshatrave, shkatërrim që nuk është i arsyetuar nga nevojat ushtarake.

Krimet kundër njerëzimit quhen:

- Vrasje, shfarosje, nënshtrim, deportim dhe akte të tjera çnjerëzore të bëra kundër popullatës civile, ose përndjekja mbi baza politike, racore ose fetare, kur veprimet dhe persekutimet e tilla janë kryer në ekzekutimin ose në lidhje me ndonjë krim kundër paqes ose ndonjë krim lufte.
- Bashkëpunimi në kryerjen e një krimi kundër paqes, krim lufte ose krim kundër njerëzimit, gjithashtu paraqet krim sipas të drejtës ndërkombëtare.²¹

Duke shtjelluar përmbajtjen e dispozitave të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak mund të themi se ajo ka siguruar disa institute kryesore, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe

²¹ crimeofaggression.info/documents/6/1950_Nuremberg_Principles.pdf, Principles of International Law Recognized in the Charter of the Nürnberg Tribunal and in the Judgment of the Tribunal, UN, 1950.

liritë themelore të të pandehurve në një procedurë gjyqësore, institute që edhe sot janë bazë e funksionimit të drejtë të procedurave para gjykatave, të cilat duke pasur parasysh kohën në të cilën janë zhvilluar gjykimet dhe cilësinë e subjekteve, që janë gjykuar, kanë qenë shumë të përparuara dhe humane.

Për dallim nga Tribunalet e mëvonshme ad-hoc, Tribunali i Nurembergut lidhur me përgjegjësinë penale të atyre që kanë kryer krime përveç përgjegjësisë së drejtpërdrejtë ka paraparë edhe përgjegjësinë për pjesëmarrje në një grup ose në një organizatë kriminale. Në nenin 1 të Statutit të Tribunalit është paraparë se kriminelët do të akuzohen në mënyrë individuale ose si pjesëtarë të organizatës ose të grupit, por edhe në të dyja rastet. Më tej në nenin 9 është paraparë që gjatë gjykimit të personave, Tribunali mundet që organizatën ose grupin, anëtar i të cilit ka qenë personi, t'i shpallë si kriminalë, cilësim që ka patur fuqinë edhe në rastet kur një pjesëtar i grupit ose i organizatës së tillë do të gjykohej para gjykatës nacionale, ushtarake ose profesionale (neni 10). Në Statut nuk janë numëruar kushtet në bazë të të cilave Tribunali, një organizatë ose një grup ka mundur ta shpallë si kriminale, kjo ka qenë një mangësi, sepse ka krijuar hapësirë për keqpërdorime nga ana e Tribunalit. Një formë e tillë e përgjegjësisë është karakteristike vetëm për Tribunalin e Nurembergut, sepse në statutet e Tribunaleve të mëvonshme ad-hoc si dhe në statutin e GJPN-së, një formë e tillë e përgjegjësisë nuk parashihet. Ekzistimi i kësaj lloji përgjegjësie, në statutin e Tribunalit të Nurembergut, arsyetohet ndoshta me faktin se në të kaluarën njëherë përgjegjësia kolektive e shteteve për veprime të kundërligjshme, e nga këtu duke pasur parasysh kohën në të cilën është themeluar dhe ka ekzistuar ky Tribunal mund ta kuptojmë arsyen e përfshirjes së kësaj lloji përgjegjësie në Statutin e Tribunalit të Nurembergut. Një përgjegjësi e tillë tani është një relinkt i kohës së kaluar, i cili në të drejtën penale

ndërkombëtare bashkëkohore nuk është më i pranueshëm. Heqja e një përgjegjësie të tillë nga e drejta ndërkombëtare, në përgjithësi, ka qenë një proces i gjatë dhe i vështirë derisa të arrihej bindja se një lloj i tillë i përgjegjësisë nuk duhet të ekzistojë për shumë arsye edhe praktike, sepse p.sh. nuk është e mundur që populli në tërësi të merret në përgjegjësi penale ose të gjykohej, për veprimet e kundërligjshme të shtetit, kur dihet se një popullsi përbëhet nga kategori të ndryshme personash, që për arsye të ekzistencës të rrethanave të caktuara, të njohura nga shumica e legjislacioneve bashkëkohore, nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale si, p.sh., fëmijët, personat me aftësi të kufizuara mendore etj. Për shembull, gjatë pushtetit nazist në Gjermani janë kryer veprime nga më mizoret ndaj hebrenjve, por ne nuk mund t'i fajësojmë të gjithë gjermanët për një gjë të tillë dhe nuk duhet të themi, p.sh., se ata janë fajtorë sepse shumica prej tyre kanë qenë pjesëtarë të partisë, por normalisht do të përgjigjen vetëm ata që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë kryer krime të tilla cilado qoftë mënyra me të cilën kanë kontribuar në kryerjen e krimeve të tilla ose ata të cilët kanë urdhëruar kryerjen e krimeve të tilla. Prandaj ekzistimi i përgjegjësisë penale kolektive, në përgjithësi, në të drejtën ndërkombëtare penale është i palogjikshëm. Një gjë e tillë vlen edhe për këtë dispozitë të parashikuar në Statutin e Tribunalit të Nurembergut, pra që personat mund të përgjigjen vetëm nëse kanë qenë pjesëmarrës të një grupi ose organizate të cilësuar si kriminale. Paraqitja e institutit të përgjegjësisë individuale të personave që, në emër të shtetit dhe për llogari të tij, kryejnë veprime kriminale, dhe ngritja e tij në nivel më të lartë, përveç të tjerash kontribuoi edhe në uljen në maksimum të mundësisë që personat, të cilët kryenin veprime të tilla, të fshiheshin nën mburojën e shtetit dhe të përgjegjësisë kolektive.

Gjithashtu, në Statutin e Tribunalit është paraparë edhe mundësia që një person i cili për të njëjtën vepër është proceduar më parë nga Tribunali mundet sërish të procedohet edhe nga ndonjë gjykatë nacionale ose ushtarake, dhe dënimi mund t'i shqiptohet si dënim më vete ose si dënim plotësues i dënimit të parë. Gjegjësisht në nenin 11 të Kartës së Tribunalit është paraparë se personi që është pjesëtar i një grupi ose i një organizate kriminale mund të gjykohej edhe nga gjykata nacionale, ushtarake dhe profesionale, me çka një personi të tillë mund t'i jepet dënim i pavarur ose dënim shtesë ndaj dënimit të dhënë nga Tribunali për pjesëmarrje në aktivitete kriminale të grupit ose organizatës së tillë kriminale. Përmbajtja e kësaj dispozite shkel parimin *non bis in idem*, parim që garanton sigurinë juridike të qytetarëve dhe i mbron ata nga veprimet arbitrare të organeve shtetërore dhe që është parim shumë i rëndësishëm i drejtësisë në sistemet juridike bashkëkohore, gjë e cila është pasqyruar edhe gjatë krijimit të Tribunaleve të mëvonshme ad-hoc si dhe në Statutin e GJPN-së, në dispozitat e të cilave nuk parashihet një rregullim i tillë, gjegjësisht mundet që një procedurë e filluar para gjykatës nacionale të ndërmerret për procedim nga gjykata ndërkombëtare, por vetëm në kushte të caktuara, pra në ato raste kur për të njëjtën vepër personi në veçanti është shpallur fajtor ose është dënuar nga një gjykatë nacionale, kur veprimet për të cilat është proceduar para gjykatës nacionale kanë qenë të cilësuar si krime të zakonshme ose në rastet ku zhvillimi i procedurës para gjykatës nacionale ishte i anshëm dhe i varur dhe në ato raste që ishin dizajnuar në atë mënyrë që ta mbronin të akuzuarin nga përgjegjësia penale ndërkombëtare ose kur një rast i tillë nuk ishte proceduar penalisht si duhet, pra në këto raste do të fillohet sërish procedura dhe në raste të tilla Tribunali Ndërkombëtar penal do të ketë parasysh faktin nëse të njëjtit person, për të njëjtën vepër nga një gjykatë nacionale i është shqiptuar dënim, i cili është vuajtur.

Instituti i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave, si shumë i rëndësishëm për një zhvillim objektiv të procedurës gjyqësore, nuk është paraparë me Kartën e Tribunalit, e cila pa dyshim paraqet një mangësi të madhe. Sepse duke siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, sigurohet deri te ardhja e së vërtetës më të plotë, sepse edhe dëshmitarët dhe viktimat të cilët u kanë mbijetuar krimeve, shpeshherë duke u frikësuar nga etiketimi dhe nga hakmarrja nuk dëshmojnë drejt ose fshehin fakte të rëndësishme për zbardhjen e së vërtetës. Prandaj një institut i tillë, në Tribunalet e mëvonshme, është paraparë, se ka garantuar dhe ka funksionuar si duhet, gjë që në masë të madhe ka kontribuar në arritjen e së vërtetës.

Në Kartën për Tribunalin e drejta e apelimit të vendimit nuk është paraparë, ku procedura para Tribunalit ka qenë vetëm njëshkallësh. Mohimi i së drejtës së ankesës pa dyshim paraqet një të metë shumë të madhe, e për më shumë edhe për faktin se ka qenë i paraparë dënimi me vdekje, ku dënimet e shqiptuara kanë qenë të plotfuqishme dhe për pasojë menjëherë të ekzekutueshme. Ekzekutimi i dënimit me vdekje është një akt i cili as nuk mund të kthehet e as të përmirësohet, dhe moslejimi i apelimit së paku të dënimeve të tilla, ka qenë një e metë shumë e madhe e Tribunalit, duke pasur parasysh faktin se dënime të tilla janë shqiptuar nga njerëzit që me veprimet dhe vendimet e tyre nuk mund të jenë të përsosur.

Në juridiksion të Tribunalit të Nurembergut kanë qenë tri lloje krimesh për të cilat ka pasur kompetencë ky Tribunal dhe ato janë krimet kundër paqes, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Krimi i gjenocidit është një krim i cili është kryer në përmasa të mëdha gjatë LDB-së, por që fatkeqësisht në kohën e funksionimit të Tribunalit të Nurembergut nuk ka qenë i njohur në asnjë konventë ose dokument ndërkombëtar. Ky krim u parapa dy

vite pas përfundimit të punës së Tribunalit të Nurembergut, gjegjësisht në Konventat e Gjenevës të vitit 1948, në të cilat për herë të parë u përcaktuan veprimet që përbëjnë figurën e krimit të gjenocidit.

Themelimi dhe funksionimi i Tribunalit të Nurembergut është një faktor kyç në vendosjen e bazamenteve për përgjegjësi penale në të drejtën ndërkombëtare penale. Ky Tribunal, gjithashtu, ka një ndikim të madh në thyerjen e shumë tabuve, deri atëherë të pakapërcyeshme, lidhur me përgjegjësinë penale për veprimet e shtetit ose të personave të cilët ndërmarrin veprime në emër dhe për llogari të shtetit, veprim që e kanë lidhur ekskluzivisht me sovranitetin shtetëror duke e llogaritur të drejtën si absolute, dhe përgjegjësia eventuale e shtetit për veprimet e tij ose të personave të tij përgjegjës do të nënkuptonte përzierje në punët e brendshme të atij shteti.

Dhe pa dyshim kontributi më i madh i Tribunalit të Nurembergut është vendosja e parimeve të cilat më vonë, nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, u pranuan si parime të së drejtës ndërkombëtare. Sepse nga përfundimi i punës së dy Tribunaleve *ad-hoc* dhe konkretisht atij të Nurembergut dhe të Tokios nga viti 1946 e deri në vitin 1992, kohë kur u themelua Tribunali i Hagës dhe kur për ish-Jugosllavinë ende nuk kishte një gjykatë e cila do të gjykonte krimet dhe kriminelët e tillë, por ishin parimet e Nurembergut dhe të Tokios, mbi të cilat bashkësia ndërkombëtare mund të vepronte në çdo kohë.

Edhe pse arsyetimet ligjore për gjykimet që u zhvilluan në Tribunalin e Nurembergut dhe risitë e tyre procedurale ishin të diskutueshme në atë kohë, krijimi i Tribunalit të Nurembergut konsiderohet si një moment historik drejt themelimit të një gjykate të

përhershme ndërkombëtare, dhe një precedent i rëndësishëm për t'u marrë me rastet e mëvonshme të gjenocidit dhe me krime të tjera kundër njerëzimit.²²

4.2. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Tokios

Në pajtim me Deklaratën e Potsdamit, e nënshkruar më 26 korrik të vitit 1945 midis Shteteve të Bashkuara, Kinës dhe Britanisë së Madhe, në të cilën aderoi më vonë edhe Bashkimi Sovjetik, u themelua Tribunali Ndërkombëtar i Tokios. Deklarata theksoi se “drejtësia e ashpër do të vinte për të gjithë kriminelët e luftës, duke përfshirë edhe ata të cilët kanë kryer mizoritë mbi të burgosurit tanë”. Ndjekja e fuqive të mëdha iu delegua Komandantit Suprem të forcave aleate në bazë të Instrumentit të Dorëzimit, të nënshkruar më 2 shtator të vitit 1945 në Bay të Tokios midis Japonisë dhe nëntë kombeve aleate. Gjenerali, MacArthur, themeloi Gjykatën Ndërkombëtare Ushtarake për Lindjen e Largët me një shpallje të veçantë të datës 19 janar të vitit 1946.²³

Kjo Deklaratë parashihte:

Artikulli 1 – Do të themelohet një Tribunal Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët për të gjykuar personat e akuzuar individualisht ose si anëtarë të organizatës, ose në të dyja rastet, me akuzat që përfshijnë krimet kundër paqes.

Artikulli 2 – Themelimi, juridiksioni dhe funksionet e këtij Tribunali janë të rregulluara me Kartën për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët, të aprovuara nga gjeneral MacArthur në cilësinë e Komandantit Suprem të fuqive aleate, më 19 janar të vitit 1946.

²² http://www.history.com/topics/world-war-ii/nuremberg-trials#section_1 (shikuar me date 26.04.2016 ne ora 20.32)

²³ http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/english/ilc_1950_v2.pdf, Yearbooks of the International Law Commission, 1950, Volume II, Documents of the second session including the report at the Commission to the General Assembly, United Nations.

Artikulli 3 – Asgjë nga ky urdhër nuk do të paragjykojë juridiksionin e ndonjë gjykate ndërkombëtare, kombëtare ose profesionale, komisioni ose gjykata të tjera të krijuara ose që do të krijohen në Japoni ose në ndonjë territor të Kombeve të Bashkuara me të cilat Japonia ka qenë në luftë, për gjykimin e kriminelëve të luftës.²⁴

Karta për Tribunalin Ndërkombëtar për Lindjen e Largët, e proklamuar nga Komandanti Suprem i fuqive aleate, më 19 janar të 1946-ës, përmban pesë pjesë.

Në pjesën e parë përmban dispozita lidhur me themelimin e Tribunalit i cili është themeluar për gjykim të drejtë dhe të shpejtë si dhe për ndëshkimin e kriminelëve më të mëdhenj të luftës në Lindjen e Largët, selia e përhershme e të cilit ishte përcaktuar të jetë në Tokio (neni 1).

Lidhur me përbërjen parashihej se kjo gjykatë do të përbëhej nga jo më pak se pesë, e as më shumë se nëntë anëtarë, të emëruar nga Komandanti Suprem i fuqive aleate, të cilët do të zgjidhen nga lista e emrave të paraqitur nga nënshkruesit e Instrumentit të dorëzimit (neni 2).

Gjykata ka pasur sekretariatit dhe zyrtarët e tjerë. Presidenti është emëruar nga ana e Komandantit Suprem të fuqive aleate, nga radhët e gjyqtarëve. Sekretariati i Tribunalit është përbërë nga sekretari i përgjithshëm, nga sekretarët ndihmës, nëpunësit, përkthyesit si dhe nga personeli tjetër sipas nevojave të Tribunalit. Sekretari i përgjithshëm e ka organizuar dhe drejtuar punën e Sekretariatit, me çka të gjitha dokumentet drejtuar Tribunalit janë pranuar nga sekretari, ka ofruar shërbimet e nevojshme administrative për

²⁴ www.loc.gov/law International Military Tribunal for the Far East, Special Proclamation by Supreme Commander for the Allied. Powers at Tokyo, 19 January, 1946.

Tribunalin dhe anëtarët e saj, si dhe ka kryer detyra të tjera të caktuara nga Tribunali (neni 3).

Dispozitat lidhur me kuorumin dhe votimin janë paraparë në nenin 4, ku është paraparë që për formimin e kuoromit nevojitet prania e shumicës të të gjithë anëtarëve, kurse lidhur me mënyrën e votimit është paraparë që të gjitha vendimet dhe gjykimet e Tribunalit, përfshirë edhe shqiptimin e dënimeve, do të bëhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe në rast të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

Në pjesën e dytë të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët janë paraparë dispozita të përgjithshme lidhur me juridiksionin e Tribunalit.

Tribunali do të ketë fuqinë që të ndëshkojë kriminelët e Luftës për Lindjen e Largët, të cilët si individë ose si anëtarë të organizatave ngarkohen me vepra që përfshijnë krime kundër paqes. Më tej parashihen aktet, ndërmarrja e të cilave ose e ndonjërës prej tyre, paraqet krime që bien brenda juridiksionit të Tribunalit, për të cilat do të ketë përgjegjësi individuale:

- Krimet kundër paqes, gjegjësisht planifikimi, përgatitja ose inicimin për të bërë një luftë agresioni të deklaruar ose jo, ose një luftë në kundërshtim dhe duke shkelur ligjin ndërkombëtar, traktatet, marrëveshjet ose deklaratat ndërkombëtare, ose pjesëmarrja, plani i përbashkët ose komploti në realizimin e akteve të mësipërme;
- Krimet e luftës, gjegjësisht shkelja e ligjeve dhe zakoneve të luftës;
- Krimet kundër njerëzimit, gjegjësisht vrasje, shfarosje, nënshtrim, deportim dhe veprime të tjera çnjerëzore të kryera kundër çdo popullsie civile para ose gjatë luftës, ndjekja mbi baza politike apo racore, ekzekutimi, ose ndonjë krim tjetër

brenda juridiksionit të Tribunalit, pavarësisht se akte të tilla janë ose jo shkelje të ligjit të brendshëm të vendit ku janë kryer. Udhëheqësit, organizatorët, nxitësit dhe bashkëpunëtorët, që marrin pjesë në formulimin ose në ekzekutimin e një plani të përbashkët apo komploti për të kryer ndonjë ose disa nga krimet e mësipërme janë përgjegjës për të gjitha veprat që kryhen nga çdo person në zbatimin e një plani të tillë (neni 5).

Për përgjegjësinë penale të të akuzuarve është paraparë se pozita zyrtare e të akuzuarit ose fakti se të akuzuarit kanë vepruar në bazë të urdhrit të qeverisë së tyre ose të një eprori, nuk do të jetë bazë e mjaftueshme për ta liruar atë nga përgjegjësia për çdo krim për të cilin është akuzuar, por rrethana që personi ka vepruar në bazë të urdhërave të qeverisë ose eprorit të tij mund të konsiderohen si rrethana që mund të ndikojnë në zbutjen e dënimit nëse Gjykata e konsideron se kështu e kërkon drejtësia (neni 6).

Rregullat e procedurës, që aplikohen nga Tribunali, mund të hartohen dhe të ndryshohen në pajtim me dispozitat themelore të Kartës (neni 7).

Shefi i Këshillit është person që caktohet nga Komandanti Suprem i fuqive aleate, dhe është personi përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e të gjitha akuzave kundër kriminelëve të luftës brenda juridiksionit të Tribunalit, por dhe ai që do t'i japë asistencë ligjore Komandantit Suprem ashtu si është e përshtatshme.

Këshilltari i Asociuar mund të emërohej nga çdo komb me të cilin Japonia ka qenë në luftë, me qëllim që t'i japë ndihmë shefit të Këshillit (neni 8).

Pjesa e tretë e Kartës përmbante dispozita lidhur me gjykimin për të të akuzuarve, ku parashihej procedura e caktuar me qëllim të sigurimit të gjykimin për të akuzuarit.

Kjo nënkuptonte se aktakuza duhej të ishte një deklaratë e thjeshtë dhe koncize, si dhe secilit të akuzuar duhej t'i jepet një kopje e aktakuzës në gjuhën që ai e kupton me qëllim që i akuzuari të ketë kohë për të përgatitur mbrojtjen. Gjithashtu, të akuzuarit i sigurohej edhe e drejta e shprehjes gjatë gjykimit ose gjatë zhvillimit të ndonjë procedure paraprake; të akuzuarit duhej t'i jepej e drejta për të dhënë shpjegim përkatës lidhur me akuzat e bëra ndaj tij.

E drejta e gjuhës si një mjet në drejtim të sigurimit të gjykimit fer gjithashtu sigurohej kur parashihej që gjykimi dhe procedurat e tjera do të kryhen në gjuhën angleze e gjithashtu edhe në gjuhën e të akuzuarit.

Çdo i akuzuar përfaqësohej nga mbrojtësi i zgjedhur prej atij vetë, i cili mund të mos miratohet nga Tribunali në çdo kohë. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij kishin të drejtën e paraqitjes së provave në gjyq, në mbështetje të mbrojtjes së tij, si dhe të drejtën për të shqyrtuar ndonjë dëshmitar të thirrur nga prokuroria, por me kufizime të arsyeshme që përcaktoheshin nga Tribunali.

Lidhur me shqyrtimin e dëshmitarëve ose të dokumenteve i akuzuari duhej t'i drejtohej Tribunalit me shkrim, ku aplikimi duhet domosdo të përmbajë lokacionin se ku është menduar se ndodhet dëshmitari ose dokumenti si dhe të japë deklaratë lidhur me faktet që janë propozuar dhe që duhet të provohen nga dëshmitari ose nga dokumenti si dhe rëndësinë e fakteve të tilla për mbrojtjen. Gjykatës duhet t'i ofrohet ndihmë për marrjen në shqyrtim të provave të caktuara ashtu siç kërkojnë rrethanat (neni 9).

Aplikimet dhe parashtresat e tjera, që dorëzoheshin deri te Tribunali, ishin paraparë që në formë të shkruar ato duhej t'i dorëzoheshin sekretarit të përgjithshëm para gjykimit, me qëllim që Tribunali të mund të veprojë lidhur me to (neni 10).

Me qëllim që procedura e gjykimit të rrjedhë normalisht Tribunali kishte disa kompetenca dhe sjellje të cilat duhej t'i respektojë:

- Të thërrasë dëshmitarë në gjykim, duke tentuar që të sigurojë praninë e tyre në gjykim, dëshminë dhe pyetjet e tyre;
- Të marrë në pyetje secilin të akuzuar si dhe lejimin e komentit lidhur me refuzimin për përgjigje në ndonjë pyetje;
- Të kërkojë shqyrtimin e dokumenteve dhe materialeve të tjera të provave;
- Të kërkojë nga çdo dëshmitar një betim, një pohim apo një deklaratë, pavarësisht se cila është e zakonshme në vendin e dëshmitarit të një pohimi të tillë nga ana e Gjykatës;
- Të përcaktojë nëpunës për kryerjen e detyrave, që përcaktohen nga Gjykata, përfshirë edhe fuqinë e të pasurit të provave të marra nga një komision (neni 11).

Më tej me këtë Kartë janë përcaktuar masat që duhej të ndërmarrë Tribunali lidhur me kryerjen e gjykimit në kohë të arsyeshme:

- Të kufizojë gjykimin në mënyrë rigoroze për shqyrtimin e çështjeve të ngritura në aktakuzë, në një seancë të shpejtë;
- Të marrin masa të rrepta për të parandaluar ndonjë veprim i cili do të shkaktonte vonesë të paarsyeshme duke përjashtuar çështjet e parëndësishme dhe deklaratat e panevojshme të çfarëdo natyre qofshin ato;
- Të sigurojë ruajtjen e rendit në gjyq si dhe marrjen, me mashtrimet e mundshme lidhur me dënimin e duhur, duke përfshirë edhe të drejtën e Tribunalit që të përjashtojë secilin të akuzuar ose mbrojtësin e tij nga procedurat e mëtejshme, por pa paragjykuar lidhur me determinimin e akuzave;

- Përcaktimin e kapacitetit mendor ose fizik të secilit të akuzuar, dhe aftësinë e tij për të vazhduar gjykimin (neni12).

Lidhur me dëshmitë dhe pranueshmërinë e tyre është paraparë që Gjykata nuk do të jetë e lidhur me rregullat teknike të provave. Ajo do të miratojë, por edhe do të zbatojë sa më shumë që të jetë e mundur procedurën e shpejtë dhe joteknike, gjithashtu duhet të pranojë secilën dëshmi që e konsideron se ka vlerë provuese. Të gjitha pranimet e supozuara ose deklaratat e të akuzuarit janë të pranueshme.

Tribunali, para se t'i ofrohet ndonjë dëshmi, mund të kërkojë që të informohet për natyrën e dëshmisë me qëllim që të gjykojë mbi rëndësinë e saj.

Pranueshmëria e provave specifike, në mënyrë të veçantë dhe të pakufizuar, mund të heqë dorë nga rregullat e përgjithshme dhe të pranojë dëshmitë në vijim:

- Një dokument pavarësisht klasifikimit të shkallës së sigurisë, për të cilin nuk ka prova për firmën ose identitetin e lëshuesit, i cili kur paraqitet para Tribunalit duhet të ketë qenë i nënshkruar ose i lëshuar nga një oficer, nga një departament, nga një agjenci apo nga një anëtar i forcave të armatosura të secilës qeveri;
- Një raport i cili Tribunalit i duket se është nënshkruar apo lëshuar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar ose nga ndonjë anëtar i saj, nga ndonjë mjek ose nga ndonjë personel mjekësor, nga ndonjë zyrtar i hetuesisë ose i inteligjencës, ose nga ndonjë person që Tribunalit i duket se ka njohje personale të çështjeve të përfshira në raport;
- Një dëshmi, depozitim ose deklaratë tjetër të shkruar;
- Një ditar, letër apo dokument tjetër duke përfshirë deklaratat nën hetim ose pa hetim, të cilat Tribunalit i duken se përmbajnë ndonjë informacion në lidhje me akuzat;

- Një kopje e dokumentit ose e provave të dyta me një përmbajtje të caktuar, në qoftë se origjinali nuk është menjëherë në dispozicion.

Për të ashtuquajturat njohuri për faktet e zakonshme gjykata nuk do të kërkojë prova, por dhe as për origjinalitetin e dokumenteve zyrtare të qeverisë, raportet e çdo kombi ose të procedimit, të dhënat dhe gjetjet e ushtrisë ose të ndonjë organizate të Kombeve të Bashkuara.

- Procesverbali dhe dokumentet;
- Transkripti i procedurës dhe i dokumenteve të dorëzuara në Tribunal, do të dorëzohen sekretarit të përgjithshëm të Tribunalit dhe do të përbëjnë pjesë të procesverbalit (neni13).

Me qëllim të zhvillimit të duhur të procedurës, është paraparë ndërmarrja e disa veprimeve:

- Aktakuza do të lexohet në gjykatë me përjashtim të rasteve kur për leximin e tillë kanë hequr dorë të gjithë të akuzuarit;
- Tribunali do të pyesë të akuzuarin se a ndihet fajtor ose jo;
- Prokuroria dhe secili i akuzuar mund të bëjë kopje koncize të deklaratave të tyre;
- Prokuroria dhe mbrojtja mund të ofrojnë prova, pranueshmëria e të cilave do të përcaktohet nga Gjykata;
- Prokuroria dhe mbrojtja do të shqyrtojnë çdo dëshmitar dhe çdo të akuzuar që jep dëshmi;
- Mbrojtësi i të akuzuarit mund t'i drejtohet gjykatës, gjithashtu edhe prokuroria;
- Gjykata do të dorëzojë gjykimin dhe shqiptimin e dënimit (neni 15).

Në pjesën e pestë të Kartës për Tribunalin Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët janë paraparë dispozita lidhur me aktgjykimin dhe dënimin.

Gjykata ka fuqinë që një të akuzuar ta ndëshkojë me vdekje ose t'i shqiptojë një lloj tjetër sanksioni, të cilin do ta përcaktojë në bazë të bindjes së lirë (neni 16).

Aktgjykimi dhe rishikimi i tij – aktgjykimi, që duhet të shpallet publikisht, duhet të përmbajë arsyet mbi të cilat është bazuar.

Të dhënat nga gjykimi do të transmetohen drejtpërdrejt deri te Komandanti Suprem i fuqive aleate, për veprimin e tij të mëtejshëm.

Dënimet do të ekzekutohen në përputhje me urdhrat e Komandantit Suprem të fuqive aleate, i cili në çdo kohë mundet që të zvogëlojë ose të ndryshojë dënimin, me përjashtim të shtimit të dënimit (neni 17).²⁵

Tribunali i Tokios, i krijuar pas atij të Nurembergut, në esencë është shumë i ngjashëm dhe i themeluar pothuajse mbi të njëjtat parime me ato të Nurembergut, përsëri duke shtjelluar dispozitat e përmbajtura në Kartën për Gjykatën Ndërkombëtare Ushtarake për Lindjen e Largët (i njohur shkurt si Tribunali i Tokios), shohim se ndërmjet këtyre dy Tribunaleve ekzistojnë dallime të caktuara, të determinuara kryesisht nga rrethanat që e kanë kushtëzuar themelimin e secilit prej dy Tribunaleve.

Lidhur me numrin e gjykatësve dhe prokurorëve, Tribunali i Tokios është paraparë që të ketë nga pesë deri në shtatë gjykatës, që nuk kanë pasur zëvendës, kurse prokurorë ka qenë vetëm një, për dallim nga Tribunali i Nurembergut i cili ka pasur katër prokurorë, një nga secili shtet nënshkrues i marrëveshjes së Londrës për themelimin e Tribunalit të Nurembergut. Sigurisht, një gjë e tillë ka qenë e determinuar nga volumi i ndryshëm i çështjeve që kanë pasur për zgjidhje të dyja Tribunalet.

²⁵ International Military Tribunal for the Far East, Special Proclamation by Supreme Commander for the Allied Powers, Treaties and other International Acts Series, Tokyo, 1946.

Te pjesa e inkriminimit të veprimeve, të cilat përbëjnë krime ndërkombëtare dhe që janë në juridiksion të këtyre Tribunaleve, edhe te Karta për Tribunalin e Tokios parashihen tri lloje të krimeve dhe gjegjësisht krimet kundër paqes, krimet konvencionale të luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Karta për Tribunalin e Tokios në dallim nga Karta për Tribunalin e Nurembergut, për sa i përket inkriminimit të krimit kundër paqes e ka të rregulluar disi më ndryshe pjesën e “planifikimit, përgatitjes, inicimit ose kryerjes së deklaruar ose jo të luftës së agresionit”, gjë e përcaktuar kryesisht nga rrethanat në të cilat filluan dhe u zhvilluan armiqësitë në Lindjen e Largët, pa asnjë deklaratë për luftë nga të dyja anët.²⁶

Për sa i përket përgjegjësisë penale të personave, të cilët veprojnë si pjesëtarë të grupit ose të organizatës kjo është në juridiksion të të dyja Tribunaleve, mirëpo për dallim nga ai i Tokios, Tribunali i Nurembergut parasheh se është në kompetencë të tij që ta shpallë si kriminal një grup ose një organizatë.²⁷

Ndërsa për sa i përket mundësisë së rishikimeve të vendimeve ka dallim midis dy tribunaleve. Përderisa Karta për Tribunalin e Nurembergut në mënyrë specifike përjashton mundësinë e rishikimit të vendimeve të saja lidhur me gjetjet e Tribunalit për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarve, Karta për Tribunalin e Tokios nuk e përmban një ndalesë të tillë. Bile në raste të caktuara për disa procedime të gabuara ndaj disa të akuzuarve, pati përpjekje që si organ i apelit të veprojë gjykata Supreme e Kombeve të Bashkuara, e cila nuk e pranoi një juridiksion të tillë.

²⁶ <http://www.un.org/law/ilc/index.html-website> f. 81 of International Law Commission – Document A/CN.4/5- The Charter and Judgment of the Nürnberg Tribunal – History and Analysis: Memorandum submitted by the Secretary-General - Formulation of the Nürnberg Principles.

²⁷ Po aty, f. 82.

Përmbajtja e aktakuzave në të dyja Tribunalet, sigurisht që ishte e kushtëzuar nga rrethanat nën të cilat ishin kryer krimet dhe për të cilat duhej të ngriheshin aktakuzat.

Një argument, që është përdorur nga mbrojtja e të akuzuarve ka qenë se, sipas Instrumentit Japonez të dorëzimit, duhet që Deklaratës së Postdamit t'i jepet efekt në lidhje me ndjekjen e kriminelëve të luftës, kuptohet për krimet që kanë qenë të njohura në kohën e Deklaratës së Postdamit, pra vetëm ato kanë mundur të akuzohen.

Mirëpo nga ana e Tribunalit të Tokios, lidhur me një argumentim të tillë, është deklaruar se lufta agresive ka qenë e njohur si krim ndërkombëtar shumë më përpara Deklaratës së Potsdamit.

Konspiracioni dhe domethënia e tij janë diskutuar shumë në Tribunalin e Tokios, gjegjësisht lidhur me atë se çka paraqet konspiracioni dilemë që nuk është diskutuar edhe në Tribunalin e Nurembergut.²⁸

Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios si gjatë funksionimit të tyre, ashtu edhe pas përfundimit të punës, janë kritikuar shumë lidhur me mangësitë që kanë pasur në punën e tyre, disa prej të cilave janë edhe kritika të qëndrueshme.

Parimi i ekonomizimit si parim i cili parasheh kryerjen e procedurës në një kohë sa më të shkurtër, ka qenë një parim i cili është theksuar shumë gjatë gjykimeve në Nuremberg dhe Tokio, madje e i njëjti edhe është aplikuar në të gjitha fazat e procedurës gjegjësisht gjatë hetimit, mbledhjes së provave, shqyrtimit të tyre, e deri në fazën përfundimtare gjegjësisht shqiptimin e aktgjyqimit. Gjithsesi se parimi i ekonomizimit është parim shumë i rëndësishëm i secilës procedurë, por respektimi i saj nuk nënkupton edhe heqjen dorë nga veprime të caktuara procedurale të cilat janë kyçe për vendosjen e drejtë të një çështjeje të

²⁸ Po aty, f. 83-84.

caktuar. Prandaj në rastin e gjykimeve të zhvilluara në Nurenberg dhe Tokio është ndjekur pikërisht një praktikë e tillë, nisur nga fakti se të gjitha gjykimet kanë përfunduar për një periudhë rekorde prej afër një viti. Kjo për mendimin tim është gjithashtu një e metë e këtyre proceseve për faktin se duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e proceseve të tilla gjyqësore, faktin se vërtetimi i elementeve objektive dhe subjektive të krimeve që janë gjykuar është një proces kompleks i cili kërkon kohë më të gjatë dhe më shumë impenjim, pastaj koha përgjatë së cilës janë kryer krimet e pretenduara, lokacioni hapësinor i kryerjes së krimeve, kërkon një kohë më të gjatë për vërtetim, gjëra të tilla ngrisin dyshimin se gjykatat e tilla nuk kanë qenë sa duhet efikase dhe të drejta në gjykim, ose të çojnë të mendosh se procedurat e tilla kanë qenë vetëm formale dhe sa për të pasur alibi para publikut, ku personat që do të dënoheshin dhe lartësia e dënimeve të tilla kanë qenë të paracaktuara, në bazë të fakteve dhe rrethanave tjera ndoshta të vërtetuara ose të njohura më herët. Por sidoqoftë dhe pavarësisht kritikave dhe të metave që i kanë pasur këto dy Tribunale, kontributi i tyre në të drejtën penale ndërkombëtare është i pamohueshëm. Themelimi dhe funksionimi i tyre paraqet një erë të re në të drejtën penale ndërkombëtare. Ato shënuan jetësimin në praktikë të përgjegjësisë penale ndërkombëtare dhe bënë realitet gjykimin e personave përgjegjës për krime lufte, krime kundër paqes dhe krime kundër njerëzimit, dhe me këtë i dhanë fund periudhës së mospërgjegjësisë dhe mosgjyimit të personave, të cilët kryenin krime ndërkombëtare dhe më pastaj mbroheshin dhe fshiheshin nën mburojën e shtetit dhe interesave shtetërore.

4.3. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Hagës

Pas përfundimit të punës së Tribunaleve të Nurembergut dhe të Tokios dhe para themelimit të Tribunalit të Hagës, në suaza ndërkombëtare nuk ekzistonte një organ i përhershëm i cili do të ishte përgjegjës për ndjekjen dhe gjykimin e personave që kryenin krime ndërkombëtare duke shkelur rëndë dispozitat e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe rregullat dhe zakonet e luftës, e aq më pak gjykatat nacionale ishin të gatshme që të hetonin dhe të gjykonin kriminelë të tillë, të cilët në të shumtën e rasteve nga një klasë e caktuar, në vendet ku ata kryenin krimet ose nga vendet për të cilat vepronin, konsideroheshin si heronj.

Edhe përkundër faktit se në bashkësinë ndërkombëtare shumë më herët janë inkriminuar rregulla dhe dispozita qoftë në konventa dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, qoftë si rregulla të së drejtës zakonore, me të cilat ndalohen shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare si dhe rregullat zakonore, dhe për faktin se ato nuk mund të zbatoheshin dhe as të aplikoheshin në praktikë nga një organ konstant, ato ngelin vetëm shkronja të vdekura në letër dhe pa asnjë efekt real.

Mirëpo, në anën tjetër realiteti i hidhur i zhvillimit të konflikteve të armatosura, i shkeljeve të rënda dhe i pasojave marramendëse negative ishte shumë i madh. Vendimi për themelimin e Tribunalit të Hagës, përveç të tjerave ishte edhe rezultat i një presioni publik ndaj OKB-së që si organizatë ndërkombëtare përparësi kryesore ka ruajtjen dhe mbrojtjen e paqes në nivel botëror, prandaj nuk duhej dhe nuk mund të mbetej e verbër dhe e shurdhër ndaj shkeljeve të rënda që kryheshin në territorin e ish-Jugosllavisë, posaçërisht ndaj

civilëve, masat e pastrimit etnik si dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare (Krapac,2011:178).

Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara duke u bazuar në Kartën e OKB-së, gjegjësisht në pjesën VII të saj, e cila ka të bëjë me “aktet të cilat kërcënojnë paqen, cenojnë paqen dhe aktet e agresionit” duhet të dënohen. Themelimit të Tribunalit të Hagës i parapriu miratimi i dy Rezolutave edhe Rezoluta 787 e dt. 16.XI.1992 dhe Rezoluta 808 e dt. 22.II.1993.

Me Rezolutën 787 të vitit 1992 u përfshi mandati i komisionit i cili ishte kompetent për hetimin dhe mbledhjen e fakteve për krimet e kryera, i cili në fund të punës së saj i parashtoi Këshillit të Sigurimit një raport të detajuar lidhur me hetimet dhe faktet e mbledhura për krimet e kryera.

Me Rezolutën 808 të vitit 1993, Këshilli i Sigurimit erdhi me vendimin se do të themelohet një Tribunal Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish-Jugosllavisë (Krapac,2011:178).

Kështu Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përcaktoi se situata në ish-Jugosllavi përbënte një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, me Rezolutën 827 të datës 25 maj 1993, u krijua Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, si një masë e përkohshme për të kontribuar në restaurimin e ruajtjes së paqes në territorin e ish-Jugosllavisë. Si organ vartës i Kombeve të Bashkuara, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë u ngarkua me detyrën e vështirë të ndjekjes penale të personave të akuzuar

për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë.²⁹

Për dallim nga mënyra e themelimit të Tribunalit të Nurembergut dhe Tokios, të cilat u krijuan nga fuqitë fitimtare të luftës, karakteristikë e themelimit të Tribunalit të Hagës është që, për herë të parë në histori, komuniteti ndërkombëtar dhe jo vetëm fitimtarët e kohës së luftës, veproi për të krijuar një Tribunal për ndjekjen penale të personave në mënyrë që të frenohet kryerja e krimeve të tjera, dhe fajtorët të dilnin para drejtësisë me qëllim që të kontribuohet në rikthimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.³⁰

TPNJ-ja vepron në bazë të Statutit, i miratuar nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së me rezolutën 827 të vitit 1993, i cili bazohet në dispozitat kryesore të së drejtës humanitare dhe ndërkombëtare penale, të përmbajtura në konventat dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare si dhe në rregullat zakonore të së drejtës ndërkombëtare. Me një qasje të tillë Statuti ka pretenduar t'i largohet kritikës lidhur me shkeljen e parimit të ligjshmërisë, që ka qenë njëra ndër kritikët kryesore për të cilën të akuzuarit i janë adresuar Tribunalit të Nurembergut (Dimitrijevic, Hazdi-Vidanovic, Jovanovic, Markovic, Milanovic, 2013:24).

Me Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, janë rregulluar të gjitha çështjet materiale, formale dhe procedurale për funksionimin e duhur të këtij Tribunali.

Sipas Statutit, Tribunali përbëhet nga tri organe kryesore:

²⁹ http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/manual_developed_practices/icty_manual_on_developed_practices_alb.pdf, Manual i TPNJ-së mbi praktikën e zhvilluar-përgaditur së bashku me UNICRI-në si pjesë e një projekti për të ruajtur trashëgiminë e TPNJ-së, 2009, f. 3.

³⁰ Po aty, f. 3.

- Dhomat, ku përfshihen tri Dhomat Gjyqësore dhe Dhoma e Apelit
- Prokuroria dhe
- Sekretaria, e cila u shërben si dhomave, po ashtu edhe prokurorit (neni 11).

Dhomat përbëhen nga gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm dhe nga dymbëdhjetë gjykatës *ad litem*, të emëruar në përputhje me dispozitat e këtij Statuti. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë tre gjykatës të përhershëm dhe gjashtë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore, në të cilën caktohen gjykatës *ad litem*, ndahet në trupa gjykues të përbërë prej tre gjykatësish, secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem* përveç rrethanave të përcaktuara me dispozitat e këtij Statuti (të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni). Trupi gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

Anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet nga pesë prej anëtarëve të saj.

Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave – gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar e zgjedhin kryetarin nga radhët e veta. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i Dhomës së Apelit dhe kryeson punimet e saj.

Kryetari i Tribunalit, pas konsultimeve paraprake me gjykatësit e përhershëm, cakton në Dhomën e Apelit katër gjykatës të përhershëm dhe nëntë gjykatës të përkohshëm. Anëtarë të Dhomës së Apelit janë edhe dy gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën.

Rregullorja e procedurës dhe provave – në nenin 15 të Statutit të Tribunalit të Hagës, është paraparë se gjykatësit e Tribunalit miratojnë një rregullore të procedurës dhe të provave për

kryerjen e fazës paragjyqësore, gjykimit dhe apelit, pranimin e provave, mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve dhe çështje të tjera përkatëse (neni15).

Rregullat e Procedurës dhe Provave janë adaptuar më 11 shkurt 1994 dhe janë ndryshuar dhe plotësuar disa herë. Amendamenti i fundit është bërë më 22 maj të vitit 2013. Kjo rregullore përmban 127 rregulla të ndara në dhjetë pjesë, ku rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e procesit gjyqësor para Tribunalit prej fillimit e deri në përfundimin e saj.

Prokurori është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish-Jugosllavisë. Prokurori vepron në mënyrë të pavarur si organ i veçantë i Tribunalit Ndërkombëtar dhe si i tillë për punën e tij nuk kërkon dhe nuk merr leje prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

Zyra e prokurorit përbëhet nga prokurori dhe sipas nevojës edhe nga personel tjetër i kualifikuar (neni16).

Për administrimin dhe shërbimet për Tribunalin është përgjegjëse Sekretaria, e cila përbëhet nga sekretari dhe nga personel tjetër sipas nevojës (neni 17).

Hetimi dhe përgatitja e aktakuzës – prokurori fillon hetime *ex officio* ose në bazë të të dhënave të marra nga çfarëdo burimi, veçanërisht prej qeverive, organeve të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare. Prokurori i vlerëson të dhënat e marra ose të siguruara dhe vendos nëse ekziston bazë e mjaftueshme për të proceduar.

Prokurori është ai që ka kompetencë të marrë në pyetje të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët, të bëjë mbledhjen e provave dhe kryerjen e hetimeve në terren, dhe gjatë kryerjes së detyrave të tilla prokurori mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve të shtetit përkatës sipas nevojës.

Kur i dyshuari merret në pyetje ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat, që e zgjedh vetë i dyshuari, ose të shfrytëzojë të drejtën e ndihmës juridike pa pagesë në qoftë se atij i mungojnë fondet e mjaftueshme për të paguar, si dhe për përkthimin e nevojshëm në një gjuhë dhe prej një gjuhe që ai e flet dhe e kupton. Pas konstatimit se ekziston një çështje *prima facie*, prokurori përgatit aktakuzën, që përfshin një përshkrim të shkurtër të fakteve dhe të krimit ose krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari në bazë të Statutit dhe pastaj aktakuza i përcillet një gjykatësi të dhomës Gjyqësore (neni 18).

Shqyrtimi i aktakuzës bëhet nga gjykatësi i Dhomës Gjyqësore, të cilit i është përcjellë aktakuza. Gjykatësi e konfirmon aktakuzën në qoftë se bindet se prokurori e ka provuar çështjen *prima facie*, por në qoftë se nuk bindet për këtë atëherë e hedh poshtë aktakuzën.

Pas konfirmimit të aktakuzës dhe me kërkesë të prokurorit, gjykatësi mund të lëshojë urdhra dhe autorizime për arrestimin, paraburgimin, dorëzimin dhe transferimin e individëve dhe çfarëdo urdhra të tjerë që mund të jenë të nevojshëm për zhvillimin e procesit gjyqësor (neni 19).

Fillimi dhe zhvillimi i procesit gjyqësor – Dhomat Gjyqësore garantojnë gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe zhvillimin e procesit në përputhje me rregulloren e procedurës dhe të provave, duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe mbrojtjes së dëshmitarëve.

Individi kundër të cilit është konfirmuar një aktakuzë, në bazë të një urdhërese ose fletarrestimi të lëshuar nga Tribunali, do të arrestohet dhe menjëherë do të informohet për akuzat kundër tij dhe po menjëherë do të transferohet në Tribunal.

Dhoma Gjyqësore e lexon aktakuzën, siguron se janë respektuar të drejtat e të akuzuarit, konfirmon se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe e udhëzon atë që të deklarohet për fajësinë ose pafajësinë dhe në fund caktohet një datë për gjykim.

Seancat janë publike përveç rasteve kur Dhoma Gjyqësore vendos ta mbyllë seancën për publikun në përputhje me rregulloren e procedurës dhe të provave (neni 20).

Gjatë zhvillimit të procedurës para Tribunalit janë të garantuara të drejtat e të akuzuarit të përfshira në nenin 21 të Statutit të Tribunalit.

Të gjithë personat janë të barabartë para Tribunalit Ndërkombëtar. I akuzuari, në vërtetimin e akuzave kundër tij, gëzon të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik dhe ai konsiderohet i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë së tij sipas dispozitave të Statutit të Tribunalit.

I akuzuari ka të drejtën e disa garancive minimale gjatë vërtetimit të çdo akuze kundër tij:

- Të informohet në kohë dhe në hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;
- Të ketë kohë dhe kushte të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikojë me avokatin që e ka zgjedhur vetë;
- Të jetë i pranishëm në gjykimin kundër tij, të mbrohet vetë ose me anë të avokatit që e ka zgjedhur vetë, të informohet për këtë të drejtë dhe në qoftë se e kërkojnë interesat e drejtësisë t'i caktohet ndihmë juridike pa pagesë në rastet kur i akuzuari nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar;
- Të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në mbrojtje të tij në kushte të njëjta si dëshmitarët kundër tij;

- Të ketë ndihmën pa pagesë të përkthyesit në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në Tribunalin Ndërkombëtar;
- Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë (neni 21).

Mbrojtja e viktimave dhe e dëshmitarëve përcaktohet me rregulloren e procedurës dhe provave të Tribunalit Ndërkombëtar në të cilën parashihen disa masa mbrojtëse për dëshmitarët dhe për viktimat ndër të cilat edhe mbajtja e seancave të mbyllura dhe mbrojtja e identitetit të viktimave (neni 22).

Aktgjykimet dhe dënimet shqiptohen në Dhomat Gjyqësore, kundër individëve të cilët shpallen fajtorë për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Aktgjykimi jepet nga shumica e gjykatësve të Dhomës Gjyqësore dhe shpallet publikisht. Ai duhet të përmbajë arsyetimin me shkrim, të cilit mund t'i bashkëngjiten mendime të veçanta ose mospajtuese (neni 23).

Dënimi shqiptohet nga Dhoma Gjyqësore dhe i vetmi dënim që jepet është dënimi me burgim. Në përcaktimin e kushteve të burgimit, Dhomat Gjyqësore i referohen praktikës së përgjithshme të dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë. Në përcaktimin e kohës së dënimit, Dhomat Gjyqësore duhet të marrin parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të fajtorit.

Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë që pronarëve të ligjshëm t'u kthehet çdo pronë ose fitim i siguruar nëpërmjet shtrëngimit (neni 24).

Në Statutin e Tribunalit janë paraparë dy raste si bazë juridike për apelin e aktgjykimeve, gjegjësisht ku ka gabim ligjor që e shfuqizon vendimin dhe rasti i gabimit faktik i cili ka shkaktuar dështim të drejtësisë si dhe janë përcaktuar subjektet që mund të apelojnë vendimet dhe aktgjykimet dhe ata janë personi i gjykuar dhe prokurori.

Dhoma e Apelit mund të konfirmojë, të shfuqizojë ose të ndryshojë vendimet e marra nga Dhomat Gjyqësore (neni 25).

Një aktgjykim mund të rishqyrtohet kur zbulohet një fakt i ri, i cili nuk njihet në kohën e zhvillimit të procesit në Dhomat Gjyqësore ose në Dhomën e Apelit, dhe i cili mund të kishte qenë faktor përcaktues në marrjen e vendimit, në raste të tilla personi i gjykuar ose prokurori mund t'i bëjë kërkesë Tribunalit për rishqyrtim të aktgjykimit (neni 26).

Lidhur me zbatimin e dënimeve, që shqiptohen nga Tribunali, parashihet që burgimi të ekzekutohet në një shtet të caktuar nga Tribunali Ndërkombëtar, të zgjedhur nga një listë shtetesh, të cilat para Këshillit të Sigurimit kanë shprehur gatishmërinë për pranimin e individëve të dënuar dhe burgimi zbatohet në përputhje me ligjin, që është në fuqi në shtetin përkatës, nën mbikëqyrjen e Tribunalit (neni 27).

Gjithashtu me Statut është rregulluar edhe falja, po edhe ulja e dënimeve, ku parashihet se në qoftë se në bazë të ligjit në fuqi në shtetin ku i dënuari e kryen dënimin, dhe në qoftë se i dënuari plotëson kushtet për faljen ose uljen e dënimit, shteti përkatës njofton Tribunalin për këtë gjë. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar në konsultim me gjykatësit vendos për çështjen në bazë të interesave të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme ligjore (neni 28).

Me Statut është rregulluar edhe çështja e bashkëpunimit dhe ndihmës juridike midis shteteve dhe Tribunalit Ndërkombëtar. Shtetet duhen të bashkëpunojnë me Tribunalin në drejtim të hetimit dhe ndjekjes penale të individëve të akuzuar për kryerjen e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare (neni 29).

Me Statut është përcaktuar që selia e Tribunalit Ndërkombëtar është në Hagë dhe gjuhët e punës së Tribunalit janë gjuha angleze dhe gjuha franceze (neni 31 & 33).

Shpenzimet, të cilat bëhen gjatë punës së Tribunalit Ndërkombëtar, mbulohen nga buxheti i rregullt i Kombeve të Bashkuara (neni 32).

Puna, aktivitetet njëvjeçare si dhe veprimet e planifikuara, që do të ndërmerren më tej, i paraqiten me anë të një raporti, të hartuar nga Kryetari i Tribunalit, Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme (neni 34).³¹

Nga dispozitat e Statutit të Tribunalit, të shtjelluara më lart shihet se këto dispozita në aspektin formalo-procedural nuk kanë ndonjë dallim me procedurën penale të zakonshme, që parashihet në shumicën e sistemeve ligjore të botës, por veçori e këtij Tribunali është lloji i veprave penale për të cilat ka kompetencë ky Tribunal.

Pavarësisht të gjitha të metave, që mund të ketë pasur Tribunali i Hagës, si në kohën e themelimit të tij, ashtu edhe përgjatë funksionimit të tij, është e pamohueshme se themelimi dhe funksionimi i tij ka kontribuar në shumë aspekte në të drejtën ndërkombëtare penale dhe kjo përbën një arritje në luftën kundër mosndëshkimit të shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Në kohën e krijimit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ishte ende një besim i paprovuar ideja që e drejta ndërkombëtare humanitare jo vetëm që është e zbatueshme, por mund të kontribuojë në rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Krijimi i TPNJ-së, përveç vënies përpara përgjegjësisë të individëve, shënoi një hap të fuqishëm në kuptimin që shtetet duhet t'i ndjekin penalisht individët për shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare në zbatim të ligjit të tyre vendor në pajtim me standardet ndërkombëtare.

³¹ <http://www.icty.org/sections/LegalLibrary>, Statute of The Tribunal, September, 2009.

TPNJ-ja u krijua edhe si rezultat i asaj se në atë kohë institucionet vendore nuk ishin në gjendje të ndiqnin penalisht çështjet e tilla, për çka edhe në Statut u parapa juridiksion parësor i Tribunalit në krahasim me gjykatat nacionale, në gjykimin e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë.³²

Ndërkohë që proceset e TPNJ-së po i afrohen fundit, është bërë gjithnjë e më e rëndësishme të theksohet përgjegjësia e përbashkët e juridiksioneve ndërkombëtare dhe kombëtare në ndjekjen penale dhe parandalimin e krimeve të luftës, si dhe krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet gjykatave ndërkombëtare dhe vendore është thelbësor për t'u larguar një herë e përgjithmonë nga kultura e mosndëshkimit dhe t'i përshtatemi kulturës së përgjegjësisë. Nga kjo pikëpamje, përfundimi i mandatit të TPNJ-së duhet parë si një strategji e krijuar për të lejuar vazhdimin e aktiviteteve që janë nisur nga TPNJ-ja prej aktorëve vendas.

Në mbështetje të këtij qëllimi, në vitin 2003 duke pranuar se kapaciteti vendas ishte rritur, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën 1503 (2003), duke udhëzuar TPNJ-në që të transferonte të gjitha akuzat e nivelit të ulët dhe të mesëm në rajon me qëllim që të gjykoreshin nga gjykatat vendase.

Megjithatë proceset penale për shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare do të dalin me sukses vetëm nëse institucionet vendase kanë burime të mjaftueshme dhe kapacitetet e duhura për të kryer gjykime penale komplekse të kësaj natyre.³³

³² http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/manual_developed_practices/icty_manual_on_developed_practices_alb.pdf, Manual i TPNJ-së mbi praktikën e zhvilluar, përgatitur së bashku me UNICRI-në si pjesë e një projekti për të ruajtur trashëgiminë e TPNJ-së, f. 3.

³³ Po aty, f. 4.

Nëse krahasojmë Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios me atë të Hagës mund të vërejmë shumë dallime, gjë e cila është normale duke pasur parasysh periudhën e gjatë kohore që ka kaluar ndërmjet themelimit dhe funksionimit të këtyre Tribunalëve.

Tribunali i Nurembergut ka pasur vetëm katër gjykatës dhe katër zëvendës, Tribunali i Hagës ka një numër të madh gjykatësish të përhershëm dhe gjykatës *ad litem*, gjë e cila ndoshta ka qenë e detyruar edhe nga volumi i çështjeve që janë dashur të zgjidhen nga këto dy Tribunale. Gjithashtu, edhe në aspektin procedural, Statuti i Tribunalit të Hagës është më i sofistikuar për sa i përket rregullimit në mënyrë më të detajuar të të gjitha çështjeve procedurale. Puna e Tribunalit të Hagës, gjegjësisht procedurat që duhet të ndiqen që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, janë më komplekse krahasuar me ato të Kartës për Tribunalin e Nurembergut. Ndoshta një gjë e tillë përveç të tjerash është përcaktuar edhe nga afati kohor shumë i shkurtër, gjegjësisht vetëm një vit i është dashur Tribunalit të Nurembergut që të zhvillojë dhe të përfundojë të gjitha procedurat ndaj të gjithë të akuzuarve. Sipas dispozitave të Kartës së Tribunalit të Nurembergut, Tribunali në shumë çështje, e sidomos në pjesën e marrjes dhe shqyrtimit të provave, është udhëhequr nga parimi i ekonomizimit, gjë e cila në mënyrë aq të theksuar nuk është paraparë në Statutin e Tribunalit të Hagës, e sidomos në pjesën e marrjes dhe shqyrtimit të provave.

Në Statutin e Tribunalit të Hagës një vëmendje e posaçme i është kushtuar dispozitave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, zbatimi i të cilave në mënyrë plotësuese është siguruar edhe me masa të tjera praktike si themelimi i seksionit të veçantë për mbrojtjen e viktimave në kuadër të Tribunalit, e cila në mënyrë efikase ka bërë të mundur zbatimin e këtyre dispozitave në praktikë. Për funksionimin efikas të Tribunalit të Hagës ka qenë i patjetërsueshëm parashikimi i dispozitave të tilla sepse marrëdhëniet shoqërore në vendet e

ish-Jugosllavisë, pas zhvillimit të konflikteve të armatosura, ishin të rrënuara dhe armiqësitë midis popujve të përkatësive të ndryshme nacionale ishin ende të përkeqësuar, kështu që parashikimi i dispozitave të tilla ishte i patjetërsueshëm.

Për dallim nga Tribunali i Nurembergut në Kartën e të cilit nuk ekzistonin dispozita lidhur me të drejtën e apelimit të vendimeve, Tribunali i Hagës në bazë të Statutit të tij është dyshkallësh, ku vendimet e apeluara shqyrtohen nga Dhoma e Apelit.

Në aspekt të llojit të sanksioneve, që mund të shqiptohen nga Tribunali i Hagës, parashihet se mund të shqiptohen vetëm dënime me burgim, ku në krahasim me Tribunalin e Nurembergut kemi një përparim sepse dënimi me vdekje nuk ekziston, por dënimi më i lartë që mund të shqiptohet nga ky Tribunal është dënimi me burgim të përjetshëm. Gjithashtu, në Statutin e Tribunalit të Hagës është rregulluar dhe mundësia e shqiptimit edhe të dënimeve alternative, t'i quajmë gjegjësisht në nenin 24 të Statutit ku parashihet që pronarëve të ligjshëm t'u kthehet çdo pronë ose fitim i siguruar nëpërmjet shtrëngimit.

Për të patur një proces plotësisht të suksesshëm, në aspektin e zbulimit të së vërtetës dhe të gjyqimit e sanksionimit të personave që me të vërtetë kanë kryer krimet, ka qenë i nevojshëm bashkëpunimi i shteteve me Tribunalet. Përderisa raporti i bashkëpunimit të shteteve me Tribunalin e Nurembergut ose të Tokios ka qenë më i thjeshtë sepse proceset gjyqësore, si të Nurembergut, ashtu edhe të Tokios, janë zhvilluar në vendet ku janë kryer krimet, por edhe duke pasur parasysh faktin që gjykata të tilla janë krijuar nga fuqitë fituese të luftës, këto shtete kanë qenë të detyruara t'i binden një bashkëpunimi të tillë. Gjatë bashkëpunimit për mbledhjen e provave ose për kapjen dhe dorëzimin e kriminelëve, Tribunalet nuk kanë pasur probleme ndërmjet tyre, as edhe gjatë punës së Tribunalit të Ruandës sepse qeveria e Ruandës vetë e ka kërkuar themelimin e një Tribunali të tillë, dhe

në çdo aspekt ka qenë e gatshme, sigurisht brenda mundësive të saja, t'i ofrojë ndihmë Tribunalit. Problemi i bashkëpunimit ka qenë më i theksuar gjatë punës së Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë, kryesisht refuzimi i Serbisë që të bashkëpunojë me Tribunalin dhe t'i dorëzojë të akuzuarit për krime, fakt i cili ka ndikuar edhe në tejzgjatjen e disa proceseve gjyqësore para Tribunalit.

Lidhur me përgjegjësinë penale të personave për krimet e parapara me Statutin e TPNJ-së, parashihet vetëm përgjegjësia penale individuale, për dallim nga të dyja Tribunalet e mëparshme të cilat krahas përgjegjësisë penale individuale parashihnin edhe përgjegjësinë e personit si pjesëtar i grupit ose i organizatës.

Dallimet dhe ndryshimet e tilla sigurisht se janë në konotacion pozitiv, me tendencë që procedurat e tilla të jenë sa më efikase në drejtim të zbulimit të së vërtetës dhe gjyqimit të drejtë.

4.3.1. Analizë e shkurtër e procedurës së zhvilluar para TPNJ-së ndaj Ramush Haradinajt, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj

Para Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë u ngritën shumë aktakuza dhe u zhvilluan shumë procedura gjyqësore ndaj shumë pjesëtarëve të forcave të ndryshme gjatë zhvillimeve të konflikteve të armatosura që ndodhën në kohën e shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Aktakuza u ngritën edhe ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lidhur me krimet e pretenduara e të kryera gjatë zhvillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë.

Me 5 mars të vitit 2005, gjatë kohës që Ramush Haradinaj ishte Kryeministër i Kosovës ai u akuzua nga TPNJ-ja, së bashku me Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, për 37 vepra penale ku

përfshihen vrasje, tortura si dhe trajtimi çnjerëzor i serbëve, shqiptarëve dhe romëve me anë të veprimtarisë së përbashkët kriminale.

Konflikti në Kosovë

Lufta në Kosovë ishte një konflikt i armatosur i cili u zhvillua midis forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë luftë u dëbuan 800 000 shqiptarë, u vranë 15 000 persona, u zhdukën 5 000 njerëz, fati i disave prej të cilëve është zbardhur, por ka mbetur ende një numër i madh i rasteve të pasqaruara.³⁴

Gjatë kohës së zhvillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, u kryen shumë krime, të cilat paraqesin format më të rënda të shkeljes së të drejtës ndërkombëtare humanitare.

Prokurori i TPNJ-së dhe ndihmësit e tij, hetuan shumë sjellje dhe veprime të cilat dëshmonin për shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të kryera në territorin e Kosovës, ku në bazë të hetimeve të tilla u ngritën shumë akuza, të cilat u paraqitën para TPNJ-së.

Sipas Dhomës së Apelit të TPNJ-së, konflikti i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur, e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti. E drejta humanitare ndërkombëtare zbatohet që prej fillimit të konfliktit të armatosur dhe vazhdon përtej mbarimit të luftimeve deri në arritjen e përgjithshme të paqes ose në rast konfliktesh të brendshme, deri në momentin kur arrihet një zgjidhje paqësore. Deri në atë moment, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet në tërë territorin e palëve

³⁴ <https://sq.wikipedia.org>

luftuese, ose në rast konfliktesh të brendshme, në tërë territorin nën kontrollin e një pale, pavarësisht nëse aty zhvillohen ose nuk zhvillohen luftime të vërteta.³⁵

Të akuzuarit dhe akuzat

Të akuzuarit, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen bashkërisht në aktakuzën e ndryshuar për herë të katërt, për krime që pretendohet se u kryen prej tyre prej 1 marsit të vitit 1998 deri më 30 shtator të 1998-ës kundër civilëve serbë, civilëve romë/egjiptianë të Kosovës si dhe civilëve shqiptarë kosovarë, të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe, në zonën e Dukagjinit në Kosovë. Nga prokuroria pretendohet se gjatë kësaj periudhe, UÇK-ja përdoqi dhe rrëmbeu viktimat e përmendura në aktakuzë për konsolidimin e kontrollit të plotë të saj në zonën e Dukagjinit. Aktakuza pretendon se, për këtë, UÇK-ja shfrytëzoi rrethinën e kanalit të Radoniqit për kryerjen e vrasjeve dhe hedhjen e kufomave të 30 viktimave të saj. Pretendohej, gjithashtu, se UÇK-ja ngriti një qendër të përkohshme burgimi në shtabin e Jabllanicës, komuna e Gjakovës, ku të burgosurit rriheshin rregullisht dhe vuajtën forma të tjera të keqtrajtimit fizik.

Prokuroria pretendonte se të paktën nga 1 marsi i vitit 1998 deri në mes të qershorit të 1998-ës, Ramush Haradinaj ishte komandant *de facto* në UÇK dhe nga mesi i qershorit ishte bërë komandant *de jure*, me çka për krimet e pretenduara me automatizëm supozohej se ai duhej të kishte njohuri për të gjitha veprimet që kryheshin në zonën operative që ai udhëhiqte.

Sipas aktakuzës, çdo zonë operative e UÇK-së në Kosovë, siç është zona e Dukagjinit në Kosovën perëndimore për të cilën pretendohet se komandohej nga Ramush Haradinaj,

³⁵ Lënda Nr.: IT-04-84-T Data: 3 prill 2008, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore i të TPNJ-së, marrë nga www.icty.org.

veproi në mënyrë të pavarur prej autoritetit të lartë komandues. Rrjedhimisht Ramush Haradinaj kishte komandën e përgjithshme mbi forcat e UÇK-së në zonën e Dukagjinit. Kjo zonë ishte e gjerë dhe përfshinte komunat e Pejës, e Deçanit, e Gjakovës dhe pjesën e komunave të Istogut dhe të Klinës.

Prokuroria pretendonte se koha, që ka lidhje me aktakuzën, është koha kur Idriz Balaj komandoi një njësi të UÇK-së, të njohur si Shqiponja të Zeza, e cila vepronte në krejt zonën e Dukagjinit si njësi speciale e ndërhyrjes së shpejtë. Sipas aktakuzës, si Komandant i Shqiponjave të Zeza, Idriz Balaj ishte në varësi të drejtpërdrejtë të Ramush Haradinajt dhe bashkëpunonte ngushtë me të.

Prokuroria pretendonte se gjatë gjithë kohës, që ka lidhje me Aktakuzën, Lahi Brahimaj ishte anëtar i UÇK-së me bazë në shtabin e Jabllanicës. Sipas Aktakuzës më 23 qershor 1998 ai u emërua zëvendëskomandant i zonës së Dukagjinit, pozitë që e mbajti deri më 5 korrik të 1998-ës, kohë kur u largua nga kjo detyrë. Pavarësisht heqjes së tij nga ky funksion, ai vazhdoi të shërbente dhe ishte drejtor i financave në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Prokuroria pretendonte se gjatë kohës që ka lidhje me aktakuzën, Lahi Brahimaj ishte vartësi i Ramush Haradinajt dhe bashkëpunonte ngushtë me të. Secili prej tre të akuzuarve akuzohet si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për krimet e përmendura në të gjitha pikat e Aktakuzës. Qëllimi, i pretenduar i përbashkët, kriminal ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit nëpërmjet largimit dhe keqtrajtimit të paligjshëm të grupeve të lartpërmendura të civilëve. Sipas aktakuzës, këtu përfshiheshin kryerja e krimeve kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit dhe shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, ndër të cilat vrasje, tortura dhe trajtim mizor. Përndryshe të tre të akuzuarit akuzohen për përgjegjësi penale individuale

sipas Nenit 7(1) të Statutit në lidhje me disa prej këtyre krimeve, për kryerjen e tyre ose për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, ose ndihmesën dhe inkurajimin në kryerjen e tyre.³⁶

Aktakuza e paraqitur nga prokuroria i ngarkonte të akuzuarit me 19 akuza për shkelje të ligjeve apo të zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, prej të cilave 18 bazohen në Nenin e Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (“Neni i Përbashkët 3”). Neni 3 i Statutit përcakton: “Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të ndjekë penalisht persona që shkelin ligjet ose zakonet e luftës” ku ekzistojnë tri kushte që duhet të përmbushen për zbatueshmërinë e Nenit 3 të Statutit dhe së pari, duhet të ekzistojë një konflikt i armatosur; së dyti, duhet të ketë një lidhje midis shkeljes së pretenduar dhe konfliktit të armatosur, dhe së treti, për akuzat e bazuara në Nenin e Përbashkët 3, viktimat nuk duhet të marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e shkeljes së pretenduar.³⁷ Për të vërtetuar ekzistimin e këtyre tri elementeve, Tribunali kryesisht u mbështet në interpretimet e mëparshme të saja të përmbajtura në shumë vendime dhe aktgjykime të mëparshme.

Rrjedhimisht, për të përcaktuar ekzistimin ose mosekzistimin e konfliktit të armatosur në Kosovë, Tribunali u mbështet në vendimin e Dhomës së Apelit gjatë vendosjes së juridiksionit në rastin Tadiq, sipas të cilit “konflikti i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti. E drejta humanitare ndërkombëtare zbatohet që prej fillimit të konfliktit të armatosur dhe vazhdon përtej mbarimit të luftimeve deri në arritjen e përgjithshme të paqes ose në rast konfliktesh të brendshme, deri në momentin kur arrihet një zgjidhje paqësore.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

Deri në atë moment, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet në të gjithë territorin e palëve luftuese, ose në rast konfliktesh të brendshme, në të gjithë territorin nën kontrollin e një pale, pavarësisht nëse aty zhvillohen ose nuk zhvillohen luftime të vërteta”. Ky kusht shërben për të dalluar konfliktin e armatosur jondërkombëtar nga banditëria, trazirat, aktet e veçuara të terrorizmit, dhe nga situata të ngjashme. Dhoma Gjyqësore duhet të përcaktojë gjithashtu nëse dhuna e armatosur është e zgjatur dhe palët në konflikt janë të organizuara.

Në drejtim të vërtetimit të ekzistimit ose jo të një konflikti të armatosur në Kosovë, Tribunali pas shqyrtimit të shumë çështjeve të ngjashme, të vërtetuara më parë në rastet e ndryshme para Tribunalit si dhe duke i krahasuar ato me elementet ekzistuese të konfliktit të Kosovës doli në përfundimin se në fund të majit të vitit 1998 UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm që emëronte komandantët e zonave, që iu jepte udhëzime njësisive të ndryshme, të formuara ose në formim e sipër dhe nxirrte deklarata publike në emër të organizatës. Komandantët e njësisive jepnin urdhra luftarakë dhe përgjithësisht njësitë vartëse dhe ushtarët vepronin në përputhje me këto urdhra. U morën masa për hartimin e rregullave disiplinore dhe për krijimin e policisë ushtarake si edhe për rekrutimin, stërvitjen dhe pajisjen e anëtarëve të rinj. Megjithëse përgjithësisht më pak të pajisur se UJ-ja dhe MPB-ja, ushtarët e UÇK-së kishin armë, ndër të cilat, mortaja artilerie dhe granathedhësa. Deri në korrik të 1998-ës UÇK-ja ishte pranuar si pjesëmarrës i nevojshëm dhe i vlefshëm në negociatat me qeveritë dhe organizmat ndërkombëtarë për përcaktimin e një zgjidhjeje të krizës së Kosovës dhe për hartimin në këto negociata të kushteve për moskryerjen e operacioneve ushtarake. Dhoma Gjyqësore, gjithashtu, interpretoi aftësinë e UÇK-së për pjesëmarrje në përleshje të armatosura kudo në Kosovë si tregues tjetër i nivelit të saj të

organizimit, me çka ajo pas shqyrtimit të rrethanave të rëndësishme, po edhe karakteristikave të UÇK-së gjatë periudhës së zhvillimit të luftimeve, doli në përfundimin se UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur e të organizuar, e aftë të merrte pjesë në një konflikt të brendshëm të armatosur. Pas shqyrtimit të një numri të madh provash, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundim se duke filluar nga data 22 prill i 1998-ës dhe më tej në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur.³⁸

Lidhur me kushtin e dytë, gjegjësisht ekzistimit të një lidhjeje midis shkeljes së pretenduar dhe konfliktit të armatosur, jo domosdoshmërisht krimi i pretenduar duhet të jetë kryer në një kohë apo në një vend të caktuar ku ka pasur luftime; duhet vetëm të ekzistojë një “lidhje e ngushtë” midis veprimeve të atyre që i kanë kryer dhe luftimeve në territorin e kontrolluar nga palët në konflikt. Ekzistenca e lidhjes së ngushtë midis krimit dhe konfliktit të armatosur vërtetohet atëherë kur provohet se konflikti luajti një rol të rëndësishëm në aftësinë e keqbërësit për kryerjen e krimit, në vendimin e tij ose të saj për ta kryer, në mënyrën e kryerjes, dhe në synimin në lidhje me kryerjen, kurse kushti i fundit për vlefshmërinë e një akuze të Nenit 3, në bazë të Nenit të Përbashkët 3, është se në kohën e shkeljes, viktimat nuk merrte pjesë aktivisht në luftime. Ky kusht përfshin, ndër të tjerët, edhe anëtarë të forcave të armatosura, të cilët dorëzojnë armët, si edhe luftëtarë të mbetur jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, lëndimit ose të burgimit, apo për shkaqe të tjera. Ai që ka kryer këto krime duhet të njohë apo duhet të ketë njohur statusin e viktimave si persona të cilët nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.³⁹

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

Në aktakuzë të akuzuarit ngarkohen me 18 akuza për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit. Në Nenin 5 pohohet: “Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë përgjegjës për krimet e mëposhtme, kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtuara kundër çfarëdo popullsie civile”. Si kusht, që TPNJ-ja të mund të ushtrojë juridiksionin e saj mbi këtë lloj krimi duhet që ky krim të jetë kryer gjatë konfliktit të armatosur.⁴⁰ Duke pasur parasysh faktin se TPNJ-ja në aktgjykim sqaron nocionin e konfliktit të armatosur si dhe nxjerrjen e përfundimit se konflikti i zhvilluar në Kosovë i përmbushte kushtet e një konflikti të armatosur, atëherë del përfundimi logjik se edhe lidhur me këtë krim TPNJ-ja kishte juridiksion, sepse ishte plotësuar kushti i lartpërmendur.

Elementet e përgjithshme për zbatimin e Nenit 5 të Statutit janë:

- Kishte një sulm;
- Sulmi ishte i gjerë ose sistematik;
- Sulmi ishte drejtuar kundër një popullsie civile;
- Veprimet e atij që kryen sulmin ishin pjesë e sulmit;
- Në kohën e veprimeve të tij ose të saj, ai ose ajo e dinte se po kryhej një sulm i gjerë ose sistematik kundër një popullsie civile dhe se veprimet e tij ose të saj ishin pjesë e sulmit.

Sulmi - sulmi kundër një popullsie civile është një koncept i veçantë dhe i ndryshëm nga konflikti i armatosur. Sulmi nuk kufizohet në përdorimin e forcës, por përfshin çdo lloj keqtrajtimi të popullsisë civile, dhe mund t’i paraprijë konfliktit të armatosur, sulmi të zgjasë gjatë konfliktit të armatosur ose mund të vazhdojë pas tij. Sulmi përbëhet prej

⁴⁰ Po aty, f.49.

veprimeve që shkaktojnë lëndime fizike apo mendore si dhe prej veprimeve përgatitore të veprimeve të lartpërmendura.

I gjerë ose sistematik - “I gjerë” tregon natyrën e përhapur të sulmit dhe numrin e personave të shënjestruar. “Sistematik” lidhet me “natyrën e organizuar të veprimeve të dhunshme”. Ekzistenca e një plani apo e një politike mund të tregojë karakterin sistematik të sulmit, por nuk përbën element ligjor të veçantë.

Drejtuar kundër një popullsie civile - “Drejtuar kundër” tregon se popullsia civile është objektivi parësor i sulmit. Nuk kërkohet që sulmi të drejtohet kundër popullsisë civile të krejt zonës që lidhet me aktakuzën. Mjafton të vërtetohet se gjatë sulmit u shënjestruan mjaft njerëz apo se ata u shënjestruan në një mënyrë që e bind Dhomën Gjyqësore se sulmi ishte drejtuar kundër “popullsisë” civile, dhe jo kundër një numri të kufizuar dhe të papërcaktuar individësh.

Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, të vitit 1949 dhe neni 50 i Protokollit Shtesë I, i këtyre Konventave japin udhëzime për përkufizimin e fjalës “civil” për qëllimet e Nenit 5 të Statutit. Protokollin Shtesë I përkufizon si “civil” “një individ i cili nuk është anëtar i forcave të armatosura apo ndryshe luftëtar”. Neni i Përbashkët 3 pasqyron të drejtën ndërkombëtare zakonore për nivelin minimal të mbrojtjes së personave që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime. Dhoma e Apelit ka përdorur një interpretim të gjerë të fjalës “civil” për qëllimet e Nenit 5, i cili tejkalon përkufizimin e përcaktuar në Protokollin Shtesë I. Rrjedhimisht popullsia civile mund të përfshijë jo vetëm civilë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe persona që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.

Veprimet e atij që kryen sulme janë pjesë e sulmit, por nuk e përmbushin këtë kusht ato

veprime që nuk mund të interpretohen në mënyrë të arsyeshme si pjesë objektive të sulmit. Vepruesit duhet ta dinë se po kryejnë një sulm me shtrirje të gjerë ose një sulm sistematik kundër popullsisë civile dhe se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e sulmit. Nuk kërkohet që ai ose ajo të ketë njohuri të hollësishme për sulmin apo të ketë të njëjtin qëllim si sulmi.

Prokuroria pretendon se kishte “një sulm të gjerë ose sistematik të UÇK-së drejtuar kundër pjesëve të popullatës civile në komunat e Deçanit, Pejës, Gjakovës, Istogut dhe Klinës në Kosovë”. Kjo pjesë e popullsisë, sipas prokurorisë, përfshinte “popullatën civile serbe në këto komuna si edhe civilë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së. Sulmi i pretenduar kundër popullsisë civile ishte “një fushatë ushtarake për largimin e serbëve etnikë prej fshatrave ku banonin. Sipas prokurorisë, UÇK-ja kërcënoi psikologjikisht ose fizikisht, rrahu dhe vrau shumë civilë serbë dhe civilë romë/egjiptianë. Së fundi, prokuroria pretendon se UÇK-ja rrëmbeu më shumë se 60 civilë serbë dhe romë si dhe civilë shqiptarë kosovarë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së në komunat e lartpërmendura, dhe vrau shumë prej tyre. Këto viktima nuk përmenden në pika të veçanta të aktakuzës. Pjesë e sulmit të pretenduar ishte edhe burgimi dhe keqtrajtimi i personave në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë, provat mbi ngjarjet e pretenduara si akuza të veçanta në aktakuzë kanë rëndësi për përfundimet e dënimeve mbi elementët e përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit. Provat e paraqitura prej prokurorisë në lidhje me shqiptarë kosovarë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së, përmendin vetëm incidentet të cilat janë përdorur si pika të veçanta të aktakuzës. Incidentet në këto pika kanë të bëjnë me pretendime për vrasjen e 17 burrave dhe grave shqiptarë kosovarë, në tri komuna, prej prillit deri në gusht të vitit 1998 dhe

burgimin e keqtrajtimin e katër burrave në shtabin e Jabllanicës. Nuk u paraqit asnjë provë në lidhje me incidente përveç atyre të përmendura ku u shënjeshtroan shqiptarë të Kosovës që konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së. Për sa i përket popullsisë civile joshqiptare, akuzat përmendin vrasjen e 21 serbëve, malazezëve dhe romëve, burra dhe gra, në katër komuna, prej prillit deri në korrik të vitit 1998. Gjithashtu përmenden pretendimet për burgimin, keqtrajtimin dhe dëbimin e rreth 14 serbëve, malazezëve, boshnjakëve dhe romëve, burra dhe gra, për afërsisht gjatë së njëjtës periudhë. Në bazë të provave të marra dhe të shqyrtuara me hollësi Dhoma Gjyqësore përfundon se keqtrajtimi, transferimi i dhunshëm dhe vrasja e civilëve serbë dhe romë, dhe e civilëve shqiptarë të Kosovës të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së (qoftë si grupe të veçantë apo bashkërisht), nuk ishin në një shkallë apo shpeshtësi të tillë që të mundësojnë përfundimin se u krye një sulm kundër popullsisë civile. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludon se disa viktimat u zgjodhën kryesisht për shkaqe individuale, për shembull se kishin apo mendohej se kishin lidhje me pushtetin serb ose për arsye të tjera, dhe jo si anëtarë të popullsisë civile. Dhoma Gjyqësore nuk analizon elemente të tjera të krimit kundër njerëzimit, “i gjerë apo sistematik” sepse këto mund të shqyrtohen vetëm në lidhje me një sulm kundër popullsisë civile. Dhoma Gjyqësore përfundon se të akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për Pikat 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, dhe 35 të Aktakuzës.

Të akuzuarit në pikat 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 30, dhe 32 të Aktakuzës ngarkohen me vrasje si shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës sipas nenit 3. Në aktgjykim më tej shpjegohen elementet përbërëse të secilit prej këtyre krimeve. Krimi i vrasjes përmban elementet e mëposhtme:

(a) Vdekja e viktimës;

(b) Një veprim apo një mosveprim i atij që shkaktoi vdekjen e viktimës: dhe

(c) Veprimi apo mosveprimi u krye me synim vrasjen e viktimës apo të shkakimit të qëllimshëm të lëndimit të rëndë trupor për të cilin ai që e kryen veprimin logjikisht duhet ta ketë ditur se mund të rezultonte në vdekjen e viktimës.

Torturë dhe trajtim mizor

Në pikat 2, 4, 6, 14, 16, 18, 20, 24, 26, 28, 30, 32, 34, dhe 37 të Aktakuzës të akuzuarit ngarkohen me trajtim mizor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, i ndëshkueshëm sipas Nenit 3 të Statutit. Pikat 2, 4, 6, 20, 24, 28, 30, 32, 34, dhe 37 të Aktakuzës ngarkojnë të akuzuarit me torturë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas nenit 3 të Statutit.

Trajtim mizor - trajtimi mizor kërkon vërtetimin e elementeve të mëposhtme:

(a) Një veprim apo mosveprim i cili shkaktoi vuajtje apo lëndime të rënda mendore apo fizike ose përbënte një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor dhe veprimi apo mosveprimi u krye me synim apo ndryshe me dijeni se veprimi apo mosveprimi kishte të ngjarë të shkaktoje vuajtje apo lëndime të rënda mendore apo fizike, ose përbënte një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor, dhe ai që e kreu ishte mospërfillës ndaj pasojave të veprimit apo mosveprimit të tij.

Torturë - krimi i torturës përmban elementet e mëposhtme:

(a) Një veprim apo një mosveprim i cili shkakton vuajtje apo lëndime fizike ose mendore shumë të rënda;

(b) Veprimi apo mosveprimi u krye qëllimisht;

(c) Veprimi apo mosveprimi synonte marrjen e informacionit apo rrëfimin ose ndëshkimin,

frikësimin apo detyrimin e viktimës ose të personit të tretë; apo diskriminimin për çfarëdo arsye të viktimës ose të personit të tretë.

Nuk kërkohet që vuajtjet apo lëndimet shumë të rënda të shkaktohen vetëm për një apo disa nga qëllimet e lartpërmendura, por vetëm që një apo disa qëllime të tilla të jenë pjesë e motivimit të sjelljes.

Përdhunim - pika 36 e Aktakuzës ngarkon të akuzuarit me përdhunim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas nenit 3 të Statutit.

Krimi i përdhunimit përmban elementet e mëposhtme:

(a) Penetrimi seksual, sado i pjesshëm: i vaginës apo anusit të viktimës prej penisit të atij që e kryen veprimin apo prej ndonjë sendi tjetër të përdorur nga kryesi; ose (ii) i gojës së viktimës nga penisi i kryesit;

(b) Penetrimi seksual u krye pa pëlqimin e viktimës. Pëlqimi në këtë rast duhet të jepet me vullnet të lirë, dhe penetrimi seksual u krye qëllimisht dhe me dijeni se u krye pa pëlqimin e viktimës.

Shkelje të dinjitetit njerëzor - pika 2 e Aktakuzës ngarkon të akuzuarit me shkelje të dinjitetit njerëzor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas nenit 3 të Statutit.

Krimi i shkeljes së dinjitetit njerëzor përmban elementet e mëposhtme:

(a) Një veprim apo një mosveprim i cili, nga pikëpamja objektive, shkakton poshtërim apo ulje të rëndë, apo ndryshe përbënte sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor, dhe;

(b) Veprimi apo mosveprimi u krye me synimin dhe dijeninë se mund të shkaktonte pasojat e lartpërmendura.⁴¹

Lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarve lidhur me krimet e përmbajtura në aktakuzë, prokuroria pretendonte se ata kishin përgjegjësi si pjesëmarrës në një pjesëmarrje të përbashkët kriminale dhe përgjegjësi penale individuale.

Përgjegjësia për pjesëmarrje në ndërmarrje të përbashkët kriminale - në aktakuzën e paraqitur nga prokuroria pretendohet se çdo krim i akuzuar përfshihej në qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së dhe secili i akuzuar kishte të njëjtin synim me bashkëkryesit e tjerë për kryerjen e këtyre krimeve. Ndryshe, në qoftë se disa prej krimeve të akuzuara nuk përfshiheshin në NPK, ato ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të NPK-së dhe secili i akuzuar ishte i vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të NPK-së.

Në kuadrin e jurisprudencës së Tribunalit, doktrina e NPK-së u trajtua hollësisht për herë të parë në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*. Dhoma e Apelit *Tadiq* përfundoi në vija të përgjithshme se: një person i cili, në zbatim të qëllimit të përbashkët kriminal, ndihmon në kryerjen e krimeve ndaj një grupi personash mund të përballet me përgjegjësi penale në kushte të caktuara. Analiza e së drejtës ndërkombëtare zakonore nga Dhoma e Apelit rezultoi në identifikimin dhe përkufizimin e tri formave të përgjegjësisë së NPK-së. Në formën e parë të NPK-së: të gjithë të bashkakuzuarit, duke vepruar në kuadrin e një qëllimi të përbashkët, kanë të njëjtin synim kriminal, për shembull, formimin e një plani mes bashkëkryesve për të vrarë, ku, në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët (edhe nëse çdo bashkëkryes ka një rol tjetër në të), ... të gjithë synonin të vrisnin. Forma e dytë e NPK-së,

⁴¹ Po aty, f. 61.

që përshkruhet si lloj i formës së parë, u identifikua në çështjet ku pretendohet se shkeljet e akuzuara u kryen nga anëtarët e njësive ushtarake apo administrative, për shembull ato që komandonin kampet e përqendrimit dhe nga “sisteme” të ngjashme. Forma e tretë e NPK-së karakterizohet nga një qëllim i përbashkët kriminal, që karakterizohet nga sjellja e një ose e disa bashkëkryesëve kryejnë një veprim i cili, megjithëse është jashtë qëllimit të përbashkët, është pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e zbatimit të këtij qëllimi. Ekzistojnë edhe dy kushte të tjera për këtë formë - kushti objektiv dhe kushti subjektiv.

Elementi objektiv nuk varet prej gjendjes mendore të të akuzuarit. Ky kusht konsiston në faktin se krimi që ndodhi ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e zbatimit të NPK-së. Ai duhet të dallohet prej gjendjes subjektive mendore, d.m.th. i akuzuari ishte në dijeni se krimi që ndodhi, ishte pasojë e mundshme e zbatimit të NPK-së dhe se mori pjesë duke e ditur këtë.

Në bazë të dëshmive të drejtpërdrejta e të disponueshme, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundim se dëshmitë nuk ishin të mjaftueshme për t’u bindur se ka ekzistuar një ndërmarrje e përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ka qenë kryerja e krimeve të akuzuara në aktakuzë.

Përgjegjësia penale individuale - Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen veç e veç, në bazë të Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, individualisht si përgjegjës për kryerjen e krimeve të parashtruara në këtë aktakuzë. Siç saktësohet më tej, ata janë përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen, ose përndryshe për ndihmë në kryerjen e këtyre krimeve. Me fjalën "kryerje", prokuroria nuk pohon se tre të akuzuarit domosdoshmërisht kryen fizikisht të gjitha krimet e akuzuara. "Kryerja" në këtë aktakuzë përfshin pjesëmarrjen e secilit të akuzuar në një ndërmarrje të përbashkët

kriminale. Secili i akuzuar mori pjesë në mënyrë të ndërgjegjshme në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, duke pasur të njëjtin qëllim si edhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë ndërmarrje dhe duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e realizimit të qëllimit të kësaj ndërmarrjeje kriminale.

Në bazë të pjesëmarrjes së tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, secili i akuzuar akuzohet si përgjegjës për veprimet e të dy të bashkakuzuarve të tjerë, për veprimet e anëtarëve të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe për të gjitha krimet e kryera për të çuar përpara planin e tyre të përbashkët kriminal, të cilat ose ishin pjesë e qëllimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ose ishin pasoja të parashikueshme të saj. Aktakuza e fajëson çdo të akuzuar për përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7 (1), bazuar në kategoritë e përgjegjësisë së kryerjes, planifikimit, nxitjes, urdhërimit apo ndihmës dhe inkurajimit.

Neni 7 (1) mbulon së pari dhe para së gjithash kryerjen fizike të një krimi apo moskryerjen e fajshme të një veprimi i cili ishte i detyrueshëm sipas ligjit. Neni 7 (1) pasqyron, gjithashtu, parimin se përgjegjësia penale për një krim sipas neneve 2 deri 5 të Statutit nuk u ngarkohet vetëm individëve që kryen krime, por mund t'u atribuohet edhe individëve të cilët ndihmojnë në krime në mënyra të tjera të përshkruara më lart. Që një i akuzuar të jetë përgjegjës për një krim, sipas këtyre kategorive të përgjegjësisë, krimi në fjalë duhet të jetë kryer. Për më tepër, veprimet e tij ose të saj duhet të kenë ndihmuar thelbësisht në kryerjen e krimit. Përgjegjësi mund të ketë përgjegjësi edhe për mosveprime kur ekziston një detyrim për të vepruar.

Planifikimi - përgjegjësia mund të burojë prej planifikimit të krimit i cili kryhet më vonë nga keqbërësi kryesor. Planifikuesi duhet të ketë si synim kryerjen e krimit, ose zbatimin e planit, duke ditur se ka shumë të ngjarë që të rezultojë në kryerjen e krimit.

Nxitja - përgjegjësia mund të burojë nëpërmjet nxitjes së keqbërësit kryesor në kryerjen e krimit. Nxitësi duhet të ketë si synim kryerjen e krimit, apo të jetë në dijeni se ka shumë të ngjarë që kryerja e krimit të jetë pasojë e sjelljes së tij ose të saj.

Urdhërimi - përgjegjësia mund të burojë prej urdhërimit të keqbërësit kryesor për kryerjen e krimit apo për kryerjen e veprimeve që rezultojnë në krim. Në kohën e dhënies së urdhrit, urdhërdhënësi duhet të ketë pushtet zyrtar apo jozyrtar mbi atë që kryen krimin. Urdhërdhënësi duhet të ketë si synim kryerjen e krimit ose ka dijeni që me shumë gjasë zbatimi i urdhrit do të rezultojë në kryerjen e krimit.

Ndihma dhe inkurajimi - përgjegjësia mund të burojë prej kryerjes së veprimeve që ndihmojnë, inkurajojnë ose përkrahin moralisht kryerjen e krimit. Inkurajimi mund të jetë miratimi i heshtur i një ndihmuesi që ka pushtet dhe që është fizikisht i pranishëm në vendin e krimit, edhe ku ai, ose ajo, nuk ka detyrimin për të vepruar. Ndihma dhe inkurajimi mund të ndodhin para, gjatë dhe pas kryerjes së krimit kryesor. Ndihma dhe inkurajimi pas kryerjes së krimit mund të ndodhë nëse kryesi e kreu krimin me dijeninë që ndihmuesi -inkurajuesi do të ofronte ndihmesë praktike. Ndihmuesi -inkurajuesi duhet të jetë në dijeni se veprimet e tij ose të saj ndihmojnë në kryerjen e krimit prej keqbërësit kryesor. Ata duhet të jetë gjithashtu në dijeni të veprimeve kriminale të keqbërësit kryesor, megjithëse jo për sa i përket cilësimit të tyre ligjor, dhe gjendjes mendore kriminale të tij ose të saj. Mirëpo nuk është e nevojshme që ndihmuesi -inkurajuesi të dijë për krimin

konkret të synuar ose për krimin konkret të kryer; mjafton që ai ose ajo të dijë që ka të ngjarë se do të kryhet një prej krimeve, nëse vërtet është kryer.⁴²

Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ndaj Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj u dëgjuan shumë dëshmitarë dhe u shqyrtuan shumë prova të tjera materiale, me ndihmën e të cilave Dhoma Gjyqësore duhej të vërtetonte faktet mbi krimet e përmbajtura në aktakuzë. Dhoma Gjyqësore për secilën pikë të përmbajtur në aktakuzë dëgjoi dhe shqyrtoi provat që i kishte në dispozicion, analizoi dhe shqyrtoi ndërlidhjen e tyre me ngjarjet e supozuara të ndodhura dhe që u ngarkoheshin të akuzuarve, dhe, gjithashtu, analizoi në hollësi se secila prej tyre përmbushte elementet që përbënin figurën e krimeve të luftës ose krimeve kundër njerëzimit. Nga të gjitha provat e marra, të shqyrtuara dhe të analizuara, Dhoma Gjyqësore I e TPNJ-së, nuk mundi të gjejë fajësi për asnjërën prej pikave për të akuzuarit Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj, kurse të akuzuarin Lahi Brahimaj e gjeti fajtor për dy pika të aktakuzës, respektivisht për pikën 28 dhe 32 të aktakuzës.

Të akuzuarit Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj u shpallën të pafajshëm lidhur me të gjitha pikat e aktakuzës.

Lahi Brahimaj u shpall fajtor për pikën 28 dhe 32 të aktakuzës. Në pikën 28 Lahi Brahimaj së bashku me Ramush Haradinaj dhe Idriz Balajn akuzoheshin se në shtabin e Jabllanicës rrahën dhe torturuan një shqiptar katolik, i cili gjatë procedurës u njoh si Dëshmitari SST7/06, me të cilat veprime kryen shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës, Trajtimi Mizor, i njohur në nenin e përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas neneve 3 dhe 7(1) të Statutit të Tribunalit. Kurse në pikën 32 Lahi Brahimaj së bashku me Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn u akuzuan për trajtim mizor

⁴² Po aty.

dhe torturë ndaj Pal Krasniqit, shqiptar katolik, Skënder Kuqit dhe dëshmitarit SST7/03, me çka kryen shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Torturë dhe Trajtim Mizor, i njohur në nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas neneve 3 dhe 7(1) të Statutit të Tribunalit.

Lahi Brahimaj nuk do të gjykohet përgjegjës për pikat 28 dhe 32 si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar format alternative të përgjegjësisë. Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet për akuzat e pikave 28 dhe 32 sepse janë plotësuar elementet e krimeve të trajtimit mizor dhe torturës. Mirëpo mbi bazën e dispozitave të ndryshme statutore, shpallja e fajësisë së shumëfishtë për të ndëshkuar të njëjtën sjellje kriminale është e lejueshme vetëm në qoftë se “çdo dispozitë statutore përkatëse ka një element materialisht të ndryshëm që nuk përfshihet në një dispozitë tjetër”, dhe një element është materialisht i ndryshëm “në qoftë se kërkon vërtetimin e një fakti që nuk kërkohet nga një dispozitë tjetër statutore”. Kur ky kriter nuk plotësohet, fajësia bazohet në dispozitën më konkrete.

Vepra penale më konkrete përfshin atë më pak konkrete, sepse kryerja e saj nënkupton domosdoshmërisht kryerjen e veprës më pak konkrete. Të dyja veprat penale kërkojnë që viktima të ketë pësuar dëmtime të rënda trupore ose mendore, dëmtimi duhet të jetë rezultat i një veprimi apo mosveprimi, dhe veprimi i kryesit duhet të ketë qenë i qëllimshëm. Vepra penale e torturës ka një element shtesë, që konsiston në faktin se veprimi apo mosveprimi duhet të jetë kryer me një qëllim të caktuar, p.sh. për të marrë informacion apo një pohim, për ta ndëshkuar, frikësuar, apo për ta detyruar viktimën ose një person të tretë, ose për të diskriminuar, për çfarëdo arsye, viktimën apo një person të tretë. Vepra penale e trajtimit mizor nuk kërkon vërtetimin e ndonjë elementi shtesë, përveç atyre të kërkuara për

torturën. Rrjedhimisht në ato raste kur veprat penale të torturës dhe të trajtimit mizor burojnë nga e njëjta sjellje kriminale e të akuzuarit, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësinë vetëm në lidhje me akuzën e torturës. Në këtë çështje Dhoma Gjyqësore është e bindur se Lahi Brahimaj ka kryer krimet e trajtimit mizor dhe torturës, akuza të pikave 28 dhe 32. Për sa i përket pikës 28, kjo buron nga e njëjta sjellje kriminale dhe, për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi vetëm për tortura. Mirëpo në lidhje me pikën 32, Dhoma Gjyqësore konstatoi dy incidente të sjelljes kriminale, të veçuara në kohë dhe në hapësirë. Sjellja në incidentin e parë ishte e barasvlershme me trajtim mizor dhe torturë, dhe, për këtë arsye, mbi bazën e fajësisë së shumëfishtë, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi vetëm për torturë. Sjellja në incidentin e dytë ishte e barasvlershme vetëm me trajtim mizor. Për këtë incident Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi për trajtim mizor.

Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet fajtor për dy rastet e torturës dhe për një rast të trajtimit mizor. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh sesa të rënda ishin këto krime në vetvete si dhe faktin se Lahi Brahimaj, i cili ka pasur poste të larta në UÇK, mori pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh, gjithashtu, gjendjen e rrezikuar të viktimave dhe traumat fizike dhe mendore të përjetuara prej tyre. Të gjithë këta faktorë përbëjnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe tërësinë e sjelljes në këtë çështje.

Dhoma Gjyqësore I shpalli fajtor Lahi Brahimajn për pikat 28 dhe 32 të aktakuzës, dhe duke pasur parasysh rrethanat personale dhe familjare të të akuzuarit, faktin se i akuzuari i ishte dorëzuar vetë Tribunalit në momentin e marrjes vesh se është akuzuar, si rrethana lehtësuese, duke pasur parasysh, gjithashtu, praktikën e përgjithshme të shqiptimit të dënimeve për vepra të njëjta në ish-Jugosllavi si dhe kuadrin ligjor për përcaktimin e

Dënimeve, gjegjësisht dispozitat e përmbajtura në nenin 24 të Statutit dhe rregullës 101 të Rregullores së Tribunalit, Dhoma Gjyqësore gjykon se dënimi më i përshtatshëm në këtë rast është një dënim prej vetëm 6 vjet burg, ku i akuzuari Lahi Brahimaj ka të drejtë të përfitojë kohën e paraburgimit, e cila deri ditën e shpalljes së vendimit arrin në 1,109 ditë. Prokuroria e apeloj Vendimin e Dhomës Gjyqësore duke pretenduar se Dhoma Gjyqësore, midis të tjerash, shkeli të drejtën e prokurorisë për gjykim të drejtë sepse nuk i mundësoi kohë të mjaftueshme për të siguruar dëshmitë e dy dëshmitarëve thelbësorë, prandaj kërkoi rigjykim.

Më 21 korrik të vitit 2010, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Robinson, miratoi pjesërisht apelin e prokurorisë dhe shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë të të akuzuarve, për disa prej pikave të aktakuzës në lidhje me krimet që pretendohej se ishin kryer në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykim të pjesshëm për këto pika. Procesi gjyqësor filloi më 18 gusht të 2011-ës. Dhoma mori dëshmitë e 56 dëshmitarëve, ndër të cilët bënë pjesë edhe dy dëshmitarët, dëshmitë e të cilëve u bënë shkak që u urdhërua aktgjykimi.⁴³

Në korrik të 2010-ës, Ramush Haradinaj u kthye në paraburgim në Hagë, në pritje të vendimit të bazuar në rigjykim.

Mbrojtja e Haradinajt pretendonte se rigjykimi i pjesshëm duhet të kufizohet në dëgjimin e dy dëshmitarëve që kanë shërbyer si shkak për hedhjen poshtë të vendimeve të pafajësisë. Prokuroria pretendonte se rigjykimi është gjykim i ri dhe i plotë dhe se prokuroria mund të thërrasë dëshmitarë të rinj dhe prova shtesë për të vërtetuar përgjegjësinë penale të të tre të

⁴³ Përmbledhje e aktgjykimit, përmbledhje e vendimit të rigjykimit për Ramush Haradinaj, Idriz Balajn dhe Lahi Brahimajn, Dhoma Gjyqësore, Hagë, 29 nëntor 2012.

akuzuarve për veprat e kryera në qendrën e paraburgimit në Jabllanicë. Më 31 maj të vitit 2011, Dhoma e Apelit hodhi poshtë të gjitha pretendimet e mbrojtjes duke u pajtuar me prokurorinë.⁴⁴

Mirëpo pavarësisht tentativave të tilla, Dhoma Gjyqësore, me vendimin e sjellë si rezultat i rigjykit të pjesshëm edhe njëherë konfirmoi pafajësinë e tre të akuzuarve, duke shpallur të pafajshëm Ramush Haradinajn, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajn, për 6 pikat e akuzës në bazë të rigjykit, me arsyetimin se nuk u gjetën fakte dhe argumente, me të cilat do të provoheshin pretendimet e akuzës.

Karakteristikat kryesore që e përshkuan procesin e zhvilluar kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt

Procesin gjyqësor që u zhvillua ndaj Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt, e përshkuan disa karakteristika. Njëra ndër karakteristikat që u theksua edhe në aktgjykim ishte hezitimi i dëshmitarëve për të dëshmuar ku disa prej tyre nuk u përgjigjeshin aspak thirrjeve të Tribunalit për t'u paraqitur si dëshmitarë, për ç'arsye para Tribunalit u zhvilluan disa procese për mospërfillje të Tribunalit, e disa prej tyre edhe pse paraqiteshin para Tribunalit nuk dëshmonin, me arsyetimin se po dëshmonin kishin frikë për sigurinë e tyre dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Edhe përkundër përpjekjeve të Tribunalit, me anë të masave mbrojtëse për të siguruar fshehtësinë e identitetit të tyre, nuk u arrit sukses sepse vendet ku supozohej se ishin kryer krimet e pretenduara në aktakuzë ishin vende të vogla ku të gjithë pak a shumë ishin të lidhur nëpërmjet lidhjeve familjare, miqësore ose fqinjësore njiheshin mes vete dhe ishte e vështirë të sigurohej fshehtësi e plotë. Dyshimi i

⁴⁴ www.telegafi.com, Rigjykimi i Ramush Haradinajt në Hagë: A po dëmtton gjykata drejtësisë duke favorizuar prokurorinë, shkrim i Roland Gjenës, publikuar më dt. 11.08.2011.

Tribunalit se vetë të akuzuarit, gjithashtu, mund të ndikonin ndaj dëshmitarëve që të mos dëshmonin, ishte edhe arsyeja kryesore që në disa raste Dhoma Gjyqësore ose Dhoma e Apelit të refuzojë kërkesën e të akuzuarve për lirim të përkohshëm.

Në aktakuzë pretendohet për 30 vrasje, emërues i përbashkët i të cilave ishte se viktimat u gjetën në një rrethinë që shtrihet nga kanali i Radoniqit deri në Liqenin e Radoniqit, në komunën e Deçanit. Dëshmitë e paraqitura para Dhomës Gjyqësore, lidhur me autorët e shumë prej vrasjeve të pretenduara, dhe rrethanat e tyre janë të mjegullta, të paqarta, apo thjesht joekzistuese. Shpesh dëshmia ndërpritet në momentin kur personi zhduket në rrethana të dyshimta dhe rifillon kur gjenden eshtrat e kufomave me shenja të një vdekjeje të dhunshme dhe kur këto eshtra identifikohen. Sidoqoftë mbetet e paqartë çfarë i ka ndodhur personit në fjalë në periudhën e ndërmjetme.⁴⁵ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore vërtetoi se përveç faktit që në shumicën e kohës, me të cilën lidhet kjo aktakuzë, rrethina e kanalit të Radoniqit ishte nën kontrollin e UÇK-së, por që në raste të caktuara edhe armata dhe MPB-ja e Serbisë kishte qasje në këtë territor, gjë e cila u vërtetua nga dëshmi dhe dëshmitarë që dëshmonin se varësisht prej intensitetit të përleshjeve midis armatës jugosllave dhe UÇK-së, ky territor merrej në pushtetin e njëres ose palës tjetër, fakt ky i cili në ndërlidhje edhe me provat dhe dëshmitë e tjera e përjashtonte mundësinë që me saktësi dhe jashtë çdo dyshimi të vërtetohej se UÇK-ja ishte autorja e vrasjeve të tilla.

Përveç përgjegjësisë individuale të të akuzuarve për kryerjen e krimeve të pretenduara në aktakuzë, të akuzuarit u akuzuan edhe për përgjegjësi për pjesëmarrje në ndërmarrje të përbashkëta kriminale. Veprimtaria e përbashkët kriminale është një nga llojet e përgjegjësisë penale, që përdoret shpesh nga prokuroria në gjykatat penale ndërkombëtare,

⁴⁵ Po aty.

për veprat penale që lidhen me krimet e luftës ose me krimet ndaj njerëzimit. Kur prokurorët pretendojnë se ka ekzistuar veprimtaria e përbashkët kriminale, duhet provuar se bashkëpjesëmarrësit kanë vepruar si grup individësh në një vepër penale me një qëllim të përbashkët konkret dhe secili individ ka kryer veprime konkrete me qëllim që të zbatohet plani dhe të arrihet qëllimi i përbashkët.⁴⁶ Mirëpo në rastin konkret, Dhoma Gjyqësore pas shqyrtimit të të gjitha provave të duhura nuk mundi të arrijë në përfundim se të akuzuarit kanë vepruar si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale në drejtim të realizimit të një qëllimi të përbashkët sipas ndonjëres prej krimeve të përmbajtura në 37 pikat e aktakuzës. Edhe aq më tepër dhe me rastin e shpalljes fajtor të të akuzuarit Lahi Brahimaj për pikën 28 dhe 32 të aktakuzës; ai u shpall fajtor për veprat penale torturë dhe trajtim mizor si pjesë e shkeljeve të ligjeve dhe zakoneve të luftës, për të cilat kishte vetëm përgjegjësi individuale e jo përgjegjësi se veprimet e tilla i kishte ndërmarrë në drejtim të realizimit të qëllimit të përbashkët kriminal, sepse një qëllim i tillë nuk ishte provuar në asnjë rast nga ana e Dhomës Gjyqësore.

Si rezultat i apelimit nga ana e prokurorisë ndaj aktgjyqimit të shpallur nga Dhoma Gjyqësore më 3 prill të vitit 2008, Dhoma e Apelit shfuqizoi aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore dhe urdhëroi rigjykim të pjesshëm lidhur me gjashtë pika. Vendimi për rigjykim, lidhur me pikat që veçmë janë gjykuar një herë, dhe hedhja poshtë e një vendimi pafajësie nga ana e Dhomës së Apelit, paraqitte rast të paprecedentë në historinë 18 vjeçare të funksionimit të TPNJ-së. Me dhënien e një vendimi të tillë nga Dhoma e Apelit, lindën dilema se me një vendim të tillë a u shkelën disa parime shumë të rëndësishme të së drejtës

⁴⁶ www.telegafi.com, Shkrim nga Roland Gjana, (autori është ekspert i së drejtës ndërkombëtare dhe ka shërbyer si këshilltar juridik në OKB, Bankën Botërore dhe organizata të tjera), me titull Rigjykimi i Haradinajt në Hagë: A po e dëmton Gjykata drejtësinë duke favorizuar Prokurorinë, publikuar më 11.08.2012.

dhe gjegjësisht parimi *res judicata* dhe parimi *non bis in idem*. Parimet *res judicata* (çështja e gjykuar) dhe parimi *non bis in idem* (moslejimi që një person për të njëjtën çështje të gjykohet dy herë) janë parime fundamentale në të drejtën penale si dhe në të drejtën penale ndërkombëtare, të cilat garantojnë siguri juridike për të akuzuarit dhe mbrojtjen e tyre nga veprimet arbitrare të organeve shtetërore. Parime të tilla, gjithashtu, janë të parapara edhe në Statutin për TPNJ-në, gjegjësisht në nenin 10 të këtij Statuti parashihet parimi *non bis in idem*.

4.4. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit të Ruandës

I ngjashëm me Tribunalin e Hagës, edhe Tribunali për Ruandën u krijua me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Me rezolutën 955, të datës. 08.XI.1994 të Këshillit të Sigurimit u krijua Tribunali Penal Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe shkeljen e nenit 3 të Konventave të Gjenevës për mbrojtjen e viktimave të luftës të vitit 1949 dhe protokolleve plotësuese të Konventave të Gjenevës të vitit 1977, të kryera në periudhën prej 01.01.1994 deri më 31.12.1994 në territorin e Ruandës dhe të vendeve fqinje (Krapac,2011:182).

I krijuar menjëherë pas Tribunalit të Hagës dhe nga i njëjti organ, gjegjësisht nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ai ka shumë ngjashmëri me TPNJ-në.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, duke pasur parasysh raportet e sekretarit gjeneral dhe të të dërguarit special për Ruandën, të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, të cilat alarmojnë për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në mënyrë sistematike në territorin e Ruandës, dhe që paraqesin kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, ishin faktorë vendimtarë që bashkësia ndërkombëtare të

merrte një vendim të tillë me qëllimin që ata të cilët kanë kryer akte të tilla të vihen para drejtësisë dhe mos të mbeten pa u ndëshkuar.⁴⁷

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të kryera në territorin e Ruandës, dhe qytetarëve të Ruandës përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të kryera në territorin e shteteve fqinje, në periudhën midis 1 janarit të vitit 1994 e deri më 31 dhjetor të vitit 1994, i njohur shkurt si Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën, vepron në bazë të Statutit të miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, me rezolutën 955. Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën përmban 32 nene, me të cilat rregullohen të gjitha çështjet materiale dhe formale-procedurale për funksionimin e këtij Tribunali.

Fillimisht rregullohet kompetenca e Tribunalit, ku në nenin e parë të këtij Statuti parashihet se Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën është kompetent për ndjekjen e personave përgjegjës për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Ruandës dhe qytetarëve të Ruandës përgjegjës për shkelje të tilla të kryera në territorin e shteteve fqinje në periudhën midis janarit të vitit 1994 deri më 31 dhjetor të vitit 1994, në pajtim me dispozitat e Statutit (neni 1).

Në vazhdim, me Statut janë përcaktuar nocionet e krimeve dhe të elementeve të cilat përbëjnë figurat e krimeve, për gjykimin e të cilave është kompetente Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën.

Sipas Statutit, gjenocidi nënkupton kryerjen e cilit do prej akteve të kryera me qëllim të shkatërrimit, plotësisht ose pjesërisht të grupit nacional, etnik, racor ose religjioz, si:

⁴⁷ www.unictr.org, Basic Documents, International Criminal Tribunal for Ruanda, Statute, 31 january 2010, f. 1.

- Vrasjen e anëtarëve të grupit;
- Shkaktimin e lëndimeve të rënda fizike ose psikike ndaj anëtarëve të grupit;
- Shkaktimin e qëllimshëm të kushteve të tilla të jetës ndaj grupit, me qëllim sjelljen e grupit deri te shkatërrimi fizik, në tërësi ose pjesërisht;
- Imponimin e masave me qëllim të parandalimit të lindjeve brenda grupit;
- Transferimin me forcë të fëmijëve prej një grupi në grupin tjetër.

Në paragrafin 3 të nenit 2 të Statutit janë përcaktuar edhe veprimet të cilat, gjithashtu, janë të sanksionueshme si:

- Gjenocidi;
- Konspiracioni për kryerjen e gjenocidit;
- Nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për kryerjen e gjenocidit;
- Tentativa për të kryer gjenocid;
- Bashkëpunimi në gjenocid (neni 2).

Në nenin 3 janë paraparë elementet që përbëjnë figurën e krimeve kundër njerëzimit, ku parashihet se Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën ka në kompetencë ndjekjen e personave përgjegjës për krimet e kryera si pjesë e sulmit të përhapur ose sistematik kundër popullsisë civile në baza nacionale, politike, etnike, racore ose religjioze si:

- Vrasje;
- Asgjësim;
- Skllavërim;
- Deportim;
- Burgim;
- Torturë;

- Dhunim;
- Persekutimi në baza politike, racore ose religjioze;
- Akte të tjera johumane (neni 3).

Në nenin 4 të Statutit janë paraparë shkeljet e nenit 3, i përbashkët për Konventat e Gjenevës dhe Protokolli II Plotësues, ku parashihet se Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën ka në kompetencë ndjekjen e personave të cilët kanë kryer ose kanë urdhëruar të kryhen shkeljet serioze të nenit 3 të Konventave të Gjenevës për mbrojtjen e viktimave të luftës të vitit 1949, dhe Protokollit II Plotësues të vitit 1977. Shkelje të tilla përfshijnë aktet e mëposhtme, por që nuk kufizohen vetëm me akte të tilla si:

- Dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike dhe mendore të personave, në veçanti vrasje dhe trajtim mizor si tortura, gjymtim ose çdo formë tjetër e dënimit trupor;
- Dënimet kolektive;
- Marrja e pengjeve;
- Aktet e terrorizmit;
- Nëpërkëmbja e dinjitetit personal, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues, përdhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë e sulmit të paligjshëm;
- Plaçkitje;
- Shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimeve pa u shpallur paraprakisht nga një gjykatë e rregullt, duke shkelur të gjitha garancitë e domosdoshme gjyqësore të njohura nga popujt e civilizuar;
- Kërcënimet për të kryer ndonjë prej akteve të mësipërme (neni 4).

Në nenet 5 dhe 6 janë paraparë dispozita lidhur me juridiksionin personal të Tribunalit dhe përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën ka juridiksion mbi personat fizikë në pajtim me dispozitat e këtij Statuti (neni 5).

Lidhur me përgjegjësinë penale individuale parashihet se ai person i cili planifikon, nxit, urdhëron, kryen ose në ndonjë mënyrë tjetër ndihmon ose mbështet planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e krimeve të parapara me këtë Statut, do të përgjigjet individualisht për krimin.

Pozita zyrtare e personit të akuzuar, qoftë kryetar i shtetit ose i qeverisë ose si person përgjegjës zyrtar i qeverisë, nuk paraqet bazë për lirimin e atij personi nga përgjegjësia penale, e as nuk do të ndikojë në zvogëlimin e dënimit.

Fakti se veprimet e kryera, të cilat përbëjnë krim sipas këtij Statuti, janë kryer nga vartësit nuk ndikon në lehtësimin e përgjegjësisë penale të eprorit, sepse eprori kishte njohuri ose duhej të kishte, për faktin se vartësi i tij ishte në gjendje të kryente veprime të tilla kriminale dhe eprori dështoi në marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar ndërmarrjen e veprimeve të tilla ose nëse ato veçmë ishin kryer duhej të ndërmernte masa për ndëshkimin e tyre.

Fakti se i akuzuari në kryerjen e krimeve ka vepruar në bazë të urdhrave të qeverisë ose të eprorit nuk e liron atë nga përgjegjësia, por ky fakt mund të paraqitet si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit, në qoftë se Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën e konsideron se kështu e kërkon drejtësia (neni 6).

Në nenet 7 dhe 8 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën janë paraparë dispozitat lidhur me juridiksionin e gjykatave nacionale.

Juridiksioni territorial dhe kohor është rregulluar duke u nisur nga qëllimi për të cilin është themeluar ky Tribunal, gjegjësisht Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën në të cilin përfshihet hapësira tokësore dhe ajrore si dhe territori i shteteve fqinje, ku janë kryer shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare nga qytetarët e Ruandës. Fakti se Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën ka karakter të përkohshëm theksohet edhe në Statutin e saj, ku lidhur me juridiksionin hapësinor parashihet se Tribunali ka juridiksion për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e Ruandës në periudhën prej 1 janarit të vitit 1994 deri më 31 dhjetor të vitit 1994 (neni 7).

Raporti i juridiksionit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe i gjykatave nacionale ka paraparë juridiksionin e harmonizuar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkeljet e së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Ruandës dhe qytetarëve të Ruandës për shkelje të tilla të kryera në territorin e shteteve fqinje në periudhën kohore midis 1 janarit të vitit 1994 deri më 31 dhjetor të vitit 1994.

Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën ka përparësi në raport me gjykatat nacionale të të gjitha shteteve, që do të thotë se Tribunali, në cilindo stad të procedurës, mund të kërkojë nga gjykatat nacionale që një çështje t'ia transferojë në kompetencë për procedim të mëtejshëm në përputhje me Statutin dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën (neni 8).

Parimi *non bis in idem* si parim shumë i rëndësishëm i së drejtës është parim i cili është paraparë edhe në Statutin për Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën.

Një person i cili, për veprimet që përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, është përgjigjur para Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, nuk mundet që për veprime të njëjta të përgjigjet edhe para gjykatave nacionale. Kurse në rastet kur një person për

veprime që përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare është përgjigjur para gjykatës nacionale, mundet që rasti i tij sërish të procedohet në mënyrë plotësuese nga Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën vetëm nëse:

- Veprimet për të cilat është proceduar para gjykatës nacionale kanë qenë të cilësuar si krime të zakonshme ose
- Zhvillimi i procedurës para gjykatës nacionale nuk ishte i paanshëm dhe i pavarur, ose ishte i dizajnuar në atë mënyrë që ta mbrojë të akuzuarin nga përgjegjësia penale ndërkombëtare ose një rast i tillë nuk ishte proceduar penalisht si duhet. Në raste të tilla Tribunali Ndërkombëtar penal do të ketë parasysh faktin se të njëjtit person për të njëjtën vepër nga një gjykatë nacionale i është shqiptuar dënim, i cili veçmë është vuajtur (neni 9).

Organizimi i Tribunalit për Ruandën – Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën përbëhet nga këto organe:

- Dhomat – ku përfshihen tri Dhoma Gjyqësore dhe Dhoma e Apelit;
- Prokuroria;
- Sekretaria (neni 10).

Dhomat përbëhen nga 14 gjykatës të pavarur, të cilët nuk mund të jenë të së njëjtës kombësi, prej të cilëve:

- Tre gjyqtarë do të shërbejnë në nga një Dhomë gjyqësore;
- Pesë gjyqtarë do të shërbejnë në Dhomën e Apelit (neni 11).

Për sa i përket përbërjes së Dhomës së Apelit me Statut është paraparë përbërje e njëjtë me Dhomën e Apelit të TPNJ-së, gjegjësisht gjyqtarët e njëjtë, të cilët do të shërbejnë në Dhomën e Apelit të TPNJ-së, do të jenë gjykatës edhe në Dhomën e Apelit të TPNR-së.

Gjyqtarët e TPNR-së zgjedhin kryetarin, i cili pas konsultimeve me gjyqtarët cakton gjyqtarët për Dhomat Gjyqësore. Gjyqtari do të shërbejë vetëm në atë Dhomë në të cilën është caktuar,

Gjyqtarët e Dhomës Gjyqësore zgjedhin Kryetarin e trupit gjykues, i cili udhëheq punimet e Dhomës Gjyqësore në tërësi (neni 13).

Rregullat e Procedurës dhe Provave miratohen nga gjyqtarët e TPNR-së me qëllim të procedimit para Tribunalit dhe zhvillimit të të gjitha fazave të procedurës si procedurën paraprake, procedurën gjyqësore, apelet, pranimi i provave, mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve dhe çështje të tjera të përshtatshme të TPNR-së, me ndryshimet që ata i gjykojnë si të nevojshme (neni 14).

Prokurori i TPNR-së është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Ruandës dhe qytetarëve të Ruandës përgjegjës për shkelje të tilla të kryera në territorin e shteteve fqinje në periudhën midis 1 janarit të vitit 1994 deri më 31 dhjetor të vitit 1994.

Prokurori duhet të veprojë në mënyrë të pavarur dhe si organ i ndarë nga TPNR-ja, si dhe nuk duhet të ndikohet ose të pranojë instruksione nga ndonjë qeveri ose nga ndonjë burim tjetër.

Deri në vitin 2003 prokurori i TPNJ-së vepronte edhe për TPNR-në, kurse pas vitit 2003 TPNR-ja ka prokurorin e vet.

Sekretari është përgjegjës për administrimin dhe shërbimin e TPNR-së, e cila përbëhet nga sekretari dhe nga stafi tjetër që përcaktohet sipas nevojave të Tribunalit.

Sekretari emërohet nga sekretari gjeneral pas konsultimeve me kryetarin e TPNR-së, mandati i të cilit zgjat katër vjet, por ka edhe të drejtën e rizgjedhjes, kurse stafi i sekretarisë emërohet nga sekretari gjeneral, pas konsultimit me sekretarin e TPNR-së (neni 16).

Prokurori është përgjegjës për hetimin dhe përgatitjen e aktakuzës, hetimet i fillon *ex-officio* ose në bazë të informacioneve të siguruara nga secili burim, por veçanërisht nga qeveritë, nga organet e Kombeve të Bashkuara si dhe nga organizatat ndërqeveritare ose joqeveritare. Prokurori shqyrton dhe vendos se cilat informacione të pranuar ose të siguruara do të procedojë.

Prokurori ka të drejtë që t'i marrë në pyetje të akuzuarit, viktimat dhe dëshmitarët, të mbledhë prova dhe të hetojë në vendin e ngjarjes. Për kryerjen e detyrave të tilla, nëse prokurori e sheh të nevojshme, mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve të shtetit ku kryhen hetimet.

Kur i dyshuari merret në pyetje, duhet të udhëzohet për të drejtën e ndihmës nga avokati, të cilin e zgjedh vetë, por ka edhe të drejtën për të pasur ndihmë ligjore pa pagesë nëse i dyshuari nuk ka mjete materiale për të paguar avokatin mbrojtës, si edhe të drejtën e sigurimit të përkthyesit në një gjuhë që e kupton.

Pas konstatimit se ekziston një rast *prima facie*, prokurori duhet të përgatisë një aktakuzë, që përmban një deklaratë të përmbledhur të fakteve dhe për krimin ose krimet me të cilat i akuzuari ngarkohet sipas Statutit, e cila i dorëzohet gjyqtarit të Dhomës Gjyqësore (neni 17).

Gjyqtari i Dhomës Gjyqësore, tek i cili është dorëzuar aktakuza, do ta shqyrtojë aktakuzën, dhe nëse është i mendimit se një rast *prima facie* është formuluar nga prokurori, ai do të

konfirmojë aktakuzën, dhe nëse nuk është formuluar nga prokurori atëherë aktakuza do të hedhet poshtë.

Pas konfirmimit të aktakuzës gjyqtari, me kërkesë të prokurorit, mund të lëshojë urdhra për arrestimin, ndalimin, dorëzimin apo transferimin e personave dhe çdo urdhër tjetër që është i nevojshëm për mbajtjen e gjykimit (neni 18).

Për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor kujdeset trupi gjykues, i cili duhet të sigurojë një gjykim fer dhe në kohë të arsyeshme dhe zhvillimin e procedurës në përputhje me Rregullat e Procedurës dhe Provave, me respekt të plotë për të drejtat e të akuzuarit si dhe me kujdesin e duhur për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

Personi, ndaj të cilit aktakuza është konfirmuar në bazë të një urdhri për arrestim të lëshuar nga TPNR-ja, do të transferohet në TPNR, do të paraburgoset dhe menjëherë informohet për akuzat kundër tij. Më pas trupi gjykues do të lexojë aktakuzën dhe duhet të bindet se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar dhe duhet të konfirmojë se i akuzuari e kupton aktakuzën, më pas i akuzuari duhet të betohet dhe në fund Dhoma Gjyqësore do të caktojë datën për gjykim. Gjykimi do të jetë publik vetëm në qoftë se Dhoma Gjyqësore nuk vendos të kundërtën në pajtim me rregullat e procedurës dhe të provave (neni 19).

Nuk ka gjykim të drejtë pa përfshirjen në procedurë të të drejtave të të akuzuarit, ku me Statutin për TPNR-në parashihet se të gjithë personat janë të barabartë para TPNR-së. Gjatë vendosjes lidhur me akuzat, të akuzuarit duhet t'i sigurohet gjykim fer dhe publik dhe ai do të konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia e tij në pajtim me dispozitat e Statutit. Gjatë shqyrtimit të akuzave kundër të akuzuarit, në pajtim me këtë Statut, të akuzuarit i sigurohen garancitë minimale, në barazi të plotë:

- Të informohet në mënyrë të duhur dhe në detaje, në një gjuhë që e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij;
- Të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësirat e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes si dhe të komunikojë me mbrojtësin që e zgjedh vetë;
- Të gjykohet pa shtyrje të panevojshme;
- Të gjykohet në prezencë dhe të ketë të drejtën që të mbrohet vetë ose nëpërmjet mbrojtjes legale juridike që do ta zgjedhë vetë;
- Të informohet për të drejtën e mbrojtësit. Nëse i akuzuari nuk ka mbrojtës, t'i caktohet mbrojtës juridik në qoftë se interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, si dhe të ketë të drejtën e shfrytëzimit të mbrojtësit pa pagesë në rast se i akuzuari nuk ka mjete materiale për ta siguruar vetë mbrojtësin;
- Të ekzaminojë dëshmitarët kundër tij si dhe sigurimin dhe ekzaminimin e dëshmitarëve në mbrojtje të tij, nën të njëjtat kushte si dhe dëshmitarët kundër tij;
- Të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në Tribunal;
- Të mos detyrohet që të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë (neni 20).

Për zhvillimin e gjykimit pa ndikime është shumë e rëndësishme mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave, me qëllim që të sigurohet pasqyrimi objektiv i realitetit nga dëshmitarët dhe viktimat.

Në Rregullat e Procedurës dhe Provave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të TPNR-së, parashihen një sërë masash për një mbrojtje të tillë, të cilat ndër të tjerat përfshijnë edhe masat e shfrytëzimit të kamerave gjatë procedurës dhe mbrojtjen e identitetit të viktimave (neni 21).

Pas përfundimit të gjykit, Dhoma Gjyqësore do të shpallë aktgjykimin dhe do të shqiptojë dënimin për personin e gjykuar për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Vendimi do të merret nga shumica e gjyqtarëve të Dhomës së Gjykit dhe do të shpallet publikisht. Aktgjykimi duhet të përmbajë arsyetimin me shkrim, të cilit duhet t'i bashkëngjiten edhe opinionet e kundërta nëse ka (neni 22).

Dënimi i vetëm, që mund të shqiptohet nga TPNR-ja, është dënimi me burgim, i cili në përcaktimin e kushteve të burgimit do të ketë parasysh praktikën e përgjithshme në lidhje me dënimet me burgim që shqiptohen nga gjykatat e Ruandës. Në përcaktimin e lartësisë së dënit Dhoma Gjyqësore do të ketë parasysh peshën e veprës për të cilën ngarkohet dhe rrethanat individuale të atij që ka kryer veprën penale. Përveç shqiptimit të dënit me burgim, Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë edhe kthimin e pasurisë ose të të ardhurave të fituara nëpërmjet sjelljes kriminale, të pronarët e tyre të ligjshëm (neni 23).

Aktgjykimet e shqiptuara mundet të apelojnë para Dhomës së Apelit, me kërkesë të personit të dënuar ose me kërkesë të prokurorit, për arsye të:

- Gabimit gjatë aplikimit të së drejtës, e cila çon në shpalljen e vendimit si të pavlefshëm ose
- Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike që ka shkaktuar dështim të drejtësisë.

Dhoma e Apelit duke vepruar në bazë të ankesës mund ta konfirmojë, ta shfuqizojë ose ta ndryshojë vendimin e marrë nga Dhoma Gjyqësore (neni 24).

Si mjet juridik i cili mund të ndryshojë aktgjykimin e shpallur parashihet rishqyrtimi i aktgjykit i cili lejohet të shfrytëzohet nga personi i dënuar ose prokurori në rastet kur zbulohen fakte të reja të cilat nuk kanë qenë të njohura gjatë zhvillimit të procedurës para

Dhomës Gjyqësore ose para Dhomës së Apelit dhe të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e aktgjykimit (neni 25).

Ekzekutimi i aktgjykimeve, gjegjësisht i dënimit me burg, bëhet në Ruandë ose në territorin e shteteve që janë në listën e atyre shteteve që para Këshillit të Sigurimit kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të pranuar personat e dënuar, ashtu si përcaktohet nga TPNR-ja. Në raste të tilla dënimi me burgim ekzekutohet në pajtim me dispozitat ligjore të aplikueshme në atë shtet, me mbikëqyrje nga ana e TPNR-së (neni 26).

Në Statutin e TPNR-së është paraparë edhe instituti i faljes dhe uljes së dënimeve, ku parashihet se nëse personi i dënuar në pajtim me ligjin e zbatueshëm të shtetit ku ekzekutohet dënimi, i plotëson kushtet ligjore për falje ose ulje të dënimit të personit të dënuar në qoftë se vendosin kështu Kryetari i TPNR-së në pajtim me gjykatësit mbi bazën e interesave të drejtësisë dhe parimet e përgjithshme të së drejtës (neni 27).

Në lidhje me hetimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e çështjeve të paraqitura para TPNR-së, është i nevojshëm bashkëpunimi dhe ndihma juridike e shteteve dhënë Tribunalit.

Shtetet duhet që pa vonesë të përmbushin çdo kërkesë për ndihmë ose për urdhër të lëshuar nga Dhomat Gjyqësore, ku përfshihen:

- Identifikimi dhe vendndodhja e personave;
- Marrja e dëshmive dhe procedimi i provave;
- Arrestimi ose ndalimi i personave;
- Dorëzimi ose transferimi e të akuzuarve në TPNR (neni 28).

Shpenzimet e punës së TPNR-së mbulohen nga buxheti i OKB-së (neni 30).

Gjuhët zyrtare të TPNR-së janë gjuha angleze dhe gjuha franceze (neni 31).

Për punën e TPNR-së, Kryetari i Tribunalit duhet të dorëzojë një raport vjetor te Këshilli i Sigurimit dhe tek Asambleja e Përgjithshme (neni 32).⁴⁸

TPNR-ja ishte Tribunali i cili për herë të parë në histori shqiptoi dënime ndaj personave përgjegjës për kryerjen e gjenocidit. TPNR-ja ishte, gjithashtu, institucioni i parë i cili njohi përdhunimin si një mjet për kryerjen e gjenocidit.

TPNR-ja, së bashku me tribunalet dhe gjykatat e tjera ndërkombëtare, ka luajtur një rol pionier në krijimin e një sistemi të besueshëm ndërkombëtar të drejtësisë penale, duke prodhuar një pjesë substanciale të jurisprudencës për gjenocid, krime kundër njerëzimit, krime lufte si dhe për format individuale dhe superiore të përgjegjësisë.

Duke qenë Tribunali i Parë Ndërkombëtar që shqiptoi dënime për gjenocid, ai është edhe Tribunali i Parë Ndërkombëtar që interpretoi përkufizimin e gjenocidit, të paraparë në të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1948.

Një tjetër pikë referimi u arrit me “Rastin e Medias”, ku TPNR-ja u bë Tribunali i Parë Ndërkombëtar, i cili mori në përgjegjësi pjesëtarët e mediave që ishin përgjegjës për transmetimet me qëllim të nxitjes së publikut në kryerjen e akteve të gjenocidit.

TPNR-ja dha vendimin e saj të fundit më 20 dhjetor të vitit 2012, në rastin *Ngirbatware*. Pas kësaj arritje, puna juridike e mbetur e TPNR-së tani qëndron vetëm para Dhomës së Apelit, ku një rast i paraqitur në tetor të vitit 2014, i përbërë prej gjashtë ankesave të veçanta është në pritje në apel. Një tjetër vendim i apelit për aktgjykimin e shqiptuar nga TPNR-ja për rastin *Ngirbatware*, u dha në dhjetor të vitit 2014 nga Dhoma e Apelit të

⁴⁸ http://www.unictt.org/sites/unictt.org/files/legal-library/100131_Statute_en_fr_0.pdf, Basic Documents, STATUTE OF THE INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR RWANDA.

Mekanizmi për Tribunalet Penale Ndërkombëtare që nga 1 korriku i vitit 2012 ka filluar me marrjen e përgjegjësive për funksionet e mbetura të TPNR-së.

Mbyllja formale e TPNR-së është bërë më 31 dhjetor të v.2015, ku TPNR-ja përgjatë funksionimit të saj vazhdimisht është përpjekur për t'i dhënë fund mosndëshkimit të atyre që janë përgjegjës për gjenocid, duke kombinuar përpjekjet gjyqësore, punën në terren dhe ndërtimin e kapaciteteve. Përmes këtyre përpjekjeve, TPNR-ja përmbushi mandatin e saj për të sjellë drejtësi për viktimat e gjenocidit dhe me këtë proces shpreson për të penguar të tjerët në të ardhmen.⁴⁹

Organizimi i Tribunalit për Ruandën është shumë i ngjashëm me Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë, kryesisht nga fakti se të dyja këto Tribunale u krijuan nga i njëjti organ dhe gjegjësisht nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, por dhe duke patur parasysh faktin se krijimi i Tribunalit për Ruandën u krijua menjëherë pas themelimit të TPNJ-së dhe u mbështet mbi të njëjtat parime si ato të TPNJ-së. Të dyja këto Tribunale kanë edhe organe të përbashkëta si Dhomën e Apelit, por dhe prokurorin e përbashkët deri në vitin 2003, dhe po ashtu do të ketë një organ të përbashkët i cili do të përmbyllë punët e papërfunduara të këtyre dy Tribunaleve.

Numri i gjyqtarëve të TPNR-së është më i vogël në krahasim me numrin e gjyqtarëve të TPNJ-së, kryesisht për arsye të dallimit në numrin e lëndëve që është supozuar se do të duhet të procedohen nga këto Tribunale, si dhe duke pasur parasysh se TPNJ-ja është dashur të merret me të akuzuar nga shumë shtete që kanë qenë në përbërje të ish-Jugosllavisë, ndërkohë që konflikti i armatosur në ish-Jugosllavi ka zgjatur për një periudhë më të gjatë kohore, për dallim nga Ruanda ku janë proceduar vetëm krimet e ndodhura për

⁴⁹ www.unict.org/eu/tribunal, the ICTR in Brief.

një periudhë kohore prej një viti. Gjithashtu, për sa i përket përbërjes së gjyqtarëve nëpër dhoma duhet theksuar se TPNR-ja për dallim nga TPNJ-ja gjyqtarë *ad litem* nuk ka, me ç'rast Dhomat gjyqësore të TPNR-së përbëhen vetëm nga gjyqtarë të përhershëm.

4.5. Mekanizmi për Tribunalet Penale Ndërkombëtare

Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë dhe ai i Ruandës, ishin krijuar si Tribunale *ad hoc* me një mandat të përkohshëm dhe gjegjësisht derisa të arrinin të përmbushnin qëllimin për të cilin edhe ishin krijuar.

Këto Tribunale u themeluan në rrethana të veçanta, si masa *ad hoc* në drejtim të restaurimit dhe mirëmbajtjes së paqes si dhe duke pasur parasysh kontributin që këto gjykata kanë dhënë në të drejtën ndërkombëtare penale dhe në përgjegjësinë penale për krime të rënda ndërkombëtare si dhe në drejtim të rivendosjes të sundimit të ligjit në vendet e ish-Jugosllavisë dhe në Ruandë.

Në lidhje me përmbushjen e një qëllimi të tillë, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i është dashur të gjejë mënyra që edhe pas përfundimit të punës së këtyre dy Tribunaleve, të luftojë mosndëshkimin për ata që janë përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe nevojën që të gjithë personat e paditur nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja të sillen para drejtësisë, për arsye se si Tribunali i Hagës, ashtu edhe ai i Ruandës, ishin themeluar si Tribunale me status të përkohshëm.

Me rezolutat 1503 (2003) të 28 gushtit të vitit 2003 dhe 1534 (2004) të 26 marsit të vitit 2004, të miratuara nga Këshilli i Sigurimit, ishin sugjeruar Tribunalet që të ndërmerrnin të gjitha masat e mundshme që të kompletin hetimet deri në fund të vitit 2014, me qëllim që

t'i përmbyllin të gjitha aktivitetet gjyqësore të shkallës së parë deri në fund të vitit 2008 dhe ta përfundonin punën në bazë të “strategjisë përmbyllëse” deri në fund të vitit 2010.⁵⁰

Mirëpo ky afat në praktikë ka qenë i parealizueshëm, para se gjithash për faktin se nuk ka qenë e mundur të kapen ose nuk janë dorëzuar disa nga të akuzuarit, si dhe për faktin e zgjatjes së disa prej gjykimeve të ndërlikuara të të akuzuarve, të cilët kanë pasur funksione komanduese, dhe që kanë qenë të akuzuar për një numër të madh krimesh (Dimitrijevic, Hazdi Vidanovic, Jovanovic, Markovic, Milanovic, 2013:27).

Ishte i nevojshëm krijimi i një mekanizmi që do të ishte vazhdimësi e funksioneve, por të reduktuara ndjeshëm të Tribunaleve, veç të tjerave edhe për faktin se shumë shtete të OKB-së, përfshirë SHBA-në dhe Rusinë pothuajse për një kohë të gjatë ishin të mendimit se mbajtja dhe financimi i Tribunaleve ishte bërë shumë i shtrenjtë dhe joefikas, mirëpo nga ana tjetër asnjë nga këto shtete nuk ishin të mendimit se ato duhej të pushonin së funksionuari para se të përmbyllin plotësisht punën e tyre (Dimitrijevic, Hazdi Vidanovic, Jovanovic, Markovic, Milanovic, 2013:27).

Dhe si rezultat u gjet një rrugë e mesme, krijimi i një mekanizmi, i cili do të jetë një vend i vogël, i përkohshëm dhe me një strukturë efikase, funksionet dhe madhësia e të cilit do të zvogëlohet me kalimin e kohës, me një numër të vogël të stafit në përputhje me funksionet e tij të reduktuara.⁵¹

Këshilli i Sigurimit me Rezolutën 1966 (2010) të 22 dhjetorit të vitit 2010, duke vepruar nën autorizimet e kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, vendosi të themelojë Mekanizmin Ndërkombëtar për Tribunalet Penale, të quajtur shkurt Mekanizmi, i cili do të

⁵⁰ www.unmict.org/sites

⁵¹ www.unmict.org/sites

ketë dy degë dhe njëra për TPNR-në, që ka filluar të funksionojë nga 1 korriku i vitit 2012, dhe një për TPNJ-në e cila ka filluar të funksionojë nga 1 korriku i vitit 2013. Kjo Rezolutë, ka adoptuar edhe Statutin e Mekanizmit.

Mekanizmi është paraparë të trashëgojë juridiksionin, të drejtat, detyrimet dhe funksionet themelore të TPNJ-së dhe TPNR-së si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura nga Kombet e Bashkuara në lidhje me TPNJ-në dhe TPNR-në, të cilat janë në fuqi, do të vazhdojnë të jenë në fuqi *mutatis mutandis* nga Mekanizmi.

Si fillim Mekanizmi do të veprojë për një periudhë 4 vjeçare, punën e të cilit do ta mbikëqyrë Këshilli i Sigurimit, gjegjësisht progresin e punës dhe kompletimin e funksioneve për të cilat çdo vit Mekanizmi jep raport para Këshillit të Sigurimit, që ka të drejtën e vazhdimit të mandatit edhe për dy vite, ose të vendosë ashtu si është e arsyeshme ose e nevojshme.

Në preambulën e Statutit të Mekanizmit Ndërkombëtar për Tribunalet Ndërkombëtare është paraparë që ky Mekanizëm krijohet për të marrë përsipër funksionet e mbetura të Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje serioze të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991, dhe të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ndjekjen e personave përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të kryera në territorin e Ruandës dhe qytetarët e Ruandës përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të kryera në territorin e shteteve fqinje, midis periudhës prej 1 janarit të vitit 1994 deri më 31 dhjetor të vitit 1994.

Mekanizmi do të vazhdojë me juridiksionin material, territorial, kohor dhe personal të TPNJ-së dhe TPNR-së, si dhe me të drejtat dhe obligimet e TPNJ-së dhe TPNR-së.

Mekanizmi ka të drejtë që të ndjekë penalisht personat e akuzuar nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja, që janë udhëheqësit e lartë përgjegjës për krimet e parapara në Statutin e TPNJ-së dhe TPNR-së, duke pasur në konsideratë peshën e krimeve me të cilat ngarkohen dhe shkallën e përgjegjësisë të personave të akuzuar. Mekanizmi, gjithashtu, do të ketë fuqinë e ndjekjes penale të personave të cilët janë akuzuar nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja dhe që nuk bëjnë pjesë në grupin e udhëheqësve të lartë, por vetëm pasi të jenë shteruar mënyrat e tjera të procedimit të parapara në këtë Statut.

Mekanizmi do të ketë fuqinë që të ndjekë, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti:

- Çdo person që me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyr ose ka ndërhyrë në administrimin e drejtësisë nga ana e Mekanizmit dhe ta ndalojë një person të tillë;
- Një dëshmitar i cili me vetëdije dhe qëllimisht i jep ose i ka dhënë dëshmi të rreme Mekanizmit ose gjykatave.

Para se të fillojë procedimin për shqyrtimin e një personi të tillë, Mekanizmi do të marrë në konsideratë referimin e rastit nga autoritetet e shtetit, si dhe interesat e drejtësisë dhe të përshtatshmërisë.

Mekanizmi nuk ka të drejtë që të ngrejë padi të reja, përveç atyre të parapara në këtë nen (neni 1).

Përgjatë periudhës së funksionimit, Mekanizmi do të vazhdojë me funksionet e mbetura të TPNJ-së dhe TPNR-së (neni 2).

Mekanizmi do të ketë dy degë, njëra për TPNJ-në, me seli në Hagë, dhe tjetra për TPNR-në selia e së cilës do të jetë në Arusha (neni 3).

Mekanizmi përbëhet nga këto organe:

- Dhomat, që përbëhen nga një Dhomë Gjyqësore për çdo degë të Mekanizmit dhe një Dhomë e Apelit e përbërë për të dyja degët e Mekanizmit;
- Prokurori i cili është i përbashkët për të dyja degët e Mekanizmit;
- Regjistri, i përbashkët për të dy degët e Mekanizmit, për të siguruar shërbime administrative për Mekanizmin, përfshirë dhomat dhe prokurorin (neni 4).

Lidhur me raportin e juridiksionit midis Mekanizmit dhe gjykatave nacionale, është paraparë që Mekanizmi të ketë përparësi ndaj gjykatave nacionale, ku parashihet se në çdo fazë të procedurës para gjykatave nacionale, ndaj një personi për të cilin ka kompetencë edhe Mekanizmi në bazë të Statutit, Mekanizmi mund të kërkojë nga gjykata nacionale të transferojë procedurën në kompetencën e Mekanizmit në pajtim me Statutin dhe me Rregullat e Procedurës dhe Provave të Mekanizmit (neni 5).

Mekanizmi ka fuqinë dhe duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që t'i transferojë rastet e personave, gjegjësisht të udhëheqësve të lartë shtetërorë dhe personave të tjerë të dyshuar, ose që akuzohen se kanë kryer krime të parapara në Statutin e TPNJ-së dhe TPNR-së, në gjykatat nacionale.

Pasi të konfirmohet aktakuza dhe para fillimit të gjykimit, pavarësisht nëse i akuzuari është ose nuk është nën kujdesin e Mekanizmit, Presidenti mund të caktojë një trup gjykues i cili do të përcaktojë se rasti i caktuar a do t'iu referohet autoriteteve të shtetit:

- Në territorin e të cilit është kryer krimi;
- Në territorin e të cilit i akuzuari është arrestuar ose
- Ka juridiksion dhe është i gatshëm dhe i përgatitur në mënyrë adekuate që të pranojë një rast të tillë, në mënyrë që këto autoritete menjëherë duhet të referojnë çështjen deri te gjykata e përshtatshme për gjykim brenda shtetit.

Me një rregullim të tillë të juridiksionit të Mekanizmit në raport me gjykatat kombëtare, është tentuar që në praktikë të realizohet ajo që ka qenë edhe njëra ndër detyrat themelore të Tribunaleve të Hagës dhe atij të Ruandës; aftësimi i juridiksioneve nacionale që të zhvillojnë gjykime për lloje të tilla të krimeve, sepse arsyeja për të cilin edhe ishin themeluar Tribunalet *ad hoc* ka qenë mospërgatitja dhe mosgatishmëria e gjykatave nacionale për zhvillimin e gjykimeve të tilla.

Në përcaktimin lidhur me atë që një rast duhet t'iu referohet autoriteteve vendase për gjykim ose jo, dhoma gjyqësore do të ketë parasysh peshën e krimeve dhe nivelin e përgjegjësisë të të akuzuarit.

Vetë dhoma gjyqësore ose me kërkesë të prokurorit mund të japë rekomandim me qëllim që të akuzuarit t'i jepet mundësia të shprehet dhe pasi dhoma gjyqësore të fitojë bindjen se i akuzuari do të gjykohet në bazë të një gjykimi fer ka dhe sigurinë se të akuzuarit nuk do t'i shqiptohet dënimi me vdekje. Mekanizmi do të mbikëqyrë rastet e referuara në gjykatat nacionale, nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe nga Mekanizmi, me ndihmën e organizatave dhe trupave ndërkombëtarë dhe regjionalë.

Në qoftë se një urdhër për referim, i lëshuar para se i akuzuari të jetë shpallur fajtorë ose të jetë liruar nga një gjykatë kombëtare nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe Mekanizmi dhe, kur është e qartë se kushtet në bazë të të cilave rasti i tillë është referuar nuk ekzistojnë më dhe në qoftë se një gjë e tillë është në interes të drejtësisë, Dhoma Gjyqësore mundet që vetë ose në bazë të kërkesës së prokurorit, duke i dhënë mundësi autoriteteve të shtetit që të shprehen në lidhje me rastin, të revokojë urdhrin e tillë dhe të bëjë një kërkesë formale për shtyrje (neni 6).

Parimi *non bis in idem* si një parim shumë i rëndësishëm i së drejtës, është paraparë edhe në Statutin e Mekanizmit, i cili parasheh se asnjë person, që më parë është trajtuar nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe Mekanizmi, për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, nuk mundet sërish të trajtohet për të njëjtat vepra edhe nga gjykata nacionale. Personi i tillë, në qoftë se është trajtuar para gjykatave nacionale për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, mundet në mënyrë plotësuese të trajtohet edhe nga Mekanizmi, por vetëm nëse:

- Veprimi për të cilin është gjykuar para gjykatës kombëtare, ka qenë i karakterizuar si krim i zakonshëm;
- Procedura para gjykatës kombëtare nuk ka qenë e paanshme dhe e pavarur, ishte e dizajnuar në mënyrë që i akuzuari t'i shpëtojë përgjegjësisë penale ndërkombëtare, ose rasti nuk ishte proceduar në mënyrë dinjitoze.

Gjatë shqyrtimit të dënimit, që do t'i shqiptohet të dënuarit në bazë të Statutit, Mekanizmi do të marrë parasysh shkallën në të cilën dënimi i shqiptuar nga gjykata nacionale ndaj të njëjtit person, për të njëjtën vepër, veçmë është mbajtur (neni 7).

Lidhur me gjyqtarët, që do të jenë pjesë e Mekanizmit, është paraparë që mekanizmi të ketë një Regjistër prej 25 gjyqtarësh të pavarur, prej të cilëve jo më shumë se dy mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet. Gjyqtarët e Mekanizmit nuk do të jenë gjithmonë prezent në selitë e degëve të Mekanizmit, por vetëm me kërkesë të Presidentit aq sa është e nevojshme për të ushtruar funksionet që kërkojnë praninë e tyre. Për aq sa është e mundur, dhe si të vendoset nga Presidenti, gjyqtarët funksionet e tyre mund t'i ushtrojnë nga distanca, larg nga selitë e degëve të Mekanizmit.

Në përbërjen e Dhomave Gjyqësore dhe të Apelit, do të mbahet llogari për përvojën e gjyqtarëve në të drejtën penale, të drejtën ndërkombëtare duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtat e njeriut (neni 9).

Mandati i gjyqtarëve të Mekanizmit zgjat katër vite, me të drejtë të riemërimit nga ana e sekretarit të përgjithshëm, pas konsultimit me kryetarin e këshillit të sigurimit dhe kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme.

Caktimi i gjyqtarëve dhe përbërja e Dhomave bëhet nga presidenti, në mënyrë që kur gjykohen personat shtetërorë, të rangut të lartë ose të mesëm ose kur është e nevojshme të vendoset lidhur me transferimin e një rasti për gjykim në gjykatat nacionale, atëherë Presidenti do të formojë një trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarëve nga regjistri i gjyqtarëve të mekanizmit, ndërsa kur gjykohet për rastet e tjera, që janë në juridiksion të Mekanizmit në pajtim me këtë Statut, atëherë presidenti emëron një gjyqtar të vetëm nga regjistri i gjyqtarëve të Mekanizmit.

Presidenti mund të caktojë një gjyqtar nga regjistri i gjyqtarëve të Mekanizmit i cili do të jetë në dispozicion, që si gjyqtar i vetëm të vendosë lidhur me aktakuza, për urdhra ose për çështje të tjera që nuk janë në kompetencë ekskluzive për t'u gjykuar nga Dhoma Gjyqësore.

Presidenti i Mekanizmit do të jetë anëtar i Dhomës së Apelit, do të emërojë anëtarët e tjerë të dhomës së Apelit dhe do të kryesojë me punimet e tij. Dhoma e Apelit, me përbërje prej tre gjyqtarëve vendos lidhur me ankesat kundër vendimeve të gjyqtarit të vetëm, kurse dhoma me përbërje prej pesë gjyqtarëve vendos lidhur me ankesat kundër vendimeve të dhëna nga trupi gjykues i Dhomës Gjyqësore.

Në rastin e kërkesës për rishikim të vendimit, të dhënë nga gjyqtari i vetëm ose nga Dhoma Gjyqësore, Presidenti do të emërojë një trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë për shqyrtimin e tillë, kurse në rastet e kërkesës nga Dhoma e Apelit, trupi gjykues i Dhomës së Apelit për rishikim do të përbëhet prej pesë gjyqtarëve.

Gjyqtarët e procedurës së bashku miratojnë rregullat e procedurës dhe të provave me të cilat rregullohet faza paraprake e procedurës, gjykimi dhe ankesat, pranimi i provave, mbrojtja e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe gjëra të tjera të nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje.

Amandamenti i Rregullave të Procedurës dhe provave mund të bëhet nga gjyqtarët nga distanca, përmes procedurës me shkrim.

Rregullat e procedurës dhe të provave dhe secili ndryshim i tyre fiton efektin në momentin e miratimit nga gjyqtarët e Mekanizmit përveç në rastet kur Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe, të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë Statut (neni 13).

Prokurori është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës, të personave të dyshuar për kryerjen e krimeve nën juridiksionin e mekanizmit. Prokurori vepron në mënyrë të pavarur si një organ i veçantë i Mekanizmit, dhe nuk merr udhëzime nga asnjë qeveri ose organ tjetër.

Zyra e prokurorit përbëhet nga prokurori, nga një zyrtar për secilën seli të degëve të Mekanizmit, të cilët caktohen nga prokurori, dhe nga një personel tjetër të kualifikuar sipas nevojave të prokurorit.

Si organ tjetër, në përbërje të Mekanizmit, është Sekretaria, e cila është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e degëve të Mekanizmit.

Sekretaria përbëhet nga sekretari, nga një nëpunës zyrtar për secilën seli në të dyja degët e Mekanizmit dhe nga një staf tjetër i kualifikuar sipas nevojës.

Prokurori i Mekanizmit ka të drejtë të hetojë dhe të ndjekë penalisht personat të cilët janë akuzuar posaçërisht nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja. Prokurori i Mekanizmit nuk ka të drejtë të ngrejë padi të reja kundër personave të tjerë.

Prokurori ka të drejtë që të marrë në pyetje të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët, të mbledhë provat dhe të kryejë hetime në vendin e ngjarjes, dhe në kryerjen e detyrave të tilla prokurori ka të drejtë të kërkojë ndihmën e shtetit ku duhet të ndërmerren veprimet e tilla.

Kur i dyshuari merret në pyetje, ka të drejtë të ndihmohet nga avokati sipas zgjedhjes së tij, duke përfshirë të drejtën që të ketë ndihmë juridike pa pagesë nëse i dyshuari nuk ka mjete materiale që të paguajë vetë mbrojtësin, si dhe për përkthimin e nevojshëm në një gjuhë që e kupton, nëse i dyshuari nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura para Mekanizmit.

Në qoftë se zbulohet se ekziston një rasti *prima facie*, prokurori do të përgatisë një aktakuzë që përmban një deklaratë të përmbledhur të fakteve për krimin ose për krimet me të cilat akuzohet i akuzuari, aktakuzë e cila i transmetohet gjyqtarit në detyrë ose gjyqtarit të vetëm, të cilin e cakton Presidenti (neni 16).

Aktakuza e ngritur nga prokurori, shqyrtohet nga gjyqtari në detyrë ose nga gjyqtari i vetëm, i caktuar nga Presidenti, dhe nëse gjyqtari bindet se një rast *prima facie* është formuluar si duhet nga prokurori, do të konfirmojë aktakuzën dhe nëse jo, do ta hedhë poshtë aktakuzën.

Pas konfirmimit të aktakuzës, gjyqtari me kërkesën e prokurorit mund të lëshojë urdhra dhe garanci për arrestimin, ndalimin, dorëzimin apo transferimin e personave, dhe çdo urdhër tjetër që mund të kërkohej për kryerjen e gjykimit (neni 17).

Fillimi dhe zhvillimi i procedurës gjyqësore – gjykatësi i vetëm ose trupi gjykues gjatë zhvillimit të gjykimit do të sigurohet që gjykimi të jetë i drejtë dhe efikas, se procedura është zhvilluar në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave, se gjatë zhvillimit të procedurës janë respektuar të drejtat e të akuzuarit si dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve.

Personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza dhe në bazë të urdhërarrestit të lëshuar nga Mekanizmi duhet të merret në paraburgim, menjëherë duhet të informohet për akuzat kundër tij dhe të transferohet te Mekanizmi.

Gjyqtari i vetëm apo gjyqtari i Dhomës gjyqësore i cili caktohet nga Presidenti, duhet ta lexojë aktakuzën, të sigurohet se janë respektuar të drejtat e të akuzuarit, të konfirmojë se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe e udhëzon të akuzuarin që të betohet.

Seancat janë publike, përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm ose gjyqtari i trupit gjykues vendos që seanca të mos jetë publike në përputhje me Rregullat e Procedurës dhe Provave (neni 18).

Lidhur me të drejtat e të akuzuarit, në Statutin e Mekanizmit parashihet se të gjithë personat janë të barabartë para Mekanizmit.

Gjatë përcaktimit të akuzave ndaj një personi, i akuzuari ka të drejtë për një procedurë dëgjimore të drejtë dhe publike, dhe ai konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia e tij, në pajtim me dispozitat e Statutit.

Gjatë përcaktimit të akuzave ndaj të akuzuarit, atij i garantohen disa garanci minimale, në barazi të plotë:

- Të informohet menjëherë dhe me detaje, në një gjuhë të cilën e kupton i akuzuari, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;
- Të ketë mundësi dhe kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikojë lirshëm me avokatin e tij;
- Të kryhet procedura e gjyimit pa vonesë të panevojshme;
- I akuzuari të gjykohet në prani të tij, dhe e drejta e shfrytëzimit të mbrojtësit të jetë pa pagesë, në qoftë se i akuzuari nuk ka mundësi materiale që ta sigurojë me të ardhurat e tij mbrojtësin;
- Të shqyrtojë dhe të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, si dhe dëshmitarët në favor të tij, në kushte të njëjta ashtu si edhe dëshmitarët kundër tij;
- Të ketë ndihmën e përkthyesit pa pagesë, nëse i akuzuari nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura;
- Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose që të pranojë fajësinë (neni 19).

Mekanizmi në Rregullat e Procedurës dhe Provave duhet të parashohë masa për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave në relacion me TPNJ-në, TPNR-në dhe Mekanizmin, përfshirë edhe masa të tilla si shfrytëzimi i kamerave gjatë procedurës dhe mbrojtja e identitetit të viktimave (neni 20).

Gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues do të shpallë aktgjykimin dhe do të shqiptojë dënime dhe gjopa ndaj personave të dënuar nga Mekanizmi.

Të gjitha aktgjykimet duhet të shpallen publikisht dhe të përmbajnë arsyetim me shkrim.

Aktgjykimet e dhëna nga Dhoma Gjyqësore merren nga shumica e gjyqtarëve, dhe në qoftë

se ka mendime kundër ato duhet t'i bashkangjiten procesverbalit për këshillim dhe votim (neni 21).

Lidhur me llojin e sanksioneve, që mund të shqiptohen nga Mekanizmi, janë paraparë dy lloje të dënimeve: dënimi me burg dhe dënimi me gjoba. Ndaj personave të cilët në cilësi të udhëheqësve të lartë ose të mesëm shtetërorë, që gjykohen për kryerjen e krimeve nën juridiksionin e Statutit për Mekanizëm, është paraparë se i vetmi dënim që mund të shqiptohet ndaj tyre është dënimi me burg, kurse ndaj personave të cilët me veprimet e tyre ndërhyjnë në administrimin e drejtësisë ose të dëshmitarëve, që qëllimisht japin dëshmi të rrejshme, në këtë Statut është paraparë se mund të shqiptohet dënimi me burg dhe me gjobë, ku parashihet se dënimi më i lartë me burgim nuk mund të jetë më shumë se 7 vite.

Gjatë përcaktimit të kushteve të burgimit, gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues do të ketë në konsideratë praktikën e përgjithshme të zbatuar gjatë mbajtjes së dënimeve në territorin e ish-Jugosllavisë dhe Ruandës.

Gjatë vendosjes për masën e dënimit, gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues do të ketë parasysh peshën e veprës si dhe rrethanat personale të personit të dënuar.

Prona dhe të ardhurat e tjera të fituara me sjelljen kriminale, me urdhër të gjyqtarit të vetëm ose trupit gjykues mund t'u kthehen pronarëve të ligjshëm (neni 22).

Aktgjykimi i shkallës së parë mund të apelohej nga palët dhe nga prokurori në rastet:

- Kur aktgjykimi i shkallës së parë përmban ndonjë gabim në aplikimin e ligjit, i cili një aktgjykim të tillë e bën të pavlefshëm;
- Vlerësimi i gabuar i ndonjë fakti, i cili ka çuar deri tek aplikimi i gabueshëm i së drejtës.

Dhoma e Apelit kur vendos në lidhje me ankesën mundet që vendimin e shkallës së parë ta konfirmojë, ta kthejë në gjykim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë ose të vendosë vetë (neni 23).

Kërkesa për rishikimin e vendimit mund të paraqitet deri te Mekanizmi, në qoftë se është zbuluar një fakt i ri, i cili nuk ka qenë i njohur gjatë kohës së zhvillimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë, para gjyqtarit të vetëm ose trupit gjykues si dhe në procedurën në shkallën e dytë në Dhomën e Apelit. Kërkesën për rishikimin e vendimit prokurori mund ta paraqesë brenda një viti nga dita e shpalljes së vendimit. Trupi gjykues do të miratojë kërkesën e tillë në qoftë se shumica e gjyqtarëve të Dhomës Gjyqësore janë të mendimit se fakti i ri, nëse vërtetohet mund të jetë një faktor vendimtar gjatë marrjes së vendimit (neni 24).

Zbatimi i dënimeve me burgim bëhet në një shtet të përzgjedhur nga Mekanizmi i zgjedhur nga lista e shteteve që kanë marrëveshje për një qëllim të tillë me Kombet e Bashkuara.

Dënimi me burgim zbatohet në përputhje me dispozitat ligjore të shtetit ku zbatohet dënimi, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Mekanizmi. Mekanizmi ka kompetencë që të mbikëqyrë zbatimin e dënimeve të shqiptuara nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe Mekanizmi, duke përfshirë edhe zbatimin e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimeve të lidhura midis Kombeve të Bashkuara dhe shteteve anëtare, me marrëveshjet e tjera të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale si dhe të trupave dhe organizatave të tjera përkatëse (neni 25).

Në qoftë se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi të shtetit ku personi i dënuar nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe Mekanizmi, i plotëson kushtet për uljen ose faljen e dënimit, atëherë shteti në përputhje me rrethanat do të njoftojë Mekanizmin. Presidenti i Mekanizmit vendos për

uljen ose faljen e dënimit, duke u bazuar në interesat e drejtësisë dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës (neni 26).

Pa paragjykuar asnjë kusht të mëparshëm, të përcaktuar nga ofruesit e informatave dhe dokumenteve, ose të ndonjë marrëveshjeje me to, arkivat e TPNJ-së, TPNR-së dhe Mekanizmit mbeten pronë e Kombeve të Bashkuara. Këto arkiva janë të paprekshme kudo që ndodhen në pajtim me nenin 4 të Konventës për privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara të datës 13 shkurt të vitit 1946.

Mekanizmi është përgjegjës për menaxhimin, ruajtjen dhe aksesin e këtyre arkivave, të cilat do të jenë të bashkëvendosura në degët përkatëse të Mekanizmit.

Në lidhje me qasjen në këto arkiva, Mekanizmi do të sigurojë mbrojtje të vazhdueshme të informacioneve konfidenciale, duke përfshirë informacionet në lidhje me dëshmitarët e mbrojtur dhe informacionet e dhëna në bazë konfidenciale. Mekanizmi do të zbatojë një regjim të sigurisë për informacionet dhe qasjen në to, duke përfshirë edhe klasifikimin dhe deklasifikimin e arkivave sipas nevojës (neni 27).

Në lidhje me bashkëpunimin dhe ndihmën juridike, shtetet duhet të bashkëpunojnë me Mekanizmin për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të akuzuar, dhe pa vonesë duhet të përmbushin çdo kërkesë për ndihmë ose për urdhrin e lëshuar nga gjyqtari i vetëm ose nga trupi gjykues në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me personat e akuzuar, duke përfshirë:

- Identifikimin dhe lokalizimin e personave;
- Ofrimin e dokumenteve;
- Dorëzimin ose transferimin e të akuzuarve deri te Mekanizmi.

Gjithashtu, edhe mekanizmi do t'i përgjigjet kërkesës për ndihmë nga ana e autoriteteve nacionale në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e personave përgjegjës për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare në vendet e ish-Jugosllavisë dhe Ruandës, duke përfshirë edhe dhënien e ndihmës në ndjekjen e të arratisurve lidhur me rastet që u janë transferuar autoriteteve nacionale për gjykim nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe Mekanizmi (neni 28).

Harxhimet që do të bëhen gjatë funksionimit të Mekanizmit do të bien në barrë të OKB-së (neni 30).

Gjuhët zyrtare të Mekanizmit janë gjuha angleze dhe franceze (neni 31).

Lidhur me punën dhe progresin e Mekanizmit, presidenti i Mekanizmit duhet të paraqesë një raport vjetor deri te Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme, kurse për ecurinë e punës presidenti dhe prokurori duhet t'i paraqesin një raport gjashtëmuor Këshillit të Sigurimit (neni 32).⁵²

Mekanizmi u krijua si një organ për të siguruar vazhdimësinë e punës së dy Tribunalëve, TPNJ-së dhe TPNR-së. Ai do të kryejë një numër të funksioneve thelbësore të kryera më parë nga ana e TPNJ-ja dhe TPNR-ja. Për Mekanizmin arrestimi, transferimi dhe ndjekja penale e nëntë të aratisurve, të mbetur ende të kërkuar për gjykim nga ana e TPNR-së, përbën përparësinë më të madhe në punën e tij. Përveç këtyre funksioneve, Mekanizmi do të kryejë edhe funksione të tjera si: ndjekjen dhe hetimin e të ikurve të mbetur, procedura të apelit, rigjykime, gjykime për përbuzje të Tribunalit dhe dëshmitarit të rrejshëm, procedura për rishikim të aktgjyimit përfundimtar, mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve,

⁵² http://www.unmict.org/sites/default/files/documents/101222_sc_res1966_statute_en.pdf, Security Council, 22 December, 2010.

mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve, ndihmën juridiksioneve nacionale dhe ruajtjen dhe menaxhimin e MTPN-së, si dhe arkivave të TPNJ-së dhe TPNR-së.

“Duke krijuar Mekanizmin, Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka ndihmuar për të garantuar se mbyllja e dy gjykatave pionere *ad hoc*, hap rrugën që edhe një herë të mos mbretërojë mosndëshkimi” (President Theodor Moran, UN Security Council, 7 June 2012).

Dega e Mekanizmit për TPNJ-në, ka filluar të funksionojë nga 1 korriku i vitit 2013, mirëpo pavarësisht kësaj TPNJ-ja ende nuk i ka përfunduar të gjitha veprimtaritë. Sipas Raportit të bërë nga Presidenti i TPNJ-së, adresuar Këshillit të Sigurimit i datës 15 maj të vitit 2015, lidhur me kompletimin e strategjisë përmbyllëse të TPNJ-së si dhe ndërmarrjes së masave në drejtim të sigurimit të transformimit të TPNJ-së në degën e Mekanizmit.

Në raportin e lartpërmendur janë dhënë arsyet, pse dy raste janë ende në procedurë gjykimi dhe kur pritet që ato të përfundojnë.

Rasti i Goran Hadzic-it, nuk ishte përfunduar për arsye shëndetësore të të akuzuarit, i cili sipas raportit në fjalë priteshte të përfundojë deri në tetor të vitit 2016, mirëpo i njëjti u ndërpre për arsye se i akuzuari Goran Hadzic vdiq në 12 Korrik të v.2016.

Arsyeja e shtyrjes së rastit të Ratko Mladic-it ishte kërkesa e prokurorisë për rihapjen e rastit për të paraqitur dëshmi të cilat nuk kishin qenë të disponueshme më herët (dëshmia lidhur me zbulimin e një varreze masive në J. Tomasica, në komunën Prijedor të BH-së), i cili rast pritet të përfundojë në nëntor të vitit 2017.

Para Dhomës së Apelit për TPNJ-në, aktualisht është një rast i cili është në pritje të vendimit. Është rasti kundër Prliç-it dhe të tjerëve, i cili pritet të përmbyllet në nëntor të vitit 2017. Dhoma e Apelit të Tribunalit tani funksionon njëkohësisht me Dhomën e Apelit të Mekanizmit, ku para Dhomës së Apelit të Mekanizmit veçmë është duke u proceduar

rasti kundër Vojislav Sheshel-it, në bazë të ankesës së paraqitur nga prokurori kundër aktgjyqimit të TPNJ-së me të cilin Shesheli u lirua. Gjithashtu rasti i apelimit të aktgjyqimit të Radovan Karaxhiç-it me të cilin atij në 24 mars të vitit 2016 iu shqiptua dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 vitesh, si dhe apeli i rastit Mladic-it, në qoftë se ka ankesë do të procedohet nga Mekanizmi, në pajtim me përcaktimin e rezolutës 1966 (2010) të KS-së të OKB-së.

Gjithashtu, TPNJ-ja i ofron ndihmë Mekanizmit me qëllim të implementimit sa më të shpejtë dhe të suksesshëm të praktikave të fituara nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja, në rregullimin e brendshëm të Mekanizmit. Kjo ndihmë përfshin ndërmarrjen e më shumë aktiviteteve si mbështetje juridike duke përfshirë incizimet gjyqësore, shërbimet gjuhësore, shërbimet e paraburgimit dhe shërbimet për mbështetjen e dëshmitarëve. Të gjitha seksionet e sekretarisë janë të angazhuara në dhënien e ndihmës Mekanizmit, nëpërmjet shumë proceseve përfshirë rekrutimin, komunikimin, mbështetjen lidhur me teknologjinë e informacionit dhe menaxhimin e sekretarisë.

Dega e Mekanizmit për TPNR-në, me seli në Arusha, ka filluar të funksionojë nga 1 korriku i vitit 2012, dhe në bazë të raportit final të Presidentit të TPNR-së, dorëzuar deri te Këshilli i Sigurimit i OKB-së, i datës 15 nëntor të vitit 2015, TPNR-ja ka përfunduar punën e saj dhe në dhjetor të vitit 2015 TPNR-ja edhe zyrtarisht është mbyllur.

Sipas këtij raporti, Tribunali më 5 maj të vitit 2015 kishte përfunduar punën e tij në nivelin e gjyqimit për të 93 të akuzuarit nga Tribunali. Kjo përfshin 55 vendime të shkallës së parë, përfshirë 75 të akuzuar, 10 raste të referuara në juridiksionet kombëtare (prej të cilave 4 prej të akuzuarve janë të kapur dhe 6 janë të arratisur), 3 raste të të akuzuarve, që janë të arratisur janë transferuar në kompetencë të mekanizmit, raste të cilat paraqesin përparësi

për mekanizmin, 2 aktakuza janë tërhequr dhe 3 nga të akuzuarit kanë vdekur para se të gjykohen.

Procedurat e apelit lidhur me 55 persona të dënuar kanë përfunduar, dhe rasti i vetëm, i cili ndodhej në Apel, ishte rasti i Nyiramasuhuko et.al (Butane), i cili përfundoi më 14 dhjetor të v.2015.

Deri më sot, nëntë prej të akuzuarve, të akuzuar për pjesëmarrjen e tyre në gjenocid në Ruanda janë të lirë. Përgjegjësia për ndjekjen dhe gjykimin e këtyre të arratisurve i ka kaluar Mekanizmit dhe Republikës së Ruandës. Mekanizmi ndaj tre prej këtyre të akuzuarve ka juridiksion parësor, gjegjësisht rastet kundër Augustin Bizimana-s, Felicien Kabuga-s dhe Protais Mpiranya-s. Rastet e gjashtë të arratisurve të tjerë janë referuar që të gjykohen nga gjykatat e Ruandës, kurse Mekanizmi do të ndihmojë me përpjekjet për ndjekjen e tyre.

Tranzicioni i TPNR-së në Mekanizëm ka përfunduar dhe Tribunali është mbyllur më 31 dhjetor të vitit 2015.⁵³

TPNJ-ja dhe TPNR-ja kanë ndërmarrë dhe janë duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim të transferimit të plotë të të gjitha kompetencave dhe funksioneve të tyre dhe me qëllim që nëpërmjet implementimit të tyre në punën e Mekanizmit të sigurohet vazhdimi i suksesshëm i punës, funksioneve dhe përgjegjësi nga ana e Mekanizmit të trashëguara nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja.

Statuti i MTPN-së përmban të gjitha dispozitat formale-procedurale që parashiheshin edhe nga Statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së lidhur me zhvillimin e procedurës si në shkallë të

⁵³ www.unict.org/sites/unict, Letter dt. 15 May 2015 from the President of the ICTR addressed to the President of SC-UN.

parë, ashtu edhe para Dhomës së Apelit. MTPN-ja nuk ka të drejtë të ngrejë aktakuza të reja, përveç atyre që veçmë janë ngritur nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja. Por pavarësisht kësaj, MTPN-së sërish i ka mbetur një punë e madhe sepse për shumë të akuzuar, që nuk janë kapur ende, procedura nuk ka filluar fare, dhe do të jenë në barrë të Mekanizmit që të procedojë rastet e tilla. Sigurisht që në këtë drejtim një lehtësi e madhe për Mekanizmin është parashikimi i dispozitave me të cilat një trup i veçantë gjykues, në kuadër të Mekanizmit, do të jetë kompetent që rastet e caktuara t'i transferojë për gjykim në gjykatat nacionale. Transferimi i rasteve për gjykim në gjykatat nacionale paraqet njërën ndër përparësitë e Mekanizmit, gjë e cila ndoshta është qëllimi final edhe i vetë themelimit të këtyre dy Tribunaleve. Tribunalet u themeluan sepse sistemet nacionale, për arsye të problemeve dhe peripecive të ndryshme që mbretëronin në vendet postkonfliktuale, nuk ishin të afta të zhvillonin gjykime të tilla penale. Mirëpo pas një periudhe të gjatë të funksionimit të këtyre Tribunaleve dhe si rezultat i ndihmës dhe aftësimit permanent që këto Tribunale i kanë dhënë sistemeve juridike nacionale veçmë është fituar një shkallë e caktuar e besimit që edhe në gjykatat nacionale të vendeve të ish-Jugosllavisë dhe të Ruandës janë krijuar kushtet që të zhvillohen gjykime të natyrave të tilla, të cilat do të jenë fer dhe të paanshme. Gjithashtu, Mekanizmit gjatë punës së tij do t'i duhet të shqyrtojë edhe shumë raste që ende nuk kanë marrë epilogun përfundimtar, ku më shumë raste të tilla ka TPNJ-ja, dhe për të cilat në rast të apelimit të aktgjykimimeve, Mekanizmi është kompetent të veprojë si shkallë e dytë.

4.6. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare

Gjykata Penale Ndërkombëtare, e qeverisur nga Statuti i Romës, është gjykata e parë penale ndërkombëtare e përhershme e themeluar për të ndihmuar në dhënien fund të mosndëshkimit të autorëve të krimeve më të rënda që shqetësojnë komunitetin ndërkombëtar.

Gjykata Penale Ndërkombëtare është organizatë e pavarur ndërkombëtare, dhe nuk është pjesë e sistemit të Kombeve të Bashkuara. Selia e saj është në Hagë të Holandës. Komuniteti ndërkombëtar ka aspiruar gjatë për krijimin e një gjykate të përhershme, ku në shekullin XX, arriti konsensusin për përcaktimin e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krime lufte, ku në përcaktimin e nocioneve të tilla kontribuan edhe krijimi i gjykatave të Nurembergut dhe Tokios, gjykime të cilat u zhvilluan pas përfundimit të LDB-së.

Në vitet nëntëdhjetë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, u krijuan Tribunalet Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën si rezultat i arritjes së konsensusit se pandëshkueshmëria është e papranueshme. Mirëpo duke pasur parasysh faktin se këto Tribunale janë krijuar për të gjykuar krimet e kryera vetëm brenda një afati të caktuar dhe gjatë një konflikti të veçantë, me çka ishte krijuar një bindje e përgjithshme bazuar edhe në suazat ndërkombëtare se krijimi i një gjykate me karakter të përhershëm ishte një nevojë e patjetërsueshme. Më 17 korrik të vitit 1998, komuniteti ndërkombëtar ka arritur një moment historik kur 120 shtete miratuan Statutin e Romës, bazën ligjore për themelimin e Gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare.⁵⁴

⁵⁴ www.icc-cpi.int/en_menus/icc/about , About the Court.

Me Statutin e Romës themelohet Gjykata Penale Ndërkombëtare, si një institucion i përhershëm i cili ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze, që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, dhe kjo gjykatë është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare (neni 1).

Sipas Statutit GJPN-ja ka status ligjor ndërkombëtar dhe ka zotësi ligjore për ushtrimin e funksioneve dhe për përmbushjen e qëllimeve të saj. Funksionet dhe kompetencat e saj GJPN-ja mund t'i ushtrojë në territorin e çdo shteti palë, por edhe në territorin e çdo shteti tjetër me anë të një marrëveshjeje të veçantë (neni 4).

Në pjesën e dytë të Statutit të Romës, rregullohen çështjet e juridiksionit, pranueshmërisë dhe ligjit të zbatueshëm. Për sa i përket krimeve, që janë në juridiksionin të GJPN-së, parashihet se juridiksioni i Gjykatës kufizohet në krimet në serioze, që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi, dhe në pajtim me Statutin gjykata ka juridiksion për këto krime:

- Krimin e gjenocidit;
- Krimet kundër njerëzimit;
- Krimet e luftës;
- Krimin e agresionit.

Lidhur me ushtrimin e juridiksionit mbi krimin e agresionit, në momentin e miratimit të Statutit të Romës parashihej se në pajtim me dispozitat e këtij Statuti do të miratohet një dispozitë ku do të përkufizohet krimi i agresionit dhe do të përcaktohen kushtet në të cilat GJPN-ja ushtron juridiksionin mbi këtë krim (neni 5).

Në konferencën e mbajtur për rishqyrtimin e Statutit të Romës, të mbajtur në Kampala të Ugandës nga 31 maji deri më 11 qershor të vitit 2010, u miratuan amandamentet e Statutit

të Romës të cilat përfshijnë përkufizimin e krimit të agresionit si dhe regjimin që përcakton se si gjykata do të ushtrojë juridiksionin e saj mbi këtë krim. Gjithashtu, në këtë konferencë u parapa që gjykata nuk mund të ushtrojë juridiksionin e saj mbi këtë krim deri në 1 janar të vitit 2017, ku shtetet palë do të duhet të marrin një vendim me të cilin do të aktivizohet juridiksioni mbi këtë krim.⁵⁵

Lidhur me juridiksionin *ratione temporis* është parashikuar se gjykata ka juridiksion vetëm për krimet e kryera pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti. Kur një shtet bëhet palë e këtij Statuti pas hyrjes së tij në fuqi, gjykata do të ushtrojë juridiksion vetëm për krimet që janë kryer pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti në atë shtet, përveçse në rastet kur shteti ka bërë një deklaratë te sekretari me të cilën pranon juridiksionin e gjykatës edhe para se të jetë palë e këtij Statuti (neni 11).

Gjykata e ushtron juridiksionin e saj në shtetet palë, të cilat në momentin kur bëhen pjesë e Statutit të Romës pranojnë juridiksionin e saj, si dhe në shtetet të cilat nuk janë palë të Statutit, por që në bazë të një deklarate dorëzuar sekretarit, pranojnë juridiksionin e gjykatës lidhur me një krim të kryer në territorin e tyre. Juridiksioni ushtrohet në ato shtete në territorin e të cilave ka ndodhur rasti që paraqet krim sipas dispozitave të Statutit të Romës dhe ky krim është nën juridiksionin e GJPN-së; krimi ka ndodhur në anije ose në aeroplanin e shtetit ku është regjistruar anija ose një aeroplan i tillë dhe në shtetin, shtetas i të cilit është personi i akuzuar për krim (neni 12). Zyra e Prokurorit kryen një ekzaminim paraprak të të gjitha komunikimeve dhe situatave, që vijnë në vëmendjen e saj, në bazë të kriterëve ligjore dhe informatave në dispozicion.

⁵⁵ <http://www.iccnw.org/?mod=aggression>, shikuar me dt. 07 maj, 2016 ora 12.13.

Prokurori përveçse shqyrton juridiksionin (e përkohshëm, territorial, personal, dhe material) gjithashtu, duhet të shqyrtojë dhe lejueshmërinë që përfshin plotësueshmërinë dhe rëndësinë e një rasti si dhe interesat e drejtësisë.

Lejueshmëria përbëhet nga plotësueshmëria dhe rëndësia e një rasti.

Plotësueshmëria përfshin shqyrtimin e ekzistimit të procedurës së nevojshme në suaza kombëtare në lidhje me rastet e mundshme të konsideruara për hetim nga ana e Zyrës së Prokurorit. Kjo do të bëhet duke pasur parasysh strategjinë lidhur me hetimin dhe ndjekjen e atyre që janë përgjegjës për krimet më të rënda. Kur hetimi dhe ndjekja e rastit ekziston në vendet përkatëse, Zyra do të vlerësojë vërtetësinë e tyre.

Rëndësia përfshin një vlerësim të shkallës, të natyrës, dhe mënyrën e kryerjes së krimeve, si dhe ndikimin e tyre që në rastet e mundshme mund të lindin nga një hetim i një situate.

Kurse kushti "interesat e drejtësisë" është një konsideratë kundërbalancuese, ku prokurori duhet të vlerësojë nëse, duke marrë parasysh peshën e krimit dhe interesat e viktimave, ka ende arsye të konsiderueshme për të besuar se një hetim nuk do t'i shërbejë interesave të drejtësisë.

Gjykata ushtron juridiksionin e vet në lidhje me krimet që parashihen me këtë Statut, në rastet kur:

- Paraqitet rasti kur një ose më tepër nga krimet e kryera të kësaj natyre i paraqiten Prokurorit nga ana e shtetit;
- Paraqitet rasti kur një ose më tepër nga krimet e kryera të kësaj natyre i paraqiten Prokurorit nga Këshilli i Sigurimit;
- Kur vetë prokurori ka iniciuar hetimet lidhur me një krim të tillë (neni 13).

Shtetet palë kanë të drejtë të paraqesin rastin për një ose më shumë krime të kryera brenda juridiksionit të Gjykatës, duke kërkuar nga prokurori që një rast të tillë ta hetojë dhe të hetohet se cilët persona të veçantë mund të akuzohen për kryerjen e këtyre krimeve. Paraqitja e rastit duhet të specifikojë sa të jetë e mundur rrethanat përkatëse të rastit dhe të shoqërohet me dokumentacionin tjetër shtesë, i cili disponohet nga shteti që e ka paraqitur rastin (neni 14).

Prokurori mund të nisë hetimin *proprio motu*, në bazë të informacioneve mbi krimet nën juridiksionin e gjykatës. Prokurori analizon rëndësinë e informacioneve të pranura dhe mund të kërkojë edhe informacione shtesë nga shtetet, organet e Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërqeveritare ose qeveritare ose nga burime të tjera plotësuese, të cilat i konsideron të përshtatshme si dhe mund të pranojë dëshmi të shkruara ose gojore në selinë e gjykatës.

Nëse në bazë të informacioneve të tilla, prokurori konstaton se ka bazë të arsyeshme për të vazhduar hetimin, duhet të paraqesë kërkesë në Dhomën e Procedurës Paraprake e cila është kompetente për shqyrtimin e vërejtjeve para fillimit të seancës gjyqësore, që të marrë autorizim për të filluar hetimin, së bashku me të gjitha materialet e tjera të mbledhura. Viktimat mund të paraqesin parashtesat e tyre në Dhomën e Procedurës Paraprake në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake, me rastin e shqyrtimit të kërkesës dhe materialeve të tjera shtesë, konstaton se ekzistojnë baza të arsyeshme për të vazhduar me procedurën e hetimit dhe rasti duhet të trajtohet nën juridiksionin e gjykatës, autorizon fillimin e procedurës hetimore pa marrë parasysh vendimet e mëvonshme të gjykatës, lidhur me juridiksionin dhe pranueshmërinë e rastit.

Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake e refuzon dhënien e autorizimit për procedurën hetimore, kjo nuk e pengon prokurorin që të parashtojë ndonjë kërkesë të mëvonshme, duke u bazuar në fakte dhe dëshmi të reja që kanë të bëjnë me rast të njëjtë.

Nëse pas zhvillimit të hetimit paraprak, prokurori nxjerr përfundimin se informacioni i siguruar nuk siguron bazë të arsyeshme për procedurën hetimore, atëherë prokurori informon ata që kanë dhënë informacionin, dhe kjo gjë nuk e ndalon prokurorin që të shqyrtojë informacione të tjera që i dorëzohen atij në lidhje me rastin e njëjtë nën dritën e fakteve dhe provave të reja (neni 15).

Shtyrja e hetimit ose e ndjekjes penale mund të bëhet me kërkesë të Këshillit të Sigurimit në pajtim me kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ku asnjë hetim ose procedurë gjyqësore nuk mund të fillohet ose të zhvillohet për një periudhë prej 12 muajsh, dhe një kërkesë e tillë mund të bëhet përsëri nga Këshilli i Sigurimit në kushte të njëjta (neni 16).

Lidhur me çështjen se një rast bie ose jo nën juridiksionin e gjykatës, gjykata vendos për një pranueshmërinë të tillë nëse:

- Çështja është hetuar ose ndjekur nga shteti, i cili ka juridiksion mbi të, përveç kur shteti nuk dëshiron ose nuk është realisht në gjendje të kryejë hetimin dhe ndjekjen;
- Çështja është hetuar ose është ndjekur nga shteti, i cili ka juridiksion mbi të, dhe shteti ka vendosur të mos bëjë ndjekjen e personit në fjalë, përveç kur vendimi ka rezultuar nga mosdëshira ose pamundësia e shtetit për të kryer ndjekjen;
- Personi në fjalë është gjykuar për sjelljen që është objekt i ankesës, dhe gjykimi nga ana e gjykatës nuk lejohet;

- Çështja nuk ka rëndësi të tillë që të justifikojë veprimet e mëtejshme të gjykatës, në mënyrë që të konstatojë mungesën e vullnetit në një rast konkret; gjykata e shqyrton atë duke pasur parasysh parimet e procesit të rregullt, të njohur nga e drejta ndërkombëtare, nëse një ose më shumë nga këto veprime janë zbatuar gjatë zhvillimit të procedurës para gjykatës nacionale;
- Gjykimi është zhvilluar ose është duke u zhvilluar, ose vendimi nga gjykata kombëtare është marrë me qëllim të mbrojtjes së personit nga përgjegjësia penale për krimet nën juridiksionin e gjykatës;
- Ka pasur zvarritje të paarsyeshme të gjykimit, rrethana që janë në mospajtim me qëllimin e vendosjes së personit para drejtësisë;
- Gjykimi nuk është zhvilluar ose nuk është duke u zhvilluar në mënyrë të pavarur ose të paanshme, rrethana të cilat nuk janë në pajtim me qëllimin e vendosjes së personit para drejtësisë;

Në mënyrë që të përcaktohet paaftësia për një rast konkret, gjykata shqyrton nëse shteti për shkak të kolapsit të përgjithshëm ose të konsiderueshëm ose për pamundësinë e sistemit të tij gjyqësor, nuk është në gjendje të gjejë të akuzuarin, ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk ka mundësi që të zhvillojë gjykimin ndaj tij (neni 17).

Kur një rast i është paraqitur gjykatës dhe prokurori ka filluar hetimet për arsye të ekzistimit të bazave të arsyeshme, prokurori duhet t'i njoftojë shtetet palë dhe ato shtete që kanë juridiksion për krime të tilla. Prokurori mund t'i njoftojë këto shtete dhe të kufizojë gamën e informacioneve që ju jepen shteteve, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të mbrojtur personat, për të parandaluar shkatërrimin e dëshmive ose për të parandaluar fshehjen e personave.

Brenda një muaji nga marrja e një njoftimi të tillë, shtetet mund të informojnë gjykatën se lidhur me krimet që janë objekt i njoftimit, shteti ka zhvilluar ose është duke zhvilluar hetimet ndaj personave të caktuar dhe me kërkesën e shtetit të tillë, prokurori pezullon hetimin shtetëror të atyre personave, përveç në rastet kur Dhoma e Procedurës Paraprake me kërkesë të prokurorit, vendos të autorizojë hetimin. Pezullimi i hetimeve nga prokurori, është i hapur për shqyrtim nga prokurori 6 muaj pas datës së pezullimit ose në çdo kohë kur ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm i rrethanave për shkak të mosdëshirës së shtetit ose pamundësisë së tij që të kryejë hetimin.

Kundër vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake, shteti ose prokurori mund të bëjë ankesë dhe këtë ankesë Dhoma e Procedurës Paraprake duhet ta shqyrtojë në mënyrë urgjente.

Kur prokurori e ka pezulluar hetimin, prokurori mund të kërkojë nga shteti përkatës, që në mënyrë periodike, ta informojë atë në lidhje me përparimet e hetimeve dhe ndjekjes, ndërsa shteti kërkesave të tilla duhet t'u përgjigjet pa vonesë të panevojshme.

Kur prokurori e ka pezulluar hetimin dhe është në pritje të vendimit nga Dhoma e Procedurës Paraprake mund të kërkojë autorizim nga Dhoma e Procedurës Paraprake, me qëllim që të ndërmarrë masat e domosdoshme hetimore për ruajtjen e dëshmive, në rast se ekziston mundësia unike për të siguruar dëshmi të rëndësishme ose nëse ekziston rreziku i madh që dëshmi të tilla nuk mund të sigurohen më vonë.

Shteti që ka kundërshtuar vendimin e Dhomës së Procedurës Paraprake, mund të kundërshtojë edhe lejueshmërinë e rastit, bazuar në fakte të rëndësishme ose në ndryshimin thelbësor të rrethanave (neni 18).

Kundërshtimet e lejueshmërisë së çështjes ose kundërshtimet e juridiksionit të gjykatës, mund të bëhen nga:

- I akuzuari ose personi për të cilin është lëshuar urdhërarresti ose thirrja për t'u paraqitur;
- Shteti, i cili ka juridiksion mbi çështjen, bazuar mbi faktin se ka filluar hetimin ose ndjekjen penale të çështjes, ose ka hetuar ose ndjekur çështjen më parë;
- Shteti prej të cilit kërkohet pranimi i juridiksionit në bazë të dispozitave të këtij Statuti.

Shtetet, prokurori dhe viktimat mund të paraqesin kundërshtimet e tyre para gjykatës në lidhje me juridiksionin ose pranueshmërinë, e cila mund të bëhet vetëm një herë para fillimit të gjykimit, dhe vetëm në raste të veçanta gjykata mund të lejojë që ky kundërshtim të paraqitet më shumë se një herë.

Para konfirmimit të padive, kundërshtimet lidhur me juridiksionin dhe pranueshmërinë i drejtohen Dhomës së Procedurës Paraprake, kurse pas konfirmimit të padisë, ato i drejtohen Dhomës së Gjykimit. Kundër vendimeve në lidhje me juridiksionin ose pranueshmërinë mund të bëhet ankim në Dhomën e Apelit.

Nëse kundërshtimi është bërë nga shteti, shtetas i të cilit është i akuzuari, ose nga shteti i cili ka filluar hetimin ose ndjekjen për atë çështje, ose hetimin apo ndjekjen e çështjes e ka bërë më parë, atëherë prokurori e pezullon hetimin derisa gjykata të marrë vendimin.

Në pritje të vendimit nga gjykata, prokurori mundet që nga gjykata të kërkojë autorizim që të ndërmarrë disa masa të nevojshme hetimore të cilat nuk lejojnë shtyrjen, të marrë një deklaratë ose një deponim nga një dëshmitar, ose të përfundojë mbledhjen dhe

ekzaminimin e provave që ka filluar para se të bëhej kundërshtimi dhe në bashkëpunim me shtetet të parandalojë zhdukjen e personave për të cilët prokurori ka kërkuar urdhërarrest.

Paraqitja e kundërshtimit nuk cenon vlefshmërinë e asnjë veprimi të kryer nga prokurori, apo të ndonjë mendimi ose urdhri të nxjerrë nga Gjykata para se të bëhej kundërshtimi.

Nëse gjykata një çështje e ka vendosur si të papranueshme, prokurori mund të bëjë kërkesë për rishikimin e vendimit të tillë, në rastet kur është i bindur se janë paraqitur fakte të reja të cilat mohojnë bazën mbi të cilën çështja është konsideruar si e papranueshme.

Kur prokurori pezullon ndjekjen a hetimin sepse rasti është proceduar më herët nga shteti, mundet të kërkojë nga shteti përkatës që t'i paraqesë informacione mbi çështjen në gjykim, informacion që duhet të jepet, por me kërkesë të shtetit një informacion i tillë mbetet konfidencial. Nëse edhe më pas prokurori vendos vazhdimin e hetimit, për këtë duhet të njoftojë shtetin për të cilin ishte bërë pezullimi i gjykimit (neni 19).

Juridiksioni është pikënisja e parë me të cilën përcaktohet se një gjykatë mund të ndërmarrë veprime të caktuara ose jo. Çdo gjykatë duhet, që në bazë të detyrës zyrtare, të kujdeset për juridiksionin e saj, për ç'arsye edhe Statuti i Romës përmban dispozita në të cilat në mënyrë të detajuar rregullohet çështja e juridiksionit të GJPN-së në raport me gjykatat kombëtare. Faktin se GJPN-ja ka juridiksion komplementar çështja e juridiksionit në situata të caktuara mund të ndërlikohet dhe të vijë deri te konflikti i juridiksioneve në mes gjykatave kombëtare dhe GJPN-së, prandaj rregullimi i detajuar i kësaj çështjeje mundëson shmangien e situatave të tilla dhe shmangien nga konflikti i juridiksionit të GJPN-së dhe juridiksioneve të gjykatave.

Parimi *non bis in idem* si parim shumë i rëndësishëm procedural, parashihet edhe në Statutin e Romës për GJPN-në ku parashihet se asnjë person, i cili nga një gjykatë është

shpallur fajtor ose është dënuar, nuk mundet që sërish të gjykohet edhe nga GJPN-ja, me përjashtim të dy rasteve:

- Kur gjykimi në gjykatën tjetër ishte me qëllim të mbrojtjes së personit përkatës nga përgjegjësia penale për krimet në juridiksionin e gjykatës dhe
- Kur gjykimi në gjykatën tjetër nuk është kryer në mënyrë të pavarur ose të paanshme në pajtim me normat procedurale të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe është kryer në mënyrë të tillë që në bazë të rrethanave nuk i shërbente qëllimit të vendosjes së personit para drejtësisë (neni 20).

Me Statut numërohen edhe aktet dhe dispozitat ligjore në bazë të të cilave funksionon GJPN-ja:

- Statuti, Elementet e Krimeve dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave;
- Traktatet e zbatueshme, parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë parimet e pranura të së drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;
- Parimet e përgjithshme të së drejtës që nxirren nga ligjet vendase të sistemeve ligjore të botës, ligjet vendase të gjykatave të cilat normalisht do të ushtronin juridiksionin mbi krimin me kusht që këto parime të mos jenë në kundërshtim me këtë Statut dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe me normat dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht;
- Gjykata mund të zbatojë parimet dhe rregullat ligjore të interpretuara më parë në vendimet e saj.

Zbatimi dhe interpretimi i ligjit, duhet të jetë në pajtim me të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht dhe pa asnjë dallim të bazuar në gjini, moshë, racë, ngjyrë, origjinë kombëtare, etnike ose sociale, pasuri, bindje ose ndonjë status tjetër (neni 21).

Parimet e përgjithshme të ligjit penal, mbrojnë individët nga hetimi, ndjekja, gjykimi dhe dënimi, në mënyrë arbitrare nga ana e organeve shtetërore.

Parimet *nullum crime sine lege*, *nulla poena sine lege*, si parime shumë të rëndësishme të së drejtës penale, janë parime të cilat parashihen edhe në Statutin e Romës për GJPN-në, ku parashihet se:

- Asnjë person nuk përgjigjet penalisht për një vepër e cila para se të kryhet nuk është paraparë si krim me këtë Statut;
- Përkufizimi i krimit duhet të sqarohet qartë dhe nuk duhet të jetë i zgjeruar, për analogji dhe në rast të dykuptimësisë, përkufizimi duhet të interpretohet në dobi të personit që merret në pyetje, që ndiqet ose dënohet;
- Personi i fajësuar nga gjykata mund të ndëshkohet vetëm në pajtim me këtë Statut (neni 22 dhe 23).

Ndalimi i veprimit retroaktiv të ligjit penal, ku parashihet se asnjë person nuk është përgjegjës për sjelljen para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, dhe në rast të ndryshimeve në ligjin e zbatueshëm për një çështje të caktuar para vendimit përfundimtar, zbatohet ligji më i favorshëm për personin që merret në pyetje, që ndiqet penalisht ose që dënohet (neni 24).

Në këtë Statut shprehimisht janë rregulluar disa çështje të diskutueshme dhe për të cilat janë atakuar shpesh Tribunalet e mëparshme si parimi *non bis in idem*, parimi *nullum crimen sine lege scripta*, *nullum poena sine lege scripta*, ku në këtë Statut në mënyrë të prerë numërohen aktet dhe dispozitat ligjore në bazë të të cilave funksionon GJPN-ja,

ndalimi i veprimit retroaktiv të ligjit penal etj., me qëllim shmangien e kritikave të tilla me të cilat janë përballur Tribunalet e mëparshme.

Në këtë Statut parashihet kategoria e personave, të cilët në qoftë se i kryejnë krimet nën juridiksionin e GJPN-së, kanë përgjegjësi penale individuale, nëse:

- Një person kryen një krim, personalisht bashkë me ndonjë person tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, pavarësisht nëse personi tjetër përgjigjet penalisht ose jo;
- Urdhëron, kërkon ose nxit në kryerjen e një krimi të tillë, i cili kryhet ose mbetet në tentativë;
- Me qëllim mundësimin e kryerjes së krimit; ndihmon, përkrah ose asiston në kryerje ose tentim, përfshirë këtu edhe ofrimin e mjeteve për kryerjen e krimit;
- Në çfarëdo mënyre kontribuon në kryerjen ose tentimin e kryerjes së një krimi të tillë. Një kontribut i tillë duhet të jetë i qëllimshëm prandaj duhet të :
- Bëhet me qëllim të zhvillimit të aktivitetit ose qëllimit kriminal të grupit, kur një aktivitet ose qëllim i tillë përfshin kryerjen e krimit brenda juridiksionit të gjykatës;
- Bëhet një veprim edhe pse dihet se ai veprim ndërmerret nga grupi me qëllim të kryerjes së krimit;
- Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose publikisht, shtyn të tjerët që të kryejnë gjenocid;
- Tenton të kryejë një krim nëpërmjet ndërmarrjes së një veprimi, që inicion kryerjen e tij, ose ndërmerr një hap thelbësor, por megjithatë krimi nuk ndodh për shkak të rrethanave që nuk varen nga qëllimet e personit. Në rastet kur personi, që tërhiqet nga përpjekja për ta kryer krimin, por me ndonjë mënyrë tjetër e parandalon përfundimin e krimit, sipas këtij Statuti për tentim të kryerjes së krimit, nëse personi

ka hequr dorë plotësisht nga kryerja e krimit dhe në mënyrë vullnetare nga qëllimi kriminal, nuk i nënshtrohet dënimit.

Dispozitat e këtij Statuti, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale individuale, nuk ndikojnë në përgjegjësinë e shteteve sipas së drejtës ndërkombëtare (neni 25).

Edhe në këtë Statut, ngjashëm me Statutet e Tribunaleve të Hagës dhe të Ruandës, është paraparë vetëm përgjegjësia penale individuale e personave të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kryejnë veprime të inkriminuara, të përcaktuara në Statut si krime ndërkombëtare, me çka mundësia që personat të përgjigjen për pjesëmarrje në ndonjë grup ose në ndonjë organizatë, ashtu si parashihej në Statutin e Tribunalit të Nurembergut, është flakur njëherë e përgjithmonë nga praktika lidhur me përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

Për sa i përket limitit të moshës së personave që bien nën juridiksionin e gjykatës, parashihet se personat nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare nuk bien nën juridiksionin e gjykatës.

Pozita zyrtare si kryetar i shtetit ose i qeverisë, anëtar i qeverisë ose i parlamentit, përfaqësues i zgjedhur i qeverisë ose zyrtar i qeverisë, në asnjë rast nuk është bazë për përjashtimin nga përgjegjësia penale dhe nuk përbën shkak për zvogëlimin e dënimit.

Imuniteti dhe rregullat e veçanta procedurale, që lidhen me pozitën zyrtare të personit, sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare, nuk e pengojnë gjykatën në ushtrimin e juridiksionit të saj mbi një person të tillë (neni 27).

Ngjashëm me udhëheqësit shtetërorë, edhe komandantët dhe drejtuesit e tjerë të forcave të armatosura janë përgjegjës për veprimet e kryera që, sipas këtij Statuti, juridiksion ka GJPN-ja. Komandantët dhe udhëheqësit e tjerë ushtarakë përgjigjen penalisht për veprimet

e kryera nga vartësit e tyre, për të cilat kanë pasur njohuri ose sipas rrethanave të rastit duhej të kishin njohuri, komandanti ka dështuar në punën e tij dhe nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar kryerjen e krimeve dhe është përgjegjës për veprimet e kryera prej vartësve të tij, të cilët kanë vepruar me autorizimin dhe kontrollin e tij efektiv për të ushtruar kontroll efektiv mbi vartësit e tij, kur komandanti ose drejtuesi e ka ditur dhe në mënyrë të vetëdijshme nuk ka përfillur informacionin për kryerjen e krimeve nga vartësit e tij dhe krimet kanë të bëjnë me veprat që janë brenda përgjegjësisë së komandantit ose drejtuesit (neni 28).

Në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të personave, rëndësi ka edhe elementi mendor. Konsiderohet se ekziston vetëdija e personit për kryerjen e krimit kur një person me vetëdije ndërmerr një sjellje të caktuar duke i ditur pasojat ose duke qenë i vetëdijshëm se në bazë të rrjedhës së rregullt të ngjarjeve, do të shkaktohet një pasojë e tillë (neni 30).

Pavarësisht ekzistimit të kushteve, rrethanave dhe shkaqeve për ekzistimin dhe konstatimin e përgjegjësisë penale të një personi, ekzistojnë edhe shkaqe të cilat nëse vërtetohen se ekzistojnë, përjashtojnë përgjegjësinë penale të një personi, të tilla si:

- Personi vuan nga një sëmundje mendore ose nga një mangësi, që shkatërron aftësinë e këtij personi për të vlerësuar paligjshmërinë ose natyrën e sjelljes së tij, për të kontrolluar sjelljen e tij ose për të qenë në pajtim me kërkesat e ligjit;
- Personi është në gjendje helmimi që shkatërron aftësinë e atij personi për të vlerësuar paligjshmërinë ose natyrën e sjelljes së tij për të kontrolluar sjelljen e tij ose për të qenë në pajtim me kërkesat ligjore, përveç nëse personi është helmuar në mënyrë vullnetare, në rrethana të cilat personi i ka ditur, ose ka nënçmuar rrezikun

që si rezultat i helmimit ai ka kryer sjelljen, e cila sipas këtij Statuti konsiderohet si krim;

- Personi vepron me qëllim mbrojtjen e vetes ose të personit tjetër, ose në rastin e krimeve të luftës, mbron pronën që është thelbësore për ekzistencën e tij ose të personit tjetër, ose pronën që është thelbësore për plotësimin e misionit ushtarak, kundër përdorimit të pashmangshëm dhe të paligjshëm të forcës, më mënyrë proporcionale me shkallën e rrezikut që i kanoset atij apo ndonjë personi tjetër ose pronën që mbrohet. Fakti që personi ka qenë i përfshirë në operacionin mbrojtës, të zhvilluar nga personat nuk përbën shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale;
- Sjellja që paraqet krim brenda juridiksionit të gjykatës, është shkaktuar me detyrim, nga kërcënimi i pashmangshëm me vdekje, dëmtimi i vazhdueshëm ose i menjëhershëm dhe serioz trupor kundër atij ose personit tjetër dhe personi ka vepruar domosdoshmërisht dhe në mënyrë të arsyeshme për të shmangur këtë kërcënim, me ç'rast personi nuk ka pasur për qëllim të shkaktojë dëm më të madh se atë që ka dashur ta shmangë. Një kërcënim i tillë mund të jetë bërë nga persona të tjerë ose mund të jetë krijuar nga rrethana të tjera që janë jashtë kontrollit të atij personi. Në lidhje me përjashtimin ose jo të një personi nga përgjegjësia penale, këtë e përcakton gjykata, ku përveç shkaqeve të lartpërmendura gjykata mund të marrë në shqyrtim edhe shkaqe të tjera duke u bazuar gjithmonë në ligjin e zbatueshëm sipas këtij Statuti dhe në Rregullat e Procedurës dhe Provave (neni 31).

Gjithashtu, shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale është edhe gabimi në fakt ose gabimi në ligj, gabime që kanë të bëjnë me ekzistimin ose jo të elementit mendor të krimit (neni 32).

Bazë për përjashtimin nga përgjegjësia penale mund të jetë edhe fakti që një person në kryerjen e krimeve ka vepruar në bazë të urdhrave të qeverisë ose drejtuesit civil ose ushtarak, por jo gjithmonë dhe vetëm në raste të parashikuara në Statut si përjashtime, të tilla si:

- Personi ka qenë nën detyrimin ligjor të veprojë në bazë të urdhrave të qeverisë ose drejtuesit;
- Urdhri nuk ka qenë haptazi i paligjshëm, ndërsa urdhrat në çfarëdo rasti, situate ose rrethane, për të kryer gjenocid ose krime kundër njerëzimit janë dukshëm të paligjshme (neni 33).

Lidhur me përbërjen e GJNP-së, në Statut parashihet se GJPN-ja përbëhet nga katër organe kryesore:

- Kryesia
- Divizioni për Ankesa, Divizioni për gjykime dhe Divizioni për Procedurën Paraprake;
- Zyra e prokurorit;
- Sekretaria.

GJPN-ja ka 18 gjyqtarë, të cilët zgjidhen si anëtarë me orar të plotë dhe janë të disponueshëm të kryejnë detyrën në atë bazë që nga fillimi i afatit të shërbimit të tyre.

Kryesia përbëhet prej Kryetarit dhe dy nënkryetarëve, të cilët zgjidhen me votat e shumicës absolute të gjyqtarëve. Secili prej tyre shërben për një afat kohor prej tre vjetësh ose deri në përfundimin e mandatit të tyre për gjyqtarë, cilito afat që përfundon më parë. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen vetëm një herë.

Nënkryetari i parë vepron në vend të Kryetarit, në rast se kryetari nuk është në dispozicion ose është i shkualifikuar. Nënkryetari i dytë vepron në vend të Kryetarit nëse Kryetari dhe nënkryetari i parë nuk janë në dispozicion ose janë të shkualifikuar. Kryetari bashkë me nënkryetarin e parë dhe të dytë, janë përgjegjës për:

- Administrimin e duhur të gjykatës;
- Funksionet e tjera që i ka në bazë të këtij Statuti (neni 38).

Gjykata është e organizuar në Divizione si: Divizioni i Ankesave i cili përbëhet nga kryetari dhe katër gjyqtarë të tjerë, Divizioni i Gjykimeve i cili përbëhet nga jo më pak se gjashtë gjyqtarë dhe Divizioni i Procedurës Paraprake i cili përbëhet nga më pak se gjashtë gjyqtarë (neni 39).

Zyra e prokurorit është organ i ndarë prej gjykatës dhe vepron në mënyrë të pavarur. Ajo nuk është përgjegjëse për pranimin e rekomandimeve dhe për çfarëdo informacion të vërtetuar mbi krimet brenda juridiksionit të Gjykatës, për shqyrtimin e tyre dhe për kryerjen e hetimeve dhe ndjekjeve para gjykatës, ndërsa anëtari i zyrës nuk kërkon ose nuk vepron sipas instruksioneve nga cilido burim i jashtëm.

Prokurori udhëheq zyrën dhe ka autoritet të plotë në drejtimin dhe administrimin e zyrës, përfshirë këtu personelin, mjetet dhe burimet e tjera. Prokurori ndihmohet një ose më shumë zëvendësprokurorë, të cilët janë të autorizuar të kryejnë cilindo veprim të prokurorit. Prokurori duhet të caktojë këshilltarë me përvojë ligjore në çështjet specifike, përfshirë këtu, dhunën seksuale dhe gjinore si dhe në dhunën ndaj fëmijëve (neni 43).

Sekretaria është përgjegjëse për aspektet jogjyqësore të administrimit dhe shërbimit në gjykatë.

Sekretaria drejtohet nga sekretari, i cili është zyrtari kryesor administrativ i gjykatës dhe funksionet e tij i ushtron nën autoritetin e kryetarit të gjykatës. Sekretari në kuadër të sekretarisë themelon Njësinë e Viktimave dhe Dëshmitarëve, Njësi e cila në këshillim me zyrën e prokurorit cakton masa mbrojtëse dhe marrëveshje sigurie, këshillime dhe ndihmë tjetër të përshtatshme për dëshmitarët, viktimat si dhe për të tjerët që janë në rrezik për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët. Njësia ka personel me përvojë në trauma, përfshirë këtu traumat në lidhje me krimet e dhunës seksuale (neni 43).

Prokurori dhe sekretari emërojnë personel me kualifikimin që duhen për nevojat e zyrave të tyre, ku në zyrën e prokurorit përfshihet edhe caktimi i hetuesve.

Rregullat e procedurës dhe të provave miratohen nga Asambleja e shteteve palë me shumicë prej dy të tretave, amandamentimi i të cilave mund të bëhet nga çdo shtet palë, gjyqtarët nëpërmjet një shumice absolute dhe nga prokurori. Kur Rregullat nuk ofrojnë zgjidhje për një situatë specifike, mund të përpilohen rregulla të përkohshme deri në miratimin, ndryshimin ose refuzimin e tyre në sesionin e ardhshëm të shteteve palë. Rregullat e procedurës dhe të provave si dhe rregullat e përkohshme nuk kanë fuqi prapavepruese në dëm të personave, dhe në rast të konfliktit midis Statutit dhe Rregullave të procedurës dhe provave, përparësi ka Statuti (neni 52).

Hetimin e fillon prokurori, pasi vlerëson informacionin për një çështje, përveç në rastet kur vlerëson se nuk ka baza për hetim. Para se të fillojë hetimi, prokurori merr parasysh nëse:

- Informacioni i ofruar prokurorit ofron shkaqe të arsyeshme për të besuar se krimi brenda juridiksionit të gjykatës është kryer ose është duke u kryer;
- Rasti mund të jetë i pranueshëm në bazë të këtij Statuti;

- Duke marrë parasysh peshën e krimit dhe interesat e viktimave, ekzistojnë arsye thelbësore për të besuar se hetimi nuk do t'u shërbente interesave të drejtësisë.

Nëse prokurori përcakton se nuk ka baza të arsyeshme për të vepruar si dhe në rastet kur pas hetimit nxjerr përfundimin se nuk ka baza të mjaftueshme për ndjekje penale, njofton Dhomën e Procedurës Paraprake dhe shtetin, si dhe arsyet për këtë përfundim. Dhoma e Procedurës Paraprake me kërkesë të shtetit, mund të kërkojë nga prokurori që këtë vendim ta shqyrtojë edhe një herë, si dhe një vendim i tillë mund të shqyrtohet edhe nga vetë Dhoma e Procedurës Paraprake.

Prokurori, në çdo kohë, mund të rishqyrtojë vendimin në lidhje me fillimin ose ndjekjen penale, bazuar në fakte ose në informacione të reja (neni 53).

Në lidhje me hetimet dhe ndjekjen penale prokurori ka disa përgjegjësi dhe kompetenca. Në mënyrë që të zbulojë të vërtetën, i zgjeron hetimet për të zbuluar të gjitha faktet dhe provat përkatëse, me qëllim për të vlerësuar nëse ekziston përgjegjësia penale, por dhe heton rrethanat inkriminuese dhe ato shfajësuese në mënyrë të barabartë, merr masat e duhura për të siguruar hetimin efektiv dhe ndjekjen e krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës, dhe duke bërë këtë respekton rrethanat personale të viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë moshën, gjininë, shëndetin, natyrën e krimit, sidomos kur përfshin dhunën seksuale, dhunën gjinore dhe dhunën ndaj fëmijëve, si dhe respekton të drejtat e personave që rrjedhin nga ky Statut.

Prokurori gjithashtu mund të zhvillojë hetime në territorin e një shteti me autorizim të Dhomës së procedurës paraprake dhe në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Prokurori gjithashtu mundet:

- Të mbledhë dhe të ekzaminojë provat;

- Të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të personave që janë në hetim, të viktimave dhe dëshmitarëve;
- Të kërkojë bashkëpunimin e çdo shteti ose organizate ndërqeveritare;
- Të bëjë marrëveshje në pajtim me këtë Statut për nevojën e bashkëpunimit me shtetet, organizatat ndërqeveritare dhe personat;
- Të pajtohet që të mos zbulojë, në cilëndo fazë të procedurës, dokumentet ose informacionin të cilin e siguron në kushte besueshmërie dhe me qëllim të gjetjes së provave të reja, kur ofruesi i informatës nuk e jep pëlqimin dhe
- Të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme ose të kërkojë të merren të gjitha masat e domosdoshme, për të siguruar besueshmërinë e informacionit, mbajtjen e personit dhe ruajtjen e provave (neni 54).

Personi që merret në pyetje ose që hetohet i garantohen disa të drejta themelore:

- Nuk i nënshtrohet asnjë forme detyrimi, shtrëngimi, kërcënimi, torture, ose çfarëdo forme të trajtimit ose dënimit të vrazhdë ç'njerëzor ose degradues;
- Kur merret në pyetje në një gjuhë të cilën nuk e flet ose nuk e kupton personi që merret në pyetje, ka të drejtën për ndihmën e përkthyesit pa pagesë;
- Nuk i nënshtrohet arrestimit ose ndalimit arbitrar dhe nuk do të privohet nga liria përveç në rastet kur është parashikuar në këtë Statut.

Kur ekzistojnë shkaqe për të besuar se personi ka kryer krim brenda juridiksionit të Gjykatës dhe kur ai person merret në pyetje nga prokurori, personi i tillë paraprakisht duhet të informohet për arsyet pse merret në pyetje:

- Të jetë i informuar, para se të merret në pyetje, se ekzistojnë shkaqe për të besuar se personi ka kryer krim brenda juridiksionit të gjykatës;

- Të heshtë, dhe kjo heshtje të mos merret në konsideratë për përcaktimin e fajit ose pafajësisë;
- Të ketë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së vet, ose t'i caktohet ndihmë juridike pa pagesë në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë;
- Të merret në pyetje në praninë e avokatit, përveç në rastet kur personi ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta për avokat (neni 55).

Kur prokurori mendon që hetimi paraqet mundësinë e vetme për të marrë dëshminë ose deklaratën nga dëshmitari ose për të ekzaminuar, mbledhur e testuar provat, të cilat më vonë mund të mos jenë në dispozicion për qëllimet e gjyqit, prokurori informon Dhomën e procedurës paraprake, e cila mund të ndërmarrë masa të tilla që mund të jenë të domosdoshme për të siguruar efikasitetin dhe integritetin e procedurës dhe për të mbrojtur të drejtat e mbrojtjes. Në masat e tilla përfshihen:

- Dhënia e rekomandimeve ose të urdhrave në lidhje me procedurat që do të ndiqen;
- Udhëzimi që të mbahet procesverbali i gjykimit;
- Emërimi i një eksperti për të asistuar;
- Emërimi i avokatit për personin e arrestuar, dhe në qoftë se avokati ende nuk është caktuar, të përfaqësojë interesat e mbrojtjes;
- Emërimi i njërit prej anëtarëve të saj, një gjyqtar të Dhomës së Procedurës Paraprake ose të Divizionit të gjykimit për të mbikëqyrur dhe për të dhënë rekomandime ose urdhra në lidhje me mbledhjen dhe ruajtjen e provave dhe me marrjen në pyetje të personave;
- Ndërmarrja e çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë i domosdoshëm për mbledhjen dhe ruajtjen e provave.

Kur prokurori nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për efikasitetin e procedurës, por Dhoma e Procedurës Paraprake e konsideron se masa të tilla janë të nevojshme për të ruajtur provat, që beson se do të ishin thelbësore për mbrojtjen gjatë gjykimit, ajo do të këshillohet me prokurorin për të mësuar pse ai nuk ka kërkuar ndërmarrjen e masave të tilla. Dhe kur Dhoma e Procedurës Paraprake e konsideron se prokurori në mënyrë të paarsyeshme nuk ka kërkuar ndërmarrjen e masave të tilla, atëherë Dhoma e Procedurës Paraprake një gjë të tillë e bën me vetiniciativë. Lidhur me një vendim të tillë prokurori mund të bëjë ankesë, e cila duhet të shqyrtohet në mënyrë të përsheptuar.

Pranueshmëria e provave, të mbajtura ose të mbledhura, si dhe procesverbali rregullohet gjatë gjykimit dhe ka atë peshë që përcaktohet nga Dhoma e Gjykimit (neni 56).

Përveç funksioneve të tjera, që sipas këtij Statuti i ushtron Dhoma e Procedurës Paraprake, ajo ushtron edhe funksione si:

- Me kërkesë të prokurorit, të lëshojë urdhra dhe urdhërarreste që mund të kërkojnë për qëllimet e hetimeve;
- Ndërmarrjen e masave të nevojshme për zhvillimin efikas të procedurës dhe dhënien e ndihmës personit për përgatitjen e mbrojtjes;
- Kur është e domosdoshme, të mundësojë mbrojtjen dhe fshehtësinë e viktimave, dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave të arrestuar, si dhe ruajtjen e informacioneve të sigurisë kombëtare;
- Të autorizojë prokurorin në marrjen e hapave specifikë hetues brenda territorit të shtetit palë pa siguruar bashkëpunimin e tij, mundësisht duke pasur parasysh që ndihmat e shtetit në fjalë, Dhoma e Procedurës Paraprake i përcakton në atë rast kur

shteti nuk ka mundësi të ekzekutojë kërkesën për bashkëpunim, për shkak të pamundësisë të cilitdo autoritet ose për shkak të ndonjë kompetenti të tij gjyqësor;

- Kur urdhërarresti ose fletëthirrja është lëshuar duke pasur parasysh fuqinë e provave dhe të drejtat e palëve, si parashihet me këtë Statut dhe në Rregullat e Procedurës dhe Provave, të kërkojë bashkëpunimin e shteteve, të marrë masat mbrojtëse në lidhje me humbjet, sidomos për interesin e lartë të viktimave (neni 57).

Në çdo kohë pas fillimit të hetimeve, kur ekziston dyshimi i bazuar se një person ka kryer krim brenda juridiksionit të gjykatës, si dhe me qëllim të sigurimit të pranisë së personit në gjykim, siguron se personi nuk do të pengojë dhe nuk do të rrezikojë hetimet dhe procedurën gjyqësore, për të penguar personin nga vazhdimi i kryerjes së krimit ose krimit të ngjashëm, atëherë Dhoma e Procedurës Paraprake me kërkesë të prokurorit lëshon urdhërarrestin. Kërkesa e prokurorit duhet të përmbajë të dhëna të tilla me të cilat identifikohet personi, të dhënat për krimet për të cilat akuzohet, faktet për të cilat presumohet se i paraqesin ato krime dhe arsye pse prokurori kërkon arrestimin e atij personi.

Me kërkesë të prokurorit urdhërarresti mund të ndryshohet ose të shtohen krimet, ku Dhoma e Procedurës Paraprake e bën një gjë të tillë nëse fiton bindjen për një gjë të tillë.

Përveç urdhërarrestit, Dhoma e Procedurës Paraprake me kërkesë të prokurorit mund të lëshojë edhe fletëthirrje për një person.

Fletëthirrja ngjashëm me urdhërarrestin duhet të përmbajë të dhëna për identitetin e personit, datën kur duhet të paraqitet, krimet për të cilat akuzohet se i ka kryer personi, faktet për të cilat presumohet se paraqesin krimin, fletëthirrja duhet që personit t'i dorëzohet personalisht (neni 58).

Kur lëshohet urdhërarresti ose fletëthirrja, shteti që e ka pranuar atë, menjëherë duhet të marrë masa për të arrestuar personin në fjalë (neni 59).

Me rastin e dorëzimit në gjykatë ose në bazë të fletëthirrjes, Dhoma e Procedurës Paraprake ka të drejtën të vendosë nëse personin, deri në gjykim, do ta lërë të mbrohet në liri ose do t'i caktojë paraburgim. Në të dyja rastet, gjykata në mënyrë periodike e shqyrton vendimin e saj, të cilin në rastet e ndryshimit të kushteve, e ndryshon (neni 60).

Brenda një afati kohor të arsyeshëm, pas dorëzimit të personit ose paraqitjes së tij vullnetare para gjykatës, Dhoma e Procedurës Paraprake mban një seancë për të vërtetuar akuzat, seancë që mbahet në praninë e prokurorit, personit të akuzuar dhe avokatit të tij. Me kërkesë të prokurorit ose kryesisht të tij, një seancë e tillë mund të mbahet edhe pa praninë e personit të akuzuar nëse personi ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë dhe personi është larguar dhe janë ndërmarrë të gjitha masat që ai të informohet dhe të sigurohet prania e tij.

Brenda një kohe të arsyeshme personi i akuzuar duhet të marrë një kopje të dokumentit që përmban akuzat dhe informohet në lidhje me provat.

Para seancës, prokurori mund të tërheqë cilëndo akuzë dhe të ndryshojë, gjë për të cilën duhet të informohet i akuzuari dhe gjatë seancës prokurori duhet të paraqesë prova të mjaftueshme të cilat mbështesin dyshimin se personi ka kryer krimin për të cilin akuzohet.

Përveç prokurorit rol në këtë seancë ka edhe i akuzuari, që mund të bëjë vërejtje në lidhje me akuzat, të kundërshtojë provat e ofruara nga prokurori dhe të paraqesë prova.

Dhoma e Procedurës Paraprake vendos nëse ka prova të mjaftueshme ose jo. Nëse vendos që ka prova të mjaftueshme vërteton ato akuza të cilat kanë prova të mjaftueshme dhe për akuza të tilla, e çon personin para Dhomës së Gjykimit, dhe kur për mungesë provash të

mjaftueshme nuk i vërteton dot ato akuza, e shtyn seancën dhe kërkon nga prokurori që të sigurojë prova të tjera për atë akuzë ose të bëhet ndryshimi i akuzës për shkak se provat e ofruara duket se paraqesin krim tjetër brenda juridiksionit të gjykatës. Kur akuza nuk vërtetohet, prokurori duke u mbështetur në prova plotësuese, më vonë mund të kërkojë vërtetimin e saj.

Pas vërtetimit të akuzave dhe para se gjykimi të ketë filluar, prokurori me lejen e Dhomës së Procedurës Paraprake dhe pas njoftimit të të akuzuarit, mund kërkojë që të shtojë akuza plotësuese ose akuza më të rënda për të cilat duhet të mbahet një seancë për t'i vërtetuar ato. Kurse pas fillimit të gjykimit, me lejen e Dhomës së Procedurës Paraprake, prokurori mund të tërheqë akuzat.

Prokurori ka të drejtën ekskluzive të ndjekë dhe të fillojë procedurën ndaj një personi, por me qëllim që një e drejtë e tillë të mos arbitrarizohet nga ana e prokurorit, është Dhoma e Procedurës Paraprake e cila në një mënyrë paraqitet si organ kontrolli ndaj veprimeve të prokurorit, ku me dispozitat e këtij Statuti janë paraparë mekanizma me të cilët veprimet dhe vendimet e prokurorit mund të kundërshtohen dhe si të tilla edhe të ndryshohen ose të shfuqizohen.

Pasi të jenë vërtetuar akuzat, Kryesia themelon Dhomën e Gjykimit, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të mëvonshme dhe mund të ushtrojë cilindo funksion të Dhomës së Procedurës Paraprake që është e nevojshme për të vazhduar procedura (neni 61).

Gjykimi, vetëm kur vendoset ndryshe, mbahet në selinë e gjykatës, dhe i akuzuari duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.

Nëse i akuzuari e pengon gjykimin, ai mund të largohet, duke i krijuar kushte që të këshillohet nga avokati jashtë gjykatës si dhe të ndjekë gjykimin përmes teknologjisë së komunikimit dhe masa të tilla ndërmerren vetëm në rrethana të posaçme dhe pasi të gjitha mundësitë e tjera të jenë shterur (neni 62 & 63).

Dhoma e gjykimit, funksionet dhe kompetencat e saj i ushtron në pajtim me Statutin dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave. Ajo siguron që gjykimi të jetë i drejtë, i shpejtë, të zhvillohet me respekt të plotë për të drejtat e të akuzuarit, dhe me kujdes të vazhdueshëm për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

Në qoftë se paraqitet ndonjë çështje paraprake dhe me qëllim të funksionimit efektiv dhe të drejtë, këto çështje mund t’ia kalojë Dhomës së Procedurës Paraprake ose ndonjë gjyqtari nga divizioni i Procedurës Paraprake.

Dhoma e Gjykimit ka të drejtë të ndajë ose të bashkojë akuzat ndaj më shumë se një të akuzuari, ku para fillimit të gjykimit ose gjatë kohës së zhvillimit të gjykimit, Dhoma e Gjykimit mundet:

- Të ushtrojë çdo funksion të Dhomës së Procedurës Paraprake;
- Të kërkojë pjesëmarrjen dhe dhënien e dëshmive nga dëshmitarët dhe paraqitjen e dokumenteve dhe provave të tjera nëse është e domosdoshme edhe nëpërmjet të ndihmës së shteteve të tjera;
- Të mundësojë ruajtjen e informacioneve konfidenciale;
- Të urdhërojë prodhimin e provave të tjera si shtesë për ato që janë mbledhur para gjykimit ose që janë paraqitur gjatë gjykimit nga ana e palëve;
- Të mundësojë mbrojtjen e të akuzuarit, dëshmitarëve dhe viktimave dhe
- Të vendosë edhe për çështje të tjera.

Gjykimi mbahet me dyer të hapura, por në rrethana të caktuara publiku mund të përjashtohet kur duhet të mbrohen informacione konfidenciale ose delikate të cilat ofrohen si prova.

Dhoma e gjykimit, në fillim lexon akuzat dhe sigurohet se i akuzuari a i kupton akuzat, dhe e fton të akuzuarin që të deklarojë për fajësinë ose pafajësinë e tij.

Gjyqtari kryesues mund të japë udhëzime për zhvillimin e gjykimit me qëllim të zhvillimit të tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, ku palët në pajtim me këto udhëzime mund të ofrojnë prova.

Dhoma e gjykimit ka kompetencë *inter alia* ose në bazë të kërkesës së palëve të vendosë në lidhje me pranueshmërinë ose rëndësinë e provave, të ndërmarrë të gjitha hapat e domosdoshëm për të mbajtur qetësi gjatë seancës dhe të sigurohet se procesverbali i gjykimit, i përpiluar si duhet ruhet nga sekretari (neni 64).

Kur i akuzuari pranon fajin, Dhoma e gjykimit vendos nëse i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas këshillimit të mjaftueshëm me avokatin e tij dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që gjenden në akuzat e sjella nga prokurori, ndonjë material të paraqitur nga prokurori e që plotëson akuzat dhe të cilat i akuzuari i pranon dhe çfarëdo prove tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarit të paraqitura nga prokurori ose i akuzuari.

Kur dhoma e gjykimit krijon bindjen se çështjet e përmendura janë vërtetuar, ajo merr parasysh pranimin e fajit, bashkë me çfarëdo prove tjetër shtesë të paraqitur, e cila vërteton faktet thelbësore që kërkohen për të vërtetuar krimin. Ndërsa kur gjykata nuk bindet që është bërë pranimi i fajit, vazhdon me procedurat e rregullta gjyqësore dhe rastin mund ta dorëzojë në një Dhomë tjetër gjykimi. Kur Dhoma e gjykimit mendon se është në interes të

drejtësisë të paraqiten të gjitha provat, e sidomos për interesat e viktimave, ajo mund të kërkojë nga prokurori të paraqesë prova plotësuese, përfshirë këtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve.

Çdo diskutim ndërmjet prokurorit dhe mbrojtjes në lidhje me ndryshimin e akuzave, me pranimin e fajit ose me dënimin që do të jepet, nuk e detyron gjykatën (neni 65).

Prezumimi i pafajësisë sigurohet edhe në këtë Statut, ku çdo person konsiderohet i pafajshëm derisa të deklarohet fajtor para gjykatës, ku barra për vërtetimin e fajit të të akuzuarit bie mbi prokurorin. Pasi gjykata të bindet për fajin e të akuzuarit dhe pa asnjë dyshim të arsyeshëm, mund ta dënojë të akuzuarin (neni 66).

Gjatë përcaktimit të çfarëdo akuze, i akuzuari ka të drejtën e gjykimit me dyer të hapura, për një dëgjim të drejtë, të zhvilluar në mënyrë të paanshme dhe për garancitë minimale në barazi të plotë:

- Të njoftohet menjëherë dhe në hollësi rreth natyrës, shkakut dhe përmbajtjes së akuzës, në gjuhën të cilën e kupton dhe e flet i akuzuari;
- Të ketë kohë dhe mjetet e duhura për të përgatitur mbrojtjen dhe për të komunikuar lirisht në besim me avokatin të cilin e ka zgjedhur vetë;
- Të gjykohet pa shtyrje të paarsyeshme;
- Të jetë i pranishëm në gjykim, të bëjë mbrojtjen personalisht ose përmes ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij ose nëse nuk ka ndihmë juridike, të informohet për të drejtën e mbrojtjes pa pagesë të caktuar nga gjykata;
- Të ekzaminojë dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe ekzaminimin e dëshmitarëve në dobi të tij në kushte të njëjta edhe për dëshmitarët kundër tij, dhe

gjithashtu i akuzuari ka të drejtë të paraqesë mbrojtjen dhe prova të lejueshme sipas këtij Statuti;

- Të ketë ndihmën e përkthyesit kompetent falas;
- Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajin dhe të heshtë, dhe një heshtje e tillë të mos merret në konsideratë gjatë përcaktimit të fajit ose pafajësisë;
- Të japë deklaratë gojore ose me shkrim në mbrojtje të tij, pa bërë betimin dhe
- Të mos i nënshtrohet detyrimit për të vërtetuar pafajësinë e rastit ose të barrës për të kundërshtuar provat. Përveç të tjerash, prokurori duhet të njoftojë mbrojtjen për provat që i posedon dhe për të cilat mendon se kanë tendencën të tregojnë pafajësinë e të akuzuarit ose mund të ndikojnë në ndjekjen penale dhe në rast të dyshimit në lidhje me këtë çështje vendos gjykata (neni 67).

Gjatë zhvillimit të gjykimit gjykata duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur sigurinë, mirëqenien fizike e psikologjike, dinjitetin dhe fshehtësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë këtu edhe moshën, gjininë, shëndetin si dhe natyrën e krimit, e në veçanti në rastin kur krimi përfshin dhunën seksuale ose gjinore ose dhunën ndaj fëmijëve, dhe prokurori i merr këto masa sidomos gjatë hetimit dhe ndjekjes së krimeve të tilla. Këto masa janë në pajtim me gjykimin e drejtë dhe të paanshëm.

Çështje e rëndësishme është edhe mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave, prandaj Statuti parasheh disa rregulla të cilat trajtojnë çështjen e tillë. Si përjashtim nga rregulli për dëgjimet publike, Dhoma e Gjykimit mund të mbrojë viktimat dhe dëshmitarët ose të akuzuarin, mund të zhvillojë cilëndo pjesë të procedurës përmes xhirimit me kamerë ose të lejojë paraqitjen e provave nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera specifike, dhe në veçanti, në rastin e viktimës së dhunës seksuale ose fëmijës, që është viktimë ose

dëshmitar, të marrë parasysh të gjitha rrethanat, dhe nëse nuk urdhërohet ndryshe nga gjykata, dhe të ketë parasysh qëndrimet e viktimës dhe të dëshmitarit.

Kur preken interesat personale të viktimave gjykata duhet t'i lejojë ata të paraqesin qëndrimet dhe çështjet e tyre, të cilat mund të paraqiten nga përfaqësuesit ligjorë të viktimave dhe të mos të dëmtojnë të drejtat e të akuzuarit, por dhe të jenë në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Njësia e viktimave dhe dëshmitarëve mund të këshillojë prokurorin dhe gjykatën rreth masave të duhura mbrojtëse, marrëveshjeve të sigurisë, këshillimit dhe ndihmës.

Kur zhvillimi i provave dhe i informacioneve mund të shkaktojë rrezik serioz për sigurinë e dëshmitarit ose të familjes së tij, prokurori mundet që prova të tilla t'i mbajë dhe në vend të tyre të dorëzojë një përmbledhje dhe masat e tilla mund të ushtrohen në mënyrë që të mos dëmtohen interesat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Shteti, gjithashtu, mund të bëjë kërkesë që të ndërmerren masat e domosdoshme në lidhje me mbrojtjen e nëpunësve ose agentëve të tij, si dhe për ruajtjen e informacioneve konfidenciale ose delikate (neni 68).

Dëshmia e dëshmitarit jepet personalisht, ku secili dëshmitar para se të dëshmojë duhet të betohet në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave. Gjithashtu, gjykata mund të lejojë dhënien e dëshmisë gojore ose nëpërmjet mjeteve të video ose audio teknologjisë si dhe paraqitjen e dokumenteve dhe transkripteve me shkrim, dhe me kusht që këto masa mos të dëmtojnë të drejtat e të akuzuarit.

Palët mund të dorëzojnë prova që lidhen me çështjen dhe gjykata mund të kërkojë dorëzimin e të gjitha provave që janë të domosdoshme për përcaktimin e së vërtetës.

Gjykata vendos për rëndësinë ose pranueshmërinë e çdo prove, për vlerën dëshmuese dhe për rëndësinë që kanë në përcaktimin e së vërtetës, ku gjatë shqyrtimit të provave ajo respekton dhe mbikëqyr privilegjet mbi konfidencialitetin në atë mënyrë që është parashikuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Gjykata nuk duhet të marrë prova për ato fakte që janë të njohura botërisht, por mund të marrë shënime gjyqësore për to.

Dëshmitë e marra përmes mjeteve që shkelin këtë Statut ose të drejtat e njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, nuk janë të pranueshme nëse:

- Shkelja paraqet dyshim të konsiderueshëm në besueshmërinë e provave ose
- Kur pranimi i provave do të ishte kundër etikës dhe do të dëmtonte seriozisht integritetin e gjykimit (neni 69).

Në nenin 70 të Statutit të GJPN-së parashihen veprat kundër administrimit të drejtësisë, ku gjykata ka juridiksion për veprat kundër administrimit të drejtësisë kur janë kryer me qëllim:

- Dhënien e dëshmisë false kur ekziston detyrimi për të thënë të vërtetën;
- Paraqitjen e provës kur pala e di se është false;
- Ndikimin të dëshmitari duke e korruptuar atë, pengimin ose ndërhyrjen në pjesëmarrjen ose dëshminë e dëshmitarit, hakmarrjen ndaj dëshmitarit për shkak të dhënies së dëshmisë ose shkatërrimin, ndikimin ose ndërhyrjen në mbledhjen e provave;
- Pengimin, shqetësimin ose korruptimin e nëpunësit të gjykatës me qëllim të detyrimit ose bindjes së tij për të mos kryer ose për të kryer në mënyrë të gabuar detyrën e tij;

- Hakmarrjen ndaj nëpunësit të gjykatës në lidhje me detyrat e ushtruara nga ai ose ndonjë zyrtar tjetër;
- Kërkimin ose pranimin e mitmarrjes si nëpunës i gjykatës në lidhje me detyrat zyrtare të tij.

Kushtet për ushtrimin e juridiksionit të gjykatës rregullohen edhe me Rregullat e Procedurës dhe Provave. Gjithashtu në lidhje me këtë juridiksion, shtetet duhet të bashkëpunojnë ndërmjet veti, kushte të cilat rregullohen me ligjet kombëtare të shteteve.

Në rast të dënimit, gjykata mund të caktojë një afat burgimi që nuk i kalon pesë vjet, ose një gjobë në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Secili shtet palë i zgjeron ligjet e tij penale, përmes penalizimit të veprave kundër integritetit të procesit të tij hetues ose gjyqësor me veprat kundër administrimit të drejtësisë, të kryera në territorin e tij, ose nga shtetasi i tij.

Çështje të tilla, me kërkesë të gjykatës, shteti palë ua dorëzon organeve të tij me qëllim të ndjekjes penale, çështje të tilla i trajtojnë me kujdes dhe u përkushtojnë burime të mjaftueshme për të mundësuar shqyrtimin e tyre efektiv (neni 70).

Gjykata gjithashtu mund të shqiptojë sanksione për sjellje të paligjshme ndaj gjykatës, ajo mund të ndëshkojë personat e pranishëm, të cilët kryejnë sjellje të paligjshme, përfshirë këtu pengimin e gjykimeve, refuzimin e qëllimshëm për të vepruar sipas udhëzimeve të saj, me masa administrative përveç burgosjes, siç është largimi i përkohshëm ose i përhershëm nga gjykata, gjoba ose masa të ngjashme të rregulluara me Rregullat e Procedurës dhe Provave (neni 71).

Në rastet kur zbulimi i ndonjë informacioni ose dhënia e ndonjë dëshmie do të rrezikonte sigurinë kombëtare të një shteti, atëherë shteti në bashkëpunim me prokurorin, mbrojtjen,

Dhomën e Procedurës Paraprake dhe Dhomën e Gjykimit kërkon zgjidhje të çështjes me masa bashkëpunimi me qëllim ruajtjen e interesave të sigurisë kombëtare (neni 72).

Në qoftë se një dokument ose informacion i nevojitet gjykatës, të cilët i janë dhënë në mirëbesim shtetit nga një shtet tjetër, nga ndonjë organizatë ndërqeveritare ose nga ndonjë organizatë ndërkombëtare, atëherë për marrjen e tyre duhet të kërkohej pëlqim nga ky i fundit. Në qoftë se subjekti i tillë jep pëlqimin, atëherë shteti që posedon dokumentet ose informacionet e tilla ia jep gjykatës, e në qoftë se refuzon, atëherë ato nuk mund të jepen (neni 73).

Vendimi i Dhomës së gjykimit duhet të bazohet në vlerësimin e saj mbi provat dhe gjykimin në tërësi, ai nuk duhet t'i tejkalojë faktet dhe rrethanat e përshkruara në akuzë dhe në çdo ndryshim të akuzës, dhe gjykata mund të mbështesë vendimin e saj vetëm në provat e dorëzuara dhe të diskutuara para saj në gjykim.

Gjatë marrjes së vendimit gjyqtarët përpiqen të arrijnë unanimitet, e nëse nuk munden vendimi merret nga shumica e gjyqtarëve. Këshillimet e Dhomës së Gjykimit mbeten të fshehta, kurse vendimi me shkrim përmban deklaratën e plotë dhe të arsyetuar të vendimit në lidhje me provat dhe përfundimet. Dhoma e Gjykimit përpilon një vendim, dhe në qoftë se nuk ka unanimitet, duhet të përmbahen si qëndrimet e shumicës ashtu edhe pakicës, vendimi duhet të shpallet publikisht i plotë ose një përmbledhje e tij (neni 74).

Në vendimin e saj gjykata mund të përcaktojë edhe dëmshpërblimin e viktimave duke përfshirë restitucionin, kompensimin dhe rehabilitimin. Në bazë të kërkesës ose të propozimit, gjykata përcakton shkallën e gjerësisë së çfarëdo humbjeje ose lëndimi në lidhje me viktimat dhe përcakton parimet mbi të cilat ajo vepron. Gjykata mund të urdhërojë drejtpërdrejt personin e dënuar në lidhje me dëmshpërblimin e viktimës ose të

urdhërojë që dëmshpërblimi të bëhet përmes fondit “Fondi i Besimit”. Para dhënies së një urdhri të tillë, gjykata mund të ftojë dhe të marrë parasysh përfaqësimet nga i dënuari ose nga përfaqësuesi i tij, nga viktimat, nga personat e tjerë të interesuar ose nga shtetet e interesuara (neni 75).

Me rastin e shpalljes fajtor të një personi, Dhoma e Gjykimit shqyrton dënimin e duhur që duhet të jepet duke pasur parasysh provat e paraqitura dhe depozitimet e bëra gjatë gjykimit të cilat janë të rëndësishme për dënimin. Dënimi shpallet publikisht, dhe kur është e mundur në praninë e të akuzuarit (neni 76).

Për krimet që janë nën juridiksionin e GJPN-së, mund të shqiptohet:

- Dënimi me burgim, që nuk mund të kalojë maksimumin prej 30 vjetësh ose
- Dënimin me burg të përjetshëm kur është i arsyetuar me peshën e rëndë të krimit dhe me rrethanat individuale të personit të dënuar.

Si plotësim për dënimin me burg, gjykata mund të urdhërojë gjobë sipas kriterëve të parashikuara me Rregullat e Procedurës dhe Provave si dhe konfiskimin e të ardhurave, pronës dhe mjeteve të tjera që rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga krimi, pa rrezikuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë *bona fide* (neni 77).

Gjatë përcaktimit të lartësisë së dënimit, gjykata merr parasysh peshën e krimit dhe rrethanat individuale të personit të dënuar, në kohëzgjatjen e së cilës merr parasysh kohën e kaluar në paraburgim.

Kur personi është dënuar për më shumë se një krim, gjykata jep dënimin për më shumë se një krim si dhe dënimin e përbashkët, duke specifikuar periudhën e përgjithshme të burgosjes, periudhë që nuk është më pak se dënimi më i lartë individual i dhënë dhe nuk kalon dënimin prej 30 vjetësh burgim ose dënimin me burgim të përjetshëm (neni 78).

Në dobi të viktimave të krimeve dhe të familjarëve të tyre nga ana e Asamblesë së shteteve palë është themeluar “Fondi i Besimit”, i cili menaxhohet sipas kriterëve të përcaktuara nga Asambleja e shteteve palë. Gjykata mund të urdhërojë që të hollat dhe pronësitë e tjera të mbledhura përmes gjobave ose konfiskimit të transformohen në fondin “Fondi i Besimit” (neni 79).

Dispozitat lidhur me ndëshkimet, të parapara në këtë Statut, nuk ndikojnë në ligjet kombëtare të shteteve lidhur me ndëshkimet (neni 80).

Kundër vendimit të gjykatës, me të cilin personi është shpallur fajtor ose është liruar ose me të cilin është dënuar, mund të bëjë ankesë prokurori dhe personi i dënuar.

Prokurori dhe personi i dënuar mund ta godasin vendimin mbi këto baza:

- Gabimin procedural;
- Gabimin në fakt;
- Gabimin në ligj ose
- Çdo shkak tjetër që ka ndikim në paanshmërinë dhe sigurinë e gjykimit ose të vendimit.

Nëse në ankesën ndaj dënimit gjykata konsideron se ekzistojnë shkaqe për të cilat mund të mënjanohet dënimi, tërësisht ose pjesërisht, ajo fton prokurorin dhe personin e dënuar të dorëzojnë shkaqet dhe mund të vendosë në lidhje me vendimin.

Përderisa vendoset lidhur me ankesën personi i dënuar mbahet në ndalim, përveç kur Dhoma e gjykimit mendon ndryshe. Kur koha që personi kalon në ndalim tejkalon dënimin me burgim të dhënë, ai person lirohet, e nëse edhe prokurori është duke bërë ankesë lirimi kushtëzohet.

Në rast të dhënies së pafajësisë, i akuzuari lirohet menjëherë dhe kushtëzohet nëse:

- Në rrethana të veçanta dhe duke e konsideruar *inter alia*, rrezikun konkret të zhdukjes, seriozitetin e shkeljes së caktuar dhe mundësinë e suksesit të ankesës, Dhoma e Gjykimit me kërkesën e prokurorit, mund ta mbajë personin në ndalim derisa të zgjidhet ankesa. Ndaj vendimit për mbajtje edhe pas shpalljes së pafajësisë mund të ushtrohet ankesë.

Gjatë periudhës së lejuar për ankesë dhe gjatë kohëzgjatjes së procedurës së ankesës ekzekutimi i vendimit ose i dënimit pezullohet (neni 81).

Palët mund të ushtrojnë ankesë edhe ndaj vendimeve të tjera si:

- Vendimit në lidhje me juridiksionin ose pranueshmërinë;
- Vendimeve për lirim ose mohimin e lirit të personit që është marrë në pyetje ose që ndiqet penalisht;
- Vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake;
- Vendimit që përfshin një çështje, që do të kishte ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit ose në përfundimin e gjykimit, dhe për të cilën sipas Dhomës së Procedurës Paraprake dhe Dhomës së Gjykimit, zgjidhja e menjëhershme nga Dhoma e Ankimit mund të shpejtojë materialisht gjykimin.

Përfaqësuesi ligjor i viktimave, personi i dënuar ose pronari *bona fide* i pronësisë së prekur në mënyrë të pafavorshme mund të bëjë ankesë kundër urdhrit për dëmshpërblime, ashtu si është rregulluar në Rregullat e Procedurës dhe Provave (neni 82).

Gjykimi në bazë të ankesës bëhet nga Dhoma e Ankimit e cila i ka të gjitha kompetencat si edhe Dhoma e Gjykimit. Nëse Dhoma e Ankimit konstaton se gjykimi, kundër të cilit është bërë ankim ka qenë i padrejtë dhe në mënyrë të atillë që ka ndikuar në besueshmërinë e

vendimit ose të dënimit, ose vendimi dhe dënimi ndaj të cilit është bërë ankimi ka qenë thelbësisht i ndikuar prej gabimit në fakt, prej ligjit ose gabimit procedural, ajo mund të:

- Anulojë ose të ndryshojë vendimin ose dënimin ose
- Të urdhërojë një gjykim të ri para një Dhome Gjykimi tjetër.

Dhoma e Ankimit mund ta ridërgojë çështjen te Dhoma e parë e Gjykit në mënyrë që ajo të vendosë për çështjen. Kur ndaj vendimit ose dënimit është ankuar vetëm personi i dënuar ose prokurori në emër të personit të dënuar, vendimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Nëse Dhoma e Ankesave gjatë ankimit kundër dënimit, konstaton se dënimi nuk është proporcional me krimin ajo mund të ndryshojë vendimin.

Vendimi i Dhomës së Ankimit merret publikisht, në të duhet të paraqiten arsyet në të cilat ai është bazuar vendimi. Kur nuk ka unanimitet, vendimi duhet të përmbajë mendimet e shumicës dhe të pakicës, ndërsa gjyqtari mund të japë një mendim të ndryshëm ose të kundërt për një çështje ligjore. Vendimi i Dhomës së Ankesave mund të paraqitet edhe në mungesë të personit që merr fajësi ose pafajësi (neni 83).

Personi i dënuar dhe pas vdekjes së tij bashkëshorti, fëmijët, prindërit ose një person i gjallë në kohën e vdekjes së të akuzuarit, të cilit me shkrim i janë dhënë udhëzime nga i akuzuari për të bërë një kërkesë të tillë, ose prokurori në emër të personit, mund të kërkojë nga Dhoma e Ankesave që të rishikojë fajësinë ose dënimin, duke u bazuar mbi këto shkaqe:

- Është zbuluar prova e re;
- Nuk ka qenë në dispozicion në kohën e gjykit, dhe një mungesë e tillë nuk mund t'i ngarkohet tërësisht ose pjesërisht palës që bën kërkesën;
- Prova e tillë është e rëndësishme, dhe po të ishte në dispozicion gjatë gjykit ose po të ishte vërtetuar, do të ndikonte në marrjen e një vendimi krejtësisht tjetër;

- Është zbuluar që prova vendimtare, e marrë gjatë gjykimit dhe nga e cila varet dënimi, ka qenë e pavërtetë ose e falsifikuar;
- Një ose më shumë gjyqtarë, që kanë marrë pjesë në dënim ose në vërtetim të akuzave, kanë manifestuar një akt të rëndë të sjelljes së keqe si dhe shkelje serioze të detyrave me peshë të tillë që mjafton për të justifikuar përjashtimin e gjyqtarit ose gjyqtarëve nga detyra.

Dhoma e ankesave refuzon kërkesën nëse mendon se ajo është e pabazuar, kurse nëse vendos që kërkesa është e bazuar ajo mundet, sipas rastit:

- Të thërrasë përsëri Dhomën e mëparshme të Gjykimit;
- Të themelojë një Dhomë të re gjykimi ose
- Të ruajë juridiksionin mbi çështjen, me qëllim që pas dëgjimit të palëve të vendosë nëse do të rishikohet vendimi përfundimtar (neni 84).

Personi i arrestuar dhe i ndaluar në mënyrë të paligjshme ose që është dënuar si rezultat i gabimit të drejtësisë, ka të drejtën e kompensimit në bazë të ligjit. Kërkesa për kompensim mund të bëhet nga personi, ose nga Gjykata, kur ajo gjen fakte vendimtare që tregojnë se është bërë gabim i rëndë dhe i dukshëm nga ana e drejtësisë (neni 85).

Në pjesën e nëntë të Statutit të GJPN-së, janë paraparë dispozita lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën gjyqësore, ku është paraparë se shtetet palë duhet të bashkëpunojnë plotësisht me GJPN-në për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të gjykatës (neni 86).

GJPN-ja, nëpërmjet kanaleve diplomatike si dhe nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale, mund t’iu kërkojë bashkëpunim shteteve palë.

Gjykata, po ashtu, mund të kërkojë nga çdo organizatë ndërqeveritare dhënien e informacionit ose të dokumenteve, si dhe forma të tjera të bashkëpunimi dhe asistencë. Gjykata mund të merret vesh me një organizatë të tillë, sepse e ka këtë të drejtë që është në pajtim me kompetencat dhe mandatin e saj.

Në lidhje me këtë bashkëpunim shtetet palë, për të gjitha format e bashkëpunimit, duhet të sigurojnë që të kenë procedurat në dispozicion sipas ligjit të tyre kombëtar (neni 87 & 88).

Në territorin e atij shteti në të cilin ndalohej personi, që kërkohet të arrestohet, dorëzohet kërkesa nga gjykata. Në bazë të një kërkesë së tillë, personi mund të bëjë kundërshtim deri në gjykatën kombëtare në bazë të parimit *non bis in idem*.

Kur ka kërkesë për ekstradim edhe nga gjykata, por edhe nga një shtet tjetër, që nuk është palë, përparësi ka kërkesa e gjykatës, dhe gjithashtu edhe kur kërkesa bëhet nga shteti palë, shteti pritës vetëm nëse është nën detyrimin ekzistues ndërkombëtar, për të ekstraduar personin në shtetin dërgues, atëherë sjell vendim se a do ta ekstradojë atë në gjykatë ose në shtetin dërgues duke pasur në konsideratë faktorët përkatës, e në raste të tjera personi i dorëzohet gjykatës (neni 90).

Kërkesa për arrestim dhe dorëzim duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me identitetin e personit që kërkohet, por dhe me vendndodhjen e mundshme të personit (neni 91).

Gjithashtu, gjykata mund të kërkojë edhe arrestimin e përkohshëm, derisa të dorëzohet kërkesa për arrestim dhe dorëzim, gjykata menjëherë duhet të dorëzojë kërkesën e tillë. Nëse kërkesa e tillë nuk dorëzohet, atëherë shteti ka të drejtë ta lirojë personin, por gjykata nuk e humb të drejtën, që edhe pas lirimit të tij, të kërkojë përsëri arrestimin e tij (neni 92).

Gjykata dhe shtetet palë bashkëpunojnë edhe në forma tjera, në lidhje me hetimet dhe ndjekjet penale, e që nuk është ndaluar me ligjet e shtetit pritës, me qëllim të lehtësimit të hetimit dhe ndjekjes së krimeve brenda juridiksionit të gjykatës (neni 93).

Kur kërkesa për transferim dhe dorëzim nuk përmban informacionet e nevojshme për ekzekutim, kur personi i kërkuar nuk gjendet në territorin e shtetit pritës si dhe kur shteti nëse do të ekzekutonte kërkesën do të shkelte detyrimin nga një traktat, atëherë shteti në raste të tilla do të këshillohet me gjykatën për veprimet e mëtejshme (neni 97).

Personi i dorëzuar në gjykatë nuk ndiqet penalisht, nuk dënohet ose nuk ndalohet për asnjë veprë të kryer para dorëzimit, përveç sjelljes ose serisë së sjelljeve që formon bazën e krimeve për të cilat ai person është dorëzuar (neni 101).

Personi i dënuar do të vuajë dënimin në shtetin që do ta caktojë gjykata, shtet që hyn në listën e shteteve të cilat vullnetarisht janë paraqitur para gjykatës që janë të gatshëm të pranojnë personat e dënuar për vuajtje të dënimit, ku gjatë përcaktimit të tillë, nga gjykata merret parasysh zbatimi i traktateve ndërkombëtare, të pranuarra gjerësisht, mbi pranimin e të burgosurve, pikëpamjet e personit të dënuar dhe faktorë të tjerë që kanë të bëjnë me rrethanat e krimit, me personin e dënuar ose me zbatimin efektiv të dënimit (neni 103).

Edhe pas caktimit të këtij shteti, gjykata në çdo kohë mund të marrë vendimin që të transferojë personin e dënuar në burgun e një shteti tjetër dhe një gjë e tillë mund të bëhet edhe me kërkesën e një shteti tjetër (neni 104).

Dënimi në shtetin përcaktues bëhet në bazë të kushteve të përcaktuara nga gjykata, dhe gjykata vendos për çdo ankesë dhe rishikim, ku shteti zbatues nuk pengon bërjen e asnjë kërke të tillë nga personi i dënuar (neni 105).

Zbatimi i dënimit me burgim i nënshtrohet mbikëqyrjes së gjykatës, ku komunikimet midis gjykatës dhe personit të dënuar nuk pengohen dhe janë konfidenciale (neni 106).

Pas përfundimit të dënimit personi transferohet në shtetin që është i detyruar ta pranojë atë, në shtetin që bie dakord ta pranojë, ose në shtetin sipas dëshirës së personit, ku shpenzimet për një transferim të tillë i mbulon ose ndonjë shtet ose gjykata (neni 107).

Personi i dënuar në mbikëqyrje të shtetit zbatues nuk i nënshtrohet ndjekjes penale, ndëshkimit ose ekstradimit në shtetin e tretë, për çfarëdo vepër në të cilën ka qenë i angazhuar para dorëzimit të atij personi në shtetin zbatues, përveç nëse një ndjekje, ndëshkim ose ekstradim i tillë është aprovuar nga gjykata me kërkesë të shtetit zbatues dhe gjykata vendos për çështjen pasi të ketë dëgjuar pikëpamjet e personit të dënuar (neni 108).

Shtetet palë zbatojnë gjobat ose konfiskimet e urdhëruara nga Gjykata, pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë *bona fide*, në pajtim me procedurën e ligjeve të tyre kombëtare. Nëse shteti palë nuk ka mundësi të zbatojë një urdhër për konfiskim, ai merr masa për të kthyer vlerën e fitimeve, të pronës ose të mjeteve për të cilat gjykata ka urdhëruar konfiskimin, pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë *bona fide*. Prona dhe fitimet nga shitja e pasurisë së patundshme, shitja e ndonjë pasurie tjetër, që është siguruar nga shteti palë si rezultat i zbatimit të vendimit të gjykatës, transferohen në gjykatë (neni 109).

Shteti zbatues nuk e liron personin para skadimit të dënimit të dhënë nga gjykata, ku vetëm gjykata ka të drejtë të vendosë për çdo zvogëlim të dënimit dhe vendos vetëm pasi të ketë dëgjuar personin.

Kur personi ka kryer dy të tretat e dënimit ose 25 vjet në rast të burgimit të përjetshëm, gjykata rishqyrton dënimin nëse ai do të zvogëlohet dhe gjatë një rishqyrtimi të tillë gjykata

merr parasysh faktorë si gatishmërinë e hershme dhe të vazhdueshme të personit që të bashkëpunojë me gjykatën gjatë hetimeve dhe gjatë ndjekjes penale, asistencën vullnetare të personit në mundësimin e zbatimit të vendimeve dhe urdhrave të gjykatës, sidomos ofrimi i ndihmës në gjetjen e mjeteve që janë lëndë e të ardhurave për gjobë, konfiskim ose rikthim e që mund të përdoren në dobi të viktimave dhe faktorë të tjerë që krijojnë një ndryshim të qartë dhe të rëndësishëm të rrethanave, të mjaftueshëm për të arsyetuar zvogëlimin e dënimit, ashtu si është parashikuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave (neni 110).

Nëse personi i dënuar arratiset nga ndalimi dhe ikën nga shteti zbatues, ai shtet pas këshillimit me gjykatën, mund të kërkojë dorëzimin e personit nga shteti në të cilin gjendet personi në pajtim me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe ose mund të kërkojë që gjykata të bëjë përpjekje për dorëzimin e personit. Ajo mund të urdhërojë që personi të dorëzohet në shtetin ku ka qenë duke vuajtur dënimin ose në një shtet tjetër të caktuar nga gjykata (neni 111).

Në pjesën e njëmbëdhjetë të këtij Statuti rregullohet themelimi dhe funksionimi i Asamblesë së Shteteve Palë. Shtetet palë kanë nga një përfaqësues në Asamble, të cilët shoqërohen nga zëvendësit dhe këshilltarët, që ushtrojnë funksionet e caktuara për Asamblenë në këtë Statut. Asambleja ka edhe Byronë, që përbëhet nga Kryetari, nga dy nënkryetarë dhe nga 18 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja për një periudhë 3 vjeçare. Asambleja mund të themelojë edhe organe plotësuese, që janë të nevojshme, përfshirë këtu edhe një mekanizëm të pavarur mbikëqyrës për inspektimin, vlerësimin dhe hetimin e gjykatës, në mënyrë që të rritë efikasitetin dhe ekonomizimin e saj.

Asambleja takohet në selinë e gjykatës ose në selinë e Kombeve të Bashkuara një herë në vit, dhe kur rrethanat e kërkojnë, mban edhe seanca të posaçme, kurse Byroja takohet sa herë është e nevojshme, por të paktën një herë në vit, dhe ajo e ndihmon Asamblenë në ushtrimin e detyrave të saj.

Secili shtet palë në Asamble ka një votë, dhe vendimet në Asamble dhe në Byro merren me konsensus, e nëse nuk mund të arrihet konsensusi me shumicën e dy të tretave të votave. (neni 112).

Shpenzimet e gjykatës, të Asamblesë së shteteve palë, të byrosë dhe trupave plotësues, paguhen nga fondet e gjykatës, fond i cili financohet nga kontributet e caktuara nga shtetet palë, nga fondet e siguruara prej Kombeve të Bashkuara, të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme, sidomos në lidhje me shpenzimet e paraqitura për shkak të rekomandimeve nga Këshilli i Sigurimit, si dhe nga kontributet vullnetare të qeverive, organizatave ndërkombëtare, individëve, korporatave si edhe nga personat e tjerë juridikë (neni 113, 114, 115, 116 dhe 117).

Shënimet, librat, llogaritë e gjykatës, përfshirë edhe deklaratat e saj financiare vjetore, kontrollohen nga një kontrollor i pavarur (neni 118).

Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me funksionet e gjykatës zgjidhet me vendim të gjykatës, kurse çdo mosmarrëveshje midis dy apo më shumë shteteve palë zgjidhet nga Asambleja e shteteve palë ose duke çuar rastin për zgjidhje para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (neni 119).⁵⁶

⁵⁶http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998.

Akti i themelimit të GJPN-së, si institucion i përhershëm, që ka në kompetencë ekskluzive gjykimin e atyre që kanë kryer krimet më të rënda, pasojat e të cilave prekin një numër më të madh njerëzish në një hapësirë më të madhe ose më të vogël gjeografike, pa dyshim që paraqet vulën përfundimtare të faktit të vetëdijesimit të bashkësisë ndërkombëtare, se krime të tilla për nga pesha e të mirave që cenojnë dhe për pasojat që shkaktojnë janë shumë të rënda, të cilat përveç që lënë pasojë negative afatgjate në të mirat shumë të rëndësishme të njerëzve, ato janë edhe veprime që nëse nuk ndëshkohen, mund të shkaktojnë kaos dhe anarki edhe në rendin juridik ndërkombëtar në përgjithësi. Për shembull përdorimi i armëve kimike ose atomike përveç që shkakton vdekje të vuajtshme, shkatërrim të botës bimore dhe shtazore, ato lënë edhe pasojë të tjera për një periudhë më të gjatë kohore, siç e kemi të njohur tashmë rastin me qytetet e Hiroshimës dhe Nagasakit, në të cilat u hodhën bomba atomike në përfundim të LDB-së, ku edhe pse ka kaluar një kohë tepër e gjatë, përsëri edhe sot e kësaj dite paraqiten raste deformimesh si rezultat i reaksionit të këtyre armëve. Krime të tilla, të cilat u kanë shkaktuar dëme të mëdha një numri të madh njerëzish dhe që vazhdojnë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme, pa dyshim prekin shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, po sidomos kryerja e krimeve të tilla ka qenë edhe më e theksuar gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, të cilat në të kaluarën kanë qenë jo të rralla. Por fatkeqësisht tentativat për parandalimin e veprimeve të tilla, e sidomos gjykimi për krime të kësaj natyre filluan shumë vonë dhe konkretisht pas përfundimit të LDB-së, kur edhe u themelua Gjykata e Nurembergut, posaçërisht për gjykimin e krimeve dhe të personave që ndërmorën veprime të tilla gjatë zhvillimit të LDB-së. Gjykimi i krimeve të tilla, ka kaluar në rënie dhe ngritje sepse pas përfundimit të LDB-së u themeluan dy Tribunale *ad hoc* për gjykimin e kriminelëve të LDB-së, ku pas përfundimit të punës së këtyre Tribunaleve për

një periudhë të gjatë kohore nuk ekzistonte ndonjë organ që do të gjykonte krimet e kësaj natyre, gjegjësisht deri në vitin 1992 kohë kur u themelua Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë, i cili u pasua menjëherë me Tribunalin e Ruandës. Gjatë kësaj periudhe shumëvjeçare jo që nuk ishte paraqitur nevoja e një organi të tillë, por thjesht ishin disa rrethana dhe arsye të tjera për të cilat shtetet nguronin që të krijonin një organ të tillë. Përfundimisht, themelimi i GJPN-së zgjidhi një mori problemesh të krijuara si rezultat i asaj që në nivel ndërkombëtar nuk ekzistonte një organ i cili do të kishte në kompetencë gjykimin e krimeve të tilla. GJPN-ja, si një gjykatë në suaza ndërkombëtare dhe me status të përhershëm, është garant i mjaftueshëm, se tani e tutje krime të tilla nuk do të mbeten pa u gjykuar. GJPN-ja ka juridiksion mbi krimet që janë të parapara në Statutin e Romës, me të cilin edhe u themelua GJPN-ja, pavarësisht vendit se ku ndodhin krime të tilla ose pavarësisht cilësisë së subjekteve që mund të paraqiten se kanë kryer krime të tilla. GJPN-ja në raport me juridiksionet kombëtare ka juridiksion komplementar, dhe vetëm në rastet kur për arsye të parapara në Statut, sistemet juridike nacionale nuk janë në gjendje që të ndjekin, të hetojnë ose të zhvillojnë procedurë penale ndaj një personi që ka kryer një krim të tillë, atëherë vepron GJPN-ja. Çështja e juridiksionit komplementar të GJPN-së është bërë kryesisht për arsye racionale dhe të ekonomizimit, si dhe në besimin se shtetet në përgjithësi janë të afta që brenda sistemeve të tyre nacionale të zhvillojnë gjykime të tilla, sepse duke pasur parasysh gamën shumë të gjerë të personave mbi të cilët GJPN-ja mund të ushtrojë juridiksionin e saj, atëherë praktikisht ajo nuk mund të funksionojë nëse do të duhej që të gjitha rastet t'i procedojë vetë. Juridiksioni i GJPN-së në krahasim me gjykatat *ad hoc* dallon, të cilat kishin juridiksion parësor në krahasim me juridiksionet nacionale, normalisht që një juridiksion i tillë ishte i përcaktuar nga rrethanat që mbretëronin në

vendet ku ishin zhvilluar konflikte të armatosura dhe për të cilat ishin themeluar gjykatat *ad hoc*. Gjithashtu, në këtë drejtim duhet të përmendim edhe obligimin e shteteve në dhënien e ndihmës juridike në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës penale para GJPN-së, e cila pa, dyshim, në masë të madhe i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të punës së GJPN-së. Në lidhje me juridiksionin komplementar të GJPN-së, duhet theksuar se në Statut janë paraparë disa mekanizma të cilët e sigurojnë gjykatën se gjatë zhvillimit të procedurave penale nga sistemet nacionale, për të cilat ka juridiksion komplementar GJPN-ja, nëpërmjet të cilave GJPN-ja mund të sigurohet që mos të ketë keqpërdorime gjatë zhvillimit të tyre, si p.sh. në nenin 18 të Statutit të Romës për GJPN, parashihet që kur prokurori e ka pezulluar hetimin ose ndjekjen për arsye se në një shtet të caktuar është duke u zhvilluar hetimi ose ndjekja për të njëjtën vepër ndaj të njëjtit person, atëherë prokurori ka të drejtë që të kërkojë nga shteti në mënyrë periodike që ta informojë dhe shteti është i detyruar që t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.

Në krahasim me Tribunalet *ad hoc* GJPN-ja në përbërjen e saj ka më shumë organe, e cila gjë normalisht është në proporcion me funksionet dhe kompetencat e saja më të zgjeruara në krahasim me Tribunalet *ad hoc*. Organizimi i GJPN-së dhe procedura që duhet të ndiqet para saj në bazë të Statutit të Romës është shumë e përafërt me procedurën gjyqësore që zhvillohet para gjykatave nacionale në shumicën e shteteve. Duke pasur parasysh funksionet e shumta dhe gamën shumë të gjerë të çështjeve, që janë në kompetencë të GJPN-së për t'u zgjidhur, GJPN-ja pa diskutim do të hasë në shumë sfida të vështira, kapërcimi me sukses i të cilave kërkon një angazhim dhe një mund të konsiderueshëm.

Gjithashtu, për GJPN-në do të jetë shumë e rëndësishme që të ruajë objektivitetin e saj, sidomos gjatë hetimit, ndjekjes dhe fillimit të procedurës ndaj cilitdo subjekt, sepse duke

pasur parasysh faktorë të caktuar, që kanë të bëjnë me themelimin e saj si dhe me mënyrën e ekzistimit dhe funksionimit të saj, ajo mund të jetë pre e ndikimeve politike, kryesisht si rezultat i interesave të ndryshme të shteteve.

4.6.1. Situata dhe rastet para GJPN-së

Në bazë të Statutit të Romës, prokurori mund të fillojë një hetim në bazë të rekomandimit nga çdo shtet palë ose nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Përveç kësaj, prokurori mund të iniciojë hetime *proprio motu* mbi bazën e informacionit për krimet brenda juridiksionit të gjykatës, të marra nga individë ose nga organizata.

Para se të fillojë hetimet zyrtarisht, GJPN-ja kryen hetime paraprake në raste dhe situata të referuara nga subjektet që janë të autorizuar për një gjë të tillë, gjegjësisht heton se a ka kushte për të filluar hetimet. Ajo para se gjithash mban llogari për juridiksionin e gjykatës, si dhe bën plotësimin e kushteve si komplementariteti, rëndësia dhe interesat e drejtësisë, për faktin se GJPN-ja ka rol komplementar në raport me gjykatat nacionale dhe sa herë që gjykatat nacionale janë në gjendje të zhvillojnë një gjykim për një rast i cili edhe pse i është referuar GJPN-së për procedim, atëherë GJPN-ja do të luajë vetëm rolin e mbikëqyrësit ndaj shtetit ku do të zhvillohet gjykimi. Roli i GJPN-së është i tillë edhe për faktin se ajo në çdo moment mund të ndërmarrë rastin për procedim kur e konsideron se procedura, që është duke u zhvilluar, nuk është objektive. Përveç kësaj, sa herë që një rast i referohet GJPN-së për procedim ajo duhet të hetojë se mos ndoshta nga autoritetet e shtetit nacional është ndërmarrë ndonjë veprim procedural ose është posaçërisht duke u zhvilluar procedura për rastin e njëjtë. Edhe në një rast të tillë GJPN-ja do të ketë vetëm rolin e mbikëqyrësit.

Janë 9 nëntë raste që janë në fazën e hetimeve paraprake para GJPN-së: në Afganistan, Burundi, në Kolumbia, Guinea, në Irak/UK, Nigeria, Palestinë, në Ukrainë dhe në Anijet e regjistruara të Komoras, të Greqisë dhe Kamboxhias.

Situata në Afganistan -Shqyrtimi paraprak i situatës në Afganistan u bë publik në vitin 2007. Prokurori në lidhje me këtë situatë ka marrë komunikime të shumta në bazë të nenit 15 të Statutit të Romës. Ekzaminimi paraprak fokusohet në krimet e paraqitura në Statutin e Romës gjoja të kryera në kuadrin e konfliktit të armatosur mes forcave proqeveritare dhe antiqeveritare, përfshirë krimet kundër njerëzimit: vrasje, burgim ose privime të tjera të rënda të lirisë fizike; krime të luftës si vrasje, trajtim mizor; akte fyese ndaj dinjitetit personal, shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa lejen e autoritetit të duhur gjyqësor, sulme të qëllimshme kundër civilëve, objekteve civile dhe misionëve të ndihmës humanitare si dhe vrasjen ose plagosjen me pabesi të një luftëtari armik. Shqyrtimi paraprak, gjithashtu, fokusohet në ekzistencën dhe vërtetësinë e procedurave kombëtare në lidhje me këto krime.⁵⁷

Situata në Burundi-Shqyrtimi paraprak i situatës në Burundi u njoftua më 25 prill të vitit 2016. Në atë kohë më shumë se 430 persona janë raportuar të vrarë, të paktën 3,400 persona të arrestuar dhe mbi 230,000 burundians të detyruar të kërkojnë strehim në vendet fqinje. Ekzaminimi paraprak fokusohet në aktet e vrasjes, burgim, tortura, përdhunime dhe forma të tjera të dhunës seksuale, si dhe në rastet e zhdukjeve me forcë, që supozohet se janë kryer nga prilli i 2015-ës në Burundi.⁵⁸ Që nga prilli i 2015-ës, prokurori i GJPN-së e ka ndjekur nga afër situatën në Burundi duke bërë thirrje në mënyrë të përsëritur për të

⁵⁷ <https://www.icc-cpi.int/afghanistan>

⁵⁸ <https://www.icc-cpi.int/burundi>

gjithë të përfshirët që të përmbahen nga dhuna, duke paralajmëruar se ata që pretendohet se kanë kryer krime të cilat bien brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale mund të jenë individualisht përgjegjës. Një ekzaminim paraprak nuk është një hetim, por një proces i shqyrtimit të të dhënave në dispozicion në mënyrë që të arrihet një vendim plotësisht i informuar nëse ka një bazë të arsyeshme për të vazhduar me një hetim në pajtim me kriteret e vendosura nga ana e Statutit të Romës. Në mënyrë të veçantë, në bazë të nenit 53 (1) të Statutit të Romës, prokurori duhet të marrë parasysh çështjet e juridiksionit, pranueshmërinë dhe interesat e drejtësisë në marrjen e këtij vendimi. Nuk ka afat kohor të parashikuar në Statutin e Romës për një vendim mbi një ekzaminim paraprak. Në varësi të fakteve dhe të rrethanave të çdo shtate, prokurori do të vendosë nëse do të vazhdojë të mbledhë informacione për të krijuar një bazë të mjaftueshme faktike dhe ligjore për të marrë një vendim; fillimin e hetimit, duke iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor sipas rastit ose për mosfillimin e hetimit në qoftë se nuk ka baza të arsyeshme për të vazhduar.

Në përputhje me parimin e komplementaritetit, prokurori është i angazhuar, së bashku me autoritetet burundiane me qëllim diskutimin dhe vlerësimin e hetimeve dhe të ndjekjeve penale përkatëse në nivel kombëtar.⁵⁹

Situata në Kolumbi-Situata në Kolumbi ka qenë në shqyrtim paraprak që nga qershori i vitit 2004. Prokurori ka marrë komunikime të shumta në bazë të nenit 15 të Statutit të Romës në lidhje me situatën në Kolumbi.⁶⁰ Kolumbia ka depozituar instrumentin e saj të ratifikimit të Statutit të Romës më 5 gusht të vitit 2002. Për këtë arsye GJPN-ja ka juridiksion mbi krimet e Statutit të Romës, të kryera në territorin e Kolumbisë ose nga shtetasit e tij që nga

⁵⁹ <https://www.icc-cpi.int//Pages/item.aspx?name=otp-stat-25-04-2016>

⁶⁰ <https://www.icc-cpi.int/colombia>

1 nëntor i vitit 2002 e tutje.⁶¹ Ekzaminimi paraprak fokusohet në krime kundër njerëzimit dhe në krime lufte të kryera në kuadrin e konfliktit të armatosur në mes të forcave qeveritare, grupeve të armatosura paramilitare dhe grupeve të armatosura rebele, duke përfshirë krimet kundër njerëzimit si; vrasje, transferim i dhunshëm i popullsisë, burgim ose privime të tjera të rënda të lirisë fizike, tortura, përdhunim dhe forma të tjera të dhunës seksuale, krimet e luftës si: vrasje, sulme të qëllimshme kundër civilëve, tortura, trajtim tjetër mizor, nëpërkëmbje dinjiteti personal, marrje pengjesh, përdhunim dhe forma të tjera të dhunës seksuale dhe përdorimi i fëmijëve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në luftime. Shqyrtimi paraprak, gjithashtu fokusohet në ekzistencën dhe në vërtetësinë e procedurave kombëtare në lidhje me këto krime.⁶²

Situata në Guinea- Në dhjetor të vitit 2008, pas vdekjes së presidentit Lansana Conte, i cili kishte sunduar Guinean që nga viti 1984, kapiteni Moussa Dadis Camara udhëhoqi një grup të oficerëve të ushtrisë të cilët morën pushtetin në një grusht shteti ushtarak. Dadis Camara u bë kreu i shtetit, themelues i juntës ushtarake, gjegjësisht formoi Këshillin Kombëtar për Demokraci dhe Zhvillim (CNDD), dhe premtoi se CNDD-ja do të dorëzojë pushtetin për një president civil pas mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare. Megjithatë, deklaratat e mëvonshme, në të cilat u shfaq me sugjerimin se Dadis Camara mund të kandidojë për president, çuan në protesta grupet e opozitës dhe të shoqërisë civile. Më 28 shtator të vitit 2009, Ditën e Pavarësisë së Guinesë, protesta e opozitës në stadiumin kombëtar në Conakry u shtyp me dhunë nga forcat e sigurisë, duke çuar në atë që u bë e njohur si "masakër e 28 shtatorit".

⁶¹ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁶² <https://www.icc-cpi.int/colombia>

Në tetor të vitit të vitit 2009, OKB-ja kishte themeluar një komision ndërkombëtar të hetimit, i cili mes të tjerash, duhej të hetonte shkeljet e pretenduara të rënda të të drejtave të njeriut, që ndodhën më 28 shtator të vitit 2009 dhe nëse ishte e mundur, identifikimin e atyre që janë përgjegjës. Në raportin e fundit të dhjetorit të vitit të v.2009, Komisioni i OKB-së konfirmoi se të paktën 156 persona janë vrarë ose zhdukur, dhe të paktën 109 gra ishin viktime të përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale, duke përfshirë gjymtimet seksuale dhe skllavërinë seksuale. Gjatë këtij hetimi, gjithashtu janë konfirmuar rastet e torturës dhe të trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues dhe sulme ndaj civilëve në bazë të përkatësisë së tyre etnike ose politike.

Për hetimin e këtij rasti edhe autoritetet e Guinesë kishin ngritur një komision, ku në raportin e tij, të lëshuar në janar të vitit 2010 u konfirmua se vrasjet, përdhunimet dhe zhdukjet me forcë kishin ndodhur, edhe pse shifrat ishin pak më të ulëta sesa ato të dokumentuara nga Komisioni i OKB-së.

Më 8 shkurt të vitit 2010, në përputhje me rekomandimet e raporteve të Komisionit të OKB-së dhe të Komisionit të ngritur nga autoritetet guineane, Gjykata e Apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm emëruan tre gjyqtarë hetimorë guineanë ("paneli i gjyqtarëve") për të kryer një hetim kombëtar të ngjarjeve të 28 shtatorit të vitit 2009. Prandaj, edhe pse është duke u zhvilluar një hetim kombëtar, vlerësimi i prokurorit lidhur me pranueshmërinë është i përqendruar nëse autoritetet e vendit janë të gatshme dhe të afta për të kryer hetimet si duhet, dhe në veçanti nëse janë kryer procedurat me qëllim që brenda një afati të arsyeshëm të sillen para drejtësisë autorët e dyshuar. Zyra e prokurorit do të vazhdojë të

ndjekë nga afër ecurinë e procedurave kombëtare, si edhe për të inkurajuar autoritetet guineane në angazhimin e tyre për të finalizuar hetimin dhe gjykimin.⁶³

Zyra e prokurorit të GJNP-së, së bashku me OKB-në, që nga fillimi dhe vazhdimisht i ka dhënë mbështetje autoriteteve të Guinesë për të ecur përpara në procesin e hetimit të krimeve të pretenduara se janë të kryera në territorin e Guinesë, kurse në këtë rast GJNP-ja ka rol vetëm mbikëqyrës, por vetëm në rast të mossuksesit të procedurës ose dështimit të saj, për çfarëdo arsye, sigurisht që GJNP-ja do të marrë përsipër procedimin, dhe natyrisht luan rolin e garantuesit se krime të tilla, kudo që të ndodhin, nuk do të mbeten pa u ndëshkuar.

Rasti i Irakut/Mbretërisë së Bashkuar- Shqyrtimi paraprak i situatës në Irak fillimisht u ndërpre më 9 shkurt të vitit 2006 dhe u rihap më 13 maj të vitit 2014, pas marrjes së informacioneve të reja,⁶⁴ gjegjësisht më 10 janar të vitit 2014, Qendra Europiane për të Drejtat Kushtetuese dhe për të Drejtat e Njeriut ("ECCHR") së bashku me Avokatët e Interesit Publik ("PIL") paraqitën një artikull duke pretenduar përgjegjësinë e Mbretërisë së Bashkuar për krime të luftës që përfshijnë abuzimin sistematik të të ndaluarve në Irak nga viti 2003 deri në vitin 2008.⁶⁵

Ekzaminimi paraprak fokusohet në krimet e kryera nga shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar në kontekstin e konfliktit në Irak dhe pushtimin nga viti 2003 deri në 2008, duke përfshirë vrasje, tortura dhe format e tjera të keqtrajtimit.⁶⁶

⁶³ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁶⁴ <https://www.icc-cpi.int/iraq>

⁶⁵ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁶⁶ <https://www.icc-cpi.int/iraq>.

Zyra e prokurorit për momentin është e angazhuar në përpunimin dhe në analizimin e një sasive të madhe të materialit të dhënë nga dërguesit e komunikimit gjatë kryerjes së një vlerësimi të plotë të besueshmërisë së burimeve dhe me besueshmërinë e informacionit të marrë. Në kryerjen e vlerësimit të asaj nëse krimet e pretenduara përfshihen brenda juridiksionit të Gjykatës dhe nëse janë kryer në një shkallë të gjerë ose në bazë të një plani ose politike, Zyra e prokurorit merr parasysh gjetjet e hetimeve përkatëse, të kryera nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, si edhe rezultatet e procedurave të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë së Drejtësisë të Anglisë dhe Uellsit.⁶⁷

Situata në Nigeri-Shqyrtimi paraprak i situatës në Nigeri u bë publik më 18 nëntor të vitit 2010. Zyra e prokurorit ka marrë komunikime të shumta në bazë të nenit 15 të Statutit të Romës në lidhje me situatën në Nigeri. Ekzaminimi paraprak fokusohet në krimet e dyshuara që janë kryer në deltën e Nigerit, Shtetet e Brezit të Mesëm dhe në kontekstin e konfliktit të armatosur midis Boko Haram-it dhe forcave të sigurisë nigeriane, përfshirë krimet kundër njerëzimit - të vrasjes dhe persekutimit, dhe krime të shumta lufte.⁶⁸ Zyra do të vazhdojë të analizojë akuzat për krimet e kryera në Nigeri dhe për të vlerësuar pranueshmërinë e rasteve të mundshme, të identifikuara në mënyrë që të arrijnë një vendim nëse janë përmbushur kriteret për hapjen e një hetimi.⁶⁹

Shqyrtimi paraprak, gjithashtu fokusohet në ekzistencën dhe vërtetësinë e procedurave kombëtare në lidhje me këto krime.⁷⁰

⁶⁷ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁶⁸ <https://www.icc-cpi.int/nigeria>

⁶⁹ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁷⁰ <https://www.icc-cpi.int/nigeria>

Situata në Palestinë- Më 16 janar të vitit 2015, prokurori njoftoi hapjen e një shqyrtimi paraprak për gjendjen në Palestinë në mënyrë që të vendoset nëse janë përmbushur kriteret e Statutit të Romës për hapjen e një hetimi.⁷¹ Zyra e prokurorit është në proces të kryerjes së një vlerësimi të plotë faktik dhe ligjor të informatave në dispozicion, në mënyrë që të përcaktojë nëse ekziston një bazë e arsyeshme për të besuar se krimet brenda juridiksionit të Gjykatës kanë qenë ose janë duke u kryer. Në përputhje me politikën e saj të shqyrtimit paraprak, Zyra e prokurorit mund të mbledhë informacione mbi procedurat përkatëse kombëtare në këtë fazë të analizës. Çdo vendim nëse nuk ka një bazë të arsyeshme për të vazhduar me një hetim do të bazohet në një analizë të pavarur dhe të paanshme të të gjithë informacionit të besueshëm në dispozicion të Zyrës, në zbatimin e kriterëve ligjorë të përcaktuara në nenin 53 të Statutit të Romës.⁷² Në mënyrë të veçantë, në bazë të nenit 53 (1) të Statutit të Romës, prokurori duhet të marrë parasysh çështjet e juridiksionit, pranueshmërisë dhe interesat e drejtësisë në marrjen e këtij vendimi.⁷³

Situata në Ukrainë- Në vitin 1991, pas shpërbërjes e Bashkimi Sovjetik, Ukraina u bë një shtet i pavarur. Në kohën e fillimit të ngjarjeve, që janë objekt i ekzaminimi paraprak të Zyrës së prokurorit, Qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike në Ukrainë ishte e dominuar nga Partia e Rajoneve, e cila ishte edhe partia e presidenti të atëhershëm Viktor Janukoviç. Protestat “Maidan” u nxitën nga vendimi i Qeverisë së Ukrainës më 21 nëntor të vitit 2013 që të mos e nënshkruajë Marrëveshjen e Asociimit me Bashkimin European. Ky

⁷¹ <https://www.icc-cpi.int/palestine>

⁷² <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁷³ <https://www.icc-cpi.int/palestine>

vendim nuk u pëlqye nga ukrainasit proeuropianë, të cilët e perceptuan atë si një lëvizje më pranë Rusisë. Në të njëjtën ditë, filloi në Sheshin e Pavarësisë, në Kiev, protesta masive.⁷⁴

Ekzaminimi paraprak është fokusuar fillimisht në krime kundër njerëzimit të kryera në kuadër të protestave "Maidan", e cila u zhvillua në Kiev dhe në rajone të tjera të Ukrainës në mes të 21 nëntor të 2013-ës dhe 22 shkurt të 2014-ës, përfshirë vrasje, tortura dhe veprime të tjera çnjerëzore.⁷⁵

Pas depozitimit të një artikulli të ri në pajtim me nenin 12 (3) të Statutit të Romës, Zyra ka vendosur të zgjerojë shtrirjen kohore të shqyrtimit ekzistues paraprak dhe të përfshijë të gjitha krimet e dyshuara se janë kryer në territorin e Ukrainës nga 20 shkurti i vitit 2014 e në vazhdim.⁷⁶

Sipas Statutit të Romës për GJPN-në krim kundër njerëzimit nënkupton cilindo nga aktet në vijim si: vrasje, shfarosje, skllavërim, deportim ose transferim i popullsisë, burgosje ose privim i rëndë i lirisë fizike, duke shkelur rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare: torturë, përdhunim, skllavërim seksual, prostitucion i detyruar, sterilizim i detyruar, dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale e krahasueshme me këto etj., kur kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik drejtuar kundër cilësdo popullsi civile me dije për sulmin, kështu, për t'u konsideruar se në Ukrainë ishin kryer krime kundër njerëzimit duhej të vërtetohej nëse dhuna e ushtruar ishte pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik, mirëpo në bazë të informacioneve të siguruar nga Zyra e prokurorit nuk ka informata për këtë fazë, tek të cilat Zyra e prokurorit të mbështetë konkluzionin se sulmi i dyshuar, i kryer në kuadër të protestave "Maidan" ishte i përhapur ose sistematik.

⁷⁴ <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/OTP-PE-rep-2015-Eng.pdf>

⁷⁵ <https://www.icc-cpi.int/ukraine>

⁷⁶ <https://www.icc-cpi.int/ukraine>

Zyra e prokurorit do të vazhdojë të angazhohet me autoritetet ukrainase, me shoqërinë civile dhe me palët e tjera të rëndësishme për të gjitha çështje kryesore për shqyrtimin paraprak të situatës në Ukrainë.

Për sa i përket ngjarjeve që ndodhën pas 20 shkurtit të vitit 2014, Zyra e prokurorit do të vazhdojë që të mbledhë informacione nga burime të besueshme për të kryer një analizë të plotë faktike dhe juridike të krimeve të dyshuara se janë kryer në të gjithë Ukrainën, duke përfshirë ato në Krime dhe Donbas, për të përcaktuar nëse kriteret e vendosura nga Statuti i Romës për hapjen e një hetimi janë përmbushur. Në këtë kontekst, Zyra do të ndjekë nga afër progresin dhe rezultatet e hetimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në të shtënat poshtë avionit Malaysia Airlines MH17 në korrik të vitit 2014. Të gjitha krimet e pretenduara, që ndodhin në të ardhmen në kuadër të së njëjtës situatë, mund të përfshihen në analizën e Zyrës së prokurorit.⁷⁷

Situata me anijet e regjistruara të Komoras, të Greqisë dhe të Kamboxhias- Më 14 maj të vitit 2013 një firmë ligjore, që vepron në emër të Qeverisë së Unionit të Komoreve, ka paraqitur në Zyrën e prokurorit një referim "të Unionit të Komoreve" në lidhje me sulmin izraelit mbi Anijen e ndihmës humanitare, që shkonte për në Rripin e Gazës, sulm që ndodhi më 31 maj të vitit 2010, dhe kërkoi nga Prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale në përputhje me nenet 12, 13 dhe 14 të Statutit të Romës për të nisur "një hetim për krimet e kryera brenda juridiksionit të Gjykatës, që rrjedhin nga ky sulm ", dhe në të njëjtën ditë prokurori njoftoi hapjen e një shqyrtimi paraprak mbi situatën e referuar.⁷⁸

⁷⁷ <https://www.icc-cpi.int/ukraine>

⁷⁸ <https://www.icc-cpi.int/comoros>

Më 6 nëntor të vitit 2014, Zyra e prokurorit ka njoftuar se është duke përfunduar shqyrtimin paraprak të një situate të referuar nga Unioni i Komoreve, sepse kërkesat ligjore të Statutit të Romës për të vazhduar me një hetim nuk janë plotësuar, pasi rasti i mundshëm, që ka të ngjarë të vijë nga një hetim për këtë incident, nuk do të jetë e "një rëndësie të mjaftueshme" për të justifikuar veprimet e mëtejshme të gjykatës.⁷⁹

Më 29 janar të vitit 2015, përfaqësuesit e Qeverisë së Unionit të Komoreve paraqitën një kërkesë për shqyrtimin e vendimit të prokurorisë për të mos filluar një hetim të situatës. Më 16 korrik të vitit 2015, Dhoma e Procedurës Paraprake me shumicë votash vendosi se prokurori ka pasur gabime materiale në përcaktimin e tij lidhur me rëndësinë e rastit të mundshëm dhe kërkoi nga prokurori që të rishqyrtojë vendimin e tij për të mos hetuar.⁸⁰

Hetimet paraprake i ofrojnë një mundësi Zyrës së prokurorit në drejtim të inkurajimit të autoriteteve kombëtare për të përmbushur përgjegjësinë e tyre parësore dhe për të kryer hetimet dhe ndjekjet në nivel kombëtar. Në zbatimin e kriterëve të Statutit të Romës, Zyra e prokurorit duhet të përcaktojë nëse një situatë ka nevojë për një hetim, dhe nëse po, atëherë ai do ta bëjë këtë pa hezitim, kurse konsideratat politike nuk janë pjesë e vendimmarrjes së Zyrës së prokurorit.⁸¹

Përveç veprimeve, të cilat me Statutin e Romës janë përcaktuar se duhet t'i ndërmarrë prokurori, çdo herë kur ka informacione nga subjekte të ndryshme lidhur me kryerjen e krimeve brenda juridiksionit të GJPN-së, në situata të ndryshme prokurori ka një rol aktiv edhe në atë pjesën le ta quajmë joformale me ndërmarrjen e aktiviteteve të ndryshme në drejtim të inkurajimit të shteteve ku dyshohet se janë kryer ose janë duke u kryer krimet

⁷⁹ <https://www.icc-cpi.int//Pages/item.aspx?name=pr1170>

⁸⁰ <https://www.icc-cpi.int//Pages/item.aspx?name=pr1170>

⁸¹ <https://www.icc-cpi.int/about/otp?ln=en>

brenda juridiksionit të GJPN-së, që vetë të ndërmarrin hetimet dhe zhvillimin e procedurës, të bashkëpunojnë me GJPN-në për zbardhjen e krimeve ose edhe në apelet që prokurori i bën në vendet ku janë duke u zhvilluar konflikte të armatosura, që të përmbahen nga ndërmarrja e veprimeve të dhunshme sepse herët ose vonë do të ballafaqohen me drejtësinë dhe do të përgjigjen për krimet.

Situata në fazën e hetimeve

Deri më tani, katër shtete palë në Statutin e Romës – Uganda, Republika Demokratike e Kongos, Republika e Afrikës Qendrore dhe Mali kanë referuar në gjykatë situata që ndodhin në territorin e tyre. Përveç kësaj, Këshilli i Sigurimit ka referuar situata në Darfur-Sudan dhe Libi – të dyja shtete jo anëtare të Statutit. Pas një analize të plotë të informatave në dispozicion, prokurori ka hapur dhe është duke zhvilluar hetime në të gjitha situatat e lartpërmendura. Prokurori, gjithashtu ka nisur hetime *proprio motu* edhe në situatat në Keni, Bregun e Fildishtë dhe Gjeorgji.

Situata në Uganda- Hetimet e GJPN-së në Ugandë janë fokusuar në krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur, kryesisht në mes të Ushtrisë së Rezistencës së Zotit (LRA) dhe autoriteteve kombëtare, kryesisht në pjesën veriore të Ugandës, që nga 1 korrik i vitit 2002.

Pas marrjes së rekomandimit nga Qeveria e Ugandës, Zyra e prokurorit lëshoi një deklaratë për shtyp duke deklaruar: "Një çështje e rëndësishme do të jetë gjetja dhe arrestimi i udhëheqjes së LRA-së. Kjo do të kërkojë bashkëpunimin aktiv të shteteve dhe të institucioneve ndërkombëtare për të mbështetur përpjekjet e autoriteteve të Ugandës. Shumë nga anëtarët e LRA-së janë vetë viktimë, si janë rrëmbyer dhe brutalizuar nga

udhëheqja e LRA-së. Riintegrimi i këtyre individëve në shoqëri është kyç për stabilitetin e ardhshëm të Veriut të Ugandës. Kjo do të kërkojë mbështetjen e përbashkët të komunitetit ndërkombëtar. Uganda dhe Gjykata nuk mund ta bëjë këtë vetëm "

Hetimet për situatën në Ugandë filluan në korrik të vitit të vitit 2004 për krimet e supozuara të kryera në territorin e Ugandës si krimet e luftës, duke përfshirë vrasjen, trajtim mizor të civilëve, të drejtuar me qëllim për sulm kundër një popullsie civile, plaçkitja përfshirë edhe përdhunimin, dhe rekrutimin e detyruar të fëmijëve, krime kundër njerëzimit, përfshirë vrasje, skllavërim, skllavërim seksual, përdhunim, dhe veprime çnjerëzore të cilat kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe vuajtje.

Kjo situatë bëri që gjyqtarët e Dhomës së Procedurës Paraprake të lëshojnë urdhrin e parë të arrestimit të Gjykatës në vitin 2005, kundër anëtarëve të lartë të LRA-së. Të gjithë të dyshuarit mbetën në liri për një dekadë, derisa një anëtar i LRA-së, Dominic Ongwen, u dorëzua vetë në janar të 2015-ës. Anëtarët e tjerë të lartë të LRA-së, Joseph Kony dhe Vincent Otti, mbeten të lirë.⁸²

Sipas një deklaratë të lëshuar nga Zyra e prokurorit, përparimin e hetimeve dhe procesin e kapjes të udhëheqësve dhe komandantëve të LRA-së e vështirësojnë dhe e pengojnë vetë udhëheqja e LRA-së për faktin se ata kanë ende ndikim te personat e rangut të ulët ose të mesëm të rekrutuar në radhët e LRA-së, duke zhvilluar një propagandë të fuqishme për t'i bindur për mosbashkëpunim dhe mosdorëzim te GJPN-ja, duke u munduar t'i bindin se nëse dorëzohen ose bashkëpunojnë do të burgosen dhe do t'i nënshtrohen torturave dhe keqtrajtimeve ose edhe do të vdesin në burg (Message from the Prosecutor of the

⁸² <https://www.icc-cpi.int/uganda>

International Criminal Court, Fatou Bensouda, calling for defection by LRA fighters, dt.01 April.2016).⁸³

Situata në Republikën Demokratike të Kongos- Hetimet e GJPN-së në Republikën Demokratike të Kongos janë përqendruar në krime lufte dhe në krime kundër njerëzimit të kryera kryesisht në pjesën lindore, në rajonin Ituri dhe në Provincat e Veriut dhe Jugut Kivu, që nga 1 korrik i vitit 2002.

Në hapjen e hetimit në qershor të vitit 2004, Zyra e prokurorit të GJPN-së lëshoi një deklaratë për shtyp duke pranuar se krimet e pretenduara janë raportuar që nga viti 1990, por juridiksioni i Gjykatës filloi më 1 korrik të vitit 2002, dhe tha: "Shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare kanë raportuar mijëra vdekje nga vrasje masive dhe ekzekutime në territorin e Republikës Demokratike të Kongos që nga viti 2002. Raportet pretendojnë një model të përdhunimit, torturës, shpërnguljeve me forcë dhe rekrutimin dhe shfrytëzimin e paligjshëm të fëmijëve në ushtri. "

Hetimi çoi në një numër të rasteve që përfshijnë krimet: krimet e luftës përfshirë rekrutimin dhe mobilizimin e fëmijëve në ushtri nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç dhe përdorimin e tyre për të marrë pjesë aktive në luftime, në vrasje dhe tentativë për vrasje, vrasje me paramendim, sulm ndaj civilëve, përdhunim, skllavërim seksual të civilëve, plaçkitje, shpërngulje të civilëve, sulm ndaj objekteve të mbrojtura, shkatërrim të pronës, përdhunim, skllavërim seksuale, gjymtim, trajtim mizor, tortura, shkatërrim të pronës, plaçkitje dhe akte fyese ndaj dinjitetit personal, dhe krime kundër njerëzimit: vrasje dhe tentim vrasje, tortura, përdhunimi, skllavëria seksuale, aktet çnjerëzore, persekutimi, transferim i dhunshëm i popullsisë, sulmi ndaj popullatës civile, shkatërrimin e pronës dhe plaçkitje.

⁸³ <https://www.icc-cpi.int//Pages/item.aspx?name=160401-otp-stat>

Ky ishte hetimi i parë i Zyrës së prokurorit, i cili rezultoi me ngritjen e aktakuzave kundër Thomas Lubanga Dyilo-s, Germain Katanga-s, Ntaganda dhe Ngudojolo Chui-t, i cili më 18 dhjetor të vitit 2012 nga Dhoma Gjyqësore II u lirua nga akuzat, kurse gjykimi ndaj Ntaganda-s është në vazhdim e sipër.⁸⁴

Situata në Darfur-Sudan- Hetimet e GJPN-së në lidhje me situatën në Darfur fokusohen në akuzat për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në Darfur-Sudan, që nga 1 korrik i vitit 2002.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka përcaktuar se "situata në Sudan vazhdon të përbëjë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare", duke marrë parasysh raportin e Komisionit Ndërkombëtar Hetimor për shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjit të të drejtave të njeriut në Darfur. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka themeluar Komisionin "për të hetuar raportet e shkeljeve të ligjit humanitar dhe të të drejtave të njeriut në Darfur nga të gjitha palët, për të përcaktuar edhe a kanë ndodhur ose jo akte të gjenocidit, për të identifikuar autorët e shkeljeve të tilla dhe të njëjtët të përgjigjen. " Komisioni mori si pikënisje dy fakte: "Së pari, sipas Kombeve të Bashkuara vlerësohet se janë 1.65 milion persona të zhvendosur brenda vendit në Darfur, dhe më shumë se 200.000 refugjatë nga Darfuri kanë shkuar në vendin fqinj Chad. Së dyti, ka një shkatërrim në shkallë të gjerë të fshatrave përgjatë tri shteteve të Darfurit. "

Hetimi i GJPN-së për rastin e Darfurit, e cila u hap në qershor të vitit 2005, ka rezultuar me disa raste të të dyshuarish duke filluar nga zyrtarë të Qeverisë së Sudanit, udhëheqësve të grupit Janjaweed, dhe udhëheqësit e Frontit të Rezistencës, duke i përfshirë në akuzat që përfshijnë krimet e mëposhtme: gjenocid duke vrarë, gjenocid duke shkaktuar dëmtime

⁸⁴ <https://www.icc-cpi.int/drc>

serioze trupore ose mendore, dhe gjenocid nga ndërhyrja e qëllimshme në grup duke synuar krijimin e kushteve të jetës të tilla me qëllim shkatërrimin fizik të grupit, krimet e luftës si: vrasje, sulme kundër popullsisë civile, shkatërrim prone, përdhunimin, plaçkitje dhe nëpërkëmbje të dinjitetit personal, dhunë ndaj jetës dhe personit, sulm me qëllim personelin, instalimet, materialet, njësitë ose automjetet e përfshira në një mision paqeruajtës, dhe krimet kundër njerëzimit: vrasje, persekutim, transferim të dhunshëm të popullsisë, përdhunim, veprime çnjerëzore, burgim ose privimi i rëndë i lirisë, tortura dhe shfarosje. Situata në Darfur ishte situata e parë që iu referua GJPN-së nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe të parat hetime të GJPN-së në territorin e një shteti që nuk është Palë në Statutin e Romës. Ky, gjithashtu ishte hetimi i parë i GJPN-së, që ka të bëjë me pretendimet e krimit të gjenocidit.

Presidenti i Sudanit, Omar Al Bashir, është presidenti i parë i kërkuar nga GJPN-ja, dhe personi i parë që do të jetë i akuzuar nga GJPN-ja për krimin e gjenocidit. GJPN-ja ka lëshuar dy urdhër arreste për Omar Al Bashir-in, por asnjëri prej tyre nuk është zbatuar.⁸⁵

Situata në Republikën e Afrikës Qendrore - Hetimet e GJPN-së në Republikën e Afrikës Qendrore janë përqendruar në krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në kontekstin e një konflikti në këtë territor që nga 1 korriku i vitit 2002, dhunë që arriti kulmin në vitin 2002 dhe 2003.

Në hapjen e hetimit në maj të vitit 2007, Zyra e prokurorit lëshoi një deklaratë për shtyp duke deklaruar: "Bazuar në një analizë paraprake të krimeve të dyshuara, kulmi i dhunës dhe të kriminalitetit të ndodhur në vitet 2002 dhe 2003, janë civilët e vrarë dhe të përdhunuar, shtëpi e dyqane janë plaçkitur, ndodhën krimet e dyshuara në kontekstin e një

⁸⁵ <https://www.icc-cpi.int/darfur>

konflikti të armatosur mes forcave qeveritare dhe kryengritësve. Kjo është hera e parë që prokurori ka hapur një hetim në të cilin akuzat e krimeve seksuale i tejkalojnë krimet e supozuara të vrasjeve. Janë kryer qindra përdhunime ku viktimat kanë ardhur për të treguar historitë e tyre, duke rrëfyer krimet ku është vepruar me egërsi të veçantë. Viktimat kanë përshkruar hollësisht detajet e përdhunimit në publik; janë sulmuar nga persona të shumtë, janë përdhunuar në prani të anëtarëve të familjes dhe janë keqtrajtuar me mënyra të tjera në rast se kanë rezistuar ndaj sulmuesve të tyre. Shumë prej viktimave ishin tërhequr më pas nga rrethi i familjeve dhe nga komuniteti i tyre "...

Në këtë rast është akuzuar Jean-Pierre Bemba Gombo, përfshirë akuzat për krimet e luftës: vrasje, përdhunim dhe plaçkitje; dhe krimet kundër njerëzimit: vrasje dhe përdhunim. Gjithashtu, procedimet filluan në një rast tjetër që përfshin akuza kundër pesë të dyshuarve për vepra kundër administrimit të drejtësisë, gjoja të kryera në lidhje me rastin e prokurorit kundër Jean-Pierre Bemba Gombo.⁸⁶

Situata në Kenia- Hetimet e GJPN-së janë përqendruar në krime kundër njerëzimit të kryera në kontekstin e dhunës paszgjedhore në Kenia në vitin 2007-2008, në gjashtë nga tetë provincat keniane: Nairobi, Luginën Veriore Valley, Luginën Qendrore Valley, Luginën Jugore Valley, Provincën Nyanza dhe Provincën Perëndimore.

Gjatë dhënies së lejes për të hapur një hetim, Dhoma e Procedurës Paraprake vuri në dukje rëndësinë dhe shkallën e dhunës. Prokurori argumentoi se mbi 1,000 njerëz u vranë, kanë ndodhur mbi 900 akte përdhunimi të dokumentuara, si dhe akte të dhunës seksuale, rreth 350,000 njerëz janë zhvendosur, dhe mbi 3,500 u plagosën rëndë. Dhoma nëpërmjet prokurorit vuri në dukje se: "... elemente të brutalitetit, për shembull djegien e viktimave të

⁸⁶ <https://www.icc-cpi.int/car>

gjallë, duke sulmuar vende strehimi, prerje kokash, dhe duke përdorur mjete për kollitje, që çuan në vdekje njerëzish", dhe se autorët, në mesin e akteve të tjera, thuhet se terrorizuan "komunitetet duke vënë pika kontrolli, me qëllim që ata të zgjidhnin viktimat e tyre në bazë të përkatësisë etnike. Kryerja e përdhunimit zakonisht bëhet nga bandat, si p.sh, gjymtim të organeve gjenitale, dhe shpesh i kanë detyruar anëtarët e familjes që të shikojnë krimet e kryera prej tyre."

Dhoma Procedurës Paraprake gjithashtu, vërejti nga tregimet e viktimave sesi ka ndikuar dhuna ndaj viktimave: "Lëndimet e pësura rezultuan me pamundësinë e viktimave fëmijë që të vazhdojnë arsimimin e tyre, kushtet e këqija të jetesës dhe probleme shëndetësore në kampet e të zhvendosurve, dëme psikologjike të tilla si trauma, stres dhe depresion, humbje të të ardhurave për shkak të humbjes së vendeve të punës ose paaftësi për të rikrijuar biznesin e tyre, fshehje të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme pas përdhunimit, braktisjen pas përdhunimit, dhe ndarjen e familjeve. "

Hetimi ka rezultuar me ngritjen e aktakuzave fillimisht ndaj gjashtë të dyshuarve, përfshirë akuza që përfshijnë krimet: krimet kundër njerëzimit: vrasje, dëbim apo zhvendosjen e dhunshme të popullsisë, persekutimin, përdhunim, dhe akte të tjera çnjerëzore.

Megjithatë akuzat nuk janë konfirmuar dhe janë tërhequr për këto gjashtë të dyshuar.

Rasti i Kenias paraqet rastin e parë në të cilin prokurori ka hapur një hetim *proprio motu*.⁸⁷

Situata në Libi- Këshilli i Sigurimit i OKB-së e ka referuar situatën në Libi në GJPN, me këtë akt ka dënuar dhunën dhe përdorimin e forcës kundër civilëve, duke kritikuar shkeljen e rëndë dhe sistematike të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe shtypjen e demonstruesve paqësorë, duke shprehur shqetësim të thellë për vdekjen e civilëve, dhe

⁸⁷ <https://www.icc-cpi.int/kenya>

duke hedhur poshtë pa mëdyshje nxitjen e armiqësisë dhe dhunës ndaj popullsisë civile të kryera nga nivelet më të larta të qeverisë libiane ".

Kërkesa vuri në dukje se sulmet e përhapura dhe sistematike kundër popullatës civile mund të përbëjnë krime kundër njerëzimit, dhe shprehu shqetësimin për gjendjen e refugjatëve të cilët janë të detyruar të largohen me dhunë si dhe shqetësimin e paraqitur nga raportet e nxjerra për mungesën e furnizimeve mjekësore për të trajtuar të plagosurit. Kërkesa nënvizoi "nevojën për të respektuar liritë e tubimit paqësor dhe të shprehjes, duke përfshirë lirinë e mediave" dhe theksoi "nevojën që të japin llogari ata që janë përgjegjës për sulme, duke përfshirë edhe sulmet ndaj civilëve prej forcave që janë nën kontrollin e tyre ".

Hetimi, i cili u hap në mars të vitit 2011 dhe që vazhdon deri më tani ka rezultuar me ngritjen e aktakuzave kundër tre të dyshuarve, duke përfshirë akuzat për krimet kundër njerëzimit: vrasjen dhe persekutimin.

Urdhërarresti i lëshuar kundër Muamar Mohammed Abu Minyar Gadafit është tërhequr më 22 nëntor të vitit 2011, për shkak të vdekjes së tij.

Situata në Libi ishte e dyta që iu referua GJPN-së nga ana e Këshilli të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe hetimi i dytë i GJPN-së ishte në territorin e një shteti që nuk është palë në Statutin e Romës (Rasti i Darfur-Sudan-it ishte i pari).⁸⁸

Situata në Bregun e Fildishtë- Hetimi është fokusuar në krime kundër njerëzimit të kryera në vitet 2010-2011 gjatë dhunës paszgjedhore në Bregun e Fildishtë. Sipas njoftimeve, dhuna pas zgjedhjeve shpërtheu pasi rezultatet e zgjedhjeve presidenciale në mes të kundërshtarëve Mr Laurent Gbagbo dhe Mr Alassane Ouattara u kontestuan.

⁸⁸ <https://www.icc-cpi.int/libya>

Gjatë dhënies së lejes për të hapur një hetim, Dhoma e Procedurës Paraprake vuri në dukje synimin e Zyrës së prokurorit për të hetuar veprimet e të dyja forcave pro-Gbagbo dhe pro-Ouattara. Prokurori parashtroi se sulme të drejtuara kundër popullatës civile në Bregun e Fildishtë kanë qenë të përhapura dhe sistematike, dhe kanë përfshirë, për shembull, sulmet e kryera në selinë e palës kundërshtare, forcën e tepruar të përdorur në zonat e populluara, kryesisht për të shpërndarë protestuesit, barrikadat ushtarake dhe pikat e kontrollit të ngritura në të cilat thuhet se kanë ndodhur vrasjet. Prokurori parashtroi se veprimet ishin në një shkallë të gjerë, dhe se rreth 1 milion njerëz janë zhvendosur, e gjithashtu materiali i poseduar nga prokurori ka treguar edhe ekzistencën e disa varreve masive në Abixhan, si dhe dokumentacionit në lidhje me arrestimet arbitrare të përhapura, "zhdukjet" dhe incidentet e përdhunimit.

Hetimi ka rezultuar me ngritjen e aktakuzave të cilat përfshijnë krimet: krimet kundër njerëzimit: vrasje, përdhunim, veprime të tjera çnjerëzore, tentim vrasje dhe persekutim.

Ky ishte hetimi i parë që u hap në një vend i cili ka pranuar juridiksionin e Gjykatës (sipas nenit 12 (3) të Statutit të Romës), por nuk ishte ende një shtet palë i Statutit të Romës.⁸⁹

Situata në Mali-Hetimet në Mali janë fokusuar në krime lufte të kryera që nga janari i vitit 2012, kryesisht në tri rajonet veriore në Gao, Kidal dhe Timbuktu, me incidente të ndodhura në jug në Bamako dhe Sevare.

Në hapjen e hetimit në janar të vitit 2013, Zyra e prokurorit ka lëshuar një raport bazuar në nenin 53 (1), i cili thotë: "Në vitin 2012, Situata në Mali u shënua me dy ngjarje kryesore: së pari, daljen e një rebelimi në veri ose rreth 17 janarit, e cila rezultoi me pushtimin e pjesës veriore të Malit nga grupet e armatosura; dhe së dyti një grusht shteti nga një juntë

⁸⁹ <https://www.icc-cpi.int/cdi>

ushtarake më 22 mars, e cila çoi në rrëzimin e presidentit Toure pak para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, të planifikuara për në 29 prill të 2012-ës. "

Raporti tregon se rebelimi në veri përfshiu dëmtimin me qëllim të tempujve të shenjtoreve myslimanë në qytetin e Timbuktu-s, sulmet mbi një bazë ushtarake në Gao, Kidal dhe Timbuktu, ekzekutimin e dyshuar midis 70 dhe 153 të burgosurve në Aguelhok, dhe incidentet e grabitjeve dhe përdhunimeve. Në kontekstin e grushtit ushtarak janë raportuar edhe incidente të torturave dhe zhdukjeve me forcë.

Prokurori pretendon se ekziston një bazë e arsyeshme për të besuar se krimet e mëposhtme janë kryer në Mali si p.sh.: krimet e luftës, duke përfshirë vrasjen, gjymtimin, trajtimin mizor dhe tortura, sulmin me qëllim kundër objekteve të mbrojtura, shqiptimin e dënimeve dhe kryerjen e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake, të shpallura nga një gjykatë e rregullt, plaçkitje dhe përdhunime.⁹⁰

Situata në Republikën e Afrikës Qendrore II- Hetimet e GJPN-së në Republikën e Afrikës Qendrore II janë fokusuar në krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të kryera në kontekstin e një konflikti që nga 1 gushti i vitit 2012. Konflikti i vitit 2012 thuhet se përfshin krimet e pretenduara nga të dyja grupet: myslimanët Seleka dhe grupe të krishtera anti-Balaka. Dhuna e përdorur gjatë kësaj periudhe dyshohet se çoi në mijëra të vdekur, por dhe duke lënë qindra e mijëra të zhvendosur. OKB-ja gjithashtu ka paralajmëruar edhe për rrezikun e lartë për kryerjen e gjenocidit në Republikën e Afrikës Qendrore.

Në hapjen e hetimit në shtator të vitit 2014, Zyra e prokurorit lëshoi një deklaratë për shtyp ku thuhet: "Të dhënat në dispozicion sigurojnë një bazë të arsyeshme për të besuar se të dy grupet Seleka dhe anti-Balaka kanë kryer krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, duke

⁹⁰ <https://www.icc-cpi.int/mali>

përfshirë vrasje, përdhunim, zhvendosje të detyruara, persekutim, rrëmbim, sulmet kundër misionëve humanitare dhe përdorimin e fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetëvjeçare në luftime. Lista e krimeve është e pafundme. Unë nuk mund t'i injoroj këto krime të pretenduara. "

Prokurori pretendon se ekziston një bazë e arsyeshme për të besuar se krimet e mëposhtme janë kryer në territorin e Republikës së Afrikës Qendrore që nga viti 2012 si krimet e luftës: vrasje, përdhunim, plaçkitje, sulme kundër misionëve humanitare, si dhe përdorimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetëvjeçare në luftime dhe krime kundër njerëzimit si: vrasje, përdhunim, zhvendosje e detyruar dhe persekutim.⁹¹

Situata në Gjeorgji- Hetimet e GJPN-së fokusohen në krimet e pretenduara se janë kryer në kuadrin e një konflikti të armatosur ndërkombëtar midis 1 korrikut dhe 10 tetorit të vitit 2008, në dhe rreth Osetisë së Jugut, duke përfshirë krimet kundër njerëzimit: vrasje, transferim me forcë të popullatës dhe persekutim, krimet e luftës: sulmet kundër popullatës civile duke vrarë me paramendim, sulmi i qëllimshëm kundër paqeruajtësve, shkatërrimi i pronës dhe plaçkitje.

Në shqyrtimin paraprak të saj, Zyra e prokurorit ka "mbledhur informacione mbi krimet e pretenduara të cilat u atribuohen tri palëve të përfshira në konfliktin e armatosur: forcave të armatosura gjeorgjiane, forcave të Osetisë së Jugut dhe forcave të armatosura ruse"

Lidhur me procedurat kombëtare dhe procedurat e parimit të komplementaritetit, prokurori tha: "Sipas parimit të komplementaritetit në Statutin e Romës, GJPN-ja nuk mund të vazhdojë me hetimin dhe procedimin nëse autoritetet kombëtare tashmë janë duke ndërmarrë ose kanë ndërmarrë procedurat e brendshme për të njëjtin rast. Autoritetet

⁹¹ <https://www.icc-cpi.int/carli>

kompetente kombëtare të Gjeorgjisë dhe Rusisë janë të angazhuara në kryerjen e hetimeve ndaj atyre që duket se janë përgjegjës për disa nga krimet e identifikuar. Këto masa hetuese, përkundër disa sfidave dhe vonesave, duket se janë duke përparuar. Megjithatë, në mars të vitit të kaluar, autoritetet kombëtare në Gjeorgji i pezulluan hetimet për një kohë të pacaktuar. Zyra vazhdon të monitorojë procedurat përkatëse në Rusi, të cilat, sipas të dhënave të Zyrës, janë ende në vazhdim e sipër.

Në kërkesën e prokurorit për të hapur një hetim, Dhoma vuri në dukje se përfaqësimet nga ose në emër të 6,335 viktimave në këtë çështje flasin në favor të hapjes së një hetimi", vendim që me shumicë dërmuese është marrë më 4 dhjetor të 2015-ës.

Më 8 tetor të vitit 2015, Kryesia e GJPN-së caktoi situatën në Gjeorgji para Dhomës së procedurës paraprake, pas një njoftimi nga prokurori për qëllimin e saj për të paraqitur një kërkesë para Dhomës së Procedurës Paraprake për dhënien e autorizimit për të hapur një hetim për situatën në Gjeorgji. Prokurori i GJPN-së njoftoi shqyrtimin paraprak të situatës në Gjeorgji, më 14 gusht të vitit 2008. Në bazë të informatave në dispozicion, prokurori doli në përfundimin se ekziston një bazë e arsyeshme për të besuar se krimet brenda juridiksionit të Gjykatës janë kryer në Gjeorgji në kontekstin e konfliktit të armatosur të gushtit të vitit 2008. Në mbështetje të nenit 15 (3) të Statutit të Romës, prokurori paraqiti kërkesë para Dhomës së Procedurës Paraprake për marrjen e autorizimit për të hapur një hetim për këtë situatë më 13 tetor të vitit 2015.⁹²

Më 27 janar të vitit 2016, Zyrës së prokurorit të GJPN-së iu dha autorizimi nga ana e gjyqtarëve të Dhomës së Procedurës Paraprake I, për të filluar hetimet për krimet e

⁹² <https://www.icc-cpi.int/georgia>

pretenduara nga GJPN-ja e që kanë ndodhur në territorin e Gjeorgjisë në mes të 1 korrikut të vitit 2008 dhe 10 tetor të vitit 2008.⁹³

Çështja e suksesit ose mospushtimit të hetimeve dhe e procedurës së gjyqkimit në përgjithësi është e lidhur ngushtë me gatishmërinë e shteteve që të bashkëpunojnë me GJPN-në, si në sferën e hetimit të krimeve, po ashtu edhe në drejtim të arrestimit të personave të kërkuar nga GJPN-ja. Mirëpo edhe përkundër obligimit të shteteve, që në bazë të Rezolutës 1593 (2005) të KS të OKB-së, të bashkëpunojnë me gjykatën plotësisht, realiteti duket pak më ndryshe. Për shembull, në rastin e Sudanit të akuzuarit kryesorë për krimet nën juridiksionin e GJPN-së, janë ende të lirë, dhe përveç kësaj vazhdojnë të mbajnë pozita të larta në qeverinë e Sudanit. I dyshuari kryesor, presidenti Omar al-Bashir, ende vazhdon të shëtisë lirisht edhe në shtetet të cilat janë palë e Statutit të Romës, si në Afrikën Jugore më 13 qershor të vitit 2015, në Republikën Djibouti më 8 maj të vitit 2016 dhe në Republikën e Ugandës më 11 maj të vitit 2016.⁹⁴ Në rastin konkret Zyra e prokurorit të GJPN-së, fajëson drejtpërdrejt Këshillin e Sigurimit të OKB-së për dështimin e saj fillimisht në drejtim të detyrimit të shteteve që të bashkëpunojnë me GJPN-në dhe të arrestojnë të dyshuarit në qoftë se ata qëndrojnë në territoret e tyre, por edhe të mos tolerojë veprimet e qeverisë së Sudanit për mosbashkëpunim, sepse në bazë të Rezolutës 1593 (2005) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së qeveria e Sudanit dhe të gjitha palët e tjera, që janë pjesë e konfliktit në Darfur, duhet të bashkëpunojnë plotësisht dhe t'i ofrojnë çfarëdo ndihme gjykatës dhe prokurorit. Si rezultat i dështimit të arrestimit të Al-Bashir-it dhe të dyshuarve të tjerë në rastin e Sudanit, viktimat dhe dëshmitarët janë të frustruar nga dështimi i bashkësisë

⁹³ <https://www.icc-cpi.int//Pages/item.aspx?name=otp-stat-27-01-2016-georgia>

⁹⁴ https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/23-otp-rep-UNSC-darfur_ENG.pdf

ndërkombëtare në drejtim të vendosjes së sundimit të së drejtës. Edhe një fatkeqësi tjetër në rastin e Sudanit është fakti se aty ende vazhdojnë të kryhen krime nga më të ndryshmet, të cilat sipas mendimit të Zyrës së prokurorit nëse bëhet arrestimi i të dyshuarit kryesor, Al-Bashir-it, ky fakt mund të mund të kontribojë shumë në ndalimin e krimeve të tilla (Twenty-third report of the prosecutor of the International Criminal Court to the UN Security Council pursuant to UNSCR 1593 (2005), 1 April 2016).⁹⁵

⁹⁵ https://www.icc-cpi.int/iccdocs/otp/23-otp-rep-UNSC-darfur_ENG.pdf

KAPITULLI V: JURIDIKSIONI

5.1. *Nocioni*

Juridiksioni i gjykatave ka të bëjë me kompetencën e gjykatave që të gjykojnë veprimet kriminale brenda territorit të tyre shtetëror. Juridiksioni është pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror, i cili nënkupton supremacionin e organeve të shtetit në ushtrimin e pushtetit shtetëror, brenda kufijve të territorit shtetëror.

Sovraniteti është njëri ndër konceptet fundamentale të së drejtës ndërkombëtare. Ai është pjesë integrale e parimit të barazisë së shteteve, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve. Shteti nëpërmjet sovranitetit aplikon autorizimet e tij ndaj njerëzve në një territor të caktuar (Dixon&McCorquodale,2010,245). Sovraniteti i shtetit është koncept i cili përfshin më shumë sfera, dhe implikimi i tij ndihet si në sferën nacionale, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Pjesë e sovranitetit shtetëror është aktiviteti administrativ shtetëror, juridik, ekzekutiv dhe ligjdhënës, i cili ndryshe quhet edhe sovraniteti juridik shtetëror (Dixon&McCorquodale,2010,282). Nëpërmjet sovranitetit shteti ushtron kompetencat e tij ndaj njerëzve, gjegjësisht personave fizikë dhe juridikë si dhe nëpërmjet sovranitetit përcaktohen rrethanat nën të cilat shteti ushtron kompetencat e tij. Aplikimi i kompetencave ndaj personave dhe pronës, përfshin veprimet e shtetit në sferën e rregullave ligjore, nëpërmjet veprimtarisë policore dhe gjyqësore. Veprime të tilla të shtetit mund të kenë pasoja ndërkombëtare, në rastet kur shteti kompetencat e tij i ushtron ndaj shtetasve të huaj ose ndaj pronës së shtetit tjetër, si dhe në drejtim të akteve që kryhen në territorin e shtetit tjetër (Dixon&McCorquodale,2010,282).

Shtrirja e pushtetit gjyqësor të një shteti, në periudha të ndryshme të historisë, është klasifikuar në mënyra të ndryshme. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, për shembull, fushëveprimi juridik i shteteve mbi veprimet e gabuara të kriminelëve konsiderohej në bazë të kushteve të mëposhtme:

- Për ndëshkimin e të gjitha veprave kundër ligjeve të brendshme të shtetit, nga kushdo që i ka kryer, brenda territorit shtetëror;
- Me dënimin e të gjitha krimeve të tilla, nga kushdo që i ka kryer, në bordin e anijeve të saj publike dhe private në det të hapur, dhe në bordin e anijeve të saj publike në portet e huaja;
- Me dënimin e të gjitha krimeve të tilla, të kryera kudo, nga subjektet e saj;
- Për ndëshkimin e piraterisë, dhe për vepra të tjera kundër ligjit ndërkombëtar nga kushdo dhe kudo që të jetë kryer; (Malekian,1991:10).

Për sa i përket juridiksionit të gjykatave brenda një territori shtetëror, nuk ka dilema, sepse nënkuptohet se pushteti i të gjitha organeve shtetërore, e me këtë edhe i organeve gjyqësore ushtrohet mbi njerëzit, pra gjegjësisht mbi popullin i cili jeton brenda kufijve të një shteti.

Problemi lind kur na paraqiten raste të tjera si, p.sh., kur shtetasit e huaj kryejnë vepra penale në shtetin tonë, kur shtetasit tanë kryejnë vepra penale në shtetin tjetër, ose kur nga shtetasit e shtetit ose shtetasit e huaj kryhen vepra kundër sigurisë ose interesave të një shteti të caktuar.

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura brenda një territori të caktuar ose midis dy e më shumë shteteve, shumë e ndjeshme është çështja kur kryhen krime ndërkombëtare të cilat nuk parashkruhen. Zakonisht shtetet, udhëheqësit e të cilave kryejnë

krime të tilla, nuk janë të gatshëm t'i nxjerrin para drejtësisë dhe t'i gjykojnë kriminelë të tillë.

Si rezultat i një qëndrimi të tillë dhe nga e vetëdijesimi se krimet dhe kriminelët e tillë duhet të gjykohen, u themeluan Tribunalet *ad hoc* si dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare, të cilat janë kompetente për gjykimin e krimeve të tilla.

Lidhur me çështjen e kompetencës për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, Statutet e Tribunaleve *ad hoc* si dhe Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, e rregullojnë në mënyra të ndryshme.

Sipas marrëveshjes së Londrës, me të cilën fuqitë fituese të LDB-së nënshkruan themelimin e një gjykate e cila do të ketë në kompetencë ekskluzive gjykimin e kriminelëve nazistë, që cilët kryen krime gjatë LDB-së, parashihej kompetenca ekskluzive e Tribunalit për krimet dhe kriminelët e caktuar. Edhe Tribunali i Tokios, i themeluar dhe i mbështetur mbi të njëjtat parime si ato të Nurembergut, kishte kompetencë ekskluzive për gjykimin e kriminelëve japonezë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përgjatë periudhës së LDB-së.

Tribunalet e mëvonshme *ad hoc*, gjegjësisht ai i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë dhe ai i Ruandës për gjykimin e krimeve gjatë zhvillimit të luftës civile, në Statutet e tyre parashohin se për krime të tilla kompetencë parësore kanë Tribunalet në raport me gjykatat nacionale.

Statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së, në nenet 8 dhe 9, mundësojnë që secili Tribunal të ketë juridiksion konkurrues në raport me gjykatat nacionale, të ndjekë penalisht personat për shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, mirëpo në paragrafin e dytë theksohet se Tribunali duhet të ketë rol parësor ndaj gjykatave nacionale. Në bazë të kësaj

parashihet se në cilëndo fazë të procedurës, Tribunali Ndërkombëtar mundet formalisht të kërkojë që gjykatat nacionale të bazohen në kompetencën e Tribunalit të paraparë në statut dhe te Rregullat e Procedurës dhe Provave të Tribunalit.

Në literaturë përmenden disa arsye të cilat ndikuan në përcaktimin e rolit parësor në krahasim me gjykatat nacionale, si në rastin e ish-Jugosllavisë ku konfliktet e armatosura aktuale midis shteteve të sapoformuara si dhe armiqësitë e rrënjosura thellë në mes grupeve të ndryshme etnike dhe religjioze sollën deri te mungesa e vullnetit dhe e mundësisë së gjykatave nacionale që të zhvillojnë gjykime të paanshme. Një frymë e tillë e ngjashme ka mbretëruar edhe në Ruandë, ku sistemi nacional juridik kishte përjetuar kolaps, me çka ishte i pafuqishëm që të vendoste drejtësinë (Cassese,2003:339).

Kurse në Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, parashihet se GJPN-ja ka rol komplementar, në raport me gjykatat nacionale, për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të cilat parashihen në Statutin e Romës.

Gjykatat nacionale gëzojnë rol parësor në ushtrimin e juridiksionit në kushte të veçanta në rastet kur GJPN-ja është e autorizuar të ndërmarrë dhe të mbrojë juridiksionin e saj. Në literaturë përmenden dy arsye për një qasje të tillë të ushtrimit të juridiksionit nga ana e GJPN-së në raport me gjykatat nacionale.

Shtetet, duke u nisur nga arsye praktike, menduan se do të ishte e papërshtatshme që gjykata të përmbytet me raste nga e gjithë bota, meqë gjykata ka një numër të caktuar gjyqtarësh, resurse dhe infrastrukturë të kufizuar dhe nuk mundet të dalë në krye me një gamë aq të gjerë të rasteve. Për këtë arsye u mendua se do të ishte më mirë që një numër i madh i rasteve, të cilat kanë të bëjnë me kriminalitetin ndërkombëtar t'i lihen gjykatave nacionale, të cilat do të jenë në gjendje që, në mënyrën e duhur, të vendosin legjislacionin e

tyre mbi rastet e caktuara duke u bazuar në parimet e territorialitetit, nacionalitetit si dhe në bazë të parimit të universalitetit. Gjithashtu, gjykatat nacionale do të jenë në pozitë më të favorshme për mbledhjen e fakteve dhe për planifikimin e procesit kundër të akuzuarit.

Si arsye tjetër përmendet gjithashtu, motivimi principal, gjegjësisht qëllimi që të respektohet sovraniteti shtetëror sa më shumë që të jetë e mundur.

Raporti dytësor i GJPN-së, në krahasim me gjykatat nacionale, është i përfshirë në nenin 10 të Preambulës dhe në nenin 1 të Statutit si dhe në nenet 15,17,18 dhe 19 të Statutit. Gjykata është e mbyllur për të vendosur të drejtën mbi një formë kriminale në rastet ku gjykata nacionale e vendos juridiksionin e saj mbi kriminalitetin e njëjtë: a) kur shteti ka juridiksion në bazë të së drejtës së brendshme, b) kur rasti është hetuar ose është aplikuar drejt nga ana e organit ligjdhënës ose kur organet kanë vendosur drejt për mosndjekjen e personit ose c) rasti nuk e ka rëndësinë e duhur që të arsyetojë veprimet e gjyqit si dhe d) të mos e arrestojë dhe gjykojë personin i cili veçmë është gjykuar ose liruar për shkeljet e njëjta në qoftë se gjykimi ka qenë *fer* dhe korrekt. Kurse në të kundërt të kësaj GJPN-ja do të vendosë juridiksion mbi një shkelje, edhe mbi një rast i cili ende nuk është zgjidhur para organeve shtetërore, si në rastet kur: a) shteti nuk ka mundësi ose vullnet që në mënyrë të drejtë të hetojë dhe ta ndjekë personin ose në bazë të zgjedhjes së saj të mos e ndjekë personin dhe b) rasti është i një rëndësie të tillë e cila e arsyeton GJPN-në të ushtrojë juridiksionin e saj (Cassese,2003:343). Pra, juridiksioni i gjykatave është i ndryshëm i determinuar kryesisht nga rrethanat reale në kohën e themelimit si të Tribunalëve ashtu edhe GJPN-së, dhe në drejtim të zgjidhjes efikase të çështjeve të paraqituara për gjykim.

5.2. Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare

Përderisa juridiksioni i gjykatave nacionale, për veprimin mbi çështje të caktuara, buron nga sovraniteti shtetëror dhe është i lidhur drejtpërsëdrejti me të, atëherë parashtrohet pyetja se nga cili sovranitet buron juridiksioni i gjykatave ndërkombëtare dhe po të kemi parasysh faktin se kush i ka krijuar këto gjykata, vijmë te konkluzioni se sigurisht nga sovraniteti i atij subjekti, që ka krijuar një gjykatë të tillë, buron edhe juridiksioni i saj. Kjo çështje shkon edhe më tej sepse organet dhe organizatat të cilat kanë themeluar ose kanë të drejtë të themelojnë gjykata me karakter ndërkombëtar, nuk janë subjekte abstrakte, por janë krijuara nga shtetet si subjekte të pavarura. Prej këndej përsëri vijmë në përfundim se janë shtetet që, në njëfarë mase kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre i brendshëm për sa i përket aspektit të juridiksionit dhënë gjykatave ndërkombëtare për gjykimin e kategorive të caktuara të krimeve. Vetë statutet e këtyre gjykatave rregullojnë juridiksionet e tyre, juridiksion që gjatë implementimit në praktikë ndihmohet nga parimet, të cilat janë të njohura në doktrinën juridike dhe në bazë të të cilave rregullohet juridiksioni brenda sistemeve nacionale.

Sovraniteti i shteteve nënkupton pavarësinë e tyre për të vepruar lirisht si brenda, ashtu edhe jashtë territorit të tyre, pa u kufizuar nga askush. Ky kuptim i sovranitetit absolut të shteteve është tejkaluar, dhe tani në teoritë e së drejtës në përgjithësi njihet parimi i sovranitetit të kufizuar të shteteve, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Parimi i kufizimit të sovranitetit shtetëror, ka zënë vend kryesisht si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve dhe rrethanave të cilat e arsyetojnë aplikimin e një sovraniteti të tillë. Me miratimin e shumë konventave, marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe si dhe shumë

rregulloreve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, janë konsoliduar rregulla me të cilat rregullohet çështja e kufizimit të sovranitetit të shteteve në raste të caktuara.

Shtetet si subjekte të së drejtës ndërkombëtare kanë të drejta dhe detyrime. Ato si subjekte juridike ndërveprojnë me shtetet e tjera dhe marrin pjesë aktivisht në qarkullimin juridik ndërkombëtar, qarkullim gjatë të cilit veprimet e tyre shtetet duhet t'i bazojnë në ndonjë normë, në ndonjë ligj ose në ndonjë rregullore e cila njihet dhe pranohet nga shumica e shteteve në të drejtën ndërkombëtare. Në të kundërtën do të krijoheshin anarki dhe për pasojë do të mbijetonin vetëm më të fortit. Për këtë arsye, që të arrihet njëfarë mirëqenie ndërkombëtare juridike, shtetet duhet të heqin dorë nga sovraniteti absolut që deri vonë ka qenë pengesë për shumë procese ndërkombëtare.

Në fushën e sovranitetit të brendshëm hyjnë puna e organeve legislative, gjyqësore dhe ekzekutive. Organe të tilla, brenda një territori shtetëror, janë të pavarura dhe punën e tyre e bazojnë në kushtetutë dhe në ligjet e vendit, mirëpo kur organe të tilla në punën e tyre ndeshen me çështje të fushës ndërkombëtare, na paraqitet dilema se cilin legjislacion duhet të aplikojmë.

Konventat ndërkombëtare, të cilat rregullojnë çështje nga sfera të ndryshme ndërkombëtare, në legjislacionet nacionale përfshihen kryesisht nëpërmjet dy sistemeve. Njëra mënyrë është kur organi ligjdhënës i një vendi e ratifikon një konventë të caktuar ndërkombëtare dhe mënyra tjetër është kur pas dhënies së pëlqimit paraprak, nga ana e organit ligjdhënës, është presidenti i shtetit ai që jep bekimin përfundimtar. Cilado qoftë mënyrë e ratifikimit të konventave ndërkombëtare, ato bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm të shteteve në momentin e ratifikimit dhe të gjitha organet janë të detyruara t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas tyre.

Pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror është edhe juridiksioni që ka të bëjë me fuqinë e shtetit, që në bazë të së drejtës ndërkombëtare të rregullojë ose në një mënyrë tjetër të ndikojë te njerëzit, mbi pronën dhe mbi rrethanat si dhe të reflektojë parimet themelore të sovranitetit shtetëror, barazisë së shteteve dhe mospëprzierjes në punët shtetërore (Shaw,2008:551).

Në lidhje me juridiksionin e shteteve, të atyre shteteve që gjykatat nacionale i kanë në kompetencën e tyre për të gjykuar rastet e caktuara kriminale, edhe në të drejtën ndërkombëtare vlejné po ato parime që vlejné në të drejtën e brendshme e që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave.

Në teori përmenden disa parime që duhet të respektohen tek të cilat përcaktohet se cila gjykatë është kompetente në rastin e caktuar për të gjykuar, parime të cilat janë të vlefshme në shumicën e të drejtave nacionale dhe që janë të aplikueshme edhe në të drejtën ndërkombëtare.

Këto parime janë:

1. Parimi i territorialitetit
 - 1.1. Territori i shtetit
 - 1.2.Vendi i kryerjes së veprës penale
 - 1.3.Parim i flamurit dhe parimi i regjistrimit
2. Parimi real
 - 2.1.Parimi i personalitetit aktiv
 - 2.2.Parimi i personalitetit pasiv
 - 2.3.Parimi universal

2.4.Parimi i juridiksionit përfaqësues (Kambovski,1998:64-68).

5.2.1. *Parimi i territorialitetit*

Koncepti i juridiksionit kriminal historikisht është i bazuar në parimin e territorit shtetëror, parim i bazuar kryesisht në teorinë se krimi është i dëmshëm më shumë në vendin ku është kryer (Malekian,1991:10).

Parimi i territorialitetit është gjithmonë i lidhur me territorin shtetëror, gjegjësisht aplikimi i ligjit penal nacional bëhet gjithmonë kur një vepër penale e paraparë në atë ligj penal kryhet brenda kufijve të territorit shtetëror, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për shtetas të atij shteti, shtetas të huaj ose për ndonjë person pa shtetësi (Kambovski, 1998,64).

Për të aplikuar kompetencën gjyqësore, që reflekton një aspekt të sovranitetit të aplikuar nga një shtet në hapësirën e tij territoriale, duhet të ekzistojë një bazë teritoriale për shtetin, e caktuar nëpërmjet miratimit të ligjeve dhe aplikimit të të njëjtave ligje në të gjithë territorin e tij shtetëror, ky është manifestim logjik i rregullimit botëror të shteteve të pavarura, sepse organet e shtetit janë përgjegjëse për mbajtjen e rendit dhe aplikimin e së drejtës brenda territorit të tyre (Shaw,2008:556).

Parimi i territorialitetit nënkupton të drejtën e shtetit që të veprojë mbi njerëzit, mbi sendet dhe mbi proceset që ndodhin në territorin e tij shtetëror. Ky parim njëherit reflekton njohjen nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, se shteti nëse nuk ka aftësi që të kontrollojë proceset të cilat ndodhin brenda territorit të tij, atëherë ai shtet nuk mund të ekzistojë. Në literaturë njihet edhe territorialiteti objektiv, nëpërmjet të cilit shteti vepron edhe në rastet kur një proces ndodh jashtë kufijve të territorit të tij, por që ka ndikim ose mund të ketë ndikim në territorin e tij shtetëror (Marfi, 2006,242).

Parimi i territorialitetit është obligues me atë që çdoherë aplikohet e drejta e shtetit ku është kryer vepra penale, pavarësisht faktit se ai që e ka kryer për të njëjtën vepër është gjykuar më herët nga një gjykatë e huaj. Normalisht, në raste të tilla në sanksionin që do të t'ia shqiptojë gjykata do t'i llogaritet dënimi i mbajtur më herët për të njëjtën vepër (Kambovski, 1998,64). Kjo mënyrë e rregullimit bie në kundërshtim me parimin *non bis in idem* i cili është parim shumë i rëndësishëm i së drejtës, dhe që ka të bëjë me sigurinë juridike të qytetarëve, mirëpo në këtë rast nuk mund të aplikohet sepse po të pranohej drejtpërsëdrejti aktgjykimi i huaj *de facto* do të ishte njohje e veprimit negativ të aktgjykimeve të huaja. Edhe pse në raste të tilla ka përsëri përjashtime si, p.sh., në Kodin penal të R.M-së në nenin 116 parashihet se nëse procedura ndaj një personi ka filluar ose ka përfunduar, atëherë ndjekja në R.M bëhet vetëm me pëlqimin e Prokurorit Publik të R.M-së (Kambovski, 1998,65). Parimin e territorialitetit e parasheh edhe GJPN-ja në Statutin e së cilës parashihet se shteti ku kryhet veprimi kriminal ka juridiksion parësor, mirëpo parasheh përjashtim ku me plotësimin e kushteve të caktuara dhe që janë numëruar në Statut, GJPN-ja ka të drejtë të fillojë ndjekjen edhe në rastet kur për të njëjtën vepër personi veçmë është gjykuar nga një gjykatë nacionale.

Që të zbatohet drejt dhe në mënyrë të gjithanshme parimi i territorialitetit ndihmohet nga elementet përbërëse të cilat njëherit janë edhe elemente ndihmëse të këtij parimi si territori shtetëror, vendi i kryerjes së veprës penale, parimi i flamurit dhe parimi i regjistrimit.

5.2.1.1. Territori shtetëror

Element qenësor për aplikimin e legjislacionit nacional është vendi i kryerjes së veprës penale, gjegjësisht territori shtetëror. Përcaktimi i territorit shtetëror nuk është nocion

juridiko-penal, edhe pse disa legjislacione e përcaktojnë në ligjet e tyre penale (Kambovski,1998:65).

Territori shtetëror është hapësira që gjendet nën sovranitetin e një shteti dhe mbi të cilin shteti ushtron pushtetin e tij, të njohur me termin supremacion territorial (Gruda,2007:159-161).

Territorin shtetëror e përbëjnë sipërfaqja tokësore, ajo ujore dhe hapësira ajrore brenda kufijve shtetërorë.

Toka, uji dhe ajri përbëjnë pjesët e vërteta (reale) të një shteti. Gjithashtu edhe disa objekte trajtohen sikur të ishin pjesë të territorit shtetëror, megjithëse janë jashtë kufijve shtetërorë. Këto janë pjesë fiktive të territorit shtetëror si: pjesët “lundruese”, gjegjësisht anijet dhe pjesët “fluturuese”, gjegjësisht fluturaket e një shteti, si dhe pjesë të territorit të shtetit tjetër në të cilin janë të vendosura ambasadat e shtetit delegues (Gruda,2007:159).

Përcaktimi i nocionit të territorit shtetëror ka qenë e nevojshme për arsye të qartësimit të dilemave se ku dhe deri ku mund të shtrihet pushteti i shtetit e me këtë edhe juridiksioni i gjykatave.

5.2.1.2. Vendi i kryerjes së veprës penale

Kur një vepër kryhet në territorin e një shteti të caktuar, nuk ka dilemë se aplikohet e drejta e brendshme e atij shteti, pa marrë parasysh se ai që e kryen a është shtetas i atij shteti apo shtetas i huaj. Mirëpo, problemi i përcaktimit se cili legjislacion do të aplikohet mund të paraqitet sidomos tek të ashtuquajturat delikte distancionale kur veprimi është kryer në territorin e një shteti, kurse pasoja është shfaqur në territorin e shtetit tjetër, ose kur është ndërmarrë vetëm tentativa ose veprimi përgatitor i sanksionueshëm, të drejtuara kah shkaktimi i rezultatit kriminal në shtetin tjetër. Probleme të ngjashme mund të paraqiten

edhe tek të ashtuquajturat vepra penale të përbëra ose të vazhduara si dhe në rastet e veprave penale në bashkëpunim, problem që paraqitet lidhur me lokalizimin e veprës, në qoftë se veprimi i kryesit kryesor dhe veprimet e bashkëpunëtorëve janë kryer në territore të ndryshme (Kambovski,1998:67-68). Për zgjidhjen e këtij problemi në teori janë paraqitur si zgjidhje të mundshme dy teori- teoria e ndërmarrjes së veprimit kriminal dhe teoria e shkaktimit të pasojës nga veprimi kriminal. Mirëpo, secila nga këto dy teori ka mangësitë e veta dhe nuk mund të japë zgjidhje të plotë gjatë përcaktimit se cili legjislacion duhet aplikuar. Prandaj në teori është paraqitur edhe teoria e ubikvitetit e cila në fakt paraqet simbiozë të dy teorive të para e sipas së cilës vepra penale konsiderohet si e kryer si në vendin e ndërmarrjes së veprimit ashtu edhe në vendin e shkaktimit të pasojës (Kambovski,1998:67-68).

Përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale është shumë i rëndësishëm, se normalisht aty ku kryhet vepra penale, gjegjësisht aty ku shkaktohen ose ndihen pasojat e një vepre penale, ai është vendi që realisht dhe drejtpërsëdrejti preket nga delikti, dhe i njëjti ka interes parësor për gjykimin dhe sanksionimin e personit përgjegjës për shkaktimin e pasojave të dëmshme të çfarëdo natyre qofshin ato.

5.2.1.3. Parimi i flamurit dhe parimi i regjistrimit

Ky parim vlen për pjesët fiktive të territorit shtetëror, gjegjësisht për anijet lundruese dhe fluturaket, të cilat mbajnë flamurin e një shteti ose janë të regjistruara në një shtet të caktuar. Këto i nënshtrohen legjislacionit të shtetit amë, dhe në bazë të një fiksioni juridik konsiderohen si territor lundrues ose fluturues i një shteti (Gruda,2007:160).

Pranimi i këtyre parimeve në të drejtën penale bashkëkohore është pasojë e një koncepti të vjetër për anijen dhe për aviacionin si pjesë e territorit të shtetit amë: anija është territori lundrues, kurse aviacioni është territori fluturues. Sot ky koncept është zgjeruar me një qasje të reduktuar realiste, zgjerim i arsyetuar prej pushtetit represiv të shtetit amë, jo me ndonjë fiksim, por me shkaqe pragmatike që e imponojnë nevojën për vënien e regjimit juridik të një shteti, i nevojshëm veçanërisht në rastet kur vepra penale kryhet në det të hapur ose në hapësirën ajrore mbi detin e hapur (Kambovski, 2007:133).

Ky parim është paraparë që të bëjë të mundshëm gjykimin e personave që, në det të hapur ose në hapësirën ajrore, kryejnë veprime të kundërligjshme, kur dihet fakti se të dyja këto hapësira janë shumë të gjera dhe hapësira të tilla shtetet i kontrollojnë vetëm deri në njëfarë mase, kurse hapësira tjetër e mbetur në bazë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare publike është territor në të mirë të të gjithëve, dhe me qëllim shmangien e mundësisë që personat që kryejnë veprime të kundërligjshme në det të hapur ose në qiell të hapur, gjejgjisht në një territor që nuk kontrollohet nga asnjë shtet të mund të ikin nga përgjegjësia penale.

5.2.2. Parimi real

Parimi real ka të bëjë me të drejtën e shteteve për mbrojtje të nevojshme nga sulmet që vijnë nga shtetet e tjera, të drejtuara kundër sigurisë dhe sistemit të pushtetit. Ky parim kriterium për aplikimin e legjislacionit nacional është natyra e veprimit kriminal. E rëndësishme është se bëhet fjalë për veprim kriminal drejtuar sigurisë dhe interesave të tjera të shtetit, pavarësisht nga cilësia e kryesit dhe gjejgjisht a është ai shtetas i shtetit ose shtetas i huaj (Gruda, 2007:74-75).

Parimi real varet nga kriteret e secilit shtet në veçanti, që cilat akte, të kryera nga shtetasit e tij ose të huajt, shteti i konsideron se e dëmtojnë rendin e tij juridik. Interesat e shteteve mund të jenë të ndryshme, të cilat përveç të tjerash mund të përfshijnë edhe krime politike ose krime të tjera të kryera kundër sovranitetit të një shteti. Parimi real në shumë raste mund të shkelë parimet e së drejtës ndërkombëtare, me çka shteti në shumë raste për realizimin e interesave të tij mundet që t'i konsiderojë si ligjore shumë akte të cilat mund të dëmtojnë pavarësinë juridike të shteteve të tjera (Malekian, 1991:17).

Parimi real arsyetohet me të drejtën e mbrojtjes së shtetit, ai ka të drejtë të mbrohet nga sulmet që vijnë nga shtetet e tjera të drejtuara kundër sigurisë së tij. Asnjë shtet nuk mund të presë se shteti tjetër do ta mbrojë p.sh. nga falsifikimi i parave ose nga spiunazhi, kur është fakt i njohur se spiunazhi paraqet mënyrë për mbledhjen e të dhënave për shtetet e tjera, e cila është pjesë e aktiviteteve legale, juridike, institucionale të shteteve (Kambovski,2007:134).

Si parime përbërëse të parimit real, të parapara me qëllim zbatimin më të lehtë dhe në mënyrë të duhur të parimit real, janë parimi i personalitetit aktiv, parimi i personalitetit pasiv, parimi universal dhe parimi i juridiksionit përfaqësues.

5.2.2.1. Parimi i personalitetit aktiv

Parimi i personalitetit aktiv ka të bëjë me aplikimin e legjislacionit nacional ndaj shtetasve të vet, kur kryejnë veprime kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është i lidhur ngushtë me nocionin e ekstradimit, gjegjësisht me dëshirën e shteteve që gjykatat nacionale të gjykojnë shtetasit e tyre edhe kur ata kryejnë veprime kriminale jashtë territorit shtetëror ose edhe me dëshirën e vetë atij që e kryen krimin, që të gjykohet në vendin e vet, gjë të cilën e arsyetojnë shumë rrethana praktike (Koering-Joulin1994:230).

Interesi i shtetit për zgjerimin e pushtetit represiv edhe ndaj veprave të kryera jashtë vendit llogaritet si legjitim, siç është edhe interesi që qëndron pas parimit real të arsyetuar me mosbesimin në mbrojtjen e të mirave të një shteti nga ana e shtetit tjetër. Lidhur me pranueshmërinë e këtij parimi ka qëndrime të ndryshme, shumica e pranojnë si parim subsidiar ose plotësues dhe janë të rralla ato legjislacione të cilat nuk e njohin fare këtë parim p.sh. ai suedez. Pranimi i këtij parimi argumentohet me faktin se zgjerimi i pushtetit represiv, në këtë rast do të thotë prekje në sovranitetin e shtetit tjetër, dhe se kjo nxit mosbesim mes shteteve, mosbesim që mund të jetë edhe burim i konflikteve të ndryshme midis shteteve (Kambovski,2007:136).

5.2.2.2. Parimi i personalitetit pasiv

Parimi i personalitetit pasiv nënkupton mundësinë e shtetit për aplikimin e legjislacionit të vet, në rastet kur shtetasit e tij janë viktimë të veprimeve kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është i lidhur me të drejtën e shteteve që të mbrojnë shtetasit e tyre në territore të huaja (Malekian,1991:14).

Ky parim përveç të tjerave mbështetet edhe në kuptimin e sovranitetit të shtetit gjegjësisht që shteti ka të drejtë edhe ta kontrollojë sjelljen e shtetasve të tij jashtë vendit. Gjithashtu, ky parim është i lidhur edhe me parimin e mosekstradimit të shtetasve të shtetit tjetër, bile në disa vende parimi i mosekstradimit është ngritur në nivel kushtetues (Kambovski, 2007:135).

Por edhe që ky parim që të aplikohet, kërkohet inkrimini i dyfishtë si dhe respekti i ndalesës *non bis in idem* (Kambovski, 2007:135)

5.2.2.3. *Parimi universal*

Parimi universal ka të bëjë me të drejtën e secilit shtet që të aplikojë kompetencën gjyqësore për procedurat jashtë territorit të tij, në qoftë se procedurat e tilla kanë karakter të një rreziku universal për shtetin ose për qytetarët e tij (Murphy, 2006:246).

Parimi universal krijon të drejtën universale të shteteve që të sanksionojnë aktet të cilat janë të njohura si krime në të drejtën ndërkombëtare, gjegjësisht si *delicta juris gentium* (Malekian, 1991:18).

Juridiksioni universal gjyqësor tradicionalisht ishte i imponuar mbi vepra penale për pirateri në det të hapur dhe mbi persona të cilët ishin të përfshirë në tregti me njerëz. Justifikimi për ekzistimin e këtij parimi është se shteteve duhet t'u lejohet të gjykojnë veprime të tilla sa herë që paraqiten, si mjet për mbrojtjen e bashkësisë globale në tërësi, bile edhe në rastet kur nuk ka lidhje në mes të shtetit dhe palëve ose procedurave për të cilat bëhet fjalë (Murphy, 2006:246).

Parimi universal, gjithashtu, i ka dhënë të drejtën bashkësisë ndërkombëtare që t'i gjykojë krimet ndërkombëtare të cilat cenojnë të mirat dhe interesat e një numri më të madh njerëzish, sepse krimet e tilla kanë një veprim më të gjerë, pasojat e të cilave mund të ndjehen në më shumë shtete. Parimi i tillë sigurisht se do të jetë bazë edhe në të ardhmen, për gjykimin edhe të krimeve tjera ndërkombëtare si terrorizmi, trafikimi i lëndëve narkotike, kriminaliteti ekonomik etj., kur krimet e tilla do të përfshihen në juridiksionin e GJPN-së ose edhe ndoshta me krijimin e një organi të mëvetësishëm ndërkombëtar që do të ketë në juridiksion gjykimin e krimeve të tilla.

5.2.2.4. *Parimi i juridiksionit përfaqësues*

Parimi i juridiksionit përfaqësues që njëherit njihet edhe si parim plotësues nënkupton atë mënyrë të veprimit kur një shtet heq dorë nga pushteti i tij represiv, me qëllim që pushtetin e tillë në një rast të caktuar ta ushtrojë një shtet tjetër. Ky parim ka të bëjë me një kornizë të re juridiko-materiale të bashkëpunimit midis shteteve që në thelbin e saj ka të bëjë me transferimin e procedurës penale nga një shtet në shtetin tjetër, e praktikuar në rastet e kryerjes së veprës penale në territorin e shtetit nga shtetas i huaj, dhe me kusht reciprociteti (Kambovski,1998:83).

Parimet e aplikuara më lartë janë parime me ndihmën e të cilave përcaktohet juridiksioni dhe kompetenca e gjykatave nacionale. Në të drejtën ndërkombëtare penale nuk ka të përcaktuara parime fikse të përmbajtura në ndonjë konventë ose rregullore me karakter ndërkombëtar, të cilat do të ishin të obligueshme për t'u respektuar nga shtetet, por për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, kur ato procedohen nga Tribunalet Ndërkombëtare *ad hoc* ose nga GJPN-ja, zakonisht janë Statutet e tyre të cilat e kanë të precizuar këtë kompetencë, kurse në rastet kur gjykatat nacionale gjykojnë krimet e tilla, udhëhiqen nga parimet e tilla të vlefshme në të drejtat nacionale.

Parimet e tilla janë shumë të rëndësishme edhe për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve, raste të cilat nuk janë të rralla gjatë veprimit juridik e sidomos gjatë veprimit juridik ndërkombëtar. Parimet e tilla gjithashtu janë të rëndësishme edhe për qarkullimin juridik-ndërkombëtar, e sidomos në sferën e bashkëpunimit juridik dhe gjyqësor midis shteteve. Ngaqë shtetet si subjekte juridike duhet patjetër të bashkëpunojnë në mes vete në shumë sfera, e sidomos në aspektin e dhënies së ndihmës juridike dhe gjyqësore, sepse vetëm në atë mënyrë mund të arrijnë qëllimin përfundimtar të së drejtës që askush i cili kryen një vepër penale mos të mbetet pa u dënuar.

5.3. Juridiksioni primar dhe plotësues

Me themelimin e Tribunaleve Penale Ndërkombëtare si dhe me krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, u paraqit problemi i përcaktimit të kompetencës se cilat gjykata kanë prioritet në ndërmarrjen e veprimeve për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, gjykatat nacionale apo ato ndërkombëtare (Cassese,2003:336).

Tribunali i Nurembergut i cili njëherit ishte edhe i pari i llojit të tillë për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të kryera gjatë LDB-re, i cili i krijuar nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare të shteteve aleate që dolën fitimtare të LDB-re, me të cilën parashihej krijimi i një gjykate që do të ishte kompetente të gjykojë kategori të caktuara të krimeve të kryera nga një kategori e caktuar personash gjegjësisht krimet e kryera nga nazistët gjatë LDB-re, si dhe Tribunali i Tokios i krijuar mbi parimet e njëjta si ato të Nurembergut, u krijua për gjykimin e kriminelëve japonezë të cilët kryen krime ndaj popullsisë koreane juglindore.

Të dy Tribunalet kishin kompetencë primare në gjykimin e krimeve për të cilat ishin krijuar, gjë e determinuar edhe nga arsye logjike, sepse në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, gjykatat nacionale të vendeve ku ishin kryer krimet nuk mund të ishin objektive në gjykim duke pasur parasysh rrethanat që mbizotëronin në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, si dhe gjykatat nacionale as që kishin vullnetin për të bërë një gjë të tillë.

Tribunali i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe Tribunali i Ruandës në Statutet e tyre parashohin se këto Tribunale kanë prioritet në raport me gjykatat nacionale, por nuk e kufizojnë të drejtën e gjykatave nacionale që të ndjekin

personat përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare (Cassese,2003:339).

Me Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, rregullohet çështja e juridiksionit sipas të cilit Gjykata Penale Ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale, ka raport komplementar.

Në nenin 1 të Statutit të Romës thuhet se Gjykata Penale Ndërkombëtare është institucion i përhershëm dhe ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, sipas parashikimit në këtë Statut, dhe është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare.⁹⁶

Sa i përket çështjes së përcaktimit të juridiksionit si primar ose plotësues, kemi dallim midis juridiksionit të Tribunaleve *ad hoc* dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Në kohën e krijimit të Tribunalit të Nurenbergut, dhe më pas edhe të Tokios, nga rrethanat nën të cilat kishte përfunduar lufta dhe nga rezultati përfundimtar i saj, as që mund të pritej se vendet si Gjermania ose Japonia do të hetonin ose do të gjykonin krimet dhe kriminelët e tillë, bile një gjë e tillë as që vinte në shprehje sepse edhe pas përfundimit të luftës në këto shtete mbizotëronte mendimi se lufta e tyre ishte e drejtë dhe se nuk kishte hapësirë për kërkimin e ndonjë fajësie eventuale të dikujt e aq më pak gjykimin ose sanksionimin. Dhe po tu lireshin në dorë këtyre vendeve zhvillimi i gjykimeve të tilla, ishte e sigurt se ato nuk do të zhvilloheshin kurrë, e as që do të gjykohej ndokush. Prandaj edhe në Statutet e këtyre Tribunaleve as që guxohej të flitej për juridiksion subsidiar.

Në rastin e Tribunalit të Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, arsyet për përcaktimin e juridiksionit të Tribunalit si primar në raport me

⁹⁶ <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>

gjykatat nacionale, kanë qenë të determinuara kryesisht nga rrethanat politike. Konfliktet e armatosura midis shteteve të sapokrijuara si dhe armiqësitë e rrënjosura thellë midis grupeve të ndryshme etnike dhe religjioze kontribuan që të gjykatat nacionale të mungojë vullneti dhe aftësia që të zhvillojnë gjykime *fer* dhe të paanshme (Cassese,2003:339).

Në krahasim me Tribunalet, të Gjykata penale ndërkombëtare situata është ndryshe. Me Statutin e Romës parashihet se Gjykata penale ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale ka juridiksion plotësues, çka nënkupton se Gjykata penale ndërkombëtare ka kompetencë të veprojë vetëm në rastet kur për arsye të caktuara, të cilat numërohen në nenet 15, 17, 18 dhe 19 të Statutit të Romës⁹⁷, gjykatat nacionale nuk janë në gjendje të ushtrojnë juridiksionin mbi personat të cilët kryejnë krime që sipas Statutit të Romës janë në kompetencë të Gjykatës penale ndërkombëtare.

Rregullimi i juridiksionit subsidiar të GJPN-së në raport me juridiksionin e gjykatave nacionale, është bërë edhe me qëllim të respektimit dhe besimit ndaj kapacitetit të juridiksioneve nacionale, se janë të afta të zhvillojnë gjykime të natyrave të tilla. Mirëpo nëse shikojmë praktikën e deritanishme të funksionimit të GJPN-së, mund të shohim se janë të rralla rastet kur gjykimet për krime ndërkombëtare zhvillohen në shtetet ku kryhen këto krime gjejjësisht në gjykatat nacionale, për arsye të natyrave të ndryshme por më së shumti për faktin e mungesës së vullnetit të shteteve për të bërë një gjë të tillë ose edhe në mosbesimin e subjekteve të caktuara që një gjykim i bërë nga gjykatat nacionale do të jetë objektiv.

⁹⁷ <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>

KAPITULLI VI: NOCIONI I KRIMEVE NDËRKOMBËTARE

6.1. Krimet ndërkombëtare të parapara me Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare

Çështja e inkriminimit se cilat veprime konsiderohen krime ndërkombëtare, është pjesë e së drejtës ndërkombëtare penale materiale. Definimet e tilla janë kryesisht të përmbajtura ose në të drejtën zakonore ose në konventat ndërkombëtare.

Problematika e definimit të qartë të nocionit të krimeve ndërkombëtare qëndron në faktin se ato nuk e kanë burimin vetëm në një vend, gjegjësisht ekzistimit të numrit të madh të konventave ndërkombëtare si dhe mosekzistimit të unifikimit të së drejtës ndërkombëtare (Kambovski,1998:235-236).

Problem shtesë është gjithashtu edhe mosekzistimi i një kodi ndërkombëtar penal, i cili do të ishte një shtyllë e fortë në unifikimin si të legjislacionit ashtu edhe të praktikës ndërkombëtare.

Autorë të ndryshëm në teoritë e tyre japin përcaktime të ndryshme lidhur me përkufizimin e këtij nocioni, të cilat në thelb janë të ngjashme, por kanë dallime për sa i përket elementeve të caktuara.

Krime ndërkombëtare konsiderohen ato shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, të cilat cenojnë të mirat dhe vlerat që mbrohen nga konventat ndërkombëtare ose janë pjesë e së drejtës zakonore, me theks të veçantë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut (Kambovski,1998:255-256).

Karakteristikë e krimeve ndërkombëtare është se akte të tilla janë kryer nga përfaqësues shtetërorë ose nga persona fizikë të cilët sjellje të tilla i kryejnë dhe i lidhin me një konflikt të armatosur, të brendshëm ose ndërkombëtar, pra një veprim i tillë ka dimension politik

ose ideologjik ose në njëfarë mënyre është e nxitur, e toleruar ose e pranuar nga përfaqësuesit shtetërorë, nga grupet e organizuara joqeveritare ose nga etnitete të caktuara (Cassese, 2003,54).

Nëse krimet ndërkombëtare i shikojmë nga aspekti i të mirave që cenohen mund të themi se këto krime janë në shumë raste të ngjashme me veprat penale që parashihen në legjislacionet nacionale si, p.sh., vrasja ku e mira që cenohet është jeta e njeriut ose vjedhja ku cenohet prona ose të mirat materiale të njerëzve, karakteristikë e krimeve ndërkombëtare është se këto në njëfarë mënyre janë të lidhura me qëllime politike ose kanë të bëjnë me sistemin e kriminalizuar (Cassese,2003,54), dhe domosdo edhe ekzistenca e elementit subjektiv i cili i dallon nga elementi subjektiv i veprave penale, që parashihen nga legjislacionet e brendshme, dhe që është karakteristik vetëm për krimet ndërkombëtare. Aplikimi i elementit subjektiv është paksa i ndërlikuar për faktin se dispozitat e dokumenteve ndërkombëtare me të cilat inkriminohen veprimet, që përbëjnë figurën e krimeve ndërkombëtare, përmbajnë dispozita lidhur me elementin subjektiv, por jo në masën e duhur.

Një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin dhe përkufizimin e veprimeve që konsiderohen krime ndërkombëtare, kanë edhe Tribunalet *ad hoc*, të cilat u themeluan pas LDB-së.

Gjatë zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare penale, përveç problemit të ngritjes në nivel të rregullave të obligueshme të çështjes së përgjegjësisë penale individuale, problem shtesë ka qenë edhe përcaktimi se për cilat veprime duhet të përgjigjen individët që i nënshtrohen përgjegjësisë penale individuale.

Edhe në këtë kontekst është paraqitur dilema se a respektohet parimi *nullum crimen sine lege*, gjegjësisht se nuk mund të dënohet një person për një veprim i cili paraprakisht nuk është paraparë me ligj. Me një argumentim të tillë personat e akuzuar për krime ndërkombëtare kanë tentuar t'i ikin përgjegjësisë penale me arsyetimin se veprimet për të cilat akuzohen nuk janë të përmbajtura në ligj. Duke shfrytëzuar një arsyetim të tillë Vilhelmi II i ka ikur përgjegjësisë penale, duke u strehuar në Holandë, e cila nuk e ka ekstraduar me arsyetimin se veprimet për të cilat akuzohet nuk paraqesin krime sipas legjislacionit holandez (Kambovski,1998:379).

Dilema të tilla janë qartësuar me themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe tanimë askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë penale duke u thirrur në shkeljen e parimit *nullum crimen, nullum poena sine lege scripta*.

Në Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare numërohen në mënyrë më se të përpiktë veprimet që konsiderohen si krime ndërkombëtare, gjegjësisht në nenin 5 të Statutit të GJPN-së, numërohen krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare. Ato janë:

- Krimi i gjenocidit;
- Krimet kundër njerëzimit;
- Krimet e luftës;
- Krimi i agresionit.⁹⁸

Përmbajtja dhe përshkrimi i secilit element, që përbën figurën e secilit prej krimeve të parapara në Statutin e GJPN-së, është një lehtësim për punën e gjykatës e gjithashtu

⁹⁸ http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Rome Statute, **Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998, neni 5.**

edhe fakt shtesë në sigurinë juridike të subjekteve që mund të akuzohen, gjykohen dhe sanksionohen nga GJPN-ja. Sepse parimi *nullum crimen, nullum poena sine lege scripta*, është një parim shumë i rëndësishëm në të drejtën penale dhe në të drejtën penale ndërkombëtare. Mosrespektimi i tij paraqet shkelje të rëndë të dispozitave të së drejtës penale materiale. Një përshkrim i tillë i detajuar, i të gjitha veprimeve që përbëjnë figurën e secilit prej krimeve mbi të cilat ka kompetencë GJPN-ja, mbështetur dhe bazuar edhe në dokumentet e tjera të rëndësishme ndërkombëtare, që rregullojnë këtë problematikë, ka evituar në maksimum mundësinë e legjitimit të akteve kriminale nën mburojën dhe me arsyetimin se veprime të tilla nuk janë të paligjshme ose nuk ka bazë juridike ku do të mbështetej gjykimi i tyre. Sepse gjatë zhvillimit të gjykimeve para Tribunalit të Nurembergut dhe të Tokios kritika kryesore, që i adresohet këtyre Tribunalëve, ishte pikërisht shkelja e parimit *nullum crimen, nulla poena sine lege scripta*.

Përcaktimi i të gjitha veprimeve që përbëjnë secilën prej figurave të krimeve ndërkombëtare sigurisht që ka kaluar nëpër një proces të gjatë evolutiv, i cili vazhdimisht ka ndryshuar paraqitjen edhe të formave të tjera kriminale deri në konsolidimin e mirëfilltë të tyre. Dhe sigurisht që në të ardhmen ky spektër do të zgjerohet edhe me inkriminime të tjera, duke pasur parasysh faktin se marrëdhëniet shoqërore vazhdimisht ndryshojnë dhe përsosen, e me këtë ndryshojnë edhe format e paraqitjes së veprimeve kriminale, ku e patjetërsueshme është që edhe inkriminimet ligjore nga fusha e së drejtës penale ndërkombëtare të përcjellin modifikime dhe risi të tilla. Në të kundërtën ajo do të jetë e mangët dhe nuk do të mundet që në mënyrë të plotë të ushtrojë funksionet e saj. Një nevojë e tillë ekziston edhe tani p.sh. me krimin e

terrorizmit i cili si krim i veçantë nuk është i përfshirë në juridiksionin e GJPN-së, edhe pse për nga rrezikshmëria dhe pasojat e rënda negative që ka është e intensitetit të njëjtë me krimet të cilat janë përfshira në juridiksionin e GJPN-së, por siç ceket shpesh në literaturën juridike se krimi është gjithmonë një hap përpara ligjit, na mbetet të shohim sesi do të veprohet në të ardhmen. Sepse për mendimin tim do të ishte mirë që edhe krimi i terrorizmit të përfshihet si krim i veçantë në juridiksionin e GJPN-së, për të cilin GJPN-ja do të kishte kompetencë të fillonte procedurë *ex officio*, përveç të tjerash edhe për faktin se kohët e fundit kryerja e tij është shpeshtuar në masë të madhe, dhe si i tillë ai paraqet rrezik permanent për paqen dhe sigurinë në bashkësinë ndërkombëtare. Përfshirja e këtij krimi në Statutin e GJPN-së, në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, nuk është adekuat për një kategori të tillë të rrezikshme të krimit ndërkombëtar.

Në këtë Statut, gjithashtu përcaktohet se GJPN-ja ushtron kompetencat dhe funksionet e saja në territorin e secilit shtet palë, si dhe në territorin e çdo shteti tjetër nëpërmjet një marrëveshje të veçantë.⁹⁹

Themelimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është një arritje shumë e madhe për të drejtën penale ndërkombëtare, e cila si një gjykatë me karakter të përhershëm, nëpërmjet Statutit dhe instrumenteve të tjera ligjore, të cilat i shfrytëzon në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të saj, është një garant i fuqishëm se askush që kryen krime ndërkombëtare nuk do të mbetet pa u gjykuar.

Me këtë përfundimisht janë hedhur poshtë pretendimet dhe përpjekjet e subjekteve të caktuara që të mos i nënshtrohen përgjegjësisë penale ndërkombëtare, me arsyetimin se

⁹⁹ Po aty, neni 6.

nuk ekzistojnë rregulla juridike që të inkriminojnë veprimet e caktuara si krime ndërkombëtare.

6.2. *Krimi i gjenocidit*

Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare gjenocidin e përcakton në nenin 6 sipas të cilit gjenocidi nënkupton cilindo nga aktet vijuese të kryera me qëllimin e shkatërrimit në tërësi ose pjesërisht të grupit nacional, etnik, racor ose fetar, si të tillë janë:

- Vrasja e anëtarëve të grupit;
- Shkaktimi i dëmtimeve serioze trupore ose mendore, anëtarëve të një grupi të menduara që të sjellin shkatërrimin e tij fizik, të plotë ose të pjesshëm;
- Imponimi i masave me qëllim që të parandalohen lindjet brenda grupit;
- Transferimi i dhunshëm i fëmijëve të grupit në grupin tjetër,¹⁰⁰ i përcaktuar si i tillë fillimisht në Konventën për preventivë dhe sanksionim të krimit të gjenocidit të vitit 1948, dhe më pastaj i riaplikuar edhe në Statutet e TPNJ-së, TPNR-së dhe GJPN-së (Kittichaisaree, 2001,66).

Për herë të parë termin gjenocid e ka përdorur Rafael Lemkin duke përdorur një kombinim nga fjala greke *genos* (racë ose fis) dhe fjalës latine *cide* (vrasje) (Kittichaisaree,2001:65).

Në kartën e gjykatës ndërkombëtare ushtarake për gjykimin e kriminelëve të luftës nuk është paraparë gjenocidi si krim i cili hyn në kompetencën e Tribunalit të Nurembergut. Gjenocidi si nocion i krimit ndërkombëtar fitoi kuptimin e tij autonom gjegjësisht si krim i veçantë në vitin 1948 kur Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Konventën për preventivë dhe sanksionim të krimit të gjenocidit të vitit 1948 (Cassese,2003:127).

¹⁰⁰http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Rome Statute, Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998 , neni 1.

Tribunali *ad hoc* i Hagës për krimet në territorin e ish-Jugosllavisë si dhe Tribunali i Ruandës kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për sqarimin e elementeve objektive dhe subjektive të krimit të gjenocidit.

Elemente objektive të krimit të gjenocidit sipas nenit 2 të Konventës për gjenocid janë:

- Vrasja e anëtarëve (më shumë se e një anëtari) nga ajo që mund ta quajmë “grup të mbrojtur”, gjegjësisht grupit nacional, etnik, racor ose fetar;
- Shkaktimi i dëmit serioz trupor ose mendor të anëtarëve të “grupit të mbrojtur”;
- Krijimi i kushteve të tilla për jetesën e grupit duke i imponuar me qëllim kushte jetese të atilla që të shkaktojnë shkatërrimin fizik të pjesshëm ose të plotë;
- Imponimi i masave me anë të të cilave pengohet lindja brenda grupit dhe
- Transferimi i dhunshëm i fëmijëve të grupit në grup tjetër (Cassese,2003:133).

Karakteristikë e krimit të gjenocidit është se krimi i gjenocidit, gjegjësisht viktima e këtij krimi viktimizohet për arsyen e vetme se është pjesëtar i një grupi të caktuar e jo për arsye të posedimit të karakteristikave të caktuara personale.

Krimi i gjenocidit është i adresuar vetëm ndaj një grupi të caktuar dhe prej këndej del konkluzioni se ky krim kryhet atëherë kur veprimi i inkriminuar është i drejtuar ndaj dy ose më tepër anëtarëve të një grupi të caktuar.

Çështje tjetër e rëndësishme për përcaktimin e krimit të gjenocidit është edhe përkufizimi i nocionit se cili grup mund të jetë subjekt i krimit të gjenocidit. Tribunali i Ruandës duke shpallur fajtorë dhe duke dënuar udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë për krimin e gjenocidit ka përcaktuar se çka nënkuptojmë me grup nacional, etnik, racor dhe religjioz dhe gjithashtu, nuk u kufizua vetëm me këto katër grupe sepse secili grup i përhershëm dhe i qëndrueshëm mund të kualifikohet si grup për mbrojtje (Murphy,2006:423).

Në përcaktimin e përgjegjësisë penale për krimin e gjenocidit të një individi të caktuar shumë i rëndësishëm është edhe elementi subjektiv.

Krimi i gjenocidit mund të kryhet me veprim ose me mosveprim dhe për ta shpallur fajtor një person për krimin e gjenocidit duhet të ekzistojë domosdo dashja dhe vetëdija e personit se është duke kryer krim ndaj një grupi të caktuar me qëllim shkatërrimin pjesërisht ose plotësisht të atij grupi (Kittichaisaree,2001:70-71).

Elementet subjektive të dashjes dhe të vetëdijes për të kryer krimin e gjenocidit janë të vështira për t'u vërtetuar, mirëpo nga mbledhja e të gjitha fakteve dhe rrethanave, që kanë sjellë deri te kryerja e krimit të gjenocidit, mund të nxirret përfundimi nëse një person ka pasur dashje dhe vetëdije për kryerjen e këtij krimi ose jo (Cassese,2003:142).

Me shqiptimin e aktgjykimeve ku janë shpallur fajtorë udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë për krimin e gjenocidit, TPNJ-ja dhe TPNR-ja kanë kontribuar mjaft në sqarimin e shumë nocioneve që kanë të bëjnë me elementet objektive dhe subjektive të krimit të gjenocidit duke përshkruar dhe sqaruar secilin veprim që lidhet me krimin e gjenocidit.

Mbledhja dhe sqarimi i detajuar i elementeve të krimit të gjenocidit përbën një lehtësim të madh për punën e mëtejshme të GJPN-së, gjatë ngritjes së përgjegjësisë penale ndërkombëtare për krimin e gjenocidit (Kittichaisaree,2001:81).

Duke qenë se gjenocidi për herë të parë është paraparë në vitin 1948, kur Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Konventën kundër gjenocidit, gjykatat e Nurembergut dhe më pas edhe ajo e Tokios nuk e kishin në juridiksionin e tyre krimin e gjenocidit. Për herë të parë krimi i gjenocidit u parapa në juridiksionin e Tribunaleve të Hagës dhe të Tokios.

Gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura në vendet e ish-Jugosllavisë dhe në Ruandë u kryen shumë veprime të cilat përbëjnë figurën e krimit të gjenocidit, me ç'rast ishin këto dy

Tribunale të cilat për herë të parë shqiptuan aktgjykime ndaj personave të akuzuar për kryerjen e gjenocidit. Gjithashtu nga TPNR-ja, për herë të parë u shqiptua aktgjykimi për nxitje në kryerjen e gjenocidit, çka nënkupton se krimi i gjenocidit përveç se mund të kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ai është i ndëshkueshëm edhe në rastet kur ai kryhet në mënyrë të tërthortë, gjegjësisht nëpërmjet kryerjes së veprimeve të cilat nxisin të tjerët në kryerjen e gjenocidit.

Gjykimi i parë për krimin e gjenocidit u zhvillua nga TPNR-ja kundër Jean-Paul Akayesu-t, me ç'rast Dhoma Gjyqësore me 2 shtator të vitit 1998, ish -kryetarin e komunës Taba, Jean-Paul Akayesu-n, e shpalli fajtor për krimin e gjenocidit. Me këtë rast TPNR-ja u bë Tribunali i parë i cili shqiptoi aktgjykimin për gjenocid dhe gjithashtu risi e këtij aktgjykimi ishte se për herë të parë u njoh përdhunimi si një mjet për të kryer krimin e gjenocidit.¹⁰¹

Lidhur me krimin e gjenocidit, TPNR-ja gjithashtu, njihet si Tribunali i parë para të cilit një person pranon fajësinë për gjenocid, gjegjësisht përgjegjësinë për kryerje të gjenocidit dhe nxitje në kryerjen e gjenocidit, fajësi të cilën TPNR-ja pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave, lidhur me pranimin e fajësisë, e pranoi me 4 shtator të vitit 1998 me shpalljen e aktgjykimit ndaj Jean Kambanda-s, ish-kryeministër i qeverisë së përkohshme të Ruandës.¹⁰²

6.3. Krimet kundër njerëzimit

Sipas Statutit të Romës për GJPN-në krimi kundër njerëzimit nënkupton cilindo nga aktet në vijim, kur kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik drejtuar kundër cilësdo popullsi civile me dije për sulmin:

- Vrasje;

¹⁰¹ <http://www.unictr.org/en/ictr-milestones>

¹⁰² <http://www.unictr.org/en/ictr-milestones>

- Shfarosje;
- Skllavërim;
- Deportim ose transferim i popullsisë;
- Burgosje ose privim i rëndë i lirisë fizike, duke shkelur rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;
- Torturë;
- Përdhunim, skllavërim seksual, prostitucion i detyruar, sterilizim i detyruar, çdo formë tjetër e dhunës seksuale e krahasueshme me këto;
- Persekutim i çdo grupi të identifikueshëm bashkësie, në bazë të përkatësisë fetare ose gjinore, ose për shkaqe që janë pranuar përgjithësisht si të palejueshme në bazë të së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me çdo akt të përmendur në këtë paragraf ose me çdo krim brenda juridiksionit të GJPN-së;
- Zhdukje e detyruar e personave;
- Krimi i aparteidit;
- Akte të tjera johumane të karakterit të ngjashëm që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha ose dëmtime serioze trupore të shëndetit fizik ose mendor.

Veprimet e inkriminuara si krime kundër njerëzimit kanë të bëjnë me kryerjen e sulmit të karakterizuar si johuman, veprime me të cilat shkaktohet torturim i rëndë dhe lëndim serioz trupor dhe mendor, ku kjo mënyrë e tillë veprimi duhet të jetë kryer si pjesë e sulmit partikular ose sistematik kundër pjesëtarëve të popullsisë civile (Kittichaisaree,2001,86).

Krimet kundër njerëzimit janë krime kundër "njerëzisë" e cila është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës dhe si e tillë është brengë e bashkësisë

ndërkombëtare. Ajo ka reperkusione jashtë kufijve ndërkombëtarë dhe për nga madhësia dhe egërsia i tejkalon të gjithë kufijtë të cilët i toleron civilizimi bashkëkohor.¹⁰³

Krim kundër njerëzimit është term relativisht i ri dhe si i tillë në terminologjinë juridike ndërkombëtare nuk ka ekzistuar deri para shpërthimit të LBD-së. Megjithëse termi krimet kundër njerëzimit është i lidhur me luftën, shtirja e tij nuk është e kufizuar vetëm me kohën e luftës. Ajo mund të aplikohet ndaj cilitdo aktivitet johuman të kryer para ose gjatë luftës (Kittichaisaree,2001:83).

Termi krim kundër njerëzimit është përdorur qysh në vitin 1915 në Deklaratën e 9 majit të vitit 1915 të qeverive të Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë, që e kanë gjykuar masakrën e Turqisë ndaj popullsisë armene, si krim kundër njerëzimit dhe civilizimit për të cilin do të mbajnë përgjegjësi të gjithë pjesëtarët e qeverisë turke që kanë qenë të përfshirë në atë masakër (Malekian,1991:263).

Pas përfundimit të LDB-së, në Statutet e Tribunalit të Nurembergut dhe atij të Tokios, u parapanë krimet kundër njerëzimit ku në mënyrë të saktë numëroheshin të gjitha veprimet që përbëjnë figurën e krimit kundër njerëzimit.

Në kuadër të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, nocioni i krimeve kundër njerëzimit përfshin veprime të ndryshme. Në drejtim të sqarimit se çka përmban secili prej këtyre veprimeve kanë kontribuar shumë Tribunalet ad-hoc, e sidomos TPNJ-ja dhe TPNR-ja. Krimet kundër njerëzimit përmbajnë shumë elemente të cilat përbëjnë figurën e krimit kundër njerëzimit si: vrasje, shfarosje, robërim etj., dhe gjatë zhvillimit të gjykimeve të

¹⁰³http://www.iccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Rome Statute, Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998.

shumta para Tribunaleve ad hoc, u sqarua secili element i figurës së këtij krimi si i mëvetësishëm dhe në lidhje edhe me veprimet e tjera, të cilat pa dyshim kanë kontribuar edhe gjatë përpilimit të dispozitave të Statutit të Romës për GJPN-në. Sepse nocioni i krimeve kundër njerëzimit ka evoluar shumë nga LPB-ja, duke pasur parasysh faktin që pas përfundimit të LPB-së krimet kundër njerëzimit nuk njiheshin aspak. Kështu komisioni që u formua pas përfundimit të LPB-së, në konferencën e Versajës propozoi krijimin e një gjykate ndërkombëtare për gjykimin e krimeve të luftës dhe për shtrirjen e juridiksionit të saj edhe në gjykimin e krimeve kundër njerëzimit, mirëpo një propozim i tillë dështoi sepse SHBA-ja e kundërshtoi një nismë të tillë me arsyetimin se krimet kundër njerëzimit nuk janë të përcaktuara, sepse ato ndryshojnë me kalimin e kohës, me ndryshimin e vendit dhe rrethanave, faktorë të cilët ndikojnë që çdo gjyqtar të ketë bindje të ndryshme lidhur me ekzistencën ose jo të këtij krimi (Cassese,2003,103).

Krimet kundër njerëzimit janë krime të tmerrshme, për arsye se paraqesin sulm serioz ndaj dinjitetit njerëzor, por dhe poshtërim e degradim të rëndë të një ose më shumë personave.

Karakteristikë tjetër e krimeve kundër njerëzimit është se ato nuk janë të pjesshme ose të përkohshme, por janë pjesë e aplikimit sistematik dhe gjithëpërfshirës të akteve johumane, që janë pjesë e politikës së pushtetit ose ato si të tilla tolerohen ose pranohen nga ana e shtetit ose nga ndonjë pushtet *de facto*. Dhe pikërisht kur këto krime kryhen prej pushtetit shtetëror kemi një formë edhe më të rëndë të këtij krimi dhe jo vetëm, sepse presupozohet që shteti duhet t'i mbrojë shtetasit e vet nga çfarëdo sulmi dhe t'u garantojë të gjitha të drejtat dhe liritë që ata të mund të jetojnë në mirëqenie. Elementi politik është pjesë e kryerjes së krimeve kundër njerëzimit, sepse në të shumtën e rasteve të kryerjes së këtij krimi është dëshmuar se politika ka qenë shtytëse e kryerjes së këtij krimi. Gjatë gjykimeve

të zhvilluara para Tribunalit të Nurembergut, është konstatuar se aktet johumane të kualifikuara si krime kundër njerëzimit ishin kryer si pjesë e politikës për terrorizim dhe në shumë raste ishin të organizuara dhe sistematike (Kittichaisaree, 2001,94).

Edhe TPNJ-ja ka shpallur aktgjykime në të cilat ka njohur elementin politik për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit, për shembull aktet e spastrimit etnik të ndërmarra mbi baza politike ose kryerjen e akteve johumane ndaj popullsisë civile për realizimin e idesë së krijimit të Serbisë së madhe (Kittichaisaree, 2001,95).

Në Statutin e Romës për GJPN-në, elementi politik është i njohur në dispozitat e tij, ku në nenin 7(2) (a) thuhet se sulmi i drejtuar kundër çdo popullsie civile duhet të jetë në pajtim ose në lidhje me aplikimin e politikës shtetërore ose politikës së organizuar për kryerjen e një sulmi të tillë (Kittichaisaree, 2001,95).

Krimet kundër njerëzimit janë të ndaluara dhe të dënueshme si gjatë kohës së luftës, po ashtu edhe në kohë paqeje dhe viktimat e këtyre krimeve janë zakonisht persona civilë (Cassese,2003:98-99).

Me veprimet e inkriminuara si krime kundër njerëzimit sulmohen dhe cenohen të mira shumë të rëndësishme siç janë jeta, shëndeti, liria etj. të cilat paraqesin të mira themelore për mirëqenien e njerëzve, kështu cenimi i tyre shkakton dëme të konsiderueshme për mbarë njerëzimin.

6.4. Krimet e luftës

Tradicionalisht krimet e luftës janë të lidhura me shkeljet serioze të kryera gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar. Mirëpo, në ditët e sotme, në shumicën e sistemeve

juridike parashihet që një person mund të përgjigjet penalisht për shkelje të kryera gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur (Murphy,2006:420).

Një qëndrim i tillë ishte i parashikuar në konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollin shtesë të vitit 1949, sipas të cilit shkeljet serioze që klasifikoheshin si krime lufte, ishin të kushtëzuara me atë që veprime të tilla duhet të ishin kryer gjatë zhvillimit të një konflikti të armatosur ndërkombëtar. Dhoma e Apelit e TPNJ-së në rastin Tadiq, gjatë shqyrtimit që veprimet e të akuzuarit a mund të klasifikohen si krime lufte, e konsideroi që edhe pse në konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollin shtesë të vitit 1977 ekzistimi i konfliktit të armatosur ndërkombëtar ishte i kushtëzuar, Dhoma e Apelit e TPNJ-së e konsideroi se dispozita të tilla ishin në proces të krijimit dhe se shkeljet serioze mund të kryheshin edhe gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur (Cassese,2003,88). Më tej gjatë punës së tyre TPNJ-ja dhe TPNR-ja u mbështetën në një parim të tillë edhe për shumë raste të tjera, p.sh. nga TPNJ-ja gjatë gjykimit të Boshkovskit dhe Tarçullovskit, për kryerjen e krimeve gjatë zhvillimit të konfliktit të armatosur në Vitin 2001 në Maqedoni, që ishte një konflikt i brendshëm, ku Lube Boshkovski në cilësinë e ministrit të Punëve të Brendshme dhe Tarçullovski në cilësinë e udhëheqësit të njësisë speciale, u akuzuan për veprime si vrasje, trajtim çnjerëzor dhe shkatërrim i qyteteve, qytezave dhe fshatrave, veprime që janë pjesë e figurës së krimeve të luftës duke shkelur ligjet dhe zakonet e luftës. Gjithashtu, lidhur me gjykimin e krimeve të kryera gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur ishte edhe rasti i konfliktit të zhvilluar në Ruandë gjatë të cilit u kryen shumë krime ndërkombëtare, për gjykimin e të cilave u themelua edhe TPNR-ja. Çështja e të drejtës së bashkësisë ndërkombëtare, me qëllim që të gjykojë veprimet dhe personat gjatë zhvillimit të konfliktit të brendshëm të armatosur, u diskutua gjatë krijimit të Tribunalit të

Ruandës, i cili sulmohej për jolegjitimitet me arsyetimin se një gjykim i tillë paraqiste përzierje në punët e brendshme të një shteti dhe se me krijimin e një gjykate të tillë shkelej parimi *jus de non evocando*. Mirëpo, KS i OKB-së, i cili ishte themelues edhe i TPNR-së, arsyetoi vendimin e saj me atë se madhësia dhe serioziteti i shkeljeve, që ishin bërë në territorin e Ruandës, si dhe faktin që qeveria e Ruandës vetë e kishte kërkuar një gjë të tillë, e përligjte veprimin e bashkësisë ndërkombëtare në këtë rast gjegjësisht veprimin e KS të OKB-së, me çka ajo përmbushte qëllimin e saj parësor për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në nivel botëror. Gjithashtu, qeveria e Ruandës pas përfundimit të konfliktit brenda sistemit të saj gjyqësor nuk kishte kapacitet që të zhvillonte gjykime komplekse të natyrës së gjykitimit të krimeve ndërkombëtare

Për përcaktimin e ekzistencës dhe fajësisë gjatë kryerjes së këtij krimi, shumë i rëndësishëm është edhe elementi subjektiv, gjegjësisht vetëdija e personit për kryerjen e veprimeve të cilat përbëjnë figurën e krimeve të luftës. Dashja dhe pakujdesia janë dy elemente subjektive, të cilat nëse ekzistojnë te një person, atij mund t'i vishet fajësia për kryerjen e një veprimi dhe elemente të tilla subjektive janë marrë parasysh edhe për gjykimin e krimeve të luftës. Për shembull për vrasjen si veprim, që përbën figurën e krimeve të luftës, gjatë zhvillimit të shumë gjykimeve para Tribunaleve të TPNJ-së dhe TPNR-së, vazhdimisht është mbajtur qëndrimi që vdekja e viktimës të jetë shkaktuar nga veprimi ose lëshimi i të akuzuarit, e kryer me qëllim të vrasjes ose shkaktimit të lëndimit serioz trupor, me ekzistimin e bindjes se një veprim i tillë do të shkaktojë vdekjen (Cassese,2003,94). Përveç dashjes në elementin subjektiv të krimeve të luftës bëjnë pjesë edhe elemente të tjera të cilat nëse konstatohen se ekzistojnë atëherë llogaritet se janë kryer krime lufte si të kesh njohuri se ndërmarrja e një veprimi si, për shembull, fillimi i sulmit

pa u selektuar objekti që sulmohet, mund të jetë objekt civil ose sulmi është duke u kryer ndaj popullsisë civile, duke e ditur se një sulm i tillë do të shkaktojë humbje të mëdha të jetëve të njerëzve, plagosje ose dëmtim të objekteve civile, ose në disa raste edhe pakujdesia si element që manifestohet me vetëdijen e personit i cili edhe pse e di se mund të shkaktohen pasoja të rrezikshme nga veprimi i tij, ai sërish e ndërmer veprimin e tillë (Cassese, 2003,93).

Tentativa që ndërmarrja e veprimeve të caktuara gjatë veprimeve luftarake të parandalohet, ka një histori të gjatë. Qysh në kohën antike është e njohur se gjatë zhvillimit të luftërave bëhej dallimi midis personave të armatosur dhe popullsisë civile. Mirëpo, veprime të tilla, të ndaluara gjatë zhvillimit të luftërave, si krime lufte nuk kanë qenë legalisht të njohura deri në përfundimin e LDB-së, ku me Kartën për Tribunalin e Nurembergut u parapa se krime lufte janë shkeljet e parapara me të drejtën tradicionale ose konvencionale të luftës (Malekian,1991:101).

Në Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, GJPN-ja ka juridiksion mbi krimet e luftës, sidomos kur janë kryer si pjesë e një plani ose politike, ose si pjesë e kryerjes së krimeve të tilla në shkallë të lartë.

Sipas Statutit të Romës, GJPN-ja ka juridiksion për këto krime lufte:

- Shkeljet e rënda të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, pikërisht, secili nga aktet e mëposhtme kundër personave ose pasurisë që mbrohet sipas dispozitave të Konventës përkatëse të Gjenevës;
- Vrasje e qëllimshme;
- Tortura ose trajtim çnjerëzor, përfshirë këtu edhe eksperimentet biologjike;

- Shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha, ose dëmtime serioze të trupit ose shëndetit;
- Shkatërrimi masiv dhe përvetësimi i pasurisë, që nuk justifikohet me nevojat ushtarake dhe është kryer në mënyrë të paligjshme e të pamëshirshme;
- Detyrimi i të burgosurve të luftës ose i personave të mbajtur për të shërbyer në forcat e një pale armike;
- Privimi i qëllimshëm i të burgosurit të luftës ose personit tjetër të mbrojtur nga e drejta për një gjykim të drejtë e të rregullt;
- Deportimi, transferimi ose dënimi i paligjshëm;
- Marrja e pengjeve;
- Shkeljet e tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve, që zbatohen në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, brenda kornizës së themeluar nga e drejta ndërkombëtare, pikërisht secila nga aktet e mëposhtme:
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër objekteve civile, pra objekteve që nuk janë objektiva ushtarake;
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialit, njësisve ose automjeteve të përfshira në ndihmën humanitare ose në misionin paqeruajtës, në pajtim me Kartën e OKB-së, kur ato kanë të drejtë të mbrojnë civilët ose objektet civile sipas së drejtës ndërkombëtare, gjatë konflikteve të armatosura;
- Fillimi i qëllimshëm i sulmit duke ditur se një sulm i tillë do të shkaktonte humbjen e rastësishme të jetës ose plagosjen e civilëve, ose dëme në objekte civile, ose dëmtimin në masë, po dhe afatgjatë e serioz të mjedisit natyror do të ishin haptazi në dispozicion me avantazhet konkrete të pritura;

- Sulmi ose bombardimi, pa marrë parasysh me çfarë mjetes, i qyteteve, fshatrave, banesave ose ndërtesave të pambrojtura e që nuk janë objektiva ushtarake;
- Vrasja ose plagosja e një luftëtari, që ka hedhur poshtë armët e tij ose që nuk ka mjete për mbrojtje, e që është dorëzuar në besim;
- Përdorimi i padrejtë i flamurit të paqes, flamurit ose simboleve ushtarake dhe i uniformës së armikut, ose të Kombeve të Bashkuara e po ashtu edhe të shenjave dalluese të Konventave të Gjenevës, që shkaktojnë vdekjen dhe dëmtimin trupor;
- Transferimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, nga forcat pushtuese, i pjesëve të popullsisë së saj në territorin që ka pushtuar, ose deportimi a transferimi i të gjithëve ose e një pjese të popullsisë së territorit të okupuar brenda ose jashtë këtij territori;
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve ose për qëllime humanitare, e monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë të mbledhur të sëmurët e të plagosurit e që nuk janë objektiva ushtarake;
- Nënshtrimi i personave, që janë në pushtetin e palës kundërshtare, kryerjes së gjymtimeve fizike ose eksperimentimeve njerëzore a shkencore të çfarëdo lloji, të cilat nuk janë të justifikuara nga trajtimi mjekësor, dental ose spitalor të personit në fjalë e as që janë kryer në interesin e tij ose të saj personal dhe të cilat shkaktojnë vdekjen ose rrezikojnë seriozisht shëndetin e personit ose të personave të tillë;
- Vrasja ose plagosja me pabesi e individëve, që janë pjesëtarë të kombit a ushtrisë armike;
- Deklarimi se nuk ofrohet strehë;

- Shkatërrimi ose marrja e pasurisë së armikut, vetëm nëse një shkatërrim ose marrje e tillë e pasurisë kërkohet për shkak të domosdoshmërisë së luftës;
- Deklarimi në gjykatë i të drejtave dhe veprimeve të pjesëtarëve të palës armiqësore për të marrë pjesë në operacionet e luftës të detyruara kundër vetë shtetit të tyre, edhe nëse kanë qenë në shërbim luftarak para fillimit të luftës;
- Plaçkitja e qytetit ose e vendit edhe atëherë kur është marrë me sulm;
- Përdorimi i helmeve ose armëve helmuese;
- Përdorimi i gazrave asfiksuese, helmues ose të tjerë dhe lëngje, material ose pajisje të ngjashme me to;
- Përdorimi i plumbave, që zgjerohen ose shpërndahen lehtë në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbështjellje të fortë, të cilët nuk mbulojnë në tërësi pjesën e brendshme ose që janë me prerje;
- Përdorimi i armëve, predhave dhe materialit e metodave të luftës, të cilat janë të asaj natyre që shkaktojnë lëndime të tepërta ose vuajtje të panevojshme, që janë vetiu të pakujdesshme, duke shkelur të drejtën ndërkombëtare për konfliktin e armatosur, me kusht që këto armë, predha, material, si dhe metoda luftimi të jenë plotësisht të ndaluara dhe të jenë të përfshira në një shtesë të këtij Statuti;
- Ushtrimi i dhunës mbi dinjitetin personal, sidomos trajtimi poshtërues dhe degradues;
- Kryerja e përdhunimit, skllavërimit seksual, prostitucionit të detyruar, shtatzënisë së detyruar, sterilizimi i detyruar, ose cilado formë tjetër e dhunës seksuale, gjithashtu paraqet shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës;

- Shfrytëzimi i pasurisë së personit civil ose e personit tjetër të mbrojtur për të dorëzuar pikat, rajonet ose forcat ushtarake, të pacenueshme nga operacionet ushtarake;
- Kryerja e sulmeve të drejtpërdrejta ndaj ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportuese, dhe personelit që përdor shenjat dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;
- Përdorimi i qëllimshëm i vuajtjes së civilëve nga uria, si metodë e luftës, përmes privimit të tyre nga objektet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, përfshirë këtu pengimin me dëshirë të furnizimeve me ndihma ashtu siç është paraqitur në Konventat e Gjenevës;
- Rekrutimi dhe regjistrimi i fëmijëve nën moshën 15 vjeçare në forcat e armatosura kombëtare ose shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktivisht në konflikte;
- Në rast të konfliktit të armatosur, që nuk ka karakter ndërkombëtar, shkeljet e rënda të nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, cilado nga aktet në vijim të kryera ndaj personave që nuk marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në konflikt, përfshirë këtu edhe anëtarët e forcave të armatosura, të cilët kanë hedhur poshtë armët e tyre dhe që janë vendosur jashtë fushëbetejës për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose çfarëdo shkakut tjetër;
- Dhuna kundër jetës dhe personit, sidomos vrasja e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi i vrazhdë dhe tortura;
- Kryerja e keqtrajtimeve mbi dinjitetin personal, sidomos trajtimi poshtërues dhe degradues;
- Marrja e pengjeve;

- Dhënia e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa një vendim gjyqësor të shpallur nga gjykata e themeluar në mënyrë të rregullt, që ofron të gjitha garancitë gjyqësore, përgjithësisht të pranuar si të domosdoshme;
- Veprimet si dhuna kundër jetës dhe personit, sidomos vrasja e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi i vrazhdë dhe tortura, zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, prandaj nuk zbatohet në situatat e trazirave të brendshme dhe tensioneve, siç janë kryengritjet, aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës ose aktet e tjera të një natyre të ngjashme;
- Shkeljet e tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura, që nuk kanë karakter ndërkombëtar, brenda kuadrit të caktuar të së drejtës ndërkombëtare, pikërisht secili nga aktet në vijim:
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave, materialit, njësive mjekësore dhe transportuese, dhe personelit që përdorin shenjat dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialit, njësive ose automjeteve të përfshira në një ndihmë humanitare ose në mision paqeruajtës, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për aq kohë sa janë në mbrojtje të personave civilë ose objekteve civile, sipas së drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur;
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave kushtuar fesë, arsimit, artit, shkencës ose nevojave humanitare, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku mbahen të sëmurët dhe të plagosurit, që nuk janë objektiva ushtarake;
- Plaçkitja e qytetit ose e vendit edhe atëherë kur është marrë me sulm;

- Kryerja e përdhunimeve, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar, ose cilado formë tjetër e dhunës seksuale, që gjithashtu paraqet shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës;
- Rekrutimi dhe regjistrimi i fëmijëve nën moshën 15 vjeçare në forcat e armatosura, ose shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktive në konflikt;
- Udhëzimi i zhvendosjes së popullsisë civile për arsye të lidhjes me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet nga siguria e civilëve të interesuar ose për arsye shumë të rëndësishme ushtarake;
- Vrasja ose plagosja e luftëtarit kundërshtar me pabesi;
- Deklarimi se nuk ofrohet strehim;
- Nënshtrimi i personave, që janë nën kontrollin e palës kundërshtare, gjymtimet fizike ose eksperimentimet mjekësore ose shkencore të çfarëdo lloji e që nuk janë të justifikueshme me trajtimin mjekësor, dental ose spitalor të këtyre personave, e as që janë kryer në interesimin e tij ose të saj personal të cilat shkaktojnë vdekjen ose rrezikojnë seriozisht shëndetin e këtij ose këtyre personave;
- Shkatërrimi ose konfiskimi i pronës së armikut, përjashtoj rastin kur një shkatërrim ose konfiskim i tillë i pasurisë kërkohet patjetër për shkak të nevojave të luftës;
- Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave, materialit, njësive mjekësore dhe transportuese, dhe personelit që përdorin shenja dalluese të Konventës së Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, që zbatohet në konfliktet e armatosura të cilat nuk kanë karakter ndërkombëtar, por nuk zbatohet në situatat e trazirave të brendshme dhe tensioneve, siç janë kryengritjet, aktet e izoluara

sporadike të dhunës, ose akte të tjera të kësaj natyre. Ai zbatohet në konfliktet e armatosura, që zhvillohen në territorin e shtetit, kur është fjala për konfliktin e zgjatur të armatosur në mes të organeve qeveritare dhe grupeve të organizuara dhe të armatosura, ose edhe në mes vetë këtyre grupeve.¹⁰⁴

Nga pamundësia e bashkësisë ndërkombëtare, që të parandalojë luftërat dhe konfliktet e armatosura, është ndier nevoja që së paku të humanizohen veprimet që ndërmerren gjatë zhvillimit të tyre. Procesi i humanizimit të luftërave, i intensifikuar posaçërisht pas përfundimit të LDB-së solli deri te kodifikimi i krimeve të luftës në të katër konventat e Gjenevës të vitit 1949 (Kambovski,1998:264-265).

Kështu, nëpërmjet Konventave të ndryshme që janë miratuar në lidhje me procesin e humanizimit të luftës si dhe nëpërmjet Statuteve të Tribunalëve Ndërkombëtare Penale dhe Statutit të Romës për GJPN-në, dispozitat lidhur me inkriminimin e krimeve ndërkombëtare janë ngritur në nivel supranacional dhe si të tilla janë të obligueshme për shumicën e shteteve në të drejtën ndërkombëtare dhe me një pamundësi që ato gjatë aplikimit në praktikë të modifikohen ose të ndryshohen.

6.5. Krimi i agresionit

Krimi i agresionit, gjegjësisht fillimi dhe zhvillimi i luftës agresive si krim ndërkombëtar ka kaluar nëpër një procesi evolutiv. Pas mbarimit të LDB-së Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak i vitit 1945, Statut që zhvilloi veprimtarinë Tribunali i Nurembergut në klasifikimin tripartit të krimeve ndërkombëtare e klasifikon këtë krim si

¹⁰⁴ http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Rome Statute, Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998.

vepër themelore kundër paqes, tretman i cili i ka mbetur këtij krimi në të gjitha rregulloret e mëvonshme të së drejtës penale ndërkombëtare (Kambovski,1998:267).

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e pranoi përcaktimin lidhur me përkufizimin e krimit të agresionit si krim kundër paqes dhe aplikimin e tij nga të gjitha gjykatat ndërkombëtare ushtarake të cilat gjykuan kriminelët e luftës, ku në vitin 1974 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së pranoi rezolutën që e përmbante këtë përcaktim të krimit të agresionit (Cassese,2003:152).

Përkundër faktit se Tribunali i Nurembergut dhe Tokios, në kuadër të krimeve kundër paqes, e parashihnin agresionin si veprim i cili cenonte paqen, ai si krim i veçantë nuk u parapa me statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së. Pas përfundimit të LDB-së, e vetmja dispozitë që kishte të bënte me sanksionimin e agresionit dhe që kishte karakter universal është dispozita që parashihet në Kartën e OKB-së, ku në nenin 1(1) thuhet: se detyra kryesore e OKB-së është ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare “ ku ndërmarrja e masave kolektive për pengimin dhe mënjanimin e kërcënimeve ndaj paqes dhe shtypjes së akteve të agresionit ose shkeljeve të tjera kundër paqes, dhe për zgjidhjen me mjete paqësore, në pajtim me parimet e së drejtës dhe të së drejtës ndërkombëtare, deri tek arritja e zgjidhjeve ose marrëveshjeve lidhur me konfliktet ndërkombëtare, ose situatat të cilat mund të çojnë deri te prishja e paqes” (Kittichaisaree,2001:212). Këshilli i Sigurimit i OKB-së është organi që vendos lidhur me intervenimin ushtarak të bashkësisë ndërkombëtare ndaj një shteti i cili mund të cilësohet si agresor ose shteti i cili me veprimet e veta shkel rëndë liritë dhe të drejtat e njeriut. Për këtë pikë ka dilema të shumta të paraqitura edhe në literaturë, lidhur me atë se kur KS-së të OKB-së i jepet e drejta që të ndërhyjë ushtarakisht ndaj ndonjë shteti, dhe cila është baza juridike që e legjitimon një gjë të tillë. Sepse në raste të

tilla mund të ndodhnin edhe keqpërdorime ose veprime arbitrare, p.sh. nga ana e shteteve që kanë të drejtën e vetos në KS të OKB-së, të shtyrë nga interesa politike ose nga interesa të tjera.

Në momentin e miratimit të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, në nenin 5 parashihej krimi i agresionit si krim nën juridiksionin e saj, i cili ishte i kushtëzuar me miratimin e një amandamenti plotësues i cili do të përkufizonte nocionin e krimit të agresionit dhe do të vendoste kushtet në të cilat Gjykata e ushtron juridiksionin në lidhje me atë krim.¹⁰⁵

Gjatë diskutimeve lidhur me miratimin e Statutit të Romës për GJPN-në, lidhur me përkufizimin e nocionit të krimit të agresionit, kishte më shumë qëndrime të cilat përfaqësoheshin dhe mbroheshin nga grupe të caktuara shtetesh, ku edhe përkundër të gjithave nuk u arrit një përcaktim unik lidhur me nocionin e këtij krimi. Shumë shtete të shtyra nga arsye historike, politike ose ndonjë arsye tjetër, diskutimin dhe vendosjen lidhur me përcaktimin e krimit të agresionit e konsideronin si çështje shumë të ndjeshme, arsye e cila ndikoi, që lidhur me këtë pikë, i vetmi konsensus që u arrit ishte shtyrja që kjo çështje të diskutohej më vonë, me ç'rast do të plotësohet Statuti me amandament kur të arrihet konsensusi (Kittichaisaree, 2001, 210-211).

Në konferencën për rishikimin e Statutit të Romës, të mbajtur në Kampala nga 31 maji deri më 11 qershor të vitit 2010, u miratuan amandamentet e Statutit të Romës që kanë të bëjnë me përcaktimin e krimit të agresionit dhe regjimit i cili përcakton sesi GJPN-ja do të ushtrojë juridiksionin e saj mbi këtë krim. Në këtë konferencë u përcaktua se GJPN-ja nuk

¹⁰⁵ http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Rome Statute, Entry into Force: 01.07.2002, Source : UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998.

mund të ushtrojë juridiksionin e saj mbi krimin e agresionit deri më 1 janar të vitit 2017, ku me një vendim të shteteve palë do të aktivizohet juridiksioni i saj.

Në nenin 8 bis, të miratuar në Kampala, krimi i agresionit nënkupton planifikimin, përgatitjen, fillimin ose ekzekutimin e një akti të agresionit nga një person në një pozicion udhëheqës, që në mënyrë efektive ushtron kontroll mbi veprimin politik apo ushtarak të një shteti, akt i cili për nga karakteri i tij, nga pesha dhe për nga shkalla e rrezikshmërisë, përbën një shkelje të qartë të Kartës së Kombeve të Bashkuara. "Akti i agresionit" nënkupton përdorimin e forcës së armatosur nga një shtet kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër, ose në ndonjë mënyrë tjetër është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Ndonjë prej akteve të mëposhtme, pavarësisht një deklarate të luftës, në përputhje me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 3314 të 14 dhjetorit të vitit 1974, do të cilësohet si një akt agresioni:

- Pushtimi apo sulmi i forcave të armatosura të një shteti në territorin e shtetit tjetër, ose ndonjë pushtim ushtarak, qoftë ai edhe i përkohshëm, i cili rezulton nga pushtimi ose sulmi, ose çdo aneksim me përdorimin e forcës në territorin e një shteti tjetër apo në pjesë të tij;
- Bombardimi nga forcat e armatosura të një shteti në territorin e një shteti tjetër, ose përdorimin e çdo arme nga një shtet në territorin e shtetit tjetër;
- Bllokada e porteve apo kufijve të një shteti nga forcat e armatosura të një shteti tjetër;
- Një sulm nga forcat e armatosura të një shteti mbi forcat tokësore, detare apo ajrore, ose marinës detare dhe flotave ajrore të një shteti tjetër;

- Përdorimi i forcave të armatosura të një shteti të cilat janë në territorin e një shteti tjetër me marrëveshjen e shtetit pritës, në kundërshtim me kushtet e parashikuara në marrëveshje ose ndonjë zgjatje e pranisë së tyre në këtë territor, përtej mbarimit të marrëveshjes;
- Akti i një shteti i cili ka lejuar që territorin e tij ta përdorë një shtet tjetër, territor që shfrytëzohet nga ai shtet tjetër për përgatitjen e një akti të agresionit ndaj shtetit të tretë;
- Dërgimi nga ose në emër të një shteti të bandave të armatosura, grupeve, rezervistëve ose mercenarëve, që kryejnë akte të forcës së armatosur kundër një shteti tjetër, pesha e të cilave arrin peshën e akteve të numëruara më sipër, ose përfshirja e tyre thelbësore në këto akte.

Juridiksioni i GJPN-së mbi krimin e agresionit do të ushtrohet ndaj shteteve që janë palë e Statutit të Romës, përveç në rastet kur shteti palë paraprakisht ka deklaruar se nuk e pranon një juridiksion të tillë dhe deponon një deklaratë të tillë deri te sekretari i GJNP-së. Kurse ndaj shteteve që nuk janë palë në Statutin e Romës, GJPN-ja nuk do të ushtrojë juridiksion mbi krimin e agresionit.

Kur prokurori konstaton se ka baza të arsyeshme për të vazhduar një hetim në lidhje me një krim të agresionit, ai së pari duhet të konstatojë nëse Këshilli i Sigurimit ka bërë një përcaktim të një akti të kryer nga shteti në fjalë si akt agresioni. Prokurori duhet të njoftojë Sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara lidhur me situatën para gjykatës, duke përfshirë çdo informacion dhe dokumentet e domosdoshme.

Kur Këshilli i Sigurimit ka bërë një përcaktim të tillë, prokurori mund të vazhdojë me hetimin në lidhje me një krim të agresionit. Kur një përcaktim i tillë nuk është bërë brenda

gjashtë muajve nga data e njoftimit, prokurori mund të vazhdojë me hetimin në lidhje me një krim të agresionit, me kusht që Dhoma e Procedurës Paraprake ka autorizuar fillimin e hetimeve në lidhje me një krim të agresionit.¹⁰⁶

Lënia e mundësisë Këshillit të Sigurimit për përcaktimin e asaj se një akt i një shteti mund të konsiderohet ose jo si akt i agresionit, pasqyron atë se problemi i përkufizimit të kësaj çështjeje ende nuk është zgjidhur, gjë e cila pa dyshim lidhet me interesat politike dhe interesat e tjera të shteteve në bashkësinë ndërkombëtare. Përzierja e drejtpërdrejtë e një organi, i cili është organ politik në punën e GJPN-së, pa dyshim që ngre dyshime lidhur me objektivitetin e zhvillimit të procedurës gjyqësore të ndërthurur me këtë krim. Në këtë rast vjen në mend thënia se *kush është më i fuqishëm fiton dhe sundon*-rregull i anarkisë dhe diametralisht i kundërt me sundimin e së drejtës, çka do të thotë që në qoftë se Këshilli i Sigurimit në të cilin të drejtën e vetos e kanë fuqitë botërore do të vendosë se një akt i ndërmarrë nga një shtet nuk paraqet akt të agresionit, edhe përkundër faktit se ai mund të jetë i tillë, atëherë GJPN-ja nuk mund të veprojë, sepse me amandamentet plotësuese të Statutit të Romës, që kanë të bëjnë me rregullimin dhe përcaktimin e krimit të agresionit, gjykatës nuk i është dhënë ndonjë mundësi veprimi në rastet kur Këshilli i Sigurimit e konsideron se një akt i ndërmarrë nga një shtet nuk paraqet akt të agresionit. Me këto amandamente parashihet vetëm rasti kur Këshilli i Sigurimit në një afat prej 6 muajve nga momenti i njoftimit nuk përgjigjet, atëherë Dhoma e Procedurës Paraprake të GJPN-së mund të autorizojë fillimin e hetimeve, çka në fakt paraqet një zgjidhje inferiore ndaj punës së gjykatës, gjegjësisht një çështje që për Këshillin e Sigurimit nuk është e një rëndësie të tillë që të përgjigjet dhe në këtë rast prokurori mund të fillojë një hetim edhe pa pëlqimin

¹⁰⁶ https://asp.icc-cpi.int/iccdocs/asp_docs/Resolutions/RC-Res.6-ENG.pdf

deklarativ të saj. Sigurisht që gjykimin, lidhur me çështjen se cili do të jetë efekti real i zbatimit të dispozitave të cilat kanë të bëjnë me krimin e agresionit, do t'ia lëmë së ardhmes ku nga praktika e zbatimit të tij do të mund të shohim përparësitë dhe të metat e tij, si dhe ndikimin e tyre në drejtim të hetimit dhe të gjykimin të akteve të agresionit, por dhe ndikimin eventual në parandalimin e ndërmarrjes së akteve të agresionit në të ardhmen.

Para përcaktimit të nocionit të krimit të agresionit, në literaturë nocioni i krimit të agresionit përcaktohet bazuar në të drejtën ndërkombëtare të zakonshme ose të ashtuquajturat parimet e përgjithshme të së drejtës të njohur nga popujt e civilizuar në bashkësinë ndërkombëtare.

Në literaturë njihen elementet objektive dhe subjektive të krimit të agresionit. Sipas të drejtës ndërkombëtare të zakonshme si elemente objektive llogariten organizimi, përgatitja dhe pjesëmarrja në përdorimin e dhunës me iniciativë të një shteti ose të një organizate joshitetërore ose nga ana e ndonjë etniteti tjetër të organizuar kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shtetit tjetër, dhe në kundërshtim me Kartën e OKB-së, me çka veprimet e caktuara të agresionit duhet të jenë të përmasave të mëdha dhe do të shkaktojnë pasoja serioze (Cassese,2003,158-159).

Gjithashtu, për t'u llogaritur një veprim si krim i agresionit, si element subjektiv i krimit të agresionit, domosdo duhet të ekzistojë edhe qëllimi kriminal, si element subjektiv i krimit të agresionit. Duhet të dëshmohet se ai që ka kryer krimin ka pasur për qëllim të jetë pjesëmarrës i planifikimit dhe i kryerjes së agresionit, ka qenë i vetëdijshëm për përfshirjen, domethënien dhe pasojat e veprimeve të ndërmarra, dhe dukshëm ka kontribuar në formësimin ose ka ndikuar në planin ose udhëheqjen e agresionit (Cassese,2003:158-159).

E drejta e fillimit të veprimeve luftarake, është një çështje e vështirë për t'u përcaktuar dhe kjo për arsyen se gjatë historisë shtetet gjithmonë, kur kanë filluar një luftë ose kanë ndërmarrë veprime luftarake ndaj një shteti, veprimet e tyre i kanë justifikuar si të arsyeshme, pavarësisht gjendjes reale. Më herët zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet luftës ka qenë mënyrë e zakonshme e veprimit të shteteve, dhe një veprim i tillë ka qenë normal. Edhe pse qysh herët ka pasur disa tendenca për kufizimin e ndërmarrjes së veprimeve luftarake, por jo në kuptim të flakjes së tyre totalisht nga veprimet e shteteve, por në drejtim të gjetjes së mënyrave të cilat do të kushtëzonin me plotësimin e parakushteve të caktuara, ndërmarrjen e tyre. Me ç'rast fillimisht u parapaj që fillimi i luftës pa paralajmërim është shkelje. Me kalimin e kohës, si rezultat i ngritjes së vetëdijes në aspekt të pasojave që kishin luftërat dhe si rezultat i paraqitjes së disa ideve progresive lidhur me humanizimin e veprimeve luftarake, filluan edhe tentimet e para për kufizimin e tyre deri në njëfarë mase, sepse shumë konflikte midis shteteve për të cilat ekzistonte bindja se mund të zgjidheshin vetëm me armë, mund të zgjidheshin edhe me mjete të tjera paqësore. Si rezultat i ideve të tilla filluan të miratohen konventa dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, të cilat pa dyshim patën një ndikim të fuqishëm në drejtim të fillimit të luftës, dhe gjithashtu edhe në humanizimin e veprimeve luftarake. Pavarësisht përmirësimeve dhe ndryshimeve të tilla, përsëri për konceptin e së drejtës së fillimit të luftës si dhe asaj se cilat veprime mund të ndërmerren gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, është e hapur dilema se çka konsiderohet në ditët e sotme luftë e drejtë dhe në fund të fundit a mundet të flasim për një koncept të tillë. Vetë nocioni luftë dhe nocioni e drejtë janë dy nocione diametralisht të kundërta, prandaj edhe sot e kësaj dite nuk mund të ketë një konsensus ose të paraqiten kushte dhe rrethana të cilat nëse ekzistojnë do ta

arsyetonin fillimin e luftës. Prandaj edhe në momentin e ratifikimit të Statutit të Romës për GJPN-në, ekzistonte një zbrazëti lidhur me përcaktimin e nocionit të këtij krimi. Tek e fundit problemi i përkufizimit të këtij nocioni ndoshta është pak edhe problem i shkaktuar nga vetë shtetet, të cilat të shtyra nga interesa të caktuara politike dhe materiale, e kishin të vështirë ta përkufizonin këtë nocion sepse do të dëmtonin interesat e tyre dhe gjetja e një balancimi midis asaj çka duhet dhe asaj çka dëshirohet është paksa e vështirë. Me amandamentet plotësuese të statutit të Romës, u përcaktua nocioni i krimit të agresionit, por jo i plotë për mendimin tim, sepse në bazë të dispozitave që e përkufizojnë këtë krim mund të shohim se sërish interesat politike të shteteve janë mbisunduese në raport me interesat reale të drejtësisë.

6.6. Terrorizmi si krim i veçantë kur kryhet në kontekstin e luftës

Terrorizmi si akt i dhunshëm me të cilin shkaktohen humbje të jetëve të njerëzve në përmasa të mëdha, si dhe shkaktimi i konsiderueshëm i dëmeve materiale dhe pasojat afatgjate të tij, është shumë aktual në arenën ndërkombëtare. Terrorizmi është një problem global, i cili edhe pse luftohet nga shtetet dhe nga subjektet e tjera ndërkombëtare me mjete e metoda të ndryshme, prapëseprapë është shumë e vështirë të parandalohet. Bashkësia ndërkombëtare këtë problem global e ka luftuar qysh në kohën e funksionimit të Lidhjes së Kombeve, me miratimin e Konventës për parandalimin dhe sanksionimin e terrorizmit në vitin 1937 (Kajmakovic:101).

Sipas kësaj konvente terrorizëm paraqesin të gjitha aktet kriminale të drejtuara kundër ndonjë shteti, me qëllim që të krijohet frikë ndaj personave të caktuar, grupit të njerëzve

ose publikut më të gjerë. Edhe pse kjo konventë nuk hyri kurrë në fuqi ajo vendosi një traditë të gjatë në luftën ndaj terrorizmit.¹⁰⁷

Përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare në krye me OKB-në, për miratimin e një konvente për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit kanë dështuar, çka shihet edhe nga fakti se edhe Statuti i Romës për GJPN-në nuk e parashikon terrorizmin si krim të posaçëm mbi të cilin do të kishte juridiksion kjo gjykatë.¹⁰⁸

Mirëpo, edhe përkundër faktit se Statuti i Romës për GJPN-në, krimin e terrorizmit nuk e parasheh si krim mbi të cilin ka juridiksion dhe në nenet ku numërohen veprimet që përbëjnë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, në nenin 10 të Statutit të GJPN-së parashihet se asgjë në këtë pjesë nuk do të interpretohet në mënyrë si kufizim ose prejudikim i rregullave ekzistuese ose i rregullave në zhvillim të së drejtës ndërkombëtare, për nevojat e këtij Statuti (Cassese,2008:173).

Bashkimi European luftën kundër terrorizmit e ka paraparë në Traktatin e Maastrichtit të vitit 1992 dhe në Traktatin e Amsterdamit të vitit 1997, me qëllim që vendet anëtare të mund të zhvillojnë politika të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit, ku kompetencat në çështjet kundër terrorizmit mund të ndahen ndërmjet BE-së dhe vendeve anëtare të saj.¹⁰⁹

Anëtarët e Këshillit të Europës më 27.01.1977 në Strasburg kanë miratuar Konventën Europiane për shtypjen e terrorizmit, duke qenë të ndërgjegjshëm për numrin gjithnjë në rritje të akteve terroriste si dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave efikase që aktorët e akteve të tilla të mos i shpëtojnë ndjekjes penale dhe ndëshkimit dhe se ekstradimi është një mjet i veçantë efikas për të arritur këtë rezultat. Në nenin 1 të Konventës Europiane për

¹⁰⁷ www.idmalbania.org **Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim**, Çështje të sigurisë, f. 45.

¹⁰⁸ Po aty, f. 46.

¹⁰⁹ Po aty, f. 48.

shtypjen e terrorizmit, numërohen veprat penale të cilat nëse kryhen nga shtetet kontraktuese nuk do të konsiderohen si vepra penale politike, si vepra penale politike lidhur me një vepër tjetër politike ose si vepër e frymëzuar politike, e ato janë:

- Veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen dhe marrjen e paligjshme të mjeteve fluturuese, të nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970;
- Veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen e akteve të paligjshme të drejtuara ndaj sigurisë së avionëve civilë, të nënshkruar në Montreal më 23.09.1971;
- Veprat e rënda penale, që drejtohen kundër jetës, integritetit trupor ose lirisë së personave që gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare, duke përfshirë agjentët diplomatikë;
- Veprat penale që përmbajnë rrëmbim, marrje peng ose sekuestrim arbitrar personi;
- Vepra penale që përmbajnë përdorim bombash, granatash, raketash, armë zjarri automatike, ose letra apo pako shpërthyes në masën që ky përdorim paraqet rrezik për personat dhe
- Tentativa për kryerjen e një vepre penale të sipërpërmendur ose pjesëmarrja si bashkautor ose si bashkëpunëtor i një personi që kryen ose tenton të kryejë një vepër penale të tillë.¹¹⁰

Ky mekanizëm ligjor, i krijuar nga organizatat ndërkombëtare si dhe nga shtetet, tenton në njëfarë mënyre të parandalojë ndërmarrjen e akteve terroriste edhe pse është shumë e

¹¹⁰ Konventat europiane për shtypjen e terrorit, Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për drejtësinë, botim i qendrës së publikimeve zyrtare, qershor 2010.

vështirë të arrihet një gjë e tillë, por së paku duke inkriminuar akte të tilla si në konventat ndërkombëtare, po ashtu edhe në legjislacionet nacionale, kryesit e këtyre akteve do të përgjigjen dhe do të dënohen.

Opinionit publik në mbarë botën në vazhdimisi është dëshmitar i sulmeve të ndryshme që ndodhin në të gjithë globin, akte që përfshijnë një territor lokal ose ndonjë hapësirë më të madhe. Bashkësia ndërkombëtare është e angazhuar vazhdimisht që të zbulojë dhe parandalojë akte dhe sulme të tilla terroriste, por një gjë e tillë fatkeqësisht është shumë e vështirë e në disa raste edhe e pamundur, për arsye se tani në krahasim me të kaluarën, mundësitë që ofrohen duke përdorur mjete teknike dhe teknologjike janë shumë të sofistikuar dhe normalisht janë menduar për të përmirësuar mirëqenien e njerëzve, por fatkeqësisht zbulimet e tilla keqpërdoren për arritjen e qëllimeve kriminale.

Kryesisht shtetet e zhvilluara kanë sofistikuar tej mase metodat e sigurisë shtetërore me synim mbrojtjen e qytetarëve nga sulmet e mundshme terroriste. Shtetet në botën bashkëkohore jetojnë me ankthin dhe frikën se mund të jenë synim i sulmeve terroriste, çka është edhe qëllimi i grupazheve që ndërmarrin akte të tilla: pra të mbjellin frikë dhe pasiguri në opinionin e gjerë.

Në literaturë dhe në përditshmëri përmenden shumë shkaqe, shumë rrethana dhe faktorë të cilat grupazhet e ndryshme kriminale i kanë arsyetuar për të ndërmarrë akte terroriste. Një akt terrorizmi mund të kryhet në kontekstin e një lufte dhe mund të konsiderohet si një shkelje e rëndë e ligjeve të luftës, një akt i dhunës terroriste mund të ketë si qëllim parësor përdorimin si instrument propagandistik komunikimi, me qëllim impresionimin e një audience të caktuar, përdorimi i dhunës terroriste dhe interpretimi i saj si sakrificë për

qëllime fetare, përmes së cilës terroristi synon të sakrifikojë jetë të civilëve të pafajshëm për qëllimet e tij ose edhe flijojë veten si martir (Hide:11).

Në shumë konventa dhe dokumente ndërkombëtare sanksionohen veprimet terroriste të cilat kryhen gjatë konflikteve të armatosura, veprime që konsiderohen si nënkategori të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Me konventën e katërt të Gjenevës të vitit 1949 ndalohen të gjitha masat e terrorizmit ndaj personave civilë, ku fillimisht dispozita për ndalimin e terrorizmit ishte menduar për të kufizuar forcat okupatore nga ndërmarrja e veprimeve të tilla, mirëpo aktet terroriste gjithashtu janë të ndaluara edhe nëse kryhen nga persona civilë, grupe të organizuara në territoret e okupuara ose në territorin e konfliktit. Kjo dispozitë është me kuptim të përgjithshëm dhe e aplikueshme në secilën situatë dhe pa marrë parasysh që aktet terroriste kryhen në territorin e ndonjërës prej palëve ndërluftuese, në fushën e veprimeve luftarake ose në territorin e okupuar. Qëndrim i njëjtë lidhur me veprimet terroriste mbahet edhe në dy protokollet shtesë të konventave të Gjenevës (Cassese,2008:176).

Në bazë të rregullave ekzistuese ndërkombëtare si dhe në bazë të elementeve të krimeve kundër njerëzimit aktet terroriste bëjnë pjesë si nënkategori e krimeve kundër njerëzimit, pa marrë parasysh a kryhen gjatë luftës ose paqes. Ato si të tilla duhet të përbëhen nga këto sjellje: vrasje, vuajtje të mëdha, dëmtim serioz i trupit, i shëndetit mendor ose trupor, ose ndonjë formë të maltretimit (torturë), përdhunim ose zhdukje me forcë si: “burgim, mbajtja ose grabitja e personave nga ana ose me autorizimin, pëlqimin apo përmbajtjen e shtetit ose të organizatës politike, e përcjellë me refuzimin që të pranohet një privim i tillë nga liria ose nga refuzimi i dhënies së informacioneve për fatin ose lokacionin e personave të tillë, me qëllim që t’ua marrin të drejtën e mbrojtjes juridike për një periudhë të zgjatur kohore”.

Gjithashtu, akti terrorist duhet të jetë pjesë e sulmit të gjatë dhe sistematik kundër popullsisë civile, i realizuar me dijen, lejen ose pëlqimin e shtetit ose organit joshtetëror (edhe në rastet kur aktet terroriste kryhen ndaj personave ose personave zyrtarë shtetërorë të shtetit tjetër) dhe ai ose ajo që ka kryer një veprim të tillë përkajë ekzistimit të *mens rea*, duhet të dijë se veprimi i tij është pjesë e sulmit të gjerë ose sistematik (Cassese,2008:176).

Inkriminimi juridik i terrorizmit, si krim i veçantë gjatë konflikteve të armatosura, shkakton problem politik dhe mospajtim midis shteteve, të cilat kanë mendime të ndara pro dhe kundër përkufizimit të terrorizmit. Në anën e diskutimeve lidhur me sjelljen terroriste të “luftëtarëve për liri”, zhvillimi i rregullimit juridik të terrorizmit gjatë konflikteve të armatosura mund të sjellë deri te krijimi i kategorisë së re të veprave terroriste, të ngjashme me ato të luftës, ngjashëm me procesin e inkriminimit të gjenocidit si krim i veçantë i cili në fillim ishte si nënkategori e krimeve kundër njerëzimit. Dhe kështu terrorizmi gjatë konflikteve të armatosura dhe që momentalisht llogaritet si nënkategori e krimeve kundër njerëzimit gradualisht mund të fitojë statusin e krimit të posaçëm ndërkombëtar si rezultat i aplikimit të kombinuar të së drejtës humanitare dhe normave të përgjithshme lidhur me terrorizmin (Cassese.2008:178).

Të gjitha format e lartpërmendura janë forma të cilat janë përdorur realisht nga grupazhet e ndryshme terroriste në kohë dhe në hapësira të ndryshme në mbarë globin.

Në dy dekadat e fundit, ka shumë konflikte të armatosura të cilat zhvillohen nëpër botë, me pretekstin e ekzistimit të organizatave terroriste, celulave terroriste dhe rrezikut nga sulmet terroriste nëpër botë, që luftohen nga shtetet dhe kryesisht nga fuqitë botërore.

Pas sulmit të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA, kjo luftë u intensifikua tej mase dhe lufta kundër terrorizmit global u bë njëra ndër politikatat parësore të shumë shteteve kudo nëpër botë.

SHBA-ja, pas sulmit të 11 shtatorit, ndërmori shumë misione luftarake, sigurisht të përkrahura edhe nga fuqitë e tjera, sidomos në shtetet e lindjes së mesme, me të vetmin arsyetim për të luftuar organizatat terroriste dhe terroristët që organizoheshin dhe funksiononin në këto shtete, si dhe parandalimi i sulmeve të tjera terroriste, të cilët me ekzistencën e këtyre organizatave, në mënyrë të vazhdueshme paraqitnin kërcënim dhe rrezik serioz për mirëqenien e shteteve në përgjithësi, për jetët e njerëzve dhe të mirat materiale, por edhe kërcënim serioz të paqes botërore.

Është shumë shqetësues fakti se kohët e fundit, numri i sulmeve terroriste dhe sidomos në qendrat urbane, të frekuentuara nga një numër i madh njerëzish, është intensifikuar shumë, kështu që humbin jetën një numër i madh i njerëzve të pafajshëm.

Momentalisht, në arenën ndërkombëtare është shumë aktual konflikti i armatosur që po zhvillohet në Siri, midis grupeve të armatosura dhe forcave të pushtetit në krye me Bashar al-Assad-in.

Konflikti në Siri vazhdimisht shkon duke u përshkallëzuar, vazhdimisht kryen krime nga më të ndryshmet si vrasja dhe dëbimi i civilëve, shkatërrimi i qyteteve dhe vendbanimeve, skllavërimi dhe robërimi i civilëve, shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rekrutimi i fëmijëve dhe përfshirja e tyre në veprime luftarake, e shumë e shumë krime të tjera të cilat kryhen në mënyrë të vazhdueshme nga grupet e shumta terroriste që veprojnë në territorin sirian.

Bashkësia ndërkombëtare bën përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e masave të cilat mund të ishin një ndër zgjidhjet e mundshme për rivendosjen e paqes në Siri, për parandalimin e krimeve të mëtejshme dhe për të ndaluar vuajtjet e civilëve të pafajshëm sirianë. Mirëpo, fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite nuk ka ende një zgjidhje që do të përmirësonte situatën e mjerueshme në Siri. Gjendja humanitare e civilëve sirianë është e mjerueshme, kurse negociatat e paqes për Sirinë, të udhëhequra nga ndërmjetësuesi i OKB-së, Lankhedar Brahimi, janë në një rrugë pa krye, pra nuk shihet as edhe një dritë e vogël shpresëdhënëse për një zgjidhje të shpejtë të kësaj situatë kaotike, që momentalisht mbretëron në Siri.

Situata e ndërlikuar në Siri dhe krimet e shumta që janë duke u kryer në territorin e saj, sigurisht mund të ishin dhe të jenë objekt për një studim të thelluar, dhe sigurisht edhe për përgjegjësisë penale ndërkombëtare të autorëve të krimeve të tilla.

Edhe pse momentalisht GJPN-ja dhe asnjë gjykatë tjetër me karakter ndërkombëtar, nuk ka në juridiksionin e saj gjykimin e krimit të terrorizmit si krim të posaçëm penal ndërkombëtar, është pa dyshim i sigurt fakti se krime të tilla si dhe ata që i kanë kryer, në të ardhmen do të përgjigjen penalisht dhe do të dënohen. Sepse pavarësisht një fakti të tillë, shumica e veprimeve që ndërmerren nga organizatat terroriste dhe jo vetëm në Siri, por kudo nëpër botë, përfshihen në figurën e krimeve ndërkombëtare dhe futen te krimet që janë në juridiksion të GJPN-së, dhe pa dyshim do të duhet të procedohen nga kjo e fundit.

Përgjithësisht terrorizmi është një fenomen shumë dinamik, i cili ndryshon sipas prirjeve në përdorimin e terrorizmit me çka terrorizmi ndryshon paralelisht me instrumentet e dhunës dhe të komunikimit, duke bërë të ndryshojë edhe konteksti në të cilin vepron (Hide:12).

Në teori përmenden disa motive të cilat i shtyjnë grupet e caktuara kriminale të ndërmarrin akte terroriste si, p.sh. hakmarrja dhe shpagimi, frikësimi dhe çorientimi, kërkesat apo shantazhet politike, propaganda për futjen e frikës dhe për drejtimin e vëmendjes në një kah të caktuar, martirizimi nëpërmjet operacioneve vetëvrasëse si një rrugë drejt çlirimit shpirtëror, përdorimi i akteve të ndryshme terroriste me qëllim të eliminimit të forcave opozitare apo kundërshtare etj (Hide:15).

Gama e objekteve që mund të jenë cak i sulmeve terroriste është shumë e gjerë, por zakonisht si më shpesh të sulmuara në praktikë na paraqiten ato objekte të cilat frekuentohen nga një numër shumë i madh njerëzish, me qëllim që të shkaktohet një numër sa më i madh jetësh të humbura dhe dëme të konsiderueshme materiale.

Edhe për sa u përket subjekteve të cilat mund të paraqiten si kryes të mundshëm të akteve terroriste gama është shumë e gjerë dhe vështirë të kategorizohen në një ose dy grupe. Megjithatë studiuesit janë munduar të bëjnë një kategorizim të grupeve në etno-nacionaliste, separatiste ose irredentiste, grupe raciste dhe të ekstremizmit të djathtë, grupe revolucionare, të ekstremizmit të majtë dhe anarkiste, aktorë terroristë shtetëror, organizata kriminale që përdorin taktika terroriste, grupe me kauza specifike etj (Hide:15-16).

Përveç terrorizmit që kryhet nga individë dhe grupe të caktuara kriminale, kemi edhe terrorizmin shtetëror i cili kryhet nga bartës të funksioneve shtetërore. Për formën e terrorizmit shtetëror hezitohet të flitet shumë për arsye se shumë veprime të cilat ndërmerren nga bartës të funksioneve shtetërore edhe pse mund të manifestojnë ndonjërin prej formave të terrorizmit, por kur ato bartin në vete vulën dhe kinse të mbrojtjes së interesave shtetërore, me çka ato fshihen nga shtetet shpeshherë nëpërmjet një propagande

të fuqishme mediatike, bile shpeshherë viktimat e këtyre akteve shpallen fajtorë dhe kriminelë.

Prandaj kjo formë e terrorizmit është edhe më e rrezikshme sepse kryhet nga një aparat i forcës fizike i cili është i mirorganizuar dhe mundësia që këto akte të mbulohen dhe ata që i kanë kryer t'i ikin përgjegjësisë është shumë e madhe.

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përgjegjësia penale ndërkombëtare nënkupton përgjegjësi penale të personave në çfarëdo cilësie qofshin ata, shtetërore ose ushtarake, që kryejnë veprime të kundërligjshme, veprime që sipas dispozitave të së drejtës penale ndërkombëtare janë të inkriminuara dhe të sanksionuara si krime ndërkombëtare.

Në konsolidimin e nocionit të krimeve ndërkombëtare dhe të përgjegjësisë penale, ndikuan shumë faktorë të cilët luajtën një rol vendimtar në përcaktimin dhe në ngritjen në një nivel të pranueshëm për shtetet në bashkësinë ndërkombëtare.

Pranimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare nga ana e shteteve deri vonë ishte i papranueshëm dhe shumë i diskutueshëm. Pranimin e përgjegjësisë penale ndërkombëtare shtetet deri vonë e shihnin si heqje dorë nga sovraniteti i tyre i brendshëm dhe si lejim që brenda juridiksionit të tyre të brendshëm të veprojnë dikush tjetër. Shtetet deri vonë sovranitetin shtetëror e nënkuptonin si absolut dhe në kuadër të këtij sovraniteti ata mund të vepronin si të donin pa iu përgjigjur askujt. Me kalimin e kohës u zbeh kuptimi i sovranitetit absolut të shteteve, sidomos në çështjen e ushtrimit të këtij sovraniteti jashtë kufijve të territorit shtetëror, sidomos në raport dhe në ndërveprim me shtetet e tjera. Shteti si subjekt juridik është i pavarur dhe brenda territorit të tij ushtron sovranitetin, mirëpo shteti si i tillë, nuk mund të ekzistojë si subjekt i vetëm sepse në botë ka shumë shtete të tjera si subjekte juridike, të cilat gjithashtu kanë sovranitet të brendshëm brenda territorit të tyre, mirëpo ky sovranitet kufizohet në momentin kur gjatë ndërveprimit juridik të shteteve, këto sovranitete ndeshen. Dhe pikërisht për këtë arsye është e patjetërsueshme që të gjendet një kompromis, me qëllim që shtetet si subjekte juridike të bashkëpunojnë dhe të

bashkëveprojnë dhe që secili të gëzojë këtë sovranitet brenda pjesës së caktuar dhe në një masë të caktuar. Për arsyen se shtetet hynë në marrëdhënie juridike, ekonomike dhe në marrëdhënie tjera ndërmjet veti, është normale që midis tyre të lindin edhe konflikte. Tashmë për zgjidhjen e konflikteve në botën bashkëkohore janë konsoliduar shumë mjete dhe metoda që ndihmojnë shtetet që këto konflikte të zgjidhin në mënyrë paqësore. Mirëpo, edhe përkundër kësaj nuk do të thotë që edhe tani nuk fillohen lufta për zgjedhjen e tyre, por përparësia në krahasim me të kaluarën është se tani lufta shihet si mjet i fundit për zgjidhjen e tyre, dhe në rastin kur është shterur përdorimi i të gjitha mjeteve dhe metodave të tjera juridike-paqësore. Ky është një përparim, në krahasim me të kaluarën ku lufta perceptohej dhe pranohej si mjet i duhur dhe i vetmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve, e në të shumtën e rasteve ai përdorej edhe për realizimin e interesave ekonomike, politike e juridike kryesisht të shteteve të fuqishme të kohës.

Zhvillimi i luftërave shkaktonte pasoja të shumta, si humbje e jetëve të njerëzve, dëme të konsiderueshme materiale, epidemi të ndryshme, varfëri të skajshme të popullsisë e shumë dëme të tjera të cilat vështirë se mund të përmirësoheshin pa kaluar një kohë e gjatë. Si rezultat i pasojave të tilla shtetet filluan të vetëdijesohen në drejtim të kufizimit të luftërave me qëllim të parandalimit të pasojave të tilla katastrofale. Do të kishte qenë ideale, në qoftë se do të ekzistonte mundësia që luftërat të flakeshin fare nga praktika e veprimit të shteteve, por një ideal i tillë është vështirë të arrihet edhe në ditët e sotme, e aq më pak në të kaluarën, atëherë, u kërkuan zgjidhje të tjera që së paku të kufizoheshin ndodhi të tilla, ose së paku të kufizoheshin veprimet që kryheshin gjatë zhvillimit të këtyre luftërave. Si rezultat i këtyre qasjeve filluan të miratohen shumë dokumente juridike ndërkombëtare të

cilat kufizonin, ndalonin dhe sanksiononin ndërmarrjen e veprimeve të caktuara gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake.

Miratimi i dokumenteve të tilla ndërkombëtare si marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, konventa dhe traktate të ndryshme ndërkombëtare, që përmbanin dispozita për humanizimin e zhvillimit të luftërave, pati rol kyç edhe në ngritjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare të personave të cilët shkelnin dispozita të tilla dhe ndihmuan edhe në formulimin e nocioneve lidhur me krimet ndërkombëtare.

Shtrimi i përgjegjësisë penale ndërkombëtare, u bë pas përfundimit të LPB-së, ku fuqitë aleate me nënshkrimin e Traktatit të Paqes së Versajës, u zotuan se do të përgjigjen dhe do të ndëshkohen personat të cilët gjatë zhvillimit të LPB-së shkelën rëndë ligjet dhe zakonet e luftës. Një nismë e tillë dështoi sepse përgjegjësi kryesor për shkelje të tilla, Kajzeri i Gjermanisë, Vilhelmi II, u strehua në Holandë, e cila refuzoi ta ekstradonte, kurse në Gjykatën Supreme të Lajpcigut u zhvilluan disa procese gjyqësore kundër disa udhëheqësve ushtarakë gjermanë, ndaj të cilëve u shqiptuan dënime minimale, dënime që nuk u ekzekutuan kurrë. Mirëpo, pavarësisht dështimit të kësaj nisme, kjo shënoi një erë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe gjegjësisht në çështjen e vetë zhvillimit të luftërave si dhe në çështjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Aplikimi real i përgjegjësisë penale ndërkombëtare u bë pas përfundimit të LDB-së, ku me marrëveshjen e Londrës u vendos themelimi i Tribunalit të Nurembergut për gjykimin e kriminelëve nazistë, si dhe themelimi i mëvonshëm edhe i Tribunalit të Tokios. Këto dy Tribunale u themeluan për gjykimin e kriminelëve të cilët gjatë LDB-së, shkelën rëndë ligjet dhe zakonet e luftës, moment i cili përkon me përfundimin e periudhës së

mosndëshkimit të personave, të cilët gjatë zhvillimit të çfarëdo konflikti të armatosur, kryejnë veprime që janë të inkriminuara dhe të sanksionuara si krime ndërkombëtare.

Në Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios u zhvilluan shumë procese gjyqësore ndaj shumë të akuzuarve. Ndaj tyre u shqiptuan shumë dënime me burg dhe dënime me vdekje të cilat edhe u ekzekutuan.

Gjatë funksionimit të këtyre dy Tribunaleve, ato u sulmuan se ishin të njëanshme, sepse ishin themeluar vetëm nga fuqitë fitimtare të LDB, dhe se nuk kishin legjitimitet për të gjykuar, edhe nga arsyeja se krimet për të cilat zhvilloheshin gjykimet nuk ishin krime të parapara me ndonjë dokument legjitim dhe se me zhvillimin e këtyre gjykimeve shkelej një parim shumë i rëndësishëm i drejtësisë, *nullum crimen sine lege scripta, nulla poena sine lege scripta*, gjegjësisht se nuk ka krim pa ligj të shkruar dhe nuk ka dënim pa ligj të shkruar. Pretendimi për shkeljen e këtij parimi ishte edhe pretendimi kryesor i mbrojtjes, duke tentuar që pafajësinë e të akuzuarve ta dëshmojë duke u justifikuar me atë se të akuzuarit nuk kanë pasur njohuri se krimet për të cilat po akuzoheshin paraqisnin krime ndërkombëtare, sepse ato si të tilla nuk ishin të fiksuara në ndonjë ligj ose në ndonjë dokument tjetër ndërkombëtar. Sigurisht, tentativa për një arsyetim të tillë nuk mund të qëndronte nga arsyeja se edhe para themelimit të Tribunaleve të Nurembergut dhe Tokios në Statutet e të cilave rregullohej juridiksioni i tribunaleve për krime të tilla, ekzistonin edhe një mori dokumentesh juridike ndërkombëtare të cilat i ndalonin këto veprime e përveç asaj, edhe në shumicën e legjislacioneve penale ndërkombëtare, shumë veprime të cilat përbënin figurën e krimeve ndërkombëtare sanksionoheshin si veprime të kundërligjshme. Prandaj, ishte e pakuptimtë të besohej në pretendimet e tilla të mbrojtjes. Është i padiskutueshëm pranimi i faktit se këto tribunale gjatë funksionimit të tyre ndoshta

kanë pasur edhe të meta, mirëpo sërish rëndësia e tyre në vënien e themeleve të qëndrueshme për ngritjen e përgjegjësisë penale dhe për ndëshkimin e personave, që kryejnë krime të inkriminuara dhe të sanksionuara si krime ndërkombëtare, është e pamohueshme.

Këto dy tribunale u themeluan si të përkohshme dhe me arritjen e qëllimit për të cilin u themeluan ato pushuan së ekzistuari.

Zhvillimet në arenën ndërkombëtare janë shumë dinamike, sidomos në krijimin e shumë konflikteve të cilat zgjidheshin me mjete e metoda të shumta paqësore, por edhe nëpërmjet luftës. Ekzistonte vazhdimisht nevoja e domosdoshme për të patur një organ që do ishte përgjegjës për gjykimin dhe ndëshkimin e personave, kudo nëpër botë dhe në mënyrë të vazhdueshme kryenin krime ndërkombëtare. Kishte vazhdimisht iniciativa, por të pasuksesshme, për themelimin e një organi të tillë. Një zgjidhje e tillë nuk arrihej dhe kryesisht si rezultat i refuzimit të shteteve për ta bërë një gjë të tillë, sepse vërtet Tribunalet *ad hoc* të Nurembergut dhe të Tokios u themeluan dhe patën sukses në arritjen e qëllimit për të cilin u themeluan, po ato duke qenë se u krijuan si rezultat i një vendimi të cilin e morën fuqitë fituese të LDB-së, në njëfarë mënyre ishin si një zgjedhje e implementueshme për shtetet të cilave u përkisnin këta kriminelë.

Pas një periudhe të gjatë, pas përfundimit të punës së këtyre dy Tribunaleve, të krijuara pas LDB-së, u krijuan Tribunali i Hagës dhe i Ruandës, të cilat për dallim nga Tribunalet e Nurembergut dhe të Tokios, që u krijuan me anë të marrëveshjes, Tribunali i Hagës dhe i Ruandës u krijuan me anë të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Tribunali për ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, u

themelua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, si rezultat i alarmimit nga opinioni publik për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare, me ç'rast bashkësia ndërkombëtare dhe kryesisht OKB-ja, detyra parësore e së cilës ishte ruajtja e paqes në nivel botëror, nuk mundi dhe për më tepër edhe nuk duhej të mbetej e shurdhër dhe neutrale përkundrejt shkeljeve të tilla. Dhe meqë nuk ekzistonte një organ i domosdoshëm, që do të kishte juridiksion mbi krime të tilla, zgjidhja përsëri ishte konstituimi i një organi të ri, të cilit nga OKB-ja do t'i jepej juridiksion mbi krimet e pretenduara se ishin kryer në territorin e ish-Jugosllavisë.

Mbi të njëjtat parime, mbi të cilët u themelua TPNJ-ja, u themelua edhe Tribunali për Ruandën, për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e Ruandës dhe në vendet fqinje prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 1994.

Në këto dy Tribunale, që nga themelimi i tyre e deri më tani, u proceduan shumë raste kundër një numri të madh të akuzuarish, dhe u shqiptuan dënime të përshtatshme, shumica prej të cilave janë në ekzekutim e sipër. Meqë të dyja këto Tribunale, u themeluan si të përkohshme, parashihej edhe një periudhë kur ato duhej të përmbyllnin punën e tyre. Por meqë puna e tyre ishte shumë voluminoze dhe nuk kishte përfunduar ende, por nga ana tjetër funksionimi i mëtejshëm i këtyre dy Tribunaleve ishte shumë i shtrenjtë dhe joefikas, u parapa krijimi i Mekanizmit Ndërkombëtar për Tribunalet, i cili do të vazhdojë punët e mbetura të të dyja Tribunaleve, gjegjësisht të TPNJ-së dhe TPNR-së, dhe do të ketë efikasitet në përmbylljen e punës së mbetur dhe njëkohësisht edhe kosto më të ulët.

Tribunalet *ad hoc* të Hagës dhe të Ruandës luajtën një rol të rëndësishëm për përgjegjësinë penale ndërkombëtare, sepse themelimi dhe funksionimi i tyre konfirmoi edhe njëherë idenë e përgjegjësisë dhe të ndëshkueshmërisë të personave të cilët kryejnë veprime në

kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare penale. Ata do të përgjigjen dhe do të dënohen. Gjithashtu, krijimi i këtyre dy Tribunaleve kishte rol vendimtar në përforcimin e idesë së krijimit të një gjykate të përhershme e cila do ketë juridiksion për ndjekjen penale dhe gjykimin e personave të cilët në çfarëdo kohe dhe në çfarëdo vendi që do të kryejnë krime ndërkombëtare do të ndëshkohen.

Nevoja që gjykimi i personave që kryejnë veprime, të cilësuar si krime ndërkombëtare, të bëhet nga një institucion i pavarur ndërkombëtar ka lindur për arsye se për këto krime në të shumtën e rasteve gjykatat nacionale mund të mos jenë kompetente që të vendosin për më shumë arsye si, p.sh.: në rastin e ish-Jugosllavisë që për arsye të ndjeshmërisë së çështjes gjykatat vendore nuk kanë qenë në gjendje që në mënyrë të paanshme të gjykojnë personat e tillë, ose në rastin e Ruandës ku për shkak se vendi ka qenë në luftë civile, gjykatat nuk kanë poseduar kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar gjykime të përshtatshme për çështje të tilla të ndërlikuara.

Dhe pa dyshim në procesin e gjatë të konsolidimit të përgjegjësisë penale, krijimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është ngjarja e cila në mënyrë përfundimtare zgjodhi çështjen e përgjegjësisë penale ndërkombëtare. Me krijimin e GJPN-së, nuk është më e diskutueshme çështja e përgjegjësisë ose e mospërgjegjësisë të personave që kryejnë krime ndërkombëtare, por mund të jetë vetëm çështje kohe që kur dhe si personat e tillë do të dalin para drejtësisë dhe do të dënohen.

Në shtjellimin dhe analizimin e çështjes së përgjegjësisë penale ndërkombëtare, çështje shumë e rëndësishme dhe njëherit drejtpërsëdrejti e lidhur me përgjegjësinë penale ndërkombëtare, padyshim është çështja e inkriminimit që cilat veprime mund të konsiderohen si krime ndërkombëtare.

Në fillesat e konsolidimit të përgjegjësisë penale ndërkombëtare, çështje paksa e diskutueshme ka qenë çështja e përcaktimit se cilat veprime do të konsideroheshin si krime ndërkombëtare, por sidomos gjatë zhvillimit të gjykimeve në Tribunalin e Nurembergut, kjo ka qenë edhe argumenti kryesor me anë të të cilit është sulmuar legjitimiteti i funksionimit të Tribunalit.

Që nga fillimi i miratimit të dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare, me të cilat janë paraparë ndalimet e caktuara me qëllim të humanizimit të veprimeve luftarake, ka filluar inkriminimi ligjor i krimeve fillimisht të quajtura si krime lufte e më pastaj edhe ndarja dhe klasifikimi edhe në kategori të tjera krimesh, si krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, gjenocidi dhe krimin e agresionit. Në inkriminimin e veprimeve të tilla si të kundërligjshme, kanë kontribuar edhe Statutet e Tribunaleve *ad-hoc* si dhe Statuti i Romës me të cilin është konstituar Gjykata Penale Ndërkombëtare. Këto statute në mënyrë të detajuar kanë paraparë secilin nga veprimet që përbën krimet ndërkombëtare për të cilat këto Tribunale kanë pasur juridiksion. Gjithashtu edhe në Statutin e Romës në bazë të të cilit është themeluar dhe funksionon GJPN-ja, inkriminohen të gjitha veprimet të cilat përbëjnë secilin prej krimeve për të cilat ka juridiksion GJPN-ja.

Momentalisht krimet, të cilat parashihen në Statutin e Romës dhe për të cilat ka juridiksion GJPN-ja janë: krimin e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimin e agresionit.

Sigurisht se nga praktika e funksionimit të Tribunaleve dhe GJPN-së, të cilat kanë proceduar një numër të madh rastesh mund të nxjerrim konkluzione më të qarta lidhur me atë se në ç'mënyrë aplikohen dispozitat e së drejtës penale ndërkombëtare në raste konkrete, për cilat veprime individët mbajnë përgjegjësi penale ndërkombëtare, ku pa një

analizë të rasteve konkrete nuk mund të kemi një pasqyrë të plotë të të gjitha fakteve dhe rrethanave relevante e që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

Gjatë zhvillimit të luftës në Kosovë në vitet 98-99 u kryen shumë veprime të kundërligjshme, me të cilat u shkelën rëndë dispozitat e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe u shkelën të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në forma më të rënda. Për gjykimin e shkeljeve të tilla të së drejtës ndërkombëtare, kishte juridiksion TPNJ-ja. Pas zhvillimit të hetimeve në territorin e Kosovës, u ngritën shumë aktakuza kundër shumë udhëheqësve shtetërorë dhe ushtarakë serbë, u zhvilluan procese gjyqësore dhe u shqiptuan shumë dënime. Nga zhvillimi i hetimeve të tilla, prokuroria e TPNJ-së, ngriti aktakuza edhe ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën dyshimin se kanë kryer krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Ndër të akuzuarit e tjerë, nga radhët e UÇK-së, aktakuzë u ngrit edhe ndaj Ramush Haradinajt si dhe ndaj Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt.

Ata u akuzuan për 37 pika të përmbajtura në aktakuzë. Për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, me pretendimin nga ana e prokurorisë, se krimet e tilla të akuzuarit i kanë kryer në bashkëpunim kriminal.

Kur veprat penale kryhen në bashkim kriminal nga dy ose më shumë persona për arritjen e qëllimit të caktuar, atëherë ajo paraqet formë më të rëndë të veprës penale, e cila mbart në vete edhe shkallë më të lartë të përgjegjësisë penale.

Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ndaj të akuzuarve Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, nga ana e prokurorisë para Dhomës Gjyqësore të TPNJ-së, u paraqitën shumë prova dhe u propozuan dëgjimi i një numri të madh dëshmitarësh. Pas shqyrtimit të provave të ndryshme si dokumente, fotografi, skica të ndryshme, deklarata të dhëna me shkrim dhe gojore si dhe dëgjimi i dëshmimeve të pothuaj 100 dëshmitarëve, Dhoma

Gjyqësore nuk mundi të provojë fajësinë e dy të akuzuarve, Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj, për të gjitha pikat e pretenduara në aktakuzë, e aq më pak që veprat e tilla janë kryer në bashkëpunim kriminal të të akuzuarve për arritjen e një qëllimi. I akuzuari i tretë, Lahi Brahimaj, u gjet fajtor për dy pika të aktakuzës edhe për pikën 28: Torturë si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe për pikën 32: Torturë dhe trajtim mizor si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës, dhe Dhoma Gjyqësore e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 6 vjetësh. Lahi Brahimaj, nga ana e Dhomës Gjyqësore të TPNJ-së, u shpall i pafajshëm për të gjitha pikat e tjera të aktakuzës, po dhe nuk u provua se veprat për të cilat u shpall fajtor janë kryer si rezultat i bashkëpunimit kriminal, për arritjen e një qëllimi.

Aktgjykimi i tillë u apelua nga prokuroria, deri në Dhomën e Apelit të TPNJ-së, nga e cila kërkoi që lëndën veç më të vendosur ta kthente sërish në rigjykim para Dhomës Gjyqësore, sepse gjatë marrjes së vendimit nga ana e Dhomës Gjyqësore prokuroria nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për të ftuar edhe dy dëshmitarë, të cilësuar nga prokuroria si shumë të rëndësishëm.

Dhoma e Apelit pranoi kërkesën e prokurorisë dhe e ktheu çështjen në rigjykim para Dhomës Gjyqësore, vendim i cili befasoi opinionin publik, sepse në historinë 18 vjeçare të funksionimit të TPNJ-së, nuk kishte ndodhur që një vendim me të cilin të akuzuarit janë liruar, të rrëzohet nga ana e Dhomës së Apelit.

Pas dhënies së një vendimi të tillë nga Dhoma e Apelit, paraqitet dilema se në këtë rast TPNJ-ja shkeli dy parime shumë të rëndësishme të së drejtës dhe gjegjësisht parimin *non bis in idem dhe res iudicata*, parime të cilat parashihen edhe në Statutin e TPNJ-së. Në këtë rast TPNJ-ja, duke pranuar kërkesën e prokurorisë dhe kthimin e çështjes në rigjykim, shkeli parimet bazike të drejtësisë për çështjen e gjykuar dhe për moslejimin e procedimit të

ri për çështjen e njëjtë, sepse Dhoma e Apelit e TPNJ-së e ktheu çështjen në rigjykim jo sepse kishte ndonjë arsye të qëndrueshme për ta bërë një gjë të tillë, por duke marrë parasysh pretendimin e prokurorisë për moslejimin e kohës së mjaftueshme nga ana e Dhomës Gjyqësore për thirrjen dhe dëgjimin e dy dëshmitarëve, të cilësuar nga prokuroria si shumë të rëndësishëm. Sepse në nenin 26 të Statutit të TPNJ-së thuhet se një aktgjykim mund të rishqyrtohet kur zbulohet një fakt i ri, i cili nuk njihej në kohën e zhvillimit të procesit në Dhomat Gjyqësore ose në Dhomën e Apelit, dhe i cili mund të kishte qenë faktor përcaktues në marrjen e vendimit, në raste të tilla personi i gjykuar ose prokurori mund t'i bëjë kërkesë Tribunalit për rishqyrtim të aktgjykimit.

Prandaj përveç tjerash si dhe duke pasur parasysh periudhën kohore maratonë, në të cilën u zhvillua procesi gjyqësor ndaj të akuzuarve, një pretendim i tillë i prokurorisë nuk mund të ishte i qëndrueshëm.

Një çështje tjetër e diskutueshme dhe kontraverse në tërë procesin e zhvilluar ndaj Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, ishte zhvillimi i procedurës në bazë të rigjykimit. Derisa mbrojtja e të akuzuarve pretendonte se gjykimi i pjesshëm duhet të kufizohet vetëm në dëgjimin e dy dëshmitarëve, për të cilët edhe është kthyer çështja në rigjykim, prokuroria pretendonte se procedura e zhvilluar në bazë të rigjykimit, ishte procedurë e re në të cilën mund të thirreshin edhe dëshmitarë të tjerë dhe të ekzaminoheshin edhe prova të reja. Si rezultat i një kontesti të tillë, Dhoma e Apelit sërish vendosi në favor të prokurorisë, kur gjatë zhvillimit të procedurës në bazë të rigjykimit u dëgjuan edhe 56 dëshmitarë.

Për pikat e aktakuzës, për të cilat u kërkua rigjykimi i pjesshëm, dhe pika për të cilat edhe me vendimin e parë të tre të akuzuarit ishin shpallur të pafajshëm, edhe pas përfundimit të

procedurës në bazë të rigjykit, Dhoma Gjyqësore nuk mundi të provojë për asnjërin të akuzuar fajësinë lidhur me pikat e akuzës, me ç'rast të tre të akuzuarit i shpalli të pafajshëm, për të gjitha pikat e akuzës për të cilat u zhvillua rigjykimi i pjesshëm.

Sidoqoftë, tanimë ky proces ka marrë epilogun përfundimtar, me të cilin dy herë u konfirmua pafajësia e të akuzuarve Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj, dhe njëherit siç thanë shumë njohës të marrëdhënieve ndërkombëtare dy herë u konfirmua lufta e drejtë e UÇK-së dhe e popullit të Kosovës për një ideal të vetëm - lirinë.

Duke qenë se e drejta ndërkombëtare penale është një disiplinë relativisht e re shkencore, normat e së cilës janë të përmbajtura në shumë dokumente juridike ndërkombëtare, mangësi kryesore e së cilës është mosekzistimi i në akti të unifikimit të normave të tilla. Vënia në shesh e nocionit të përgjegjësisë penale individuale të kryesve të veprimeve të kundërligjshme dhe ngritja e këtij nocioni në nivel të pranimit të saj nga shumica e shteteve në arenën ndërkombëtare, padyshim se është rezultat i shumë faktorëve të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim, por para se gjithash janë tribunalet ad-hoc dhe GJPN-ja, të cilat mundësuan aplikimin real të kësaj përgjegjësie, ku përfundimisht përgjegjësia e tillë u fiksua dhe u garantua me krijimin e GJPN-së. Edhe përkundër kësaj, ende ka shumë shtete të cilat nuk e njohin dhe nuk e pranojnë përgjegjësinë penale ndërkombëtare, për çka flet edhe fakti se ende shumë shtete nuk e kanë miratuar dhe nuk janë palë të Statutit të Romës, e as me ndonjë akt tjetër nuk e kanë pranuar juridiksionin e GJPN-së, dhe në këtë kontekst janë interesat e caktuara politike që i shtyjnë shtetet të kenë një qëndrim të tillë refuzues ndaj GJPN-së.

REKOMANDIME

- *Reformimi i sistemit gjyqësor dhe organeve të hetuesisë në shtetet palë të Statutit të Romës si dhe atyre që kanë pranuar juridiksionin e GJPN-së, në mënyrë që të jenë të afta të zhvillojnë hetime dhe gjykime penale komplekse të llojit të krimeve ndërkombëtare.*

Gjykata penale ndërkombëtare si institucion i cili në nivel ndërkombëtar garanton hetimin dhe gjykimin e kryesve të cilët në çfardo vendi kryejnë veprime të cilat janë në kundërshtim me rregullat dhe normat e së drejtës ndërkombëtare penale, nuk do të mundëj realisht të funksionojë, nëse të gjitha rastet që ndodhin kudo nëpër botë, t'i procedojë vetë. Prandaj me Statutin e Romës me të cilin rregullohen statusi, veprimi, organizimi etj., të GJPN-së, është paraparë që juridiksioni i saj të jetë subsidiar, çka nënkupton se vetëm në rastet kur sistemi juridik nacional i një vendi të caktuar, për çfardo arsye ose rrethane nuk është në gjendje të zhvillojë hetim dhe gjykim për krime ndërkombëtare, atëherë GJPN-ja të ndërmarrë ndjekjen. Mirëpo, që realisht të funksionojë kjo, duhet që sistemet juridike nacionale të posedojnë kapacitetet e nevojshme që të mund të zhvillojnë gjykime të tilla komplekse, gjë e cila në shumë vende duket se është vështirë e arritshme. Nëse për shembull shohim rastin e Republikës së Maqedonisë, e cila është shtet-palë në Statutin e Romës, të cilin e ka ratifikuar në v.2002, në bazë të cilit akt është themeluar dhe funksionon GJPN-ja, atëherë presupozohet se nëse Maqedonisë i paraqitet një rast i tillë i cili duhet të procedohet nga gjykatat e vendit, të mundet të zhvillojë një gjykim të tillë. Mirëpo, nëse vështrojmë gjendjen reale në të cilën ndodhet sistemi gjyqësor në Maqedoni, atëherë vijmë menjëherë në përfundim se gjykatat e Maqedonisë nuk do të mundnin që në mënyrë objektive dhe të drejtë të zgjidhnin rastet e tilla. Sistemit gjyqësor në Republikën e

Maqedonisë i nevojitet një reformë thelbësore me qëllim të evitimit të shumë mangësive, dhe vetëm pastaj mund të flasim për çështje tjera më komplekse e që kanë të bëjnë me plotësimin e standardeve ndërkombëtare. Sepse me një sistem gjyqësor të politizuar dhe subjektiv, i cili nuk mund të përmbush standardet elementare të funksionimit të drejtë të një sistemi juridik në një shtet të së drejtës, as që mundemi të diskutojmë për çështje tjera. Në Maqedoni ende kemi shumë procese gjyqësore që janë politikisht të montuara, shumë gjykatës dhe prokurorë janë të ndikuar nga politika në veprimin e tyre në shumë çështje, mangësi të cilat hedhin dyshime serioze lidhur me funksionimin e tërësishëm të sistemit gjyqësor, gjë e cila është pasqyruar edhe në rekomandimet e Këshillit të ministrave të BE-së për Maqedoninë, ku në vazhdimësi në të gjitha rekomandimet, sistemi gjyqësor është njëra nga fushat që kritikohet më së shumti. Madje kemi rastin edhe më eklatant të formimit të Prokurorisë Speciale për t'i hetuar rastet kriminale të cilat dolën në shesh si rezultat i publikimeve të përgjimeve, gjë e cila është një fakt shtesë në pohimin se sa organet e hetuesisë në R.M. janë të politizuara dhe jo objektive.

Sigurisht se përmbushja e kërkesave të tilla në drejtim të reformimit të sistemit gjyqësor në pajtim me standardet ndërkombëtare juridike kërkon një impenjim më të thellë në më shumë sfera të organeve hetuese dhe gjyqësorit, gjë e cila sigurisht se nuk është e paarritshme, por mbi të gjitha nevojitet së pari vullneti politik i subjekteve të cilët do të duhet të jenë bartës të ndryshimeve të tilla, me qëllim që të arrihet rezultati i kërkuar.

Funksionimi i rregullt i të gjitha elementeve që përbëjnë një tërësi, direkt ndikon në dhënien e rezultateve më të mira dhe në suksesin e përgjithshëm të një tërësie. Prandaj sistemet juridike nacionale dhe në veçanti sistemi gjyqësor në vendet e ndryshme, është pjesë e rëndësishme e cila gjithashtu ka efekt real në suksesin e punës së GJPN-së,

aplikimit më efikas të normave të së drejtës ndërkombëtare, si dhe në forcimin e parimit të sundimit të së drejtës në arenën ndërkombëtare. Prandaj, në drejtim të funksionimit më efikas të GJPN-së, ndikon shumë edhe përmirësimi i praktikave të hetimit dhe gjyqimit në shtetet anëtare të Statutit të Romës, sepse një gjë e tillë ka ndikim direkt në lehtësimin e barrës që ka GJPN-ja në drejtim të hetimit dhe gjyqimit të kryesve të krimeve ndërkombëtare, si dhe në vendosjen e standardeve juridike ndërkombëtare lidhur me përgjegjësinë penale ndërkombëtare.

- *Bashkëpunimi juridik dhe politik i shteteve me GJPN-në dhe krijimi i një mekanizmi ndërkombëtar efikas për bashkëpunim të detyrueshëm të shteteve.*

Gjatë funksionimit të Tribunalit të Hagës njëra ndër peripecitë që më shumti haste gjatë punës së tij ishte pikërisht bashkëpunimi i këtij Tribunali me shtetet e ish-RSFJ-së, qasja e tillë ishte posaçërisht e theksuar në lidhje me bashkëpunimin e Serbisë me Tribunalin, po sigurisht që probleme kishte edhe në vendet tjera por kryesisht në lidhje me dëshmitarët të cilët shpeshherë refuzonin të dëshmonin.

Deri më tani, gjatë funksionimit të GJPN-së, kanë ndodhur raste kur të akuzuar të GJPN-së, kanë lëvizur lirisht nëpër vendet që janë palë të Statutit të Romës por edhe në shtetet jo palë, por të cilat në bazë të rregullave të përgjithshme juridike ndërkombëtare e kanë për obligim të bashkëpunojnë me shtetet, organizatat dhe institucionet e ndryshme në dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare, sepse përveç përmbushjes së atyre kështesave formale procedurale nga ana e një shteti për bashkëpunimin dhe dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare, duhet të ekzistojë edhe vullneti i shtetit për një gjë të tillë, e para se gjithash vullneti politik. Në këtë kontekst mund të përmendim rastin e dështimit në arrestimin e të dyshuarit Messrs Omar Hassan Ahmad Al Bashir, që nga v.2005 kur rasti i Sudanit nga ana

e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i është referuar zyrës së Prokurorit të GJPN-së. Ai në mënyrë të vazhdueshme udhëton nëpër shtete të ndryshme qofshin ato shtete-palë të Statutit të Romës ose jo. Prandaj, zyra e Prokurorit të GJPN-së, në raportin e Dhjetorit të v.2016 adresuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i bën thirrje që urgjentisht të merren masa me qëllim nxitjen e shteteve që në këtë drejtim të bashkëpunojnë plotësisht me GJPN-në.¹¹¹ Prandaj, e patjetërsueshme është krijimi i një mekanizmi efikas me qëllim të evitimit dhe parandalimit të paraqitjes së dukurive të tilla, gjë e cila në masë të konsiderueshme do të kontribonte në rritjen e efikasitetit të punës së GJPN-së, e cila gjithashtu do të kontribonte edhe në shumë sfera tjera në drejtësinë penale ndërkombëtare në përgjithësi.

- *Miratimi i ligjeve të posaçme brenda shteteve nacionale, ku me anë të mekanizmit ligjor të brendshëm shtetet do të detyrohen të bashkëpunojnë me GJPN-në*

Në këtë kontekst po përmendim rastin e Republikës së Maqedonisë e cila në v.2007 miratoi Ligjin për bashkëpunimin midis Republikës së Maqedonisë dhe Tribunalit të Hagës, me të cilin rregulloheshin obligimet, kushtet dhe lloji i bashkëpunimit. Në lidhje me bashkëpunimin me GJPN-në Maqedonia nuk ka të miratuar ndonjë ligj të posaçëm, përveç se ka miratuar Statutin e Romës në bazë të të cilit edhe funksionon GJPN-ja, dhe kur një konventë ose dokument tjetër ndërkombëtar miratohet në parlamentin e R.M-së, bëhet pjesë përbërëse e legjislacionit të brendshëm dhe i detyrueshëm për aplikim. Por do të ishte mirë që shtetet të cilat janë palë e Statutit të Romës përveç kësaj të miratonin edhe Ligj të posaçëm i cili në mënyrë të detajuar do të rregullonte këtë problematikë, e cila sigurisht se

¹¹¹ Twenty-fourth report pursuant to para. 8 of UN Security Council Resolution (UNSCR) 1593, 13 December 2016, https://www.icc-cpi.int/itemsDocuments/161213-otp-rep-24-darfur_Eng.pdf (shikuar më 10.03.2017).

do ndikonte pozitivisht në ndryshimin e praktikës së mosbashkëpunimit të shteteve me GJPN-në.

- *Përfshirja e krimit të terrorizmit në juridiksion të GJPN-së*

Në literaturë përmendet edhe terrorizmi si krim i veçantë ndërkombëtar krim që në vetvete përmban shumë elemente të cilat nëse kryhen në një kontekst të caktuar mund të cilësohen edhe si krime që përfshihen në juridiksionin e GJPN-së.

Në rastet kur veprime të caktuara terroriste kryhen gjatë zhvillimit të konfliktit të armatosur gjegjësisht ndërmarrja e veprimeve dhe kërcënimeve me dhunë, me qëllim përhapjen e terrorit ndaj popullsisë civile, atëherë këto veprime do të konsiderohen si nënkategori e krimeve të luftës.

Në Statutin e Romës për GJPN-në, krimi i terrorizmit si krim i veçantë ndërkombëtar nuk përfshihet në juridiksionin e GJPN-së, përveçse në rastet kur aktet terroriste kryhen në rrethana të tilla, të klasifikueshme në ndonjë nënkategori të krimeve të luftës ose krimeve kundër njerëzimit. Do të ishte mirë që në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe krimi i terrorizmit të përfshihet në juridiksionin e GJPN-së, si një gjykatë e përhershme e cila ka juridiksion të gjykojë krimet të cilat shkaktojnë dëme dhe pasoja të përmasave të mëdha, ndjekja dhe gjykimi i të cilave nuk parashkruhet. Edhe pse në sistemet juridike nacionale të shteteve parashihen masa efikase për parandalimin dhe luftimin e krimit të terrorizmit, prapëseprapë për një kategori të tillë të rrezikshme të krimit, do të ishte më e preferueshme të përfshihej edhe në juridiksionin e GJPN-së, gjë e cila do të jepte siguri edhe më të madhe në ndjekjen dhe gjykimin e atyre që kanë kryer krime të kësaj natyre, me pasoja katastrofale për mbarë shoqërinë. Krimi i terrorizmit sidomos është bërë shumë aktual në dhjetëvçarët e fundit, ku në masë të madhe është shpeshtuar ndërmarrja e akteve terroriste në mbarë botën, me

çka përveç të tjerash është edhe shumë shqetësues fakti se shtete të caktuara bëhen streh e akteve të tilla, i mbrojnë dhe i strehojnë ata që i kanë kryer këto akte të tmerrshme. Edhe më i rrezikshëm është terrorizmi i cili kryhet nga vetë shtetet ose bartësit e funksioneve më të larta shtetërore, sepse kjo formë e kryerjes jo vetëm që nuk ndëshkohet, por për më tepër kryesit mburren me veprimet e tyre, ku mundësia e fshehjes dhe e kamuflimit të këtyre veprimeve është shumë e madhe. Kjo formë e veprimtarisë kriminale është edhe më e rrezikshme sesa krimet e tjera që sanksionohen nga GJPN-ja, për faktin se këto sulme kryhen në mënyrë qyqare duke i sulmuar viktimat në mënyrë të papritur, për dallim nga llojet e krimeve të tjera të cilat pa dyshim janë gjithashtu shumë të rrezikshme, por që në të shumtën e rasteve kryhen në kontekst lufte ose gjatë një konflikti të armatosur, ku sado pak viktimat e këtyre krimeve janë të parapërgatitur në njëfarë forme, le të themi ndoshta psikologjikisht dhe mundësia e mbrojtjes nga sulme të tilla është pak më e madhe, p.sh. duke ikur për strehim diku në ndonjë vend më të sigurt, ndoshta edhe duke rezistuar etj., në krahasim me sulmet terroriste ku mundësia për t'u mbrojtur nga sulmet e tilla si për shtetet, ashtu edhe për njerëzit, është e barabartë gati me zeron. Prandaj duke pasur parasysh rrethanat të tilla është më se e nevojshme që ky lloj i krimit të luftohet në nivel ndërkombëtar duke siguruar një organ kompetent dhe të përhershëm, që do të kishte kompetencë luftimin dhe ndjekjen e atyre që kryejnë krimin, i cili pa dyshim, duke pasur parasysh intensitetin e shpeshtuar të këtyre veprimeve, kohët e fundit sigurisht se do të ketë një gamë shumë të gjerë të rasteve që do të procedohen.

- *Kodifikimi i normave të së drejtës penale ndërkombëtare*

Me Statutin e Romës në bazë të të cilit funksionon GJPN-ja janë të rregulluara të gjitha çështjet me rëndësi në mënyrë që ajo të mundet të ushtrojë juridiksionin e saj mbi krimet

ndërkombëtare dhe subjektet-kryesit e krimeve të tilla, e gjithashtu numërohen edhe burimet juridike ku GJPN-ja mund të bazojë vendimet gjatë punës së vet. Pavarisht kësaj, do të ishte mirë të bëhej kodifikimi i normave juridike penale ndërkombëtare sepse me anë të kodifikimit do të sigurohej një saktësi më e madhe e normave juridike që vlejnë, do të eliminohen normat e vjetëruara, sqarohen tekstet e paqarta, pajton normat kontradiktore dhe i sistematizon në një tërësi të ligjeve operative (Y.A.Korovin y otros, 1963:26), e cila do të paraqiste edhe një garancion shtesë në sigurinë juridike të subjekteve të cilët akuzohen dhe gjykohen nga GJPN-ja.

- *Respektimi në masën e duhur të parimit të gjykimit në kohë të arsyeshme*

Në Rregullat e procedurës dhe provave, në bazë të cilave zhvillohet procedura para GJPN-së gjegjësisht në nenin 101 parashihet që gjatë zhvillimit të procedurës, Gjykata do të ketë parasysh nevojën e lehtësimeve procedurale me qëllim zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurës, por duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë të drejtat e mbrojtjes dhe viktimave. Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit në procedurë duhet të përpiqen të veprojnë sa më shpejtë dhe brenda afatit të urdhëruar nga gjykata.

Nga praktika e funksionimit të GJPN-së dhe nga rastet që janë në procedim para GJPN-së e të cilat i kemi shtjelluar më sipër në këtë punim, shohim se ky parim nuk respektohet pothuajse fare, ku sigurisht se një praktikë e tillë është e determinuar nga komponentë të ndryshëm, nga të cilët varet zhvillimi dhe përfundimi i gjykimit në kohë të arsyeshme, si psh. mosbashkëpunimi i shteteve në dorëzimin e të kërkuarve nga GJPN-ja, paraqet një pengesë bazike, ngaqë pa prezencë të personit të dyshuar nuk mund të zhvillohet procedura para GJPN-së. Prandaj është e domosdoshme që të ndërmerren masa në drejtim të përmirësimit të kësaj gjendjeje, ngaqë shpeshherë drejtësia e vonuar mundet që edhe mos të

arrijë qëllimin përfundimtar gjegjësisht dhënien e dënimit meritor kryesit, gjë e cila paraqet satisfaksion moral për viktimat, por njëkohësisht është edhe premisë në drejtim të sigurimit të sundimit të së drejtës.

Literatura

Burimet parësore

Statutet dhe dokumentet ligjore:

- Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.
- Statuti i TPNJ-së.
- Statuti i TPNR-së.
- Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës, “Edukim për drejtësi”, Revistë Juridike për drejtësi, nr.1, Tiranë, qershor 2002.
- “Konventat europiane për shtypjen e terrorit”, Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për drejtësinë, botim i qendrës së publikimeve zyrtare, qershor 2010.
- “The Charter and Judgment of the Nürnberg Tribunal, History and Analysis”, Memorandum submitted by the Secretary-General, United Nations, General Assembly International Law Commission Lake Success, New York, 1949.
- Yearbooks of the International Law Commission, 1950, Volumes II, “Documents of the second session including the report at the Commission to the General Assembly”, United Nations, New York, 1957.
- “Principles of International Law Recognized in the Charter of the Nürnberg Tribunal and in the Judgment of the Tribunal”, UN, 1950.
- Yearbooks of the International Law Commission, 1950, Volumes II, “Documents of the second session including the report at the Commission to the General Assembly”, United Nations.

- International Law Commission, Document A/CN.4/5, “The Charter and Judgment of the Nürnberg Tribunal, History and Analysis”: Memorandum submitted by the Secretary-General, Formulation of the Nürnberg Principles.
- “Manual i TPNJ-së mbi praktikat e zhvilluara”, përgatitur së bashku me UNICRI-në si pjesë e një projekti për të ruajtur trashëgimin e TPNJ-së, 2009.

Burimet dytësore – autorë të huaj dhe vendas

- Askin,K. “War Crimes Against Women:Prosecution in International War Crimes”, Tribunals Martinus Nijhoff, 1997.
- Aldrich,G.H. “Jurisdiction of the International Criminal for the Former Yugoslavia”, (1996) 90 AJIL 64.
- Cassese,A. “International Criminal Law”, originally published in English in 2003, Oxford University Press, përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedone nga Vesna Kostovska, version në gjuhën maqedone, shoqëria aksionere për botimin e titujve shkollorë dhe materialeve tjera edukative PROSVETNO DELLO, Shkup, shtypi, shtypshkronja Kosta Abrash, Ohër.
- Dixon,R. “Developing International Rules of Evidence for the Yugoslavia and Rwanda Tribunals” (1997), 7 Transnafl L. & Contemp, Probs.81.
- Dimitrijeviç,V., Hazdi-Vidanoviç,V., Jovanoviç,I., Markoviç,Z., Milanoviç,M., “Haske Nedoumice - poznato i nepoznato o medjunarodnom krivicnom tribunalu za bivsu Jugoslaviju”, Beogradski Centar za ljudski prava, Beograd, 2013.
- Dugard,J. &Wyngaert,Ch., “International criminal law and procedure”, Aldershot,1996.

- Green, L.C., “Superior Orders in National and International Law” (Sijthoff,1976).
“The Contemporary Law of Armed Conflict”, Manchester University Press, 1993.
- Grey,K., “International Law and the Use of Force”, Oxford University Press, 2008.
- Gruda,Z., “E drejta ndërkombëtare publike”, botim i plotësuar dhe i përmirësuar, Prishtinë, 2007.
- Murphy,D.S., “Principles of International Law”, Professor of Law, George Washington University, © 2006 Thomson/West 610 Opperman Drive P.O.Box 64526 St.Paul, përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedone nga Marija Krakutovska, botues Ars Lamina, Biblioteka Nacionale Universitare, “ Shën Kliment Ohridski”, Shkup.
- McCorquodale,R. & Dixon,M., “Cases & Materials on International Law”, përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedone nga Vasil Xherkovski, Biblioteka Nacionale Universitare, “ Shën Kliment Ohridski”, Shkup Datapons, 2010.
- Malekian,F., “International Criminal Law – The Legal and Critical Analysis of International Crimes”, Volume I and II, Uppsala, 1991, Printed in Sweden by Borgstroms Tryckeri AB, Motala.
- McKeown,T., “The Nurnberg Trial: Procedural due process at the International Military Tribunal”, Article submitted as a poirt of LLD (Haus) programme at Victoria university of Washington, 2014.
- Lopiçiç Jançiç,J., “Anali na pravnog fakulteta u Beogradu”, godina LIX, 2/2011, f. 383, prof. Albert Vajs i Nirnberski proces.

- Kittichaisaree,K., “International Criminal Law”, 2001, originally published in English 2001, Oxford University Press, përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedone nga Mirjana Burazer dhe Dimitar Simonovski, Tabernauka, 2012.
- Shaw,M.N., “International Law, 2009, Prosvetno Delo on Macednian translation, Copyright © M.N.Shaw 2008, Cambridge Universty Press, Shoqëria aksionere për botimin e titujve shkollorë dhe materialeve tjera edukative PROSVETNO DELLO Shkup, shtypshkronja NAPREDOK, Tetovë.
- Kambovski,V., “E Drejta Ndërkombëtare Penale”, titulli original Меѓународно казнено право, Prosvetno Dello, Shkup,1998.
- Huet,A. & Koering-Joulin,R., “Droit penal internacional”, Depot legal, 1 edition:1994 3, edition mise a jour:2005, septembre©Presses Univeritaires de France, 1994 6, avenue Reille, 75014 Paris, përkthyer nga gjuha franceze në gjuhën maqedone nga Daniella Donova, Biblioteka Nacionale Universitare, “ Shën Kliment Ohridski”, Shkup Ars Lamina, 2013.
- Hill,Ch. & Smith,M., “International Relations and the European Union”, Oxford Universitz Press, 2011, përkthyer në gjuhën maqedonase nga Tatjana Petrushevska, Ars Lamina, Shkup, 2013.
- Viotti,P.R. & Kauppi,M.V., “International Relations and World Politics”, përkthyer në gjuhën maqedonase nga Biljana Stefanovska, Akedemski peçat, Shkup, 2009.
- Y.A.Korovin y otros, Derecho Internacional publico, Mexico, D.F., 1963.
- Waltz,K.N., “Theory of International Politics”, McGraw-Hill, Inc., përkthyer nga gjuha angleze nga Dragan Jakimovski, MAGOR, Shkup, 2008.

Faqe interneti:

- <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>.
- www.unictr.org/eu/tribunal
- www.juridiku.weebly.com.
- www.idmalbania.org Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- <http://legal.un.org/ilc/documentation>.
- http://crimeofaggression.info/documents/6/1950_Nuremberg_Principles.pdf.
- http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/english/ilc_1950_v2.pdf.
- <http://www.un.org/law/ilc/index.html-website>.
- http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/manual_develop ed_practices/icty_manual_on_developed_practices_alb.pdf.
- <http://www.icty.org/sections/LegalLibrary>.
- www.unictr.org.
- http://www.unictr.org/sites/unictr.org/files/legal-library/100131_Statute_en_fr_0.pdf.
- www.slideshare.net.
- www.unmict.org/sites.
- [http://www.unmict.org/sites/default/files/documents/101222_sc_res1966_statute_en .pdf](http://www.unmict.org/sites/default/files/documents/101222_sc_res1966_statute_en.pdf).
- www.unictr.org/sites/unictr.
- www.icc-cpi.int/en_menus/icc/about.
- http://www.icccpi.int/en_menus/icc/legal%20texts%20and%20tools/official%20journal/Pages/rome%20statute.aspx, Entry into Force: 01.07.2002, Source: UNDCPEICC, Adoption: 17.07.1998.
- www.icc-cpi.int/en_menus/icc/situations.
- <https://sq.wikipedia.org>.